KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport për auditimin e ushtruar në "Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE
"MBI PËRPUTHSHMËRINË E VEPRIMTARISË SË AKTIVITETIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE"

P Ë R M B A J T J A

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....2
II.HYRJA.....10
III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT.....14
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET 15
IV.1. Mbi funksionimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.....15
IV.2.Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, treguesit dhe qëndrueshmëria financiareve.....25
IV.3. Mbi organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese të shoqërisë Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....46
IV.4. Mbi organizimin e mbikëqyrjes që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare të mbikëqyrura: licencim, monitorim, raportim dhe inspektim në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.....52
IV.5. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.....104
V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT.....126
VI. ANEKSE 127

I. PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi përputhshmërinë e veprimtarisë së Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare me kriteret e vlerësimit përfshirë ligjet, rregulloret, udhëzimet që lidhen dhe ndikojnë në rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit financiar jo bankar dhe operatorëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë sektor, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 2019 dhe 2020 duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me:

- Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, treguesit dhe qëndrueshmëria financiareve;
- Mbi organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese të shoqërisë Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave;Mbi organizimin e mbikëqyrjes që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare të mbikëqyrura: licencim, monitorim, raportim dhe inspektim në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

I.b Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

GJETJA	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi janë konstatuar mangësi nisur nga kriteret e pozicionit sipas përshkrimeve të punës dhe emërimeve. Në referim të rregullores për marrëdhëniet e punës të punonjësve në AMF, specialistët,nisur nga kriteret e pozicionit sipas përshkrimeve të punës kërkojnë shtesë dhe një përvojë pune 2 vjeçare, ndërsa personat që kandidojnë për pozicionin Drejtor Drejtorie duhet të kenë përveç kërkesave të tjera edhe të paktën 5 vite eksperiencë në institucion, ndërsa personat që kandidojnë për Drejtor Departamenti përveç kërkesave të tjera duhet të kenë edhe të paktën 7 vite eksperiencë pune. Rregullorja për marrëdhëniet e punës gjithashtu në një nen tjetër të saj parashikon gjithashtu kriteret për pozicionin e kryespecialistit ku kërkon përvojë pune në institucion mbi 6 vjet. Rregullorja e marrëdhënieve të punës ka një kontradiktë ku pozicioni i kryespecialistit ka kritere shumë më të forta dhe më të mëdha plotësimi se ai i Drejtorit edhe pse në gradën e organikës dhe në nivelin e pagës është në rang më të ulët se ai i drejtorit.	*(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*		Nga ana e AMF të kryhen ndryshimet në rregulloren për marrëdhëniet e punës punonjësve në AMF të miratuar me vendimin e bordit nr. 170 datë 14.08.2019, sipas pozicioneve të punës duke rishikuar sipas shkallës hierarkike kriteret për rekrutim/punësim në harmonizim me kompetencat/detyrat përgjegjësitë sipas pozicionit dhe nivelit të përcaktuar të shpërblimit për këto pozicione.
2.	Konstatohenmangësi gjatë procedurave të planifikimit i cili kryesisht realizohet në bazë të eksperiencës dhe pritshmërisë realizimit të treguesve dhe jo i dokumentuar plotësisht e rakorduar në përfshirjen e të gjithë treguesve dhe të dhëna më të plota:për treguesit sipas nivelit të primeve të shkruara bruto për shoqëritë e sigurimit, për kontribuuesit dhe	*(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*		Drejtoritë përgjegjëse të planifikimit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiar të rrisin bashkëpunimin për hartimin e treguesve ekonomiko financiarë, duke marrë edhe informacione shtesë nga institucione të tjera dhe tregu i sigurimeve e dokumentuar e rakorduar ato sipas treguesve.

GJETJA	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	për vlerën neto të aseteve për llogaritjen e tarifës për shoqëritë administruese të fondeve të pensionit, për fondet e Investimit dhe depozitarin e fondit të Investimeve , për numrin e subjekteve që parashikohet të licencohen si dhe tarifat përkatëse të licencimit, sipas tregjeve të mbikëqyrura nga AMF, për gjobat e vendosura për subjektet e mbikëqyrura dhe individët, për të ardhurat në formën e interesave **Bre** të përfituara për tepricat e llogarive që ka Autoriteti pranë **bankave** të nivelit të dytë. Në tregun e sigurimeve evidentohet se: plani i të ardhurave me planin e shpenzimeve është i njëjtë ose planifikohet i barabartë; shpenzimet e aktivitetit të AMF nga viti në vit janë rritur për tërësi përafruar realizimit të ardhurave; rritja e shpenzimeve të AMF është shoqëruar me uljen e rimbursimeve që AMF u kthen kompanive të sigurimit sipas ligjit, (rimbursimin është diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve); tepricat e të ardhurave të realizuara nga AMF (diferenca të ardhura ï shpenzime) ju kthehen shoqërive të sigurimit ku pjesë e tyre janë edhe gjobat që vendosen për shkelje të ndryshme; raporti dëme/prime është në nivele të ulëta ku luhatet në një mesatare tregu nga 23 % deri në 47 % ndërsa diapazoni është nga 50% deri në 80%; raporti shpenzime/prime është në nivele të larta me një mesatare tregu e cila është nga 62% deri në 75 % ndërsa diapazoni është 25-50%; numri i kontratave të sigurimit të lidhura të cilat në disa raste ka patur tendencë uljeje; tregu i sigurimeve vazhdon të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës; tregu i sigurimeve vazhdon të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e detyrueshme me ligj;			Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me institucionet ligjvënëse të mundësojë përmirësime ligjore në drejtim të mos kthimit të tepricave të ardhurave shoqërive të sigurimit si diference të ardhura shpenzime si dhe mos përfshirjes gjobave si të ardhura që u duhen kthyer shoqërive ñme shkeljeò si diference të ardhura shpenzime, por të jenë apo mbeten pjesë e fondit rezervë.
3.	Nga auditimi u konstatua se për periudhën 10.04.2020 - 28.05.2020, Bordi i AMF ka funksionuar me vetëm 3 anëtar, pa Drejtorin dhe Nëndrejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv, gjatë së cilës janë zhvilluar 2 mbledhje. Referuar nenit 16 të Ligjit nr. 9752, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, ñKompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutivò, ñ*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv organizon dhe administron veprimtarinë e Autoritetit dhe të administratës së këtij Autoriteti. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ka këto kompetenca:* *1. Përfaqëson Autoritetin.* *2. Organizon, drejton dhe kontrollon*	*(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.4. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*		AMF në vijimësi të marrë masat për zhvillimin e mbledhjeve të Bordit vetëm nëse pjesë e tyre është minimalisht një nga anëtarët ekzekutivë, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që lindin nga neni 16 i ligjit nr. 9752, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, ose të marrin masa për ndryshimet e nevojshme ligjore për delegimin e kompetencave të anëtarëve ekzekutivë në rast mungese.

GJETJA	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	veprimtarinë e administratës. *3. Përgjigjet para Bordit për zbatimin e vendimeve të miratuara.* *4. I propozon Kryetarit të Bordit çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes sëBordit dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të Autoritetit dhe për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij*ò. *Kur Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv mungon, ose kur për shkaqe të jashtëzakonshme nuk mund të delegojë kryerjen e detyrave apo është në pamundësi për të vepruar, nëndrejtori ekzekutiv drejton Autoritetin për të siguruar mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të tij".* Sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se mungesa e të dy anëtarëve ekzekutivë, duhet të sjellë mos zhvillimin e mbledhjeve të Bordit, pasi: - nuk mund të propozohen çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Bordit (pika 4); - nuk mund të përgjigjet asnjë për zbatimin e vendimeve të miratuara (pika 3).			
4.	AMF me Vendim nr. 76 datë 15.06.2020 ka miratuar licencimin e shoqërisë ñT Bò sha për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime në klasat e Jetës dhe jo-Jetës. Lista e brokerave të licencuar në kërkesën për licencim nuk përfshin B fizik të licencuar nga AMF dhe në vijim është trajtuar lista e personave të paraqitur, si kërkesë për pajisjen me licencë për B fizik. Licencimi i brokerit fizik dhe licencimi i shoqërisë së brokerimit janë dy procese të ndara të cilat në këtë praktikë licencimi janë trajtuar të bashkuara, gjë që ka sjellë edhe vonesën në licencimin e shoqërisë së brokerimit. Kërkesa për pajisjen me licencë është paraqitur nga T Bë sha me nr. 694 datë 02.03.2020 për të kryer veprimtari brokerimi në sigurime duke paraqitur listën e brokerave të licencuar me qëllim përmbushjen e kriterit përkatës, ndërkohë që brokerat nuk kanë qenë të licencuar por janë licencuar në të njëjtën kohë dhe praktikë me shoqërinë e brokerimit. Nga auditimi konstatohet se afati i dhënies së licencës për këtë shoqëri brokerimi nuk është brenda 2 muajve nga plotësimi i dokumentacionit sipas përcaktimeve të bëra në pikën 3 të nenit 13 të rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 "Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime".	*(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.4. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*		Nga ana e AMF të merren masa që në rast të mos përmbushjes së kritereve specifike të shoqërisë së brokerimit për pasjen e brokerave të licencuar fizikë nga autoriteti, trajtimi i kërkesës për licencimin e brokerit fizik të kryhet veçmas nga trajtimi i kërkesës për licencim të shoqërisë së brokerimit, me qëllim shmangien e vonesave në praktikat e licencimit.

GJETJA	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
5.	AMF me vendimin nr. 8 datë 06.06.2019 ka vendosur licencimin e shoqërisë B C sha për ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit të fondeve të pensioneve vullnetare dhe fondeve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive. -Nga auditimi mbi këtë praktikë licencimi konstatohet se kriteret për licencim nuk janë përmbushur në kërkesat e ligjit për mos dhënien e licencës së depozitarit shoqërive që zotërojnë aksione në një shoqëri administruese të fondit të pensionit, pasi B C sipas relacionit teknik të paraqitur në momentin e licencimit zotëron aksione në masën 76% tek shoqëria administruese CI sha. Nga auditimi konstatohet se deklarata e paraqitur në praktikën e licencimit të mësipërme të BC si depozitar nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 47 të ligjit nr. 10197 datë 10.12.2009 *"Për fondet e pensionit vullnetar"* ku përcaktohet se *"Për të marrë licencën e depozitarit nga autoriteti, B duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme dhe të dorëzojë pranë autoritetit dokumentacionin e mëposhtëm: deklaratën e nënshkruar nga këshilli drejtues, ku përcaktohet se B, gjatë kohës që është e licencuar, nuk zotëron dhe nuk do të zotërojë aksione në një shoqëri administruese ose aksione të ndonjë personi, që është palë e lidhur me këtë shoqëri administruese, apo se nuk do ketë marrëdhënie të tjera financiare me këta persona;"*. Sipas relacionit teknik të paraqitur në Bord, është referuar se BC zotëron aksione në masën 76% tek shoqëria administruese CI sha e cila administron FICP dhe FPCP, duke përcaktuar që në fakt B zotëron aksione në një shoqëri administruese. -Gjithashtu konstatohet se nuk janë përmbushur kriteret e licencimit përsa i përket zotërimit të një programi kompjuterik për kryerjen e aktivitetit të depozitarit përpara marrjes së licencës, por për përmbushjen e këtij kriteri është paraqitur memorandum mirëkuptimi. Pranimi i memorandumit të mirëkuptimit si evidencë për përmbushjen e kriterit nuk është në përputhje me kërkesat teknike sipas nenit 4 të rregullores Rregullore nr. 128, datë 06.10.2011 *"Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive".*			Nga ana e AMF të merren masa për rishikimin e licencës së depozitarit sipas përcaktimeve ligjore në rolin e depozitarit të fondeve të pensioneve dhe depozitarit të fondeve të sipërmarrjes së Investimeve kolektive me qëllim shmangien e konfliktit në përmbushjen e kritereve të depozitarit të licencuar i cili zotëron aksione në një shoqëri administruese të fondeve të pensionit.
6.	Mangësi në monitorimin për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit të shoqërive të brokerimit bazë të pasqyrave financiare.	*(Trajtuar më hollësisht në*		AMF të realizojë inspektim në shoqëritë e identifikuara me mungesë të kapitalit minimal në para, sipas raportimit të

GJETJA	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	Përsa i përket situacionit financiar të shoqërive të brokerimit për vitin 2019 sektori i mbikëqyrjes së BSHS-së dhe monitorimit të ndërmJetësve ka monitoruar pasqyrat financiare ku rezulton se nga 13 shoqëri brokerimi të cilat janë aktive, në një shoqëri, ASS B, rezulton me humbjet për vitin 2019, ndërkohë që 12 shoqëritë e tjera kanë rezultuar me fitim. Nga aktiviteti i ndërmjetësmit në sigurime në total janë realizuar 646,943,420 lekë të ardhura. Në bazë të rregullores për ñKriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurimeò te miratuar me vendimin e bordit nr. 48 të datës 30.06.2015 në nenin 8 të tij në pikën 1 shkronja ñhò thotë që dokumenti Br që vërteton pagimin e kapitalit bazë prej të paktën 3,000,000 lekësh në një nga Bt e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e Shqipërisë. Gjithashtu në bazë të ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò në nenin 211 të tij pika 1 a thotë: ñSh B,e cila ushtron veprimtari brokerimi në sigurime, paraqet në Autoritet kërkesën për licencim së bashku me dokumentet përkatëse që vërtetojnë kushtet e të ketë kapitalin bazë të paguar në para prej tij, të paktën 3,000,000 lekëshò Në bazë të pasqyrave financiare të konsoliduar nga ana e sektorit të monitorimit të ndërmjetësve për vitin 2019 rezulton që Ass B nuk e respektojnë këtë kriter .Ku në totalin e kapitalit Ass B ka vetëm 471,258 lekë. Pra Ass B nuk e respektojnë këtë kriter as në totalin e kapitalit. Ndërsa po ti referohemi nenit të sipërcituar të ligjit 52/2014 thotë që kushtet e kapitalit bazë duhet të jenë të paguara në para, pra në mjete monetare ku Ass B dhe ST B nuk e respektojnë këtë kriter ku kanë në mjete monetare vetëm 127,863 lekë dhe 1,189,424 lekë. Në kushte të tilla sektori i monitorimit pas mos përmbushjes së detyrimeve duhet të dërgonte një grup inspektimi edhe pse për Ass B dhe ST Bishte zhvilluar inspektimi përgjatë vitit 2019 pa identifikimin e këtyre problemeve	*Kapitullin IV.4. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*		kryer në pasqyrat financiare nga ana e tyre dhe në rast të mos përmbushjes së kritereve ligjore të marrë vendim për pezullim deri në përmbushje të kritereve apo revokim të licencës.
7.	Nuk janë marrë masa për sanksionim me gjobë ndaj shkeljeve të konstatuara e detajuar rast pas rasti si më poshtë: - Nga verifikimi i vendimit nr. 95, datë 29.07.2020 të marrë nga Bordi i AMF mbi inspektimin e zhvilluar në shoqërinë	*(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.4. të Raportit Përfundim*		Bordi i AMF në vijimësi të marrë masa për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, në drejtim të sanksionimit me gjobë për shkeljet e përcaktuara si të tilla për të gjitha rastet

GJETJA	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	e sigurimit ñAò Sh.A, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò. Saktësisht, në 4 (katër) raste janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë nga 2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj kompanisë së sigurimit si dhe nga 300,000 lekë deri në 400,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. - Nga verifikimi i vendimit nr. 17, datë 22.01.2020 të marrë nga Bordi i AMF mbi inspektimin e zhvilluar në shoqërinë e sigurimit ñS Iò Sh.A, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò. Saktësisht, në 2 (dy) raste janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë nga 2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj kompanisë së sigurimit si dhe nga 300,000 lekë deri në 400,000 lekë (në një nga rastet është sanksionuar, ndërsa në një rast jo) ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. - Nga verifikimi i diskutimeve të zhvilluara nga Bordi i AMF në mbledhjen nr. 12/2020 (nuk është marrë vendim mbi këtë çështje) mbi inspektimin e zhvilluar në shoqërinë e sigurimit ñAò Sh.A, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò. Saktësisht, në 2 (dy) raste janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë nga 2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj kompanisë së sigurimit dhe nga 300,000 lekë deri në 400,000 lekë (për secilin nga rastet e	*tar të Auditimit)*		e konstatuara, për një trajtim të barabartë për shkelje të njëjta të të gjithë kompanive të sigurimit.

GJETJA	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	konstatuara) ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. Si dhe në 1 (një) rast është konstatuar shkelje e cila referuar nenit 247 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishte sanksionuar me gjobë nga 300,000 lekë deri 500,000 lekë ndaj anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës. - Nga verifikimi i 6 (gjashtë) inspektimeve tematike me objekt ñAktiviteti i ri sigurimitò të zhvilluara në shoqëritë e sigurimit ñAò Sh.A, ñAò Sh.A, ñEò Sh.A, ñIò Sh.A, ñAò Sh.A dhe ñS U GAò, u konstatua se nuk është marrë vendim për sanksionimin me masë gjobë për shkeljet e evidentuara në masën totale 2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë për secilën nga shoqërisë e inspektuar, në kundërshtim me nenin nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò. Gjithashtu, për rastet e përmendura më sipër, nuk është sanksionuar personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit në masën 300,000 lekë deri 400,000 lekë, në kundërshtim me nenin nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, pika 2.			
8.	Nga auditimi konstatohet se dy sistemet elektronike të AMF nuk rakordojnë me njëri tjetrin; Nga verifikimi dhe analizimi i të dhënave të vëna në dispozicion për dy sistemet që AMF dhe kompanitë e sigurimit përdorin, konkretisht AMF InReg dhe Regjistri Elektronik Online i Shitjeve, u konstatua se primet e prera nga shoqëritë e sigurimit, si në vlerë ashtu edhe në numër, nuk rakordojnë për periudhën e audituar. Në vlerësimin e grupit të auditimi, ky fenomen përbën risk të lartë për mungesë monitorimi ndaj shoqërive të sigurimit. Gjithashtu konstatohet, përqindje e lartë e anulimit të kontratave kartoni jeshil (KJ). Nga analizimi i të dhënave të nxjerra nga Regjistri Elektronik Online i Shitjeve, në lidhje me anulimin e kontratave të primeve të sigurimit, u konstatua se anulimi i kontratave kartoni jeshil (KJ) arrin 1.36% të kontratave të prera, ose 2.27 herë më shumë se anulimi i kontratave TPL, çka tregon për një risk të lartë të anulimit të kontratave kartoni jeshil	*(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.5. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*		AMF të marrë masat e nevojshme për zhvillimin e Regjistrit Elektronik Online të Shitjeve, me qëllim monitorimin e të dhënave me sistemin In-Reg, si dhe të zhvillojë inspektimet përkatëse për verifikimin rast pas rasti të të dhënave të këtij regjistri.

GJETJA	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	(KJ).			

I.c. Opinioni i Auditimit

Nga auditimi ka rezultuar një opinion i kualifikuar i auditimit të përputhshmërisë, trajtuar më gjerësisht në bazën për dhënien e opinionit të kualifikuar.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 845/1, datë 06.11.2020 me ndryshime miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 07.11.2020 deri në datë 29.01.2021, në subjektin Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për periudhën nga 01.01.2019 deri në 30.09.2020 u krye auditimi ñMbi përputhshmërinë e aktivitetit të ñAutoritetit Mbikëqyrjes Financiareò nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A.Z Auditues
2. B.D Auditues
3. R.G, Auditues
4. G.T Auditues

Auditimi u krye për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin, dhënia e konkluzioneve mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, treguesit dhe qëndrueshmëria financiare; mbi organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese të shoqërisë; mbi organizimin e mbikëqyrjes që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare të mbikëqyrura: licencim, monitorim, raportim dhe inspektim në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi; etj.

Objektivi i auditimit - është për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga ñAutoritetit Mbikëqyrjes Financiareò, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mbi realizimin e të ardhurave, treguesit dhe qëndrueshmëria financiare; mbi organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese të shoqërisë; mbi organizimin e mbikëqyrjes që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare të mbikëqyrura: licencim, monitorim, raportim dhe inspektim në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi. Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për tôu bërë publike. Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, gjatë veprimtarisë së tij.

Qëllimi i auditimit - është vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura dhe procedurave të ndjekura nga ñAutoritetit Mbikëqyrjes Financiareò gjatë procesit të realizimit të objektivave saj në përputhje me legjislacionin, vlerësimi me objektivitet, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit, vlerësimi e evidentimi i shkeljeve si dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e përgjegjësisë institucionale.

Identifikimi i çështjes - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është institucion publik, i pavarur nga ekzekutivi, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit financiar joBr dhe operatorëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë sektor. AMF raporton në Kuvend për aktivitetin e tij.
Fusha kryesore e veprimtarisë së Autoritetit është rregullimi dhe mbikëqyrja:

- e tregut të sigurimeve dhe operatorëve të tij;
- e tregut të titujve dhe operatorëve të tij;
- e tregut të pensioneve private vullnetare dhe operatorëve të tij;
- e veprimtarive të tjera financiare jo Bre.

Funksioni i Autoritetit është që me anë të mjeteve ligjore, administrative dhe të informacionit, të mbrojë konsumatorët, si dhe të ruajë stabilitetin e transparencën në fushën e sigurimeve, titujve dhe pensioneve private vullnetare.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese - Është detyrimi i menaxherëve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin që të mbrojë konsumatorët, si dhe të ruajë stabilitetin e transparencën në fushën e sigurimeve, titujve dhe pensioneve private vullnetare

Përgjegjësitë e audituesve - Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar:
-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4100*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese;
-Të kryejë në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300);
-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në ketë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300);
-Të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.
Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 ñDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tò, si dhe ISSAI 30 ñKodi Etikò, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

Kriteret e vlerësimit - Për dhënien e opinionit të përputhshmërisë jemi bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të ligjit në fushën menaxhimit sigurimeve dhe administrimit shoqërive T me kapital shtetëror:

- Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, të ndryshuar;
- Ligji nr. 56, datë 20.0602020 ñPër sipërmarrjet e Investimet kolektiveò; i cili rregullon themelimin, regjistrimin dhe veprimtarinë e shoqërive administruese të fondeve, të shoqërive administruese;
- Ligji nr. 36, datë 31.03.2019 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009, ñPër sipërmarrjet e Investimeve kolektive";
- Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit", i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, ri sigurimit dhe ndërmjetësimit;
- Ligji nr. 10455, datë 21.07.2011 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit";
- Ligji nr. 10236, datë 18.02.2010 "Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike", i cili përcakton rregullat, që lidhen me kushtet dhe procedurat për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike;

- Ligji nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e Investimeve kolektive", ndryshuar me ligjin nr. 36, datë 31.03.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009ò;
- Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", i cili ka për qëllim të vendosë standardet e nevojshme për: administrimin me efektivitet të fondeve;
- Ligji nr. 10158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore", i cili ka si qëllim përmirësimin e bazës ligjore;
- Ligji nr. 10076, datë 12.02.2009 ñPër Sigurimin e detyrueshëm në sektorin e Transportitò, të ndryshuar;
- Rregullore ñMbi administrimin e fondit të kompensimitò, miratuar me vendimin e Bordit nr. 119, datë 06.06.2019;
- Vendime të bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;
- Rregullorja nr. 155 datë 23.12.2014, e ndryshuar me nr. 28 ñPër hartimin, ndjekjen, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të AMFò, miratuar me Vendim Bordi nr. 144, datë 20.10.2017;
- Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" ;
- Rregullore nr. 37, datë 27.03.2019 ñMbi rinovimin e licencës së Aktuarit të Autorizuarò;
- Rregullore nr. 57, datë 28.04.2016 "Mbi trajnimet e vazhdueshme profesionale dhe rinovimin e licencës së aktuarit të autorizuar";
- Rregullore nr. 85, datë 03.07.2017 "Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime" *(Ndryshuar me Vendimin e Bordit Nr. 36, datë 27.03.2019)(Ndryshuar me Vendimin e Bordit Nr. 164, datë 14.08.2019);*
- Rregullore nr. 79, datë 31.08.2015 "Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës*" (Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 215, datë 31.10.2018);*
- Rregullore nr. 48, datë 30.06.2015 "Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime" *(Ndryshuar me vendim Bordi nr. 18, datë 26.02.2016);*
- Rregullore nr. 35, datë 27.03.2019 ñPër organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò;
- Ligji Nr. 10198 datë 10.12.2009 ñPër Sipërmarrjet e Investimeve Kolektiveò ;
- Rregullore nr. 112, datë 31.08.2020 ñPër licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të Investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisëò.;
- Rregullore nr. 128, datë 06.10.2011 "Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive";
- Rregullore nr. 68, datë 26.05.2011 "Për dhënien e licencës, veprimtarinë T, ofertën publike dhe kërkesat e raportimit për sipërmarrjen e Investimeve kolektive me ofertë publike të krijuar nga një shoqëri e huaj administruese";
- Rregullore nr. 69, datë 26.05.2011 "Për autorizimin e individëve për shitjen e kuotave/aksioneve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive me ofertë publike";
- Ligji Nr. 10197 datë 10.12.2009 ñPër Fondet e Pensionit Vullnetarò;
- Ligji Nr. 9879, datë 21.02.2008 ñPër Titujtò,
- Rregullore nr. 165, datë 23.12.2008, ñPër licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit, brokerit dhe këshilltarit të Investimeve ò, e ndryshuar.
- Vendim nr. 55, datë 30.03.2011 "Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë";

- Rregullore nr. 124, datë 7.12.2010 ñMbi afatet, kushtet dhe procedurat për autorizim të Bve si kujdestarë të obligacioneveò;
- Rregullore nr. 21, datë 26.03.2009 "Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë";
- Rregullore nr. 120, datë 02.10.2008 "Mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e bursës së titujve";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollin ñndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15/10/2015;
- Struktura dhe organika AMF-së;
- Dosjet e punonjësve tëAMF-, vlerësimet e punës, trajnimet, përshkrimet e punës, rekrutime;
- Rregulloret e Brendshme të AMF-s;
- Memo, shkresa përcjellëse të AMF-së;
- Manualin për MFK-në (miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016;
- Procedura, procese pune, etapa raportimi;
- Strategjia afatmesme e AMF-së;

Standardet e auditimit - Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren ñPër Procedurat e Auditimitò, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 107 datë 08.09.2017, dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Gjithashtu referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t .

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është institucion publik, i pavarur nga ekzekutivi, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit financiar joBdhe operatorëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë sektor.

Fusha kryesore e veprimtarisë së Autoritetit është rregullimi dhe mbikëqyrja:

- e tregut të sigurimeve dhe operatorëve të tij;
- e tregut të titujve dhe operatorëve të tij;
- e tregut të pensioneve private vullnetare dhe operatorëve të tij;
- e veprimtarive të tjera financiare joBre.

Autoritetit ka funksion që me anë të mjeteve ligjore, administrative dhe të informacionit, të mbrojë konsumatorët, si dhe të ruajë stabilitetin e transparencën në fushën e sigurimeve, titujve dhe pensioneve private vullnetare.

Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nëpërmjet veprimtarisë së tij kontribuon në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, ngritjes së vazhdueshme të nivelit të rregullimit dhe mbikëqyrjes në treg, promovimin dhe nxitjen e standardeve të larta për mbrojtjen e konsumatorëve dhe integritetin e të licencuarve, rritjen e efikasitetit dhe stabilitetit të tregut financiar joBsi dhe përmirësimin e shkallës së profesionalizmit.

Gjithashtu ai ka si objekt të veprimtarisë:

- Rregullimin e veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura, nëpërmjet hartimit të akteve të Autoritetit, të parashikuara nga ligji nr. 9752, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar dhe nga ligjet e fushës, si dhe botimin e udhëzimeve e materialeve shpjeguese;
- Sigurimin e mbikëqyrjes shtetërore mbi tregun e titujve, tregun e sigurimeve, skemat e pensioneve vullnetare dhe veprimtari të tjera financiare që mbikëqyren, të cilat rregullohen e funksionojnë në përputhje me ligjet në fuqi.

Për sa më sipër në ushtrimin Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka të drejta të plota për:

- Miratimin, lëshimin apo refuzimin e licencave për subjektet, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare që mbikëqyren;
- Vëzhgimin dhe organizimin e mbikëqyrjes së subjekteve, që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare që mbikëqyren. Subjektet, qofshin këta individë apo persona, fizikë ose juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e përmendura në nenin 2 të Ligjit nr. 9752, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, i ndryshuar", në vijim do të quhen subjekte të mbikëqyrura;
- Ndjekjen e zbatimit të këtij ligji dhe të akteve të Autoritetit, të dala në zbatim të tij e të ligjeve të fushës dhe të akteve të Autoritetit, të dala në zbatim të tyre dhe zbatimin e masave shtrënguese.

Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

Objekt i këtij angazhimi është auditimi i përputhshmërisë të veprimtarisë Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përgjatë vitit 2019 dhe 9 mujorit të vitit 2020.

Qëllimi i auditimit në AMF është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi, vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit financiar të fondeve publike e buxhetore mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe mbi bazën e gjetjeve dhënien e rekomandimeve për përmirësime.

Fushëveprimi i auditimit është auditimi i veprimtarisë së këtij institucioni sipas drejtimeve të përcaktuara në programin e auditimit. Sipas këtyre drejtimeve fushëveprimi përfshin, funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit; planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, treguesit dhe qëndrueshmëria financiare; organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese të

shoqërisë; organizimin e mbikëqyrjes që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare të mbikëqyrura: licencim, monitorim, raportim dhe inspektim në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi; etj., ku me gjithë punën e bërë janë konstatuar dhe disa mangësi të cilat në mënyrë të detajuar janë përshkruar sipas pikave përkatëse në aktet e konstatimit, në projekraportin dhe në vijim në raportin përfundimtar të auditimit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

IV.1. Mbi funksionimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Në zbatim të praktikave më të mira të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në **Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiar**
Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e borxhit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimet apo pasaktësitë në raportim.
Strukturat përgjegjëse të AMF-së kanë dijeni mbi praktikat e mira të referuara në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar, Manualin për MFK-në (miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016) si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij,duke reflektuar në rregulloret specifike të poshtë cituara,dhe në organizimin e përgjithshëm edhe pse sipas shpjegimeve të dhëna nga ana e AMF-së sipas nenit 3 të ligjit Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15/10/2015 nuk gjenden brenda fushës së zbatimin të tij dhe nuk është caktuar një nëpunës zbatues,megjithatë konstatohet se AMF ka përcjell në ministrinë e financave dhe ekonomisë pyetësorin e vetëvlerësimit dhe deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshëm referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15/10/2015 nenit 18 pika 1 të tij. Gjithashtu në një raport auditimi të brendshëm nga ana e AMF-së me shkresën nr. 447/2 Prot të datës 18.03.2020 kryhet auditimi mbi ñVlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e pesë komponentëve për vitin 2019ò dhe si kriter auditimi merret Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15/10/2015 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin,miratuar me urdhrin nr. 108 datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave

1. Mjedisi i kontrollit
a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.
<u>AMF funksionon sipas Rregullores së Brendshme të miratuar me urdhrin nr. 170 të datës 14.08.2019 e cila përcakton rregullat mbi organizimin dhe funksionimin e brendshëm sipas strukturave</u>
Përgjatë vitit 2019 AMF ka pasur 4 departamente e shpërndarë në 12 drejtori me një numër stafi prej 100 punonjës. Përgjatë vitit 2020 numri i departamenteve ka shkuar në 5 i ndarë në 14 drejtori me një staf prej 109 punonjësish. Përgjatë periudhës objekt auditimi struktura organizative deri në muajin Korrik të vitit 2019 ka qenë ajo e miratuar me urdhrin Nr. 129 me datë 31.08.2017,më pas është ndryshuar me urdhrin Nr. 154 datë 24.07.2019 dhe është ri ndryshuar me urdhrin Nr. 107 datë 29.07.2020. Pra gjatë periudhës objekt auditimi është ndryshuar 2 herë.

Lidhur me respektimin e etikës, Institucioni ka të hartuar veçmas Kodin e Etikës,të miratuar me vendimin nr .37/2 të datës 23/02/2011 të ndryshuar, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, neni 20 ñMjedisi i kontrollitò, pika 2, germa (a). Por institucioni nuk ka një komision etike të ngritur dhe as në Kodin e etikës nuk parashikohet një komision i tillë

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Struktura lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga Bordi, Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv, nëndrejtori ekzekutiv, drejtuesit e departamenteve dhe drejtuesit e drejtorive deri tek specialistët dhe e ndihmon drejtuesin në vendimmarrje. Sipas strukturës së njësisë, Bordi, drejtori i përgjithshëm ekzekutiv dhe nëndrejtori ekzekutiv janë përgjegjës për përmbushjen e misionit dhe funksioneve të kësaj strukture. Drejtuesit, drejtorët apo përgjegjësit e sektorëve janë në varësi direkte të tyre. Mungesa e Drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv përgjatë disa muajve në periudhën objekt auditimi, ka bërë të mos sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal, etika profesionale dhe përjashtimi i konflikeve të interesit në kryerjen e detyrave funksionale në lidhje me ñndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos J përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollinò. Përgjatë vitit 2020 ky element i mjedisit të kontrollit është cenuar.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Marrëdhëniet e punëdhënësit rregullohen në bazë të Kodit të Punës dhe dispozitat e tjera ligjore si,Ligji për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Ligji për buxhetin e shtetit, Ligji për prokurimin publik, kontabilitetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin, etj., lejojnë titullarin e Institucionit që në rast të shkeljes së normave ligjore, apo të rregullave të ndërmarrë hapat e duhura. Por mungesa e Drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv përgjatë vitit 2020 lë hapësira për mos përcaktim të saktë të funksioneve dhe përgjegjësive të secilit punonjës. Në rast konflikte interesash, apo problematika në lidhje me kompetencat dhe realizimin apo mosrealizimin e detyrave të punës, sjell hapësira konfliktuale dhe paqartësie për trajtimin e situatave.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Nga auditimi i trajnimeve të zhvilluara në kuadër të rritjes së kapaciteteve dhe shkallës së profesionalizimit në punë u konstatua si në vijim:

Kalendari i trajnimeve në autoritetin e mbikëqyrjes financiare për vitin 2020 është miratuar nga drejtori i përgjithshëm ekzekutiv me nr. 703 Prot. të datës 02.03.2020

Kalendari i trajnimeve parashikon deri në 30 Shtator 2020 20 trajnime të ndryshme në vende të ndryshme të ndarë sipas departamenteve.

Nr	Data e trajnimit	Vendi i trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Nr i pjesmarrsve në trajnim
1	28 Shkurt 2020	Potgoricë, Mali iZi	1 ditë	1 (një)
2	20 mars 2020	Madrid, Spanjë	Takim virtual, 1 ditë	1 (një)
3	12 maj 2020	Bazel, Zvicër	Takim virtual, 1 ditë	1 (një)
4	27-28 maj 2020	Dublin, Irlandë	Takim virtual	6 (gjashtë)
5	15 maj 2020	Takim virtual	1 ditë	5(pesë)
6	24 Qershor 2020 - ora 12h-15h (CET)	Paris, Francë, Takim virual	1 ditë	3 (tre)
7	25 Qershor 2020 ora 14-16 p.m (Bazel time)	Bazel, Zvicër, Takim virual	1 ditë	6 (gjashtë)
8	26 qershor 2020	Takim virual	1 ditë	2 (dy)
9	30 qershor 2020	The Institutes, USA, Takim virual	1 ditë	1 (një)
10	28 korrik 2020	Dublin, Ireland. Takim virtual	1 ditë	5 (pesë)
11	4 gusht 2020	Takim virual	1 ditë	5 (pesë)
12	6 gusht 2020	Takim virual	1 ditë	7 (ditë)
13	20 Gusht - 24 Nentor	Takim virtual	3 muaj	9 (nëntë)
14	1 shtator 2020	Takim virtual	1 ditë	5 (pesë)
15	2 shtator 2020	Madrid, Spanjë, Takim virtual	1 ditë	1 (një)
16	10 shtator 2020	Takim virual	1 ditë	5 (pesë)

Të dhëna mbi trajnimet e parashikuara dhe ato të realizuara përgjatë vitit 2019:

Trajnime të Buxhetuara /Parashikuara			Trajnime të realizuara në 2019	
Kosto totale	**Nr i personelit pjesëmarrës**	**Nr. i trajnime**	**Kosto totale**	**Nr i personelit pjesëmarrës**
2,500,000 leke	90	29	1,800,000 Leke	81

Përshkrimet e punës përgjatë vitit 2019 dhe 2020 janë bërë.
Në referim të nenit 5 të rregullores për marrëdhëniet e punës të punonjësve në AMF të miratuar me Vendimin e Bordit nr. 170 të datës 14.08.2019,specialistët,nisur nga kriteret e pozicionit sipas përshkrimeve të punës kërkojnë shtesë dhe një përvojë pune 2 vjeçare, ndërsa personat që kandidojnë për pozicionin Drejtor Drejtorie duhet të kenë përveç kërkesave të tjera edhe të paktën 5 vite eksperiencë në institucion, ndërsa personat që kandidojnë për Drejtor Departamenti përveç kërkesave të tjera duhet të kenë edhe të paktën 7 vite eksperiencë pune.
Referuar nenit 14 të rregullores për marrëdhëniet e punës të punonjësve në AMF të miratuar me Vendimin e Bordit nr. 170 të datës 14.08.2019 ñKriteret dhe procedura për pozicionin e punës kryespecialistò përpos procedurave për konkurrim paraqiten dhe kriteret si më poshtë vijon:
1)Të ketë përvojën e punës mbi 6 vjet në Autoritet
2) Të ketë vlerësime të rezultateve në punë të tre viteve të fundit në nivelin ñShumë mirëò
3) Të mos ketë masa disiplinore për cenim të rregullave të etikës në tre vitet e fundit
4)Të kalojë nivelin 70% të testit me shkrim
Këtu në këtë nen rregullorja ka një kontradiktë me nenin 5 të saj pasi pozicioni i kryespecialistit ka kritere shumë më të forta dhe më të mëdha plotësimi se ai i Drejtorit edhe pse në gradën e organikës dhe në nivelin e pagës është në rang më të ulët se ai i drejtorit.
Nga auditimi konstatohet se AMF ka programe specifike për trajnimin e punonjësve përgjatë vitit 2020 por numri i trajnimeve të kryera ka qenë më i vogël nga kalendari i trajnimeve të planifikuara.

2. Menaxhimi i Riskut
Risku dhe Menaxhimi i Riskut janë përkufizuar në Nenin 21 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i cili specifikon si vijon:
1. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.
2. Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në paragrafin 1, titullari i njësisë publike miraton një strategji e cila azhornohet çdo tre vjet, ose, sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe azhornon kontrollet që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit.
3. Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsive, nëpunësit autorizues të njësive publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive.
Nga auditimi u konstatua se është miratuar dhe publikuar strategjia afatmesme e AMF-së 2018-2022
Në strategji janë vendosur objektivat,por jo në të gjitha rastet ato janë SMART{ Specific (konkrete) Mesaurable (të matshme) Achievable (të arritshme) Realistic (realiste) Timely (në kohë)}
Nga auditimi konstatohet se përsa i përket objektivave të tregut të sigurimeve dhe të tregut të kapitaleve si dhe fondet e Investimeve dhe pensionet,në këto raste mungon elementi konkret dhe ai i matshëm në bazë të analizës të kapitalit 3.2 (Menaxhimi i Riskut) të manualit të menaxhimit financiar të miratuar me urdhrin Nr. 108 të datës 17.11.2016 me Nr. 15899 Prot. Gjithashtu mungon një vlerësim i risqeve përsa i përket plotësimit të strukturës dhe elementëve të tjerë të cilësuar me risk në këtë raport.
Në hartën e risqeve janë përfshirë risqet të ndara në makro klasa si më poshtë:
1)Drejtoria e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve:
a)Është përfshirë risku i vonesave në përgatitjen e analizave financiare,
b)Shtyrje e afateve të inspektimit për shkaqe të jashtme nga subjektet e mbikëqyrura,

c)Risku i pasaktësisë në raportimin periodik nga BSHS sipas standardit dhe kërkesave ligjore të Rregullores nr. 2,
d)Moszbatimi i kërkesave ligjore dhe standardeve të auditimit nga shoqëritë e auditimit
2)Drejtoria e Administrimit të Riskut,
a)Vonesa dhe mungesa në saktësi, përsa i përket raportimit të informacionit nga shoqëritë e sigurimeve,
b)Vonesa në kontrollin dhe verifikimin e politikave të marrjes në sigurim dhe risigurim nga shoqëritë e sigurimit,
c)Risku i ruajtjes dhe integritetit të dhënave për shkak të mungesës së sistemeve elektronike të integruara,
d)Gabime njerëzore në kryerjen e detyrave rutinë
3)Sektori i mbikëqyrjes së Ndërmjetësve në sigurime.
a)Risku i mos përmbushjes së detyrimeve ligjore gjatë ushtrimit të aktivitetit të profesioneve të Vlerësuesit të dëmeve,
b)Rritje e numrit të planifikuar të inspektimeve si rezultat i informacioneve nga burime të jashtme në periudha të ndryshme,
c)Dëmtim ose humbje të dhënave dhe informacionit financiar të ruajtur në pajisjet elektronike nga stafi i AMF-së,
4)Drejtoria e mbikëqyrjes së tregut të fondeve.
a)Vonesa dhe saktësia në marrjen e raportimeve financiare dhe informacioneve shtesë nga subjektet e tregjeve financiare që mbikëqyren si dhe raportet e auditorit të jashtëm,
b)Mos shqyrtimi në kohë i raportimeve financiare të shoqërive të tregjeve nën mbikëqyrje,
c)Zgjatje e afateve të planifikuara të inspektimit,për arsye të mosbashkëpunimit të shoqërive që mbikëqyrën,
d)Dëmtimi apo humbja e serive të informacionit financiar nga pajisjet elektronike të përdorura nga punonjësit e drejtorisë
5)Drejtoria e mbikëqyrjes së tregut të kapitaleve
a) Risku i mungesës së një metodologjie/ manuali për mbikëqyrjen e tregut të titujve.
b) Risku i mos identifikimit dhe Investigimit në kohë të rasteve abuzive të tregut.
c) Risku i mungesës së bazës rregullative për mbikëqyrjen e operatoreve te tregut.
d) Risku IT në rast të rënies së sistemit për monitorimin e bursës.
e) Risku i mungesës së sanksioneve te detajuara dhe masave korrektuese mbi operatorët gjë e cila mund të cenojnë tregun e titujve dhe besimin e Investitorit
f) Risku i vonesave në shqyrtimin e pasqyrave financiare si rezultat i vonesave dhe pasaktësive në raportim nga subjektet e tregut te titujve.
6) Drejtoria e Zbatueshmërisë
a) Ankimimi në gjykatë i vendimeve të Autoritetit dhe siguria që vendimet e AMF të mbeten në fuqi.
b) Moszgjidhja në kohë e çështjeve me objekt fond kompensimi si rrjedhojë e detyrimeve të pashlyera.
c) Moszbatimi i vendimeve të Bordit nga subjektet brenda afateve të përcaktuara.
d) Bashkërendimi i punës për garantimin e së drejtës së informimit në Autoritet në përputhje me ligjin ñPër të Drejtën e Informimitò si dhe përditësimi i të dhënave në programin e transparencës për Autoritetin.
e) Mos raportimi në kohe dhe i saktë i të dhënave nga ana e subjekteve lidhur me parandalimin e Pastrimit te Parave dhe Financimit te terrorizmit
f) Mos arkëtimi i sanksioneve me gjobë brenda afateve ligjore
g) Mosrespektimi i kërkesave ligjore nga subjektet nën mbikëqyrje të AMF-së.
h) Ndjekja e masave të vendosura ndaj subjekteve të mbikëqyrura.
7)Drejtoria e mbrojtjes konsumatorit.
a) Mos trajtim në kohë i akesave të depozituara në Autoritet

b) Mos trajtim në kohë dhe kërkesave për dëmshpërblim nga subjektet e mbikëqyrura.
c) Mungesa e transparencës dhe mos përmbushja e detyrimit për informim nga ana e subjekteve nën mbikëqyrje.
8)Drejtoria Juridike dhe integrimit
a) Njohja e ndryshimeve të shpeshta të legjislacionit dhe akteve rregullative. (i jashtëm)
b) Mos bashkëveprimi i anëtarëve pjesëmarrës në grupet ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian (GNPIE) në kapitujt e acquis së BE, në të cilat AMF është institucion kontribuues
c) Ndjekja e procesit të realizimit të miratimit të ligjeve që AMF ka nisur në Ministrinë e Financave.
9)Drejtoria e Licencimit
a) Risku i miratimit të dokumentacionit ligjor të kërkuar (rregullore, plan biznesi) në procesin e licencimit të subjekteve, ai i miratimit të personave të cilët nuk plotësojnë kriteret "fit and proper" në nivelet e larta të drejtimit të shoqërive në tregun e sigurimeve, ai i licencimit të personave jo të përshtatshëm në profesionet e Vlerësuesit të dëmeve, Bdhe Aktuar në sigurime, si dhe ai i licencimit të subjekteve me probleme në aspektin e burimit të kapitalit/të ardhurave
10) Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse
a) Vlerësim subjektiv i performancës së punonjësve.
b) Mungesa e identifikimit të nevojave për trajnime për zhvillim të mëtejetëshëm profesional.
c) Mos realizimi në kohë për arsye objektive i procedurave të prokurimit.
d) Mos arkëtimi i të ardhurave brenda afateve
e) Humbja e të dhënave të arkivës për shkak të keqdashjes apo katastrofave të ndryshme.
f) Punonjësit nuk janë plotësisht të informuar dhe trajnuar me paktën ligjor të MFK-së.
g) Besimi tek stafi kyç i punonjësve (risku i mashtrimit)
11) Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI)
a) Mos funksionimi i shërbimeve të ofruara prej AMF për shkak të risqeve në infrastrukturën hadëare.
b) Mos funksionimi i shërbimeve të ofruara prej AMF për shkak të risqeve në infrastrukturën e rrjetit.
c) Mos funksionimi i shërbimeve të ofruara prej AMF për shkak të risqeve në sistemet e informacionit dhe DB të tyre.
d) Humbje të dhënave të sisteme të informacionit për shkak të ndonjë sulmi kibernetik apo ndonjë katastrofe të mundshme.
12) Drejtoria e statistikës
a) Mungesa e të dhënave te raportuara nga shoqëritë nën mbikëqyrje.
b) Vonesa në dërgimin dhe përpunimin e dhënave periodike
13) Drejtoria e Projekteve dhe Edukimit Financiar
a) Edukim relativisht i ulët financiar i publikut që sjell pasojë konsumator jo të mirë informuar financiarisht
b) Niveli i kualifikimit dhe qëndrueshmëria e stafit (i brendshëm dhe i jashtëm)
c) Risqe nga vonesat në realizmin e shtypshkrimeve sipas specifikimeve teknike për secilin nga botimet zyrtare të AMF-së, apo edhe kontrata e tjera
14)Njësia e Auditimit të Brendshëm
a) Niveli i kualifikimit të audituesve. Vështirësi në kryerjen e auditimeve të përformancës. (i brendshëm dhe i jashtëm)
b) Risku nga mos respektimi i Kodit të Etikës së Audituesëve te AMF-së (shpërdorim i detyrës, sjellja ndaj palëve të treta, etj.)
15)Sekretar i Bordit
a)Mos koordinimi i punës ndërmjet strukturave të Autoritetit.

3. Aktivitetet e kontrollit

Në drejtim të hartimit të kontrolleve të brendshëm lidhur me komponentin e ñAktiviteteve të Kontrollitò u konstatua se janë hartuar proceset kryesore të punës operacionale por në pyetësorin e dërguar AMF-së,nuk ka një përgjigje nëse janë reflektuar ndryshimet në strukturën e institucionit apo ndryshimet në risqet e institucionit në procedurat e kontrollit të brendshëm.

Procedurat e prokurimit gjatë periudhës objekt auditimi janë zhvilluar si më poshtë:

Viti 2019	Procedura prokurimi (ne numër)		Procedura prokurimi (ne vlere)	
	Planifikuar sipas regjistrit te prokurim	Realizuar	Planifikuar sipas regjistrit te prokurim	Realizuar
Procedura e hapur	0	-	0	-
Kërkese për propozim	2 procedura ñKërkese për propozimò për vitin 2019	1 me objekt ñPërmirësim I infrastrukturës se dhomës se serverëveò	3.333.333,33	3.276.050,00
Negocim me shpallje	0	-	-	-
Negocim pa shpallje	1 procedure ñNegocim pa shpalljeò për vitin 2019	1 me objekt òOrganizim i Konferencës ñForumi Ndërkombëtar 2019 për Pensionet Privateò	3.493.500,00	3. 305.500,00
Tender i kufizuar	0	-	-	-
Shërbim konsulentë	0	-	-	-
Konkursprojketimi	0	-	-	-
Blerje te vogla	46 ñBlerje te voglaò për vitin 2019	44 për vitin 2019		

Viti 2020	Procedura prokurimi (ne numër)		Procedura prokurimi (ne vlere)	
	Planifikuar sipas regjistrit te prokurim	Realizuar	Planifikuar sipas regjistrit te prokurim	Realizuar
Procedura e hapur	0	-	0	-
Kërkesëpër propozim	5 procedura ñKërkesë për propozimò për vitin 2020	Ne proces	1."Blerje hardëare" me fond limit 1.666.667,00; 2. "Zhvillime për ofrimin e shërbimeve e-Albania" me fond limit 7.500.000,00; 3."Blerje licenca te tjera" me fond limit 1.750.000,00; 4. ñBlerje pajisje Covid-19ò me fond limit 1.083.333,00 5. ñSigurim i Jetës dhe shëndetit te punonjësve te A.M.Fò, me fond limit 4.000.000,00	Ne proces te gjitha, e realizuar vetëm ñSigurim i Jetës dhe shëndetit te punonjësve te A.M.Fò ne vlerën 3.936.000,00 Lekë
Negocim me shpallje	0	-	-	-
Negocim pa shpallje	0	-	-	-
Tender I kufizuar	0	-	-	-
Shërbim konsulentë	0	-	-	-
Konkursprojketimi	0	-	-	-
Blerje te vogla	47 ñBlerje te voglaò per vitin 2020	33 Procedura ñ Blerje me vlere te vogëlò, nga te cilat 11 janë ñBlerje me vlere te vogël nen 100 000 Lekeò	17 420 995 fondi limit pa TVSH	7.833.254,00 Leke

Në lidhje me komisionet e vlerësimit të ofertave,të gjithë KVO-të që kanë vlerësuar procedurat për vitin 2019 dhe 2020:

Përbërja e KVO				
Nr	Emër Mbiemër	Profesioni	Vite pune në administratë	Vite pune në fushat respektive
1.	x	Ekonomiste	5	16
2.	x	Përkthyes	4	4
3.	x	Juriste	8	11
4.	x	IT	2	11
5.	x	Juriste	13	13
6.	x	Ekonomiste	2	4
7.	x	Ekonomist	5	10
8.	x	Jurist	Mbi 25	Mbi 25

AMF ka procedura për ruajtjen,përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit në institucion ku rregullohen nga rregullorja e miratuar me nr. 136 me datë 12.12.2015 nga bordi i AMF-së,ndërsa përsa i përket arkivimit të dokumenteve financiare,AMF i referohet akteve të tjera në Drejtorinë e Përgjithshme të arkivave

Përsa i përket hartave e proceseve të punës ku burimet që përdoren për ndërtimin e hartës së proceseve të punës në AMF përfshijnë rregulloren ñPër organizimin,funksionimin dhe përshkrimin e detyraveò të miratuar me Vendimin e Bordit nr. 109 datë 29.07.2020 ku përmbajnë përshkrimet e punës për çdo drejtori dhe departament dhe ndarjen e tyre sipas strukturave.

4. Informim komunikimi

Rregullorja e AMF ñPër organizimin,funksionimin dhe përshkrimin e detyraveò e miratuar me Vendimin e Bordit nr. 109 datë 29.07.2020 në nenin 4 pikën 5 të tij përcakton ndarjen e detyrave ñRaportimi dhe kontrolli i aktivitetit të çdo njësie (departament, drejtori, sektor) kryhet nëpërmjet analizave periodike të punës. Raportimi kryhet tek Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv në një nga datat që vendos Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutivò

Bordi informohet në mënyrë 4 mujore përsa i përket të ardhurave dhe shpenzimeve siç e përcakton rregullorja e zbatimit të buxhetit në nenin 10 të saj

Përgjatë periudhës objekt auditimi (01/01/2019-30/09/2020) bordi është informuar për raportet 4 mujore në datat e mëposhtme:

1)14/06/2019
2)20/10/2019
3)20/02/2020
4)17/06/2020

Përsa i përket manualit të MFK-së mbi shtyllën e Informimit dhe komunikimit parashikohen kanalet e komunikimit si horizontal dhe vertikal. Përsa i përket rregulloreve të AMF-së konstatohet një numër shumë i madh rregulloresh të ndara në 5 makro klasa si më poshtë:

1)Rregullore të përgjithshme,
2)Tregu i sigurimeve,
3)Tregu i kapitaleve,
4)Tregu i fondeve të pensioneve Vullnetare,
5)Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve kolektive,

Përsa i përket rregulloreve të përgjithshme janë 18 rregullore,
Përsa i përket rregulloreve të tregut të sigurimeve janë 49 rregullore,
Përsa i përket rregulloreve të tregut të kapitaleve janë 14 rregullore,
Përsa i përket rregulloreve të tregut të fondeve të pensioneve Vullnetare janë 11 rregullore,
Përsa i përket rregulloreve të tregut të tregut të Sipërmarrjeve të Investimeve kolektive janë 20 rregullore.

Totali i rregulloreve të publikuara në Web faqen e AMF-së shkon në 102. Përgjatë periudhës objekt auditimi me anë të vendimeve të bordit ka pasur 24 vendime përsa i përket rregulloreve për vitin 2019 dhe 19 deri me datë 30/09/2020 për një total prej 43 vendime në rregullore. Ndërkohë përsa i përket ndryshimeve në rregullore me anë të vendimeve të bordit rezultojnë 17 HHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHHH

5. Monitorimi

Referuar urdhrit Nr. 108 të datës 17.11.2016 të Ministrisë së Financave/Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik ñPër Miratimin e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollitò në Kapitullin III të tij përcakton procedurat e Monitorimit. Sipas shpjegimeve të AMF-së Monitorimi i punës kryhet nëpërmjet takimeve te përditshme te drejtuesve te njësisë me strukturat vartëse. Raportimi realizohet sipas shkalleve të hierarkisë.(Specialist-Përgjegjës sektori/ Dr. drejtorie/ Dr. Departamenti / Nëndrejtor ekzekutiv/ Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv)

Me vendimin Nr. 194 të datës 27/09/2018 ñPër Miratimin e planit strategjik për vitet 2019-2021 dhe planit vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2019 është miratuar:

1)Plani Strategjik
a)Qëllimi i planit Strategjik dhe misioni i Njësisë së Auditit të Brendshëm
b)Organizimi i NjAB dhe kuadri ligjor
c)Objektivat strategjikë
d)Identifikimi i subjekteve,fushave dhe sistemeve prioritare
e)Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve
f)Kufizimet e Auditimit

g)Prioritetet për tre vite
2)Plani Vjetor, ku janë planifikuar të auditohen njësitë e :a)Drejtoria e Administrimit të Riskut b) Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve c) Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit d) Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse e) Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatorit f) Të gjitha njësitë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve. Ndërsa me datë 13/03/2019 Njësia e Auditimit të brendshëm i ka dërguar bordit kërkesën për ndryshim në planin e miratuar vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2019. Ku më konkretisht kërkohet përfshirja e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe heqjen nga plani i miratuar i audimit të Drejtorinë e Mbikëqyrjes së tregut të fondeve
Ndërsa me anë të Vendimit nr. 205 të datës 14/10/2019 ñPër Miratimin e planit strategjik për vitet 2020-2022 dhe planit vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2020 është miratuar:
Plani Vjetor, ku janë planifikuar të auditohen njësitë
a) Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve,
b) Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve,
c) Drejtoria e Teknologjisë së informacionit,
d) Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse,
e) Drejtoria e Zbatueshmërisë,
f) Sekretari i Bordit.
Përsa i përket auditimeve të përfunduara për vitin 2020 përpara datës 30/09/2020
1)me anë të Raportin të auditimit Nr. 1209/4 të datës 10/07/2020 për ñPajtueshmëri e procedurave të mbajtjes së mbledhjeve të Borditò është realizuar auditimi i cili mbulonte si periudhë auditimi vitet 2016-2020. Ky raport auditimi është mbyllura pa asnjë gjetje.
2) Me anë të shkresës Nr. 447/2 Prot të datës 18/03/2020 auditi i brendshëm përfundoi auditimin lidhur mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e pesë komponentëve për vitin 2019. Ky raport auditimi mbyllet pa asnjë gjetje por me 3 rekomandime
Përsa i përket auditimeve të përfunduara në vitin 2019:
1)Me anë të njoftimit nr. 262/1 Prot të datës 12/02/2019 auditi i brendshëm përfundoi auditimi për zbatimin e rekomandimeve të vitit 2018 nga ku rezultojnë: a) 28 rekomandime të zbatuara në afat b) 21 rekomandime,me afat(në vijimësi) c) 3 rekomandime të periudhës së auditimit,por me afat jashtë saj d) 1 rekomandim i pazbatuar.
2)Përgjatë vitit 2019 dhe 2 muajve të fundit të vitit 2018 auditi i brendshëm I AMF-së ka audituar Drejtorinë e Shërbimeve mbështetëse/Sektori i Administrimit Financiar me objekt**:** Menaxhimi buxhetor dhe Fondi i rezervës në përputhje me Manualin për MFK-në (miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 në kapitullin 3.5 (Monitorimi dhe raportimi)
Auditimi ka pasur 1 (një) gjetje ku më konkretisht:
Duke analizuar treguesit (plan-fakt) të shpenzimeve të funksionit që përbëjnë përdorimin kryesor të ardhurave të AMF-së, rezulton se për vitin 2018, disa zëra shpenzimesh janë në nivele mesatare të realizimit si: ñFondi I mbështetjesò, ñShpenzime për udhëtime e dietaò, ñBlerje bojë printeri dhe fotokopjeò, ñShpenzime për ujëò, ñShpenzime për lule natyraleò, ñShpenzime për abonime brenda dhe jashtë venditò dhe ñWeb hosting dhe rikonstruksioni i faqes së internetitò ndërsa zërat me nivel të ulët ose të papërfillshëm të realizimit janë: ñShpenzime për larje automjeteshò në masën 38% ñShpenzime për riparim mirëmbajtje automjeteshò në masën 41%, ñShpenzime për mirëmbajtjen e AMF-së në masën 30%, ñBlerje inventari i imëtò në masën 20%, ñShpenzime njoftimi në mediaò nuk është realizuar, ñShpenzime për kartëvizita, licenca,kartolinaò në masën 20%, ñShpenzime për blerje librashò nuk është realizuar, ñShpenzime për Qendrën e Edukimitò në masën 10 %, ñLidhje data fibër optike me buckup site AMF2ò nuk është realizuar, ñMirëmbajtje sistemi alarmi dhe kameraò nuk është realizuar, ñIntegrimi i regjistrit elektronik të shitjeve me QKR dhe SGSò nuk është realizuar dhe ñZhvillimi i webserviseve për raportim në kohë reale të regjistrit të dëmeveò nuk

është realizuar. Gjithashtu nga zërat në shpenzime për Iime që nuk janë realizuar është ñBlerje sisteme softwareò ndërsa zëri ñBlerje pajisje të tjeraò është realizuar në masën 60 %
3)Me anë të shkresës nr. 862/4 Prot të datës 08/07/2018 auditi i brendshëm përfundoi auditimin lidhur me menaxhimin e Log-eve të qendrës së Informacionit në AMF për vitin 2018. Auditim i mbyllur me 2 gjetje
4) Me anë të shkresës Nr. 3480/5 Prot të datës 18/12/2019 auditi i brendshëm përfundoi auditimin lidhur me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare për vitin 2017 dhe 2018. Auditim i mbyllur me 3 gjetje
5) Me anë të shkresës Nr. 2817/4 Prot të datës 17/10/2019 auditi i brendshëm përfundoi auditimin lidhur me kryerjen e procedurave për prokurimet publike për periudhën 06/2018-08/2019. Auditim i mbyllur me 3 gjetje
6) Me anë të shkresës Nr. 1143/4 Prot të datës 01/07/2019 auditi i brendshëm përfundoi auditimin lidhur me ndjekjen për zbatim të vendimeve të bordit të AMF,rekomandimet e lëna në raportet e analizave financiare të ndërmjetme dhe vjetore, në raportet e inspektimit dhe çdo rekomandim tjetër që lidhet me mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit/risigurimeve për periudhën 01/01/2017-31/12/2018. Auditimi u mbyll me konstatimit se 14 vendime Bordi janë në proces zbatimi ose zbatuar pjesërisht.
7) Gjithashtu përtej planit të miratuar të auditimeve,me anë të një memoje informuese nr. 217 të datës 08/02/2019 njësia e auditit të brendshëm ka dërguar Informacion për ekzekutivin mbi procedurat e ndjekura në prokurimin me objekt ñBlerje sisteme softwareò
Nga auditimi konstatohet se në shumicën e rasteve në raportet përfundimtare nuk emërtohet drejtoria e audituar por titulli i auditimit

Observacion i subjektit: Me shkresën me nr. 41/11 prot., datë 29.09.2021, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit, mbi auditimin e ushtruar në AMF e cila është protokolluar në KLSH me nr. 845/6, datë 29.09.2021 si më poshtë:
-Kriteret e punësimit referuar rregulloreve të AMF-së parashikojnë që për pozicionin specialist të ketë 2 vite eksperiencë pune, për pozicionin drejtor drejtorie 5 vite eksperiencë në profesion dhe për pozicionin drejtor departamenti 7 vite eksperiencë në profesion,ndërkohë për pozicionin kryespecialist duhet të ketë dhe 6 vite punë në autoriet.AMF do të rishikojë rregulloren nr. 17- të datës 14.08.2019 ñPër marrëdhëniet e punës të punonjësve në AMFò
Qëndrimi i audituesve shtetëror të KLSH:Grupi i auditimit nuk vendoset përpara observacioneve të reja për gjetjen e evidentuar

Gjetja Nga auditimi janë konstatuar mangësi nisur nga kriteret e pozicionit sipas përshkrimeve të punës dhe emërimeve.

Situata: Në referim të rregullores për marrëdhëniet e punës të punonjësve në AMF, specialistët, nisur nga kriteret e pozicionit sipas përshkrimeve të punës kërkojnë shtesë dhe një përvojë pune 2 vjeçare, ndërsa personat që kandidojnë për pozicionin Drejtor Drejtorie duhet të kenë përveç kërkesave të tjera edhe të paktën 5 vite eksperiencë në institucion, ndërsa personat që kandidojnë për Drejtor Departamenti përveç kërkesave të tjera duhet të kenë edhe të paktën 7 vite eksperiencë pune. Rregullorja për marrëdhëniet e punës gjithashtu në një nen tjetër të saj parashikon gjithashtu kriteret për pozicionin e kryespecialistit ku kërkon përvojë pune në institucion mbi 6 vjet. Rregullorja e marrëdhënieve të punës ka një kontradiktë ku pozicioni i kryespecialistit ka kritere shumë më të forta dhe më të mëdha plotësimi se ai i Drejtorit edhe pse në gradën e organikës dhe në nivelin e pagës është në rang më të ulët se ai i drejtorit.

Kriteri: Neni 14 i rregullores për marrëdhëniet e punës të punonjësve në AMF të

miratuar me Vendimin e Bordit nr. 170 të datës 14.08.2019.

Impakti: Mos barazi kriteresh për pozicionet e punës

Shkaku: Mos ndryshimi i rregullores

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Nga ana e AMF të kryhen ndryshimet në rregulloren për marrëdhëniet e punës punonjësve në AMF të miratuar me vendimin e bordit nr. 170 datë 14.08.2019, sipas pozicioneve të punës duke rishikuar sipas shkallës hierarkike kriteret për rekrutim/punësim në harmonizim me kompetencat/detyrat përgjegjësitë sipas pozicionit dhe nivelit të përcaktuar të shpërblimit për këto pozicione.

IV.2. Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, treguesit dhe qëndrueshmëria financiare.

Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, treguesit dhe qëndrueshmëria financiare mbi përputhshmërinë e aktivitetit në Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Realizimi i të ardhurave për vitin 2019;
- Realizimi i të ardhurave për 8- mujorin e vitit 2020;
-Dokumentacioni i vënë në dispozicion për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe 2020 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,
- marrja e opinioneve nëpërmjet pyetësorëve për disa tregues që kanë të bëjnë kryesisht me programimin, realizimin e të ardhurave e shpenzimeve, llogaritjes së fondit rezervë e shpërndarjes së tij, gjobat, klasat e siguruara sipas legjislacionit me % e tarifës mbikëqyrjes, aftësinë pagese të kompanive të sigurimeve, struktura e tregut të sigurimeve, etj.

Nëpërmjet pyetësorëve drejtuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mbi disa nga treguesit qëndrueshmërisë financiare kryesisht që kanë të bëjnë kryesisht me programimin, realizimin e të ardhurave e shpenzimeve, llogaritjes së fondit rezervë e shpërndarjes së tij, gjobat, klasat e siguruara sipas legjislacionit me % e tarifës mbikëqyrjes, aftësinë pagese të kompanive të sigurimeve, struktura e tregut të sigurimeve, etj., rezultoi:

- nga AMF nuk u vunë në dispozicion të dhëna mbi shpenzimet nga planifikimi i tyre deri tek realizimi gjë që pengoi në analizën e tyre krahasuar me të ardhurat dhe tregues të lidhur me to për të arritur në konkluzione më të sakta mbi qëndrueshmërinë financiare të AMF, apo analizën e tregut të sigurimeve,
- megjithatë në bazë të dokumenteve të vëna në dispozicion si dhe kryqëzimi i tyre me njëra tjetrën, disa nga problematikat që u konstatuan janë: mbi në hartimin dhe realizimin planit të ardhurave; luhatjet e çmimeve të primeve; mos pagesave të dëmeve dhe aftësia e ulët pagese e kompanive të sigurimit,gjithashtustruktura e tregut të sigurimeve, vijon të mbetet e orientuar tek Sigurimet e Jo-Jetës ku sigurimi i detyrueshëm dominon, etj., janë disa nga treguesit e trajtuar më poshtë:

*****

Procedura ndjekura në planifikimit të ardhurave për vitet 2019-2020

Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare është institucion financiarisht i pavarur dhe financohet me burime të veta e për pasojë planifikimi i të ardhurave në realizohet në zbatim të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 ndryshuar me ligjin 54/2014, neni 26 dhe 27 i tij si dhe Vendimit të Bordit nr. 144, datë 2010.2017 ñPër miratimin e rregullores për hartimin, ndjekjen, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiareò neni 7 e konkretisht:

Në zbatim të ligjit: Të ardhurat e Autoritetit krijohen nga:

Neni 26

a) tarifat e mbledhura, në zbatim të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi;

b) gjobat e vendosura, në zbatim të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe penalitetet e vendosura për pagesat e vonuara të tarifave, të përcaktuara në nenin 27 të këtij ligji;

c) dhënia me qira e ambienteve në pronësi të Autoritetit;

ç) Investimi në depozita Bre apo titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë;

d) burime dhe veprimtari të tjera të lejuara nga ky ligj ose legjislacioni në fuqi.

Të ardhurat e Autoritetit përdoren:

a) për të mbuluar shpenzimet që kryen Autoriteti në përmbushje të përgjegjësive të tij, të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi;

b) për të kryer Iime apo zbatuar projekte në përmbushje të përgjegjësive të tij, të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi;
c) për të krijuar dhe mbajtur fondin e rezervës. Me ñfond rezervëò, për qëllime të këtij ligji, kuptohet fondi, në të cilin alokohet diferenca pozitive ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit ushtrimor dhe që shërben për të mbuluar diferencën negative ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit ushtrimor. Alokimi i të ardhurave në fondin e rezervës kryhet derisa ky fond të arrijë nivelin mesatar gjashtëmujor të buxhetit të Autoritetit për tre vitet e fundit.

Në zbatim të rregullores:
Neni 7
1.Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjësi i gjithë procesit të buxhetimit, ku përfshihet hartimi, ndjekja, zbatimi, kontrolli, analizimi dhe raportimi.
2. Drejtoria e shërbimeve Mbështetëse bashkëpunon dhe mbështet departamentet dhe drejtoritë në procesin e hartimit të buxhetit sipas natyrës së punës dhe përgatit për ta tabela të ecurisë së të ardhurave apo shpenzimeve të realizuara në vite dhe në vitin korrent si dhe parashikimin për të pritshmin e këtyre kategorive në nivel elementi.
Neni 8
1.Grupi për hartimin e buxhetit ngrihet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe përbëhet nga kryetari, i cili në të gjitha rastet është nëndrejtori Ekzekutiv dhe anëtarët e tjerë, drejtorë të departamenteve, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.
2. Grupi i hartimit të buxhetit punon sipas një kalendari që përcakton fazat e hartimit deri tek miratimi.
Departamentet dhe Drejtoritë raportojnë në Drejtorinë e shërbimeve Mbështetëse/Sektori i Administrimit Financiar një sërë treguesish sipas përkatësisë së objektit të punës së tyre dhe që vlerësohen të nevojetëshme për përgatitjen e projekt buxhetit dhe ndjekjen e ecurisë së zbatimit të tij.
Sektori i administrimit Financiar, mbi bazën ë treguesve të raportuar, planifikon zërat e buxhetit dhe i diskuton me Departamentet dhe Drejtoritë e konkretisht, në zbatim të këtyre detyrimeve ligjore sipas të dhënave të vëna në dispozicion në planifikimin e të ardhurave për vitin 2019 dhe 2020 janë ndjekur këto procedura:
Për vitin 2019

- Për hartimin e projekt buxhetit të AMF për vitin 2019 është ngritur grupi i punës në bazë të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 156, datë 20.06.2018 me shkresën nr. 2199, datë 20.06.2018 me anëtarë:
  1. MK (kryetar)
  2. AR anëtar
  3. FM (anëtar)
  4. MV (anëtar)
  5. HL (sekretar)
- Në përfundim të takimeve Bordi ka dalë më vendimin nr.220, datë 26.11.2018 ñPër miratimin e buxhetit të vitit 2019 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiareò e konkretisht:

I.	**Të ardhura** (mijë lekë)	**viti 2019**
	Të ardhura gjithsej	**335 600**
	Nga të cilat:	
	Të ardhura nga tregu i sigurimeve	*291 960*
	Të ardhura nga tregu i letrave me vlerë	*41 611*
	Të ardhura Shoq Adm të F të pens dhe Licenca	*1 761*
	Të ardhura të tjera(interesa banke, konver valutë, etj.)	*268*
II.	**Shpenzime (mijë lekë)viti 2019**	
	Shpenzime gjithsej	**335 600**

Nga të cilat:
Shpenzime funksionimi *245 670*
Shpenzime Administrative *49 330*
Iime *40 600*

- Për të arritur në përfundimet e mësipërme janë realizuar disa takime të cilat janë të konfirmuar më e-mailet përkatëse ku janë shqyrtuar edhe të dhënat e paraqitura në formë tabelore të kërkuara më parë apo dhe informacione më të detajuara e konkretisht:
  - takimi sipas e-mail datë 25.09.2018, 31.08.2018, 12.07.2018, shkresës nr. 2199/1, datë 10.07.2018, e-mail datë 12.07.2018, e-mail datë 17.10.2018,
  - informacionit nëpërmjet e-mail të datë 02.10.2018 të z. Arjanit Muja i cili nga analiza e tregut për parashikimin e primit të shkruar bruto për vitin 2018 ka marrë në konsideratë:
    - rritjen me 6.28 % të primeve të shkruara për shoqëritë jo J(për periudhën janar gusht 2018 krahasuar me një vit më parë),
    - uljen me 2.16 % të primeve të shkruara bruto për shoqëritë e Jetës (për periudhën janar gusht 2018 krahasuar me një vit më parë,
    - efektin sezonal (priten të shkruhen më shumë kontrata në muajin dhjetor për MTP dhe **Jn** për hua)
    - rritjen natyrore (për produktet e sigurimit vullnetar nuk është arritur akoma potenciali)
    - vlera e pritshme e primeve të shkruara bruto **për vitin 2018 do të J në nivelin** 17.5 deri në 18 miliardë lekë (pra një rritje e pritshme e primeve nga 8-11 %) Kështu që parashikohet që të ardhurat nga primet e shkruara bruto për (AMF) të jenë në nivelin 270.000 mijë lekë. Pra 270.000 mijë lekë duhet të ishte plani i vitit 2018.

      Për sa i përket projektit të vitit 2019 për kontributin e shoqërive të sigurimeve niveli 304 158 mijë lekë është shumë optimist, d.m.th. që volumi i primeve të shkruara bruto duhet të arrijë shifrën 20.3 miliard lekë në vitin 2019. (nga 16.2 miliard lekë që është në vitin 2017)

      Për këtë sugjeron se bazuar në koniunkturën e tregut si dhe në trendin ndër vite, që shifra e **duhur duhet të J 290.000 mijë** lekë e cila reflekton volumin e primeve të shkruara bruto për 2019 në vlerën 19.3 miliardë lekë (pra rreth 19.4 % më shumë se PSHB të 2017, ose një rritje mesatare prej 9.7 % për 2018 dhe 2019.
  - informacionit nëpërmjet e-mail të datë 31.07.2018 të znj. Menka Marku (zyra e licencimeve DMST) i cila në zbatim të shkresës drejtorit të përgjithshëm jep mendimet për parashikimin e pritshëm të treguesve për vitin 2018 dhe projektin e tyre për 2019 për zërat e të ardhurave në tregun e sigurimeve nga kontributet e shoqërive të sigurimit, miratimet/licencimet/autorizimet e subjekteve fizikë dhe juridike.

    Në tërësinë e tyre realizimi i pritshëm i këtyre treguesve për vitin 2018 bazohet në realizimin si 4 mujor, në vendimet e marra për miratime/licencime/autorizime deri me 31.07.2018 dhe në subjektet fizike dhe juridike që janë në proces miratime/licencime/autorizime dhe parashikohet te finalizohen deri në fund te 2018.

    Lidhur me parashikimin e tyre për vitin 2019 jemi bazuar në shprehjen e interesit të subjekteve për miratime/licencime/autorizime, që akoma nuk kanë aplikuar në AMF, në përfundimin e afateve të licencave në disa profesione si vlerësues, aktuarë, mandatet e drejtorëve ekzekutivë të shoqërive, anëtarë të këshillave mbikëqyrës të shoqërive, miratim bashkim të shoqërive të sigurimit.

Në projektin e shifrës për të pritshmin e vitit 2018 dhe parashikimin e 2019 nga kontributi i shoqërive të sigurimit është mbajtur parasysh:

- baza për kryerjen e parashikimit kanë qenë primet e shkruara bruto në nivel tregu, historiku i konsideruar 5 vitet e fundit,

- parashikimi i rishikuar për vitin 2018 është bazuar në peshën e të ardhurave të realizuara për 4 mujorin e për ndër vite krahasuar me totalin e vitit (parashikimi rreth 30 % e të ardhurave të realizuara në 4 mujorin e parë)
- për realizimin e pritshëm për 2018, ky parashikim është projektuar për vitin dhe është konsideruar një rritje rreth 13 % bazuar në mesataren reale të rritjes së primeve të shkruara bruto,
- për vitin 2019, parashikimi i pritshëm për vitin 2018 është projektuar duke marrë në konsideratë një rritje prej rreth 13 % bazuar në mesataren reale të rritjes së primeve të shkruara bruto për 5 vitet e fundit të plota ushtrimore.
- Gjithashtu janë dhënë mendime për disa zëra në shifra të vogla dhe më të detajuara me nr. personash, shoqëri sigurimi, B, drejtues shoqërish apo administratorësh, etj. e konkretisht për zërat:

- ñshoqëri sigurimiò, ñshoqëri brokerimi, B brokerò , ñshoqëri agjentësh + B agjent + subjekte të tjera agjentëò, ñbrokera persona fizikëò ñagjentë persona fizikëò ñvlerësuesò, ñaktuarëò dhe zërin ñtë tjeraò.
    - Informacione të kërkuara në formë tabelore sipas e-mail datë 17.10.2018 ku dërgohet edhe pasqyra përkatëse e projekt buxhetit, e-mail datë 12.07.2018

Për vitin 2020

- Për hartimin e projekt buxhetit të AMF për vitin 2020 është ngritur grupi i punës në bazë të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 160, datë 14.06.2018 me shkresën nr. 1964, datë 14.06.2018 me anëtarë:
    1. AR (kryetar)
    2. FM (anëtar)
    3. EK (anëtar)
    4. AD (anëtar)
    5. AM (anëtar)
    6. HL (sekretar)
- Në përfundim të takimeve Bordi ka dalë më vendimin nr.208, datë 22.11.2019 ñPër miratimin e buxhetit të vitit 2020 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiareò e konkretisht:

I.	**Të ardhura** (mijë lekë)	**viti 2020**
	Të ardhura gjithsej	**365 370**
	Nga të cilat:	
	Të ardhura nga tregu i sigurimeve	*316 220*
	Të ardhura nga tregu i letrave me vlerë	*46 000*
	Të ardhura Shoq Adm të F të pens dhe Licenca	*2 350*
	Të ardhura të tjera(interesa banke, konver valutë, etj.)	*800*

II.	**Shpenzime (mijë lekë)viti 2020**	
	Shpenzime gjithsej	**365 370**
	Nga të cilat:	
	Shpenzime funksionimi	*365 370*
	Shpenzime Administrative	*0 000*
	Iime	*0 000*

- Për të arritur në përfundimet e mësipërme janë realizuar disa takime të cilat janë të konfirmuar më e-mailet përkatëse ku janë shqyrtuar edhe të dhënat e paraqitura në formë tabelore të kërkuara më parë apo dhe informacione më të detajuara e konkretisht:
    - Kërkohet të dhëna mbi hartimin e projekt buxhetit të vitit 2020 sipas e-mail datë 03.07.2019, ku bashkangjitur është tabela përkatëse dhe shkresës nr. 2128, datë 01.07.2019, ñMbi hartimin e projektbuxhetit të vitit 2020ò të Drejtorit Përgjithshëm,
    - informacionit nëpërmjet e-mail të datë 09.07.2019 të z. Dritan Varfi i cili bashkëngjit tabelën e parashikimit të buxhetit për vitin 2019 e plotësuar vetëm për zërin të ardhura

nga primet e shkruara të sigurimeve (i pritshëm për vitin 2019 dhe projektimi për vitin 2020). Bazuar në realizimet nga viti 2012, parashikohet që i pritshmi për vitin 2019 të J 270.000 mijë lekë, duke u luhatur në diapazonin 267.000 mijë lekë dhe 272.000 mijë lekë. Një luhatje +/- 5% është mësa e pranueshme, ndërkohë që faktorët që e bëjnë të vështirë parashikimin e buxhetit janë kryesisht:

- fakti që kemi liberalizim të tarifave dhe për këtë arsye primet e shkruara mund të luhaten ndjeshëm dhe në mënyrë të paparashikueshme,
- MTPL zë pjesën dërmuese të primeve të shkruara mbi 60 % dhe ecuria e këtij produkti është vendimtar në të ardhurat e parashikuara, por ndërkohe duket sikur rritja nga viti në vit po ngadalësohet, gjë që mund të vijë si rezultat i ngopjes së tregut (ngadalësim të rritjes së numrit të automjeteve që shtohen)
- Parashikimi për vitin 2020 bazohet në realizimet e plota për vitet 2012-2018 si dhe në historikun e realizimit 4-mujor për vitin korrent 2019 dhe akoma jo në realizimin e plotë real për vitin 2019 gjë që do të ishte më e saktë se sa projektimi për vitin 2019 bazuar në realizimin 4-mujor

000 leke

Viti	Plani	Realizimi vjetor		Realizimi 4-mujor
2014	126,000	177,383		51,047
2015	144,000	208,648		60,468
2016	192,000	228,178		61,561
2017	259,000	240,609		70,155
2018	263,000	251,741		72,572
2019	290,000	270,000	I Pritshëm	78,897
2020	290,000			

- informacionit nëpërmjet e-maileve të datës 04.11.2019 (dy) të z. DV i cili njofton se projekt buxheti i vitit 2020 është rishikuar duke marrë në konsideratë edhe disa zhvillime të muajve të fundit si:
  - licencimi i një shoqërie të re sigurimi në klasat J (A J sh.a.),
  - dizenjimi i një produkti të ri sigurimi (të detyrueshëm) ñPërgjegjësitë Civile të Ndërtuesitò,
  - ñSigurimi i Jetes së Punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimitò (për zjarrfikësit) i cili pritet të bëhet efektiv duke filluar nga data 01.01.2020,
  - Në e-mailin e dytë të po kësaj date sqaron e dhe një herë se:
    - të ardhurat nga tregu i sigurimeve përbëhen nga këto zëra:
      - kontributi i shoqërive të sigurimeve,
      - të ardhurat nga licencimi në tregun e sigurimeve
      - planifikimi i të ardhurave për zërin ñKontributi i shoqërive të sigurimeveò për vitin 2020 është kryer duke marrë parasysh ñmedianënò e ndryshimeve të viteve 2014-2018 të vlerave reale dhe duke e shumëzuar me planin e të ardhurave të shoqërive për vitin 2019 i cili është bazuar në vitet paraardhëse si dhe në historikun e realizimit 8-mujor të vitit korrent 2019. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto zënë 99.5 % të ardhurave të tregut të sigurimeve. Në krahasim me planin e vitit 2019, ky zë është planifikuar 2.4 milion leke me shumë dhe faktorët e cilësuar më sipër.
      - Për sa më sipër, pritet që për vitin 2020 niveli i të ardhurave nga tregu i sigurimeve të arrijë në shifrën rreth 314 milionë lekë me një luhatje prej +/- 5 % (kjo për arsye se kemi një treg të liberalizuar por edhe për faktin se parashikimi

për vitin 2020 kryhet mbi të dhëna historike për vite më parë, dhe mbi të dhëna mbi projektimin e vitit të fundit 2019 dhe jo mbi realizimin aktual të tij)

000 leke

Viti	Plani	Realizimi vjetor		Realizimi 4-mujor
2014	126,000	177,383		51,047
2015	144,000	208,648		60,468
2016	192,000	228,178		61,561
2017	259,000	240,609		70,155
2018	263,000	251,741		72,572
2019	290,000	270,000	I pritshëm	78,897
2020	314,000			

Gjithashtu nga të dhënat dhe informacioni i përgatitur nga Zyra e Licencimit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve (DMTS), mbi parashikimin e të ardhurave nga licencimet, miratimet, autorizimet e subjekteve fizikë dhe juridikë në tregun e sigurimeve për projektbuxhetin e vitit 2020 janë marrë parasysh:

- ✓ treguesit e të ardhurave realizuar në 4 mujorin e parë të vitit 2019 (që janë të konfirmuara me Sektorin e Financës së AMF;
- ✓ aplikimet dhe praktikat që janë në proces dhe që pritet të përfundojnë brenda vitit 2019;
- ✓ kërkesat e reja për licencim/autorizim apo miratim veprimtarish në sigurime dhe ri sigurime të mundshme për tâu paraqitur në AMF brenda 2019,
- ✓ të ardhurat e pritshme për tâu realizuar brenda 2019 nga licencimi/autorizimi/miratimi i subjekteve fizikë dhe juridikë dhe miratimet e ndryshme në tregun e sigurimeve.

Lidhur me planifikimin e këtyre treguesve për vitin 2020 janë marrë në konsideratë numri i vlerësuesve, aktuarëve, anëtarëve të KM/KA të shoqërive të sigurimit, Administratorëve/ Drejtorëve të tyre, të cilët kanë licenca ose mandate me afat, i cili përfundon brenda 2020 dhe probabiliteti që të gjithë ose një numër më i vogël i tyre të vazhdojnë procedurat për rinovimin e tyre, interesi i treguar për licencime të reja nga aplikime të mundshme.

Në tabelën e mëposhtme të ardhurave, janë treguesit e planifikuar për dy kolonat e fundit të saj: Treguesit e Realizimit të pritshëm të 2019 dhe Planifikimin e tyre për 2020.

Tabela e të ardhurave

000/ Lekë

Emërtimi	Fakti 2018	Plani vjetor 2019	Realizimi 4 mujorit të parë 2019	Realizimi i pritshëm 2019	Plani për vitin 2020
I. Të ardhura				**2.140**	**1.850**
I.1. Të ardhura nga tregu i sigurimeve .	257,809	291,960	79,505	**-**	**-**
I.1.1. Kontributi i shoqërive të sigurimeve .	253,212	290,100	79,218	**-**	**-**
I.1.1.1. Shoqëria e sigurimeve.	251.741	290,000	78,898	**-**	**-**
I.1.1.2. Miratime të ndryshme në tregun e sigurimeve.	105	100	10	**80**	**220**
I.1.1.3. Tarifë nga shoqëri brokerimi	1.366	-	310	**-**	**-**
I.1.2. Të ardhura nga Licencimet	4,597	1,860	287	**2.060**	**1.630**
I.1.2.1. Shoqëri sigurimi (licencime të reja ose zgjerim licence).	20	250	-	**20**	**250**
I.1.2.2. Shoqëri brokerimi.	150	50	30	**80**	**50**
I.1.2.3. Shoqëri agjentësh, B dhe subjekte të tjera agjentë.	122	110	34	**220**	**220**
I.1.2.4. Brokera persona fizikë.	412	110	-	**110**	**110**
I.1.2.5. Agjentë persona fizikë.	3.371	530	133	**1.000**	**500**
I.1.2.6. Vlerësues dëmesh.	432	660	90	**410**	**400**
I.1.2.7. Aktuarë.	90	150	_	**220**	**100**
I.1.2.8. Te tjera.					

Gjithashtu janë dhënë mendime për disa zëra të ndryshme në tregun e sigurimeve në shifra të vogla dhe më të detajuara me nr. personash, shoqëri sigurimi, B, drejtues shoqërish apo administratorësh, etj. e konkretisht për zërat:

- ✓ Shoqëri sigurimi (licencim i ri apo zgjerim licence).
- ✓ Shoqëri brokerimi,
- ✓ Shoqëri agjentësh, B dhe subjekte të tjera si agjentë.
- ✓ Brokera persona fizike.

- ✓ Agjentë persona fizikë.
- ✓ Vlerësues dëmesh,
- ✓ Aktuarë.

*****

Gjithashtu një fenomen tjetër i analizuar për planifikimin e të ardhurave nga AMF, janë të ardhurat që realizohen nga tarifat e mbledhura në zbatim të legjislacionit në fuqi nëpërmjet tarifës mbikëqyrjes si dhe tarifave fikse për licencime e veprimtari të ndryshme të kryera nga AMF e konkretisht:

- ✓ Klasat e siguruara sipas legjislacionit janë 23 dhe janë të renditura si më poshtë:

1. ***Sigurimi i aksidenteve*** përfshin plagosjet industriale dhe sëmundjet profesionale.
2. ***Sigurimi i sëmundjeve*** mbulon të ardhura fikse financiare nga paaftësia shëndetësore si dhe rimbursimin e shpenzimeve të trajtimit spitalor.
3. ***Sigurimi i mjeteve tokësore*** (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina) mbulon dëmtimet ose humbjet nga mjetet tokësore motorike dhe mjete tokësore jo motorike.
4. ***Sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina*** mbulon dëmtimet ose humbjet nga mjetet lëvizëse mbi shina.
5. ***Sigurimi i avionëve*** mbulon dëmtimet ose humbjet e pësuara nga mjetet ajrore.
6. ***Sigurimi i anijeve***mbulon dëmtimet ose humbjet e pësuara nga anijet lumore dhe të kanaleve; anijet e liqeneve; anijet detare.
7. ***Sigurimi i mallrave në transport*** (përfshirë mallra, bagazhe dhe të gjitha llojet e tjera të sendeve) mbulon të gjitha dëmtimet ose humbjet e mallrave gjatë transportit ose bagazhet, pavarësisht nga mënyra e transportit.
8. ***Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës*** mbulon dëmtimin ose humbjen e sendeve të ndryshme nga ato të përfshira në pikat 3-7 të shkaktuara nga: zjarret, shpërthimet, stuhitë, forcat e natyrës, energjia nukleare, shkarja e tokës.
9. ***Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë*** mbulon të gjitha dëmtimet ose humbjet në pasuri (të ndryshme nga ato që përfshihen në pikat 3-7) kur dëmi është shkaktuar nga breshëri ose nga ngrica dhe çdo ngjarje e tillë, si vjedhja, të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 8
10. ***Sigurimi i përgjegjësive civile nga përdorimi i automjeteve*** mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i automjeteve mbi tokë (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).
11. ***Sigurimi i përgjegjësive civile nga përdorimi i avionëve*** mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i avionëve (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).
12. ***Sigurimi i përgjegjësive civile për anijet*** (detare, të liqeneve dhe të lumenjve, si dhe ato të kanaleve) mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i anijeve ose barkave (anije të vogla), që lundrojnë në dete, liqene, lumenj dhe kanale lundrimi (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).
13. ***Sigurimi i përgjegjësive civile të përgjithshme*** mbulon të gjitha përgjegjësitë, përveç atyre të përmendura në pikat 10-12.
14. ***Sigurimi i kreditit***mbulonrrezikun e mos pagesës për shkak të paaftësisë pagese, kreditë e eksportit, kreditë e shlyera me këste, kreditë hipotekare, kreditë bujqësore.
15. ***Sigurimi i garancive*** mbulon garancitë e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta
16. ***Sigurimi i humbjeve të ndryshme financiare*** mbulon humbjet financiare të shkaktuara si pasojë e: rrezikut në punësim, pamjaftueshmërisë së të ardhurave, motit të keq, humbjes së të ardhurave, shpenzimeve të përgjithshme të paparashikuara, shpenzimeve T të paparashikuara, humbjes së vlerës në treg, humbjes nga qiratë ose të ardhurat, humbjes nga tregtimi, humbjeve të tjera financiare.
17. ***Sigurimi i mbrojtjes ligjore*** mbulon shpenzimet për shërbimet ligjore dhe ato gjyqësore.
18. ***Sigurimi i asistencës*** ndihmon personat që kanë vështirësi gjatë udhëtimeve ose në çaste të tjera të largësisë nga shtëpia ose vendbanimi i përhershëm.

19. ***Sigurim Jetes - vdekje*** mbulon sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar, sigurimin për vdekjen, sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme, sigurimin e Jetës me kthim të primeve.
20. ***Sigurim martesë - lindje*** mbulon shpenzimet që shoqërojnë martesën ose lindjen e fëmijëve.
21. ***Sigurim Jetes i lidhur me fonde të Investimeve*** mbulon sigurimin e Jetës, të lidhur me aksione në fondet e Investimeve , ku i siguruari merr përsipër rrezikun e Investimit në lidhje me vlerën e aksioneve ose letrave të tjera me vlerë.
22. ***Sigurimi i administrimit të fondeve kolektive***mbulon sigurimin e individëve të bashkuar për qëllime të kapitalizmit të kontributeve të tyre dhe shpërndarjes së aktiveve në raport me fondet e akumuluara midis personave që kanë arritur një moshë të caktuar ose midis përfituesve të sigurimit, në rast vdekje të personave të caktuar.
23. ***Sigurimi i fondeve për pagesa*** mbulon sigurimin e Jetës së bazuar në llogaritjet aktuale, sipas të cilës, në këmbim të një pagese të vetme ose periodike të rënë dakord paraprakisht, i siguruari dëmshpërblehet për periudhën e caktuar dhe shumën përkatëse.

- ✓ Si dhe tarifa për depozitim dokumentacioni dhe tarifa licencimi e miratime që variojnë nga 5000 lekë deri në 250000 lekë,
- ✓ Në tabelën e mëposhtme janë të përcaktuar përqindjet e tarifës që aplikohet nga AMF për realizimin e të ardhurave në ushtrim të veprimtarisë së saj në tre vitet e fundit 2017-2019 nga ku rezulton se në vitin 2018 janë miratuar disa tarifa të reja për Brokera në sigurime, Brokera në letra me vlerë të qeverisë dhe B dhe B e titujve.

Tabelë përqindja e tarifës mbikëqyrjes viti 2017, 2018 dhe 2019

		Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Nr.	Emërtimi	fee ligjore	fee ligjore	fee ligjore
1	Tregu i Sigurimeve			
a	- Shoqëritë e Sigurimit (fee me %)	1.50%	1.50%	1.5%
b	- Brokerat dhe Agjentët Licencime (tarifa fikse)	n/a	n/a	n/a
c	- Brokerat ne sigurime (fee ne %)		0.20%	0.2%
2	Tregu i kapitaleve			
a	- Fondet e Investimeve administruese	0.05%	0.05%	0.05%
b	- Fondet e Investimeve depozitare	0.01%	0.01%	0.01%
c	- Brokerat ne LV. Qeverise dhe B (fee ne %)	n/a	0.002%	0.002%
d	- B e titujve (fee ne %)	n/a	0.001%	0.001%
e	- Brokerat dhe Agjentët Licencime (tarifa fikse)	n/a	n/a	n/a
3	Tregu i Pensioneve			
a	- Fondet e pensioneve administruese	0.05%	0.05%	0.05%
b	- Fondet e pensioneve depozitare	0.01%	0.01%	0.01%
c	- Licencime (tarifa fikse)	n/a	n/a	n/a

*****

Për sa më sipër nga analiza e këtyre të dhënave të nëbazëtë dokumentacionit vënë në dispozicion mbi procedurat e planifikimit të ardhurave vërehet së megjithëse kemi 23 klasa të siguruara sipas legjislacionit rezulton se një pjesë e mirë e tyre nuk konsiston të realizohet apo përdoret për tu siguruar nga konsumatori ose subjekte si dhe nuk planifikohen si të ardhura në strukturën e parashikimeve për vitin pasardhës nga AMF e cila duhet të jetë në vëmendjen e saj si element i rëndësishëm në shtrirjen e tregut të sigurimeve. Gjithashtu rezulton se rritja e të ardhurave është planifikuar se kryesisht do të vijë nga produkte të detyrueshme me ligj si ñPërgjegjësitë Civile të Ndërtuesitò apoñSigurimi i Jetes së Punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimitò gjë e cila tregon edhe një herë se tregu i sigurimeve përbëhet kryesisht nga ai i detyrueshëm pra kompanitë dhe AMF realizojnë të ardhurat e veprimtarisë tyre në një treg të sigurt dhe të sanksionuar me ligj i cili detyron konsumatorët të sigurohen.

*****

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi planin dhe realizimin e të ardhurave për periudhën e viteve 2016-2020 si dhe llogaritja e paradhënies nga ana e AMF e rezulton:

Plani dhe realizimi i të ardhurave për periudhën 2016-2020

000/lekë

EMERTESA	2016		2017		2018		2019		2020
	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
I. TE ARDHURAT (I.1+I.2+I.3+I.4+I.5)	**242,852**	**297,968**	**312,036**	**296,819**	**340,357**	**318,358**	**335,600**	**315,191**	**365,370**
I. 1 Tarifat e mbledhura nga:	242,852	277,746	311,516	291,584	340,179	302,588	335,332	312,474	364,570
-tregu i sigurimeve,	193,226	232,051	261,776	244,507	290,150	257,740	291,960	266,111	316,220
-tregu i titujve,	2,925	3,153	3,265	3,038	3,795	3,157	3,570	3,608	4,000
-tregu i Investimeve kolektive,	46,003	41,747	45,374	43,215	44,978	40,312	38,041	41,093	42,000
-tregu i pensioneve vullnetare,	698	795	1,101	824	1,256	1,379	1,761	1,662	2,350
I.2 Gjobat e vendosura	-	14,100	-	150	-	14,920	-	2,200	500
I. 3 Dhënia me qira e ambienteve ne pronësi te Autoritetit	-	-	-	-	-	-	-		
I.4 Investimi ne depozita Bre apo titujt Qeverise	-	392	-	346	178	270	268	392	300
I.5 Burime dhe veprimtari te tjera	-	5,729	520	4,739	-	580	-	125	

Llogaritja e paradhënies për periudhën 2016-2019

000/lekë

Llogaritja e Paradhenies	2016	2017	2018	2019
Të ardhura	297,968	296,819	318,358	315,191
Shpenzime	195,948	237,458	242,631	289,121
Alokimi i Fondit Rezervë	18,309	-	52,503	15,458
Paradhënia	**83,711**	**59,361**	**23,224**	**10,612**

- Nga analiza e rezultatit të paradhënies rezulton se ajo nga viti në vit ka ardhur duke u ulur si rezultat i rritjes së shpenzimeve të AMF. Grafiku më poshtë.



- Nga analiza e raportit plani i të ardhurave me planin e shpenzimeve nëse këtë të fundit e marrim të mirëqenë sipas planifikimit për vitin 2019 dhe 2020 ku planifikimi i shpenzimeve ka qenë i barabartë me planifikimin e të ardhurave rezulton se kemi rritje vit pas viti të tyre pothuajetëse të njëjtë, por nuk mund të analizojmë pse janë rritur shpenzimet dhe në cilin zë për mungesë informacioni. Grafiku si më poshtë:



- Nga analiza e raportit të realizimit të ardhurave faktike me shpenzimet për periudhën 2016-2019 rezulton se shpenzimet janë rritur nga viti në për tu përafruar në vitet e fundit por

këtë fenomen nuk mund të analizojmë konkretisht se në çfarë zëri janë rritur shpenzimet për mungesë informacioni të llojit shpenzimeve. Grafiku si më poshtë:



- Nga analiza e raportit të realizimit të shpenzimeve për periudhën 2016-2019 me rimbursimin e të ardhurave (diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve) tregon rritjen e shpenzimeve dhe uljen e rimbursimeve nga AMF, ku mund të themi se nuk i janë rimbursuar vlerat përkatëse kompanive të sigurimit se janë rritur shpenzimet e AMF, megjithëse këtu mund të themi që meqenëse kompanitë e derdhin kontributin ai mund të përdoret në një fushë tjetër e cila duhet të sanksionohet me ligj. Edhe këtë fenomen nuk mund ta analizojmë konkretisht për mungesë informacioni. Grafiku si më poshtë:



*****

Gjithashtu një tregues tjetër i veprimtarisë së AMF janë dhe gjobat e vendosura nga ana e saj për shkelje të legjislacionit të cilat janë pjesë e të ardhurave. Nga të dhëna dhe auditimi rezulton se gjobat regjistrohet dhe janë pjesë e të ardhurave që realizon AMF gjatë vitit ushtrimor e nëse rezultojnë më të mëdha se shpenzimet tepricat (diferenca te ardhura ï shpenzime) ju kthehen shoqërive të sigurimit sipas kontributit tyre në realizimin e të ardhurave, çka do të thotë se nëse shoqëritë e sigurimit që mund të jenë gjobitur për shkelja të ndryshme ajo ju kthehet përsëri atyre po në një formë tjetër. Ky fenomen mund të jete ñfrenuesò në vendosjen e penaliteteve ose gjobave ndaj shkeljeve të ndryshme me pretekstin se ato mund tõju kthehen përsëri subjekteve që kanë vepruar në kundërshtim më ligjin. Konkretisht gjobat e vendosura për periudhën 2016-2020 të cilat kanë ardhur gjithmonë duke u ulur janë :

Nr.	Vendime viti 2016	Subjekti i sanksionuar	Vlera e gjobës	Arkëtuar
1	Nr. 12, datë 25.01.2016	Drejtorit të E sh.a	100,000	100,000
2	Nr. 13, datë 25.01.2016	Drejtorit të A sh.a	100,000	100,000
3	Nr. 108, datë 07.07.2016	Shoqërisë E sh.a	2,000,000	2,000,000
4	Nr. 118, datë 19.07.2016	Shoqërisë I sh.a	1,000,000	1,000,000
5	Nr. 117, datë 19.07.2016	Shoqërisë A sh.a	1,000,000	1,000,000
6	Nr. 141, datë 29.09.2016	Drejtorit të E sh.a	300,000	300,000
7	Nr. 142, datë 29.09.2016	Shoqërisë I sh.a	300,000	300,000
8	Nr. 159, datë 03.10.2016	Shoqërisë A sh.a	1,000,000	1,000,000
9	Nr. 160, datë 03.10.2016	Shoqërisë I sh.a	1,000,000	1,000,000
10	Nr. 161, datë 03.10.2016	Shoqërisë S sh.a	1,000,000	1,000,000
11	Nr. 162, datë 03.10.2016	Shoqërisë S sh.a	1,000,000	1,000,000
12	Nr. 163, datë 03.10.2016	Shoqërisë A sh.a	1,000,000	1,000,000
13	Nr. 164, datë 03.10.2016	Shoqërisë A sh.a	1,000,000	1,000,000
14	Nr. 165, datë 03.10.2016	Shoqërisë E sh.a	1,000,000	1,000,000
15	Nr. 166, datë 03.10.2016	Shoqërisë I sh.a	1,000,000	1,000,000
16	Nr. 227, datë 27.12.2016	Shoqërisë S sh.a	1,000,000	1,000,000
17	Nr. 228, datë 27.12.2016	Anëtarit të Bordit të drejtorëve A (F. Zh)	300,000	300,000
			14,100,000	**14,100,000**

Nr.	Vendime viti 2017	Subjekti i sanksionuar	Vlera e gjobës	Arkëtuar
1	Nr. 68, datë. 26.05.2017	S i A	100,000	
2	Nr.95, date 03.07.2017	C I drej. L M	50,000	50,000
			150,000	**50,000**

Gjatë vitit 2017 subjektit Stock international Albania i është hequr licenca me Vendim nr.81, datë 19.06.2017, dhe i është përcjell zyrës përmbarimore për ekzekutim.

Nr.	Vendime viti 2018	Subjekti i sanksionuar	Vlera e gjobës	Arkëtuar
1	Nr. 86, datë 07.05.2018	Drejtorit të BSHS	75,000	
2	Nr. 107, datë 30.07.2018	Shoqërisë A sh.a	1,000,000	1,000,000
3	Nr. 108, datë 30.07.2018	Shoqërisë A sh.a	1,000,000	1,000,000
4	Nr. 109, datë 30.07.2018	Shoqërisë A sh.a	1,000,000	1,000,000
5	Nr. 110, datë 30.07.2018	Shoqërisë I Jete sh.a	1,000,000	1,000,000
6	Nr. 111, datë 30.07.2018	Shoqërisë I sh.a	1,000,000	
7	Nr. 112, datë 30.07.2018	Shoqërisë I sh.a	1,000,000	1,000,000
8	Nr. 113, datë 30.07.2018	Shoqërisë SI sh.a	1,000,000	1,000,000
9	Nr. 114, datë 30.07.2018	Shoqërisë S SSI VIG sh.a	1,200,000	1,200,000
10	Nr. 115, datë 30.07.2018	Shoqërisë E sh.a	1,000,000	
11	Nr. 160, datë 30.07.2018	Shoqërisë E sh.a	500,000	500,000
12	Nr. 161, datë 30.07.2018	Shoqërisë I sh.a	500,000	500,000
13	Nr. 162, datë 30.07.2018	Administratorit E sh.a	300,000	
14	Nr. 241, datë. 20.12.2018	A	2,000,000	2,000,000
15	Nr. 242, datë. 20.12.2018	A	100,000	100,000
16	Nr. 243, datë. 20.12.2018	I-jete	120,000	120,000
17	Nr. 244, datë. 20.12.2018	S	100,000	100,000
18	Nr. 245, datë. 20.12.2018	I	100,000	100,000
			12,995,000	**10,620,000**

Gjatë vitit 2018 rezulton se :

- Drejtorit të BSHS Fituar gjyqi nga K Ll, AMF nuk mund të animojë vendimin në apel për shkak të vlerës
- Shoqëria I është në proces gjyqësor
- Shoqërisë E sh.a është në proces gjyqësor dhe fituar në apel nga shoqëria E më datë 03.10.2019
- Administratorit të shoqërisë E sh.a i është pezulluar nga gjykata
- Shoqëria A N Sështë në proces gjyqësor në Apel

Nr.	Vendime viti 2019	Subjekti i sanksionuar	Vlera e gjobës	Arkëtuar
1	Nr. 30, datë. 04.03.2019	Drejtorit/ I	100,000	100,000
2	Nr. 67, datë. 27.03.2019	SB	100,000	100,000
3	Nr. 76, datë. 27.03.2019	EB	100,000	100,000
4	Nr. 113, datë. 06.06.2019	ZT, Vlerësues/dëmesh	200,000	
5	Nr. 128, datë. 24.07.2019	A sh.a, personi përgjegjës	100,000	100,000
6	Nr. 129, datë. 24.07.2019	A, personi përgjegjës	100,000	100,000
7	Nr. 152, datë. 24.07.2019	E, personi përgjegjës	50,000	50,000
8	Nr. 153, datë. 24.07.2019	S, personi përgjegjës	50,000	50,000
9	Nr. 225, datë. 22.11.2019	I, pers. Përgjegjës	50,000	50,000
10	Nr. 225, datë. 22.11.2019	S, pers. Përgjegjës	50,000	50,000
11	Nr. 225, datë. 22.11.2019	S, pers. përgjegjës	50,000	50,000
12	Nr. 225, datë. 22.11.2019	A, pers. Përgjegjës	50,000	50,000
13	Nr. 225, datë. 22.11.2019	I pers. Përgjegjës	50,000	50,000
14	Nr. 225, datë. 22.11.2019	A, pers. Përgjegjës	50,000	50,000
15	Nr. 225, datë. 22.11.2019	E, pers. Përgjegjës	50,000	50,000
16	Nr. 225, datë. 22.11.2019	A pers. Përgjegjës	50,000	50,000
			1,200,000	**1,000,000**

Gjatë vitit 2019 z. Zalo Topçiu, Vlerësues/dëmesh vendimi i është dërguar zyrës së përmbarimit shtetëror për ekzekutim

Nr.	Vendime viti 2020	Subjekti i sanksionuar	Vlera e gjobës	Arkëtuar
1	Nr. 17, datë. 22.01.2020	S, pers. Përgjegjës	300,000	300,000
2	Nr. 2016, datë. 29.12.2020	ES dhe Administratorit	150,000	
			450,000	**300,000**

*****

Tregues i rëndësishëm që tregon si për tregun e sigurimeve dhe ecurinë e kompanive si pjesë e tij është raporti dëme/prime neto dhe shpenzime/prime neto, pasi janë treguesit më të rëndësishëm që ndikojnë në interesat e konsumatorëve dhe në masën e dëmshpërblimeve që ata marrin. Këto raportet janë pranuar në mënyrë ndërkombëtare nga mbikëqyrësit në të gjithë botën, pasi është konstatuar se ato japin një kontribut mjaft të dobishëm për matjen e rrezikut të shoqërisë së sigurimit.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur këta dy nga tregues që janë raporti dëme/prime neto dhe shpenzime/prime neto e konkretisht :

Raporti dëme/prime dhe shpenzime/prime

	Raporti dëme/prime neto (%)					Raporti shpenzime/prime neto (%)				
	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019
A	27.00%	25.18%	28.86%	32.3%	31.3%	53.92%	68.31%	65.41%	60.7%	62.4%
A	21.39%	31.83%	25.47%	30.8%	38.6%	70.44%	90.06%	76.31%	73.1%	74.6%
A	23.19%	27.92%	22.64%	22.9%	43.1%	63.86%	67.27%	68.26%	70.8%	61.7%
E	34.68%	33.73%	28.84%	32.8%	32.7%	72.48%	69.60%	66.17%	63.7%	59.6%
I	60.35%	11.64%	25.61%	27.7%	27.6%	47.49%	77.18%	74.42%	66.8%	65.1%
S	40.43%	32.84%	32.84%	38.8%	45.2%	58.61%	61.37%	61.37%	60.1%	54.9%
I	41.67%	33.73%	38.69%	38.1%	37.1%	50.15%	63.75%	53.43%	53.3%	56.8%
S	57.19%	38.51%	44.57%	43.8%	46.6%	48.58%	67.22%	55.84%	56.9%	50.9%
Ajete				-	-				-	77.1%
I jete				27.4%	35.5%				52.9%	54.0%
S				22.1%	23.8%				81.5%	70.1%
S L				16.9%	26.9%				61.0%	62.0%

Raporti dëme/prime tregon se sa nga paratë që marrin kompanitë nga primet e shitura, i japin për të dëmshpërblyer klientët. Ky raport është në nivele shumë të ulëta ku luhatet në një mesatare tregu nga 23 % deri në 47 % ndërsa diapazoni është nga 50% deri në 80% të cilat janë pranuar në mënyrë ndërkombëtare nga mbikëqyrësit në të gjithë botën megjithëse bazuar në kuadrin ligjor në vend nuk ka diapazon të kërkuar. Gjithashtu dhe raporti tjetër shpenzime/prime nënkupton se sa nga paratë që marrin kompanitë nga primet e shitura i përdorin për shpenzimet e tyre për funksionim të aktivitetit të tyre, është në nivele shumë të larta me një mesatare tregu e cila është nga 62% deri në 75 % ndërsa diapazoni është 25-50% edhe në këtë rast janë pranuar në mënyrë ndërkombëtare nga mbikëqyrësit në të gjithë botën megjithëse bazuar në kuadrin ligjor nuk ka diapazon të kërkuar.

Këto vlera të këtyre dy treguesve nënkuptojnë se kompanitë e sigurimit, vlerat nga shitja e primeve, mund të mos i përdorin plotësisht për qëllimin e tyre primar për të dëmshpërblyer në një masë më të madhe konsumatorët gjë e cila duhet të përmirësohet në vijimësi.

*****

Gjithashtu disa problematika të tjetra që evidentohen sot në tregun e sigurimeve për të cilën AMF është përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtij sistemi si pjesë e sistemit financiar jo Br dhe operatorëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë sektor është:

- numri i kontratave të sigurimit të lidhura të cilat kanë patur në disa raste edhe tendencë uljeje si:
  - gjatë periudhës janar-nëntor 2020, numri i kontratave të sigurimit të lidhura është 857,503 me një ulje prej 29 % krahasuar me periudhën janar-nëntor 2019,
  - gjatë vitit 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,350,075 me një rritje 3.18% krahasuar me vitin 2018,

- Gjatë vitit 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,309,143 me një rritje prej 5.89% krahasuar me vitin 2017,

- llojit të sigurimeve J e jo-J, ku tregu vazhdon të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës si :
  - gjatë periudhës janar-nëntor 2020, sigurimet e Jo-Jetës, kanë 93 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimi i e Jetës me 7 %
  - gjatë vitit 2019 sigurimet e Jo-Jetës, zënë 93 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës me 7 %,
  - gjatë vitit 2018 sigurimet e Jo-Jetës, zënë 93 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës me 7 %,
  - ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit i detyrueshëm dhe vullnetar rezulton se;
  - gjatë periudhës janar-nëntor 2020, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36 % ndërsa primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 64 % të totalit të tregut,
  - gjatë vitit 2019, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36 % ndërsa primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 64 % të totalit të tregut,
  - gjatë 2018, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 37 % ndërsa primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63 % të totalit të tregut.
  - dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve të cilat:
  - gjatë periudhës janar-nëntor 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, janë rreth 6,810 milionë lekë, ose 24 % më shumë se në periudhën janar-nëntor 2019,
  - gjatë vitit 2019, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, janë rreth 6,377 milionë lekë, ose 8.58% më pak se në vitin 2018,
  - gjatë vitit 2018, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,972 milionë lekë, ose 26.23% më shumë se në vitin 2017.

Janar nëntor 2020



Viti 2019



Viti 2018



*****

a. Programimi i të ardhurave për vitet 2019-2020:

Programimi i të ardhurave është bërë nga departamentet dhe drejtoritë që mbikëqyrin tregjet përkatëse të cilat i dërgojnë në mënyrë elektronike (e-mail) pranë Sektorit të Administrimit Financiar në procesin e hartimit të projektbuxhetit të vitit pasardhës. Projekt buxheti diskutohet dhe miratohen nga Bordi i AMF-së për vitin pasardhës. Ndërsa programimi i shpenzimeve bëhet në varësi të: programimit të ardhurave, shpenzimet për burime njerëzore, shpenzimet e mirëmbajtjes si dhe shpenzimeve për Iimet kryesisht në sistemet informatike dhe programet e tyre.

Programimi i tre viteve të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 2020, 2021 dhe 2022, është bazuar dhe në rezultatet e pritshme të vitit 2019, si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	2019		2020		2021		2022	
		plani	I pritshmi	P sp%	programimi	P sp%	programimi	P sp%	programimi
I	**Të ardhurat**	**335.600**	**335.600**	**100**	**365.370**	**100**	**376.331**	100	**387.621**
1	ñ nga tregu i sigurimeve	291.960	291.960	86	316.220	86	325.707	86	335.478
2	Nga tregu i le vlerë & fon i inv.	41.611	41.611	12	46.000	12	47.380	12	48.801
3	nga tregu i fond të pens. vullnet.	1.761	1.761	2	2.350	2	2.421	2	2.493
4	Të ardhura të tjera (interest etj	268	268	0	800	0	824	0	849
II	**Shpenzimet**	**295.000**	**328.228**	**100**	**365.370**	**100**	**376.311**	**100**	**387.621**
1	Shpenzime personeli	245.670	211.910	66	252.700	69	260.281	69	268.089
2	Shpen Administrative	49.330	75.718	20	78.210	21	80.556	21	82.972
3	Iime	40.600	40.600	14	34.460	10	35.494	10	36.560
	Diferenca I-II (A-SH)		**7,372**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**

Shënim: Përgatitur nga grupi auditimit me të dhënat e subjektit.

Të ardhurat & shpenzimet:

-*Programimi i vitit 2020* është për 365,370 mijë lekë, pra 29,770 mijë lekë, ose 9% më shumë se një vit më parë;

-*Programimi i vitit 2021* është për 376,331 mijë lekë, pra 10,961 mijë lekë, ose 3% më shumë se një vit më parë;

-*Programimi i vitit 2022* është për 387,621 mijë lekë, pra 11,290 mijë lekë, ose 3% më shumë se një vit më parë;

Për programimin e vitit 2019 është diskutuar nga Bordi i AMF dhe me vendimin nr.220, datë 26.11.2018 ñPër miratimin e buxhetit të vitit 2019ò janë miratuar grupet kryesore të ardhurave dhe shpenzimeve si në tabelën e mëposhtme:

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	2018		Plani 2019	Dif. Plan 19-18	
		plan	fakt		Në vlerë	Në %
1	Të ardhura nga tregu i sigurimeve	290.150	257.809	291.960	1.810	0,6
2	Nga tregu i letrave me vlerë dhe fondi i Investimit	48,773	43.468	41.611	-7.162	-14.7
3	Të ardh nga tregu i fondeve të pens. vullnetare	1.256	1.379	1.761	505	40.2
4	Të ardhura të tjera (interest etj)	251	15.770	268	17	6.8
	Totali i të ardhurave	**340.430**	**318.426**	**335.600**	**-4.830**	**-1.4**

Shënim: Përgatitur nga grupi auditimit me të dhënat e subjektit.

Planifikimi i të ardhurave gjithsej, i bërë nga departamentet dhe drejtoritë përkatëse për **vitin 2019**, në shumën **335,600 mijë lekë**, krahasuar me një vit më parë është 4,830 mijë lekë, ose -1.4% më pak se një vit më parë, në zërat:

-*Të ardhura nga tregjet e sigurimeve* për vitin 2019, janë programuar për ***291,260 mijë lekë,*** *(ose sa 86.8% e totalit të ardhurave),* krahasuar me programimin e një viti më parë, rezultojnë me një rritje prej 1,810 mijë lekë, ose 0.6% më shumë.

-*Të ardhura nga tregu i letrave me vlerë dhe fondi i Investimit për* vitin 2019, janë programuar për ***41,611 mijë lekë,*** *(ose sa 12.4% e totalit të ardhurave),* krahasuar me programimin e një viti më parë, rezultojnë me një ulje prej -7,162 mijë lekë, ose 14.7% më pak.

-*Të ardhura nga tregu i fondeve të pensioneve vullnetare për* vitin 2019, janë programuar për ***1,761 mijë lekë,*** *(ose sa 0.5% e totalit të ardhurave),* krahasuar me programimin e një viti më parë, rezultojnë me një rritje prej 505 mijë lekë, ose 40.2% më shumë.

-*Të ardhura të tjera për* vitin 2020, janë programuar për ***268 mijë lekë****, (ose sa 0.3% e totalit të ardhurave),* krahasuar me programimin e një viti më parë, rezultojnë me një rritje prej 17 mijë lekë, ose 6.8% më shumë.

Programimin i vitit 2020 është diskutuar nga Bordi i AMF dhe me vendimin nr.208, datë 22.11.2019 ñPër miratimin e buxhetit të vitit 2020 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiareò janë miratuar grupet kryesore të ardhurave si në tabelën e mëposhtme:

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	2019		Plani 2020	Dif. Plan 20-19	
		plan	fakt		Në vlerë	Në %
1	**Të ardhura nga tregu i sigurimeve**	**291.960**	**265.989**	**316.220**	**24.260**	**8.3**
-	Kontributi i shoqërive të sigurimeve	290.100	263.125	314.220	24.120	8.3
-	Të ardhura nga licencimet	1.860	2.864	2.000	140	7.5
2	**Nga tregu i letrave me vlerë dhe fondi i Investimit**	**41.611**	**44.434**	**46.000**	**4.389**	**10.5**
-	Nga komisione/tarifa e subjekte të mbikëqyr	40.691	43.467	45.000	4.309	10.6
-	Nga licencimet e subjekteve të mbikëqyrura tregu letrave. vlerë	920	967	1.000	80	8.7
3	**Të ardhura nga tregu i fondeve të pens. vullnetare**	**1.761**	**1.397**	**2.350**	**589**	**33.4**
-	Tarifë nga subjektet e mbikëqyr të tregut f. pension vullnet.	1.711	1.272	2.050	339	19.8
-	Të ardhura nga licencimi në tregun e fond të pension private	50	125	300	250	500.0
4	**Të ardhura të tjera**	**268**	**2.241**	**800**	**532**	**198.5**
	Totali i të ardhurave	**335.600**	**314.061**	**365.370**	**29.770**	**8.9**

Shënim: Përgatitur nga grupi auditimit me të dhënat e subjektit.

Planifikimi i të ardhurave gjithsej, i bërë nga departamentet dhe drejtoritë përkatëse për vitin 2020, në shumën 365,370 mijë lekë, krahasuar me një vit më parë është 29,770 mijë lekë, ose 9% më shumë se një vit më parë, në zërat:

-*Të ardhura nga tregjet e sigurimeve* për vitin 2020, janë programuar për ***316,220 mijë lekë, (ose sa 86.5% e totalit të ardhurave,)*** krahasuar me programimin e një viti më parë, rezultojnë me një rritje prej 24,260 mijë lekë, ose 8.3% më shumë.

-*Të ardhura nga tregu i letrave me vlerë dhe fondi i Investimit për* vitin 2020, janë programuar për ***46,000 mijë lekë, (ose sa 12.6% e totalit të ardhurave),*** krahasuar me programimin e një viti më parë, rezultojnë me një rritje prej 4,389 mijë lekë, ose 10.5% më shumë.

-*Të ardhura nga tregu i fondeve të pensioneve vullnetare për* vitin 2020, janë programuar për 2,350 ***mijë lekë, (ose sa 0.6% e totalit të ardhurave),*** krahasuar me programimin e një viti më parë, rezultojnë me një rritje prej 589 mijë lekë, ose 33.4% më shumë.

-*Të ardhura të tjera për* vitin 2020, janë programuar për 2800 ***mijë lekë, (ose sa 0.3% e totalit të ardhurave),*** krahasuar me programimin e një viti më parë, rezultojnë me një rritje prej 532 mijë lekë,**ose 3 herë** më shumë.

b. Realizimi i të ardhurave për vitin 2019-2020:

Të ardhurat e AMF krijohen në përputhje me nenin 26 të ligjitnr.9572, datë 03.07.2006ñ*Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare*ò, të ndryshuar. Tarifimi i subjekteve kryhet sipas përcaktimit në rregulloren nr.155, datë 23.12.2014 ñ*Për përcaktimin e elementeve të përllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre*ò, e ndryshuar, si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	Fakti i 2018	2019		Dif fakt-plan19		Dif.fakt 19-18	
			plan	fakt	Në vlerë	%/me planin	Në vlerë	%/me 2018
1	**Të ardhura nga tregu i sigurimeve**	**257.809**	**291.960**	**265.989**	**-25.971**	**-8.9**	**8.180**	3.2
-	Kontributi i shoqërive të sigurimeve		290.100	263.125	-26.975	-9.3		
-	Të ardhura nga licencimet		1.860	2.864	**1.004**	**54.0**		
2	**Nga tregu i letrave me vlerë dhe fondi i inv.**	**43.468**	**41.611**	**44.434**	**2.823**	**6.8**	966	2.2
-	Nga komisione/tarifa e subjekte të mbikëqyr		40.691	43.467	2.776	6.8		
-	Nga lic e subjekte të mbikëqyrje tregu letrave vlerë		920	967	47	5.1		
3	**Të ardhura nga tregu i fondeve të pensione vull**	**1.379**	**1.761**	**1.397**	**-364**	**-20.7**	**18**	**1.3**
-	Tarifë nga sub.e mb të tregut f. pensione vullnet.		1.711	1.272	-439	-25.7		
-	Të ardh.nga lic tregun e fond të pen.private		50	125	75	150.0		
4	**Të ardhura të tjera**	**15.770**	**268**	**2.241**	**1.973**	**736.2**	**-13.529**	**-85.8**
	Totali i të ardhurave	**318.426**	**335.600**	**314.061**	**-21.539**	**-6.4**	**-4.365**	**-1.4**

Shënim: Përgatitur nga grupi auditimit me të dhënat e subjektit.

Të ardhura gjithsej për vitin 2019 janë realizuar në vlerë **314,061 mijë lekë** dhe krahasuar me planin e kësaj periudhe rezulton një mosrealizim në vlerë absolute prej 21,539 mijë lekë, ose 6.4% më pak. Krahasuar me faktin e vitit 2018, të ardhurat gjithsej janë realizuar për 4,365 mijë lekë, ose 1.4% më pak. Kjo ulje e të ardhurave gjithsej krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar vjen kryesisht si rezultat i diferencës së të ardhurave nga gjobat dhe të tjera, të cilat gjatë vitit 2019, kanë qenë 2.241 mijë lekë, përkundrejt 15.770 mijë lekë të arkëtuara gjatë vitit 2018.

Peshën specifike më të madhe kundrejt totalit të ardhurave e zënë të ardhurat nga tregu i sigurimeve me 84.7%, të ardhurat nga tregu i letrave me vlerë 14.1%, dhe të ardhura të tjera që zëne një peshë specifike të papërfillshme ndaj totalit të ardhurave.



-*Të ardhura nga tregjet* e sigurimeve për vitin 2019 janë realizuar në vlerë ***265,989 mijë lekë,*** dhe nëse i krahasojmë të ardhurat me planin e kësaj periudhe rezulton një mosrealizim në vlerë prej 25,971 mijë lekë ose 8.9% më pak. Krahasuar me faktin e të njëjtës periudhë të vitit 2018 të ardhurat nga tregjet e sigurimeve janë realizuar 8.180 mijë lekë ose 3.2% më shumë se një vit me parë., siç përshkruhet në grafikun e mëposhtëm:



-*Të ardhura nga tregu i letrave me vlerë dhe fondi i Investimit* për vitin 2019 janë realizuar në vlerë***44,434 mijë lekë,*** kundrejt planit me 41,611 mijë lekë, janë realizuar për 2823 mijë lekë, ose 6.8% më shumë se plani. Krahasuar me faktin e të njëjtës periudhë të vitit 2018 të ardhurat nga tregu i letrave me vlerë dhe fondi i Investimit janë realizuar 966 mijë lekë ose 2.2% më shumë se një vit me parë, si në grafikun e mëposhtëm:



-*Të ardhura nga tregu i fondeve të pensioneve vullnetare* për vitin 2019, janë realizuar në vlerë***1,398 mijë lekë,*** kundrejt planit me 1,761 mijë lekë, pra janë realizuar për -364 mijë lekë, ose 20.7% më pak se plani. Krahasuar me faktin e të njëjtës periudhë të vitit 2018, këto të ardhura janë realizuar 18 mijë lekë ose 1.3% më shumë se një vit më parë si në grafikun e mëposhtëm:



-*Të ardhura të tjera* për vitin 2019 janë realizuar për 2,241 mijë lekë,kundrejt planit me 268 mijë lekë, pra janë realizuar për 1,973 mijë lekë, ose 20.7% më pak se plani. Krahasuar me faktin e të njëjtës periudhë të vitit 2018, këto të ardhura janë realizuar 18 mijë lekë, ose 8 herë më shumë se një vit më parë.

Realizimi i të ardhurave për 8/mujorin e vitin 2020:

Me Vendim Bordi nr. 144, datë 20.10.2017, të ndryshuar, Departamenti Operacional /Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve, lidhur me situatën financiare dhe realizimin e buxhetit për periudhën e 8 mujorit të vitit 2020 ka dhënë këto të dhëna:

Krahasuar me faktin e të njëjtës periudhe të vitit 2019, të ardhurat gjithsej janë realizuar 2.1% më pak, e cila ka ardhur si rezultat i situatës së jashtëzakonshme të krijuar nga pandemia Covid-19, ku rënia më e madhe vihet re në tregun e sigurimeve, si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	Fakti i 8/mujor 19	8/muj.2020		Dif fakt-plan 20		Dif.fakt 20-19	
			plan	fakt				
1	**Të ardhura nga tregu i sigurimeve**	**170.590**	**205.320**	**166.924**	**-38.396**	**-18,7**	**-3.666**	**-2,1**
-	Kontrib. i shoqërive të sigurimeve	168.991	204.100	165.607	-38.493	-18,9	-3.384	-2,0
-	Të ardhura nga licencimet	1.599	1.220	1.317	97	8,0	-282	-17,6
2	**Nga tregu i letrave me vlerë dhe fondi i inv.**	**28.634**	**30.145**	**28.305**	**-1.840**	**-6,1**	**-329**	**-1,1**
-	Nga komisione/tarifa e subjek të mbikëqyr	28.142	29.495	27.519	-1.976	-6,7	-623	-2,2
-	Nga lic e subjek të mbikq.tregu letrave.vlerë	492	650	786	136	20,9	294	59,8

3	**Të ardh nga tregu i fondeve të pens. vull**	**928**	**1.364**	**867**	**-497**	**-36,4**	**-61**	**-6,6**
-	Tarifë nga sub.e mb të tregut f.pension vullnet.	803	1.354	867	-487	-36,0	64	8,0
-	Të ardh.nga lic tregun e fond të pen.private	125	10	0	-10	-100,0	-125	-100
4	**Të ardhura të tjera**	**952**	**400**	**574**	**174**	**43,5**	**-378**	**-39,7**
	Totali i të ardhurave	**201.104**	**237.229**	**196.670**	**-40.559**	**-17,1**	**-4.434**	**-2,2**

Shënim: Përgatitur nga grupi auditimit me të dhënat e subjektit.



Të ardhura gjithsej për 8 mujorin e vitit 2020 janë realizuar në vlerë 196,670 mijë lekëdhe krahasuar me planin e kësaj periudhe rezulton një mosrealizim në vlerë absolute prej 38,396 mijë lekë, ose 18.7% më pak. Krahasuar me faktin e të njëjtës periudhë të vitit 2019, të ardhurat gjithsej janë realizuar për 4,434 mijë lekë, ose 2.2% më pak.



-Të ardhura nga tregjet e *sigurimeve për vitin 8/ mujorin e 2020* janë realizuar në vlerë 166,924 milion lekë,dhe nëse i krahasojmë të ardhurat me planin e kësaj periudhe rezulton një mosrealizim në vlerë prej 38,396 mijë lekë ose 18.7% më pak. Krahasuar me faktin e të njëjtës periudhë të vitit 2019 të ardhurat nga tregjet e sigurimeve janë realizuar 3,666 mijë lekë ose 2.1% më pak se një vit me parë. Të ardhurat sipas zërave rezultojnë si më poshtë:

Kontributi i paguar nga shoqëritë e sigurimit për periudhën janar ï gusht është në vlerën 165.6 milion lekë.Krahasuar me planin e 8 mujorit, ato janë arkëtuar 38.4 milionë lekë (ose 19%) më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 janë arkëtuar 3.3 milionë lekë (ose 2 %) më pak.

*Të ardhura nga licencime në tregun e sigurimeve*ku përfshihen tarifat për pajisje me licenca të agjentëve, vlerësues dëmesh, shoqëri brokerimi, brokera persona fizikë dhe shoqëri agjentësh janë arkëtuar në vlerën 1.3 mijë lekë. Krahasuar me planin 8 mujor të vitit 2020 janë arkëtuar 97 mijë lekë (ose 8 %) më shumë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 janë arkëtuar 282 mijë lekë (ose 18%) më pak.

Në zërin ñTë ardhura nga licencimetò, sipas planifikimeve të bëra nga Drejtoria e Licencimit, vihet re një mos arkëtim të ardhurash në elementin ñshoqëri agjentëshò dhe ñvlerësues dëmeshò për shkak të situatës së krijuar nga pandemia, pasi rezultojnë kërkesa në nivel të ulët për licencim për këto aktivitete, si në grafikun mëposhtëm:



-*Të ardhurat nga tregu i letrave me vlerë dhe fondet e Investimeve sigurimeve për vitin 8/mujorin e 2020,* janë realizuar në vlerë ***867 mijë lekë,*** dhe nëse i krahasojmë të ardhurat me planin e kësaj periudhe rezulton një mosrealizim në vlerë prej 497 mijë lekë ose 36.4% më pak. Krahasuar me faktin e të njëjtës periudhë të vitit 2019, këto të ardhura janë realizuar 61 mijë lekë ose 6.6% më pak se një vit me parë, si në grafikun më poshtë:



Pesha specifike e këtyre të ardhurave kundrejt totalit të ardhurave për 8 mujorin e vitit 2020 është 14.3%. Peshën më të madhe tek këto të ardhura e zënë të ardhurat nga ñTarifat nga shoqëritë administruese të fondeve të Investimeve ò në vlerën 22.2 milionë lekë.

- *Të ardhurat nga tregu i fondeve të pensioneve vullnetare për vitin 8/mujorin e 2020,* janë realizuar në vlerë ***867 milion lekë,*** dhe nëse i krahasojmë të ardhurat me planin e kësaj periudhe rezulton një mosrealizim në vlerë prej 497 mijë lekë ose 36.4% më pak. Krahasuar me faktin e të njëjtës periudhë të vitit 2019, këto të ardhura janë realizuar 61 mijë lekë ose 6.6% më pak se një vit me parë, si në grafikun më poshtë:



-Të ardhura të tjera *për vitin 8/mujorin e 2020,* janë realizuar në masën 574 mijë lekë nga të cilat 300 mijë lekë janë të ardhurat nga gjobat sipas vendimit të Bordit nr.17, datë 22.01.2020 për shoqërinë ñS I Vò sha dhe pjesa tjetër të ardhura nga interesat Bre të Investimit të ñFondit rezerveò në Bt e nivelit të dytë.

Për pikën e trajtuar në projektraport "Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, treguesit dhe qëndrueshmëria financiar"me shkresën me nr. 41/11 prot., datë 29.09.2021, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit, mbi auditimin e ushtruar në AMF e cila është protokolluar në KLSH me nr. 845/6, datë 29.09.2021. Nga ana e AMF materiali i trajtuar në projektraport së bashku me gjetjet e rekomandimet është dakordësuar por është ngritur si pretendim se ".. sa i takon treguesve të përmendur nga grupi i auditimit për vitin 2020, duhet të marrin në konsideratë që viti 2020, nuk ka qenë vit normal dhe ashtu si çdo sektor tjetër i ekonomisë dhe tregjet nën mbikëqyrjen e AMF pësuan një tkurrje për shkak të pandemisë,... konstatimi merret pjesërisht në konsideratë"
Për sa më sipër sqarojmë se pretendimi për situatën e kaluar si rezultat i pandemisë globale *Covid -19* ku është përfshirë dhe vendi ynë është mbajtur në konsideratë dhe është trajtuar edhe në përgjigjet për observacionet e aktit të konstatimit.

Gjetja

U konstatuan mangësi ne treguesit e planifikimit dhe pritshmërisë realizimit të treguesve në përfshirjen e të gjithë treguesve dhe në treguesit e qëndrueshmërisë financiare.

Situata:

Konstatohenmangësi gjatë procedurave të planifikimit i cili kryesisht realizohet në bazë të eksperiencës dhe pritshmërisë realizimit të treguesve dhe jo i dokumentuar plotësisht e rakorduar në përfshirjen e të gjithë treguesve dhe të dhëna më të plota si:për treguesit sipas nivelit të primeve të shkruara bruto për shoqëritë e sigurimit, për kontribuuesit dhe për vlerën neto të aseteve për llogaritjen e tarifës për shoqëritë administruese të fondeve të pensionit, për fondet e investimit dhe depozitarin e fondit të Investimeve , për numrin e subjekteve që parashikohet të licencohen si dhe tarifat përkatëse të licencimit, sipas tregjeve të mbikëqyrura nga AMF, për gjobat e vendosura për subjektet e mbikëqyrura dhe individët, për të ardhurat në formën e interesave bankare të përfituara për tepricat e llogarive që ka Autoriteti pranë Bve të nivelit të dytë.
Konstatohet seraporti dëme/prime është në nivele të ulëta ku luhatet në një mesatare tregu nga 23% deri në 47 % ndërsa diapazoni është nga 50% deri në 80%; raporti shpenzime/prime është në nivele të larta me një mesatare tregu e cila është nga 62% deri në 75 % ndërsa diapazoni është 25-50% ; numri i kontratave të sigurimit të lidhura të cilat në disa raste ka patur tendencë uljeje; tregu i sigurimeve vazhdon të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës; tregu i sigurimeve vazhdon të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e detyrueshme me ligj;
Në tregun e sigurimeve evidentohet se: plani i të ardhurave me planin e shpenzimeve është i njëjtë ose planifikohet i barabartë. Në këtë mënyrë, shpenzimet e aktivitetit të AMF nga viti në vit janë rritur për tq̃u përafruar realizimit të të ardhurave, praktikë e cila nuk mund të vijojë përpjesëtimisht me rritjen e të ardhurave. Për më tepër, tepricat e të ardhurave të realizuara nga AMF (diferenca të ardhura ï shpenzime) pas mbulimit të rezervës ligjore, ju kthehen shoqërive të sigurimit ku pjesë e tyre janë edhe gjobat që vendosen për shkelje të ndryshme, duke i bërë këto masa administrative jo efektive, ndërkohë që këto teprica mund të shkojnë në rritjen e rezervës ligjore të institucionit mbikëqyrës apo në forma të tjera përdorimi të këtyre tepricave.

Kriteri:

- nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, të ndryshuar;
- nr. 56, datë 20.0602020 ñPër sipërmarrjet e Iimet kolektiveò; i cili rregullon themelimin, regjistrimin dhe veprimtarinë e shoqërive

administruese të fondeve, të shoqërive administruese;

- nr. 36, datë 31.03.2019 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10198, datë 10.12.2009, ñPër sipërmarrjet e Investimeve kolektive";
- nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit", i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, ri sigurimit dhe ndërmjetësmit;
- nr.10455, datë 21.07.2011 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit";
- nr. 10236, datë 18.02.2010 "Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike", i cili përcakton rregullat, që lidhen me kushtet dhe procedurat për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike;
- nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e Investimeve kolektive", ndryshuar me ligjin nr. 36, datë 31.03.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009ò;
- nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", i cili ka për qëllim të vendosë standardet e nevojetëshme për: administrimin me efektivitet të fondeve;
- nr. 10158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore", i cili ka si qëllim përmirësimin e bazës ligjore
- Rregullorja nr. 155 datë 23.12.2014, e ndryshuar me nr.28 ñPër hartimin, ndjekjen, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të AMFò, miratuar me Vendim Bordi nr.144, datë 20.10.2017.

Impakti: Është shumë e rëndësishme marrja e masave efikase nëpërmjet përcaktimit të detyrave të strukturave, duke parashikuar në mënyrë të qartë përgjegjësitë e tyre, arritjes së objektivave, përmirësimeve ligjore për përmirësimin e sistemit i cili siguron përshtatjen me standardet evropiane, në përputhje me prioritetet për zvogëlimin e riskut që të ruajë stabilitetin e transparencën në fushën e sigurimeve, titujve dhe pensioneve private vullnetare, për të siguruar mbrojtje të interesave të konsumatorit, e mbikëqyr kompanitë e sigurimit.

Shkaku: Mungesë e bashkëveprimit midis drejtorive dhe institucioneve të tjera, me qëllim dokumentimin e të dhënave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Drejtoritë përgjegjëse të planifikimit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiar të rrisin bashkëpunimin për hartimin e treguesve ekonomiko financiarë, duke marrë edhe informacione shtesë nga institucione të tjera dhe tregu i sigurimeve, duke i dokumentuar e rakorduar ato sipas treguesve.

Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me institucionet ligjvënëse të mundësojë përmirësime ligjore në drejtim kriterit për rritje të rezervës ligjore, për mos kthim të tepricave të të ardhurave të shoqërive të sigurimit, si dhe të mos përfshirjes së gjobave si të ardhura që u duhen kthyer shoqërive ñme shkeljeò si diference të ardhura shpenzime, por ato të mbeten pjesë e kësaj rezerve.

IV.3. Mbi organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese të shoqërisë

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua:
Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është organi më i lartë drejtues dhe vendimmarrës (në vijim ñBordiò). Bazuar në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò i ndryshuar, ai është një organ kolegjial i përbërë nga 5 anëtarë, dy prej të cilëve, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Nëndrejtori Ekzekutiv janë anëtarë ekzekutivë me kohë të plotë, ndërsa Kryetari dhe dy anëtarë të tjerë janë anëtarë jo ekzekutivë. Mandati i çdo anëtari Bordi është 5 vjet. Anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë sipas një procedure të përcaktuar në ligj. Aktualisht, Bordi i AMF-së përbëhet nga:

E	M	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv (emëruar më 28.05.2020)
M	K	Nëndrejtor Ekzekutiv (emëruar më 07.10.2020)
I	Gj	Anëtar (emëruar më 25.01.2018)
D	D	Anëtar (emëruar më 03.04.2019)

Gjatë periudhës në auditim 01.01.2019 - 30.09.2020, përbërja e Bordit ka pësuar disa ndryshime për shkak të mbarimit të mandateve të parashikuara me ligj. Konkretisht :

Në datë 01.01.2019 Bordi i AMF-së përbëhej nga

P	M	Kryetar
E	K	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
M	K	Nëndrejtor Ekzekutiv
I	Gj	Anëtar
K	Sh	Anëtar

Në datë 03.04.2019 Bordi i AMF-së përbëhej nga

P	M	Kryetar
E	K	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
I	Gj	Anëtar
D	D	Anëtar (emëruar më 03.04.2019)

Në datë 14.10.2019 Bordi i AMF-së përbëhej nga

E	M	Kryetar
E	K	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
I	Gj	Anëtar
D	D	Anëtar

Në datë 10.04.2020 Bordi i AMF-së përbëhej nga

E	M	Kryetar
I	Gj	Anëtar
D	D	Anëtar

Në datë 28.05.2020 Bordi i AMF-së përbëhej nga

E	M	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
I	Gj	Anëtar
D	D	Anëtar

Sa më sipër, për periudhën 03.04.2019 - 10.04.2020 Bordi ka funksionuar me 4 anëtarë (2+2) dhe pa nëndrejtorin e përgjithshëm ekzekutiv
Për periudhën 10.04.2020 - 28.05.2020, Bordi ka funksionuar me vetëm 3 anëtar, pa Drejtorin dhe Nëndrejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv. Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar 2 mbledhje Bordi.
Sipas nenit 16 të Ligjit nr. 9752, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, i ndryshuarò, ñKompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutivò, kemi

ñDrejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv organizon dhe administron veprimtarinë e Autoritetit dhe të administratës së këtij Autoriteti. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ka këto kompetenca:
1. Përfaqëson Autoritetin.
2. Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e administratës.
3. Përgjigjet para Bordit për zbatimin e vendimeve të miratuara.
4. I propozon Kryetarit të Bordit çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Bordit dhe që janë të nevojetëshme për ushtrimin e funksioneve të Autoritetit dhe për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tijò.

*****
Kur Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv mungon, ose kur për shkaqe të jashtëzakonshme nuk mund të delegojë kryerjen e detyrave apo është në pamundësi për të vepruar, nëndrejtori ekzekutiv drejton Autoritetin për të siguruar mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të tijò.
Sipas përcaktimeve të mësipërme, grupi i auditimit vlerëson se mungesa e të dy anëtarëve ekzekutivë, duhet të sjellë mos zhvillimin e mbledhjeve të Bordit, pasi:
- nuk mund të propozohen çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Bordit (pika 4);
- nuk mund të përgjigjet asnjë për zbatimin e vendimeve të miratuara (pika 3).
Në vlerësim të grupit të auditimit, në mungesë të dy anëtarëve ekzekutivë mbledhjet e Bordit nuk duhet të zhvillohen.

Për periudhën 28.05.2020 - 30.09.2020, Bordi ka funksionuar me vetëm 3 anëtarë nga të cilët vetëm një anëtar ekzekutiv.
Bordi, gjithashtu vazhdon të ketë të paplotësuar vendin e Kryetarit të Bordit prej 28.05.2020.

Përbërja e Bordit është plotësuar me pozicionin e Nëndrejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv më 07.10.2020.
Në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 ñPër autoritetin e mbikëqyrjes financiareò ndryshuar me ligjin nr.54/2014 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareôò, neni 10 ñMbledhjet e borditò cituar ñMbledhjet e Bordit thirren me nismën e Kryetarit ose me kërkesën e secilit prej anëtarëve drejtuar Kryetarit të Bordit. Bordi mblidhet të paktën një herë në muaj për të diskutuar dhe vendosur për rendin e ditës. Mbledhjet e Bordit drejtohen nga Kryetari dhe, në mungesë të tij, nga anëtari jo ekzekutiv më i vJr në moshë. Mbledhja e Bordit është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë. Vendimet e Bordit janë të vlefshme kur votojnë pro të paktën 3 anëtarë. Në votim nuk lejohet abstenimi. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje. Vendimet e marra në mbledhje nënshkruhen nga Kryetari dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv. Bordi miraton rregulloren për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjesò, gjatë vitit 2019 Bordi ka kryer gjithsej 16 mbledhje dhe ka marrë 258 vendime, në funksion të përmbushjes së objektivave kryesorë të Autoritetit. Nga tregjet e mbikëqyrura nga Autoriteti, numri më i madh i vendimeve, vazhdon të J i lidhur me tregun e sigurimeve.
Gjatë vitit 2020 (për periudhën objekt auditimi), Bordi ka zhvilluar gjithsej 12 mbledhje dhe ka marrë gjithsej 177 vendime.
Për periudhën objekt auditimi, u verifikuan procesverbalet e mbledhjeve të Bordit, nga ku rezultoi se:
- Numri i mbledhjeve për periudhën objekt auditimit është në përputhje me nenin 5 të ñRregullores për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së bordit të autoritetit të mbikëqyrjes financiareò, miratuar me vendimin e bordit nr. 17, datë 28.04.2015, ku kërkohet që Bordi i Autoritetit të mblidhet të paktën një herë në muaj.

- Numri i anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje ka qenë të paktën 3, në përputhje me nenin 10 të ligjit
nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër autoritetin e mbikëqyrjes financiareò, i ndryshuar.
- Vendimet e Bordit janë miratuar unanimisht në 100% të rasteve, duke formuar në çdo rast kuorumin e nevojetëshëm.
- Në asnjë rast nuk është konstatuar mungesë pa arsye e anëtarëve të bordit në më shumë se tri mbledhje radhazi.
Në lidhje me përcaktimet dhe kompetencat e dhëna nga neni 9 dhe neni 14 i Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, vlerësojmë se janë në kundërshtim me nenin 22 të po këtij ligji, në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, ñPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò, i ndryshuar, si dhe nenin nr. 11 të rregullores ñPër funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së bordit të autoritetit të mbikëqyrjes financiareò, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 17, datë 28.04.2015, e ndryshuar. Më hollësisht:
-Neni 9 ñStruktura organizative, pagat dhe trajtimet e tjera të Autoritetitò i Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, ku citohet:
ñBordi përcakton strukturën organizative të Autoritetit, numrin e punonjësve, pagën, shpërblimet dhe trajtimet financiare të anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, nëndrejtorit ekzekutiv, si dhe të punonjësve. Trajtimet financiare përfshijnë mbulimin e shpenzimeve të kryera në përmbushje të detyrës, pagesat për trajnimet profesionale, për sigurimin e jetes dhe të shëndetit dhe të tjera të ngjashme. Bordi, në përcaktimin e masës së pagës, shpërblimeve dhe trajtimeve financiare apo jo financiare të administratës, bazohet në një metodologji të qartë, që merr parasysh kushtet e tregut, përvojat e autoriteteve të tjera që kryejnë aktivitetin e rregullatorit financiar në Shqipëri dhe nevojat e vetë institucionit. Autoriteti, mund të krijojë një plan të pensionit profesional për punëmarrësit e tij. Përcaktimet e bëra në dispozitat e ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, ñPër pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligjò, dhe çdo përcaktim tjetër ligjor, si edhe përcaktimet e akteve nënligjore në fuqi për zbatimin e këtyre dispozitave, që bien në kundërshtim me këtë nen, nuk zbatohen për Autoritetinò.
-Neni 14 ñKompetencat e Borditò i Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, ku citohet:
ñBordi ushtron në mënyrë të pavarur këto kompetenca:
11. Miraton pagën, shpërblimet si dhe trajtimet financiare të anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, nëndrejtorit ekzekutiv, si dhe të punonjësveò.
-Neni 22 ñKonflikti i interesitò i Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar:
ñAnëtarët e Bordit nuk marrin pjesë në procedurat e diskutimit, votimit dhe vendimmarrjes, nëse kanë interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për çështjen, interes i cili cenon paanësinë e tyre në vendimet që do të merren, si dhe me qëndrimet zyrtare.
Në rast se vërehet se megjithëse janë ndodhur përpara rastit të përmendur, përkatësisht, në paragrafin e dytë apo të tretë të këtij neni dhe nuk kanë bërë deklarimin përkatës e për pasojë nuk janë tërhequr nga shqyrtimi i çështjes, ndaj tyre merret masa e lirimit ose e largimit nga detyra. Masa e lirimit ose e largimit nga detyra nuk ndikon në vendimet e marra deri në atë çastò.
-Neni 11 ñKonflikti i interesitò i ñRregullores për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së bordit të autoritetit të mbikëqyrjes financiareò miratuar me Vendimin e Bordit nr. 17, datë 28.04.2015, e ndryshuar.
ñ11.1 Çdo anëtar i Bordit, përmes deklarimit me shkrim, duhet të kërkojë heqjen dorë nga pjesëmarrja në mbledhjen e Bordit kur ndërmjet tij dhe personave ose subjekteve juridike për të

cilat diskutohet, shqyrtohet, vlerësohet dhe kryhet çfarëdolloj procedure për çështje konkrete, ka konflikt interesi.
11.2 Anëtari i Bordit nuk merr pjesë në procedurat e shqyrtimit, diskutimit dhe votimit, nëse ka interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për çështjen, interes i cili cenon paanësinë e tyre në vendimet që do të merren, si dhe me qëndrimet zyrtare të Autoritetitò.
Për periudhën objekt auditimi, Bordi i AMF ka miratuar me Vendimin nr. 108, datë 29.07.2020, Udhëzimin ñPër nivelin dhe strukturën e pagave, si dhe shpërblimeve të punonjësve, të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, Nëndrejtorit Ekzekutiv dhe shpërblimin e anëtarëve jo ekzekutive të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiareò.
Udhëzimi nr. 76, datë 28.07.2015 ñPër caktimin e shpërblimit të anëtarëve jo ekzekutivë dhe pagës së Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, Nëndrejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, është shfuqizuar.
Nga sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se e drejta e lindur për Bordin nga nenet 9 dhe 14 të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, për sa i përket miratimit të pagës, shpërblimeve si dhe trajtimeve financiare të anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv, krijojnë në mënyrë të pashmangshme risk për konflikt interesi, pasi vendimmarrja e Bordit për këtë çështje ka interes të drejtpërdrejtë personal mbi vetë anëtarët e Bordit.

Me shkresën me nr. 41/11 prot., datë 29.09.2021, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit, mbi auditimin e ushtruar në AMF.

Në lidhje me konstatimin e bërë nga grupi i auditimit mbi mbledhjet e zhvilluara nga Bordi gjatë periudhës kur AMF ka patur mungesë të Drejtorit dhe nën Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutivë, është observuar ndër të tjera se: "...zhvillimi i mbledhjeve dhe marrja e vendimeve ishte e domosdoshme për vijimësinë e aktivitetit në tregjet e mbikëqyrura, monitorimin e tyre, ruajtjen e stabilitetit financiar, vazhdimësinë e veprimtarisë së Autoritetit dhe mbrojtjen e konsumatorëve...".
Grupi i auditimit, edhe pse parimisht shprehet dakord me të gjithë arsyet e paraqitura nga AMF mbi këtë çështje, si dhe detyrimet ligjore të cilat nevojiten të përmbushen nga AMF, gjithsesi shprehet me rezervë mbi zhvillimin e këtyre mbledhjeve në një kohë kur e drejta e delegimit të funksionit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv mbi propozimin e çështjeve që duhen përfshirë në rendin e ditës, referuar nenit 16 të ligjit nr. 9752, datë 03.07.2006, mbetet deri në nivelin e nën Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv. Ligji nuk parashikon delegim tjeter, si për paraqitjen e çështjeve për tu diskutuar, ashtu edhe për zbatimin e vendimeve të miratuara.
Grupi i auditimit vlerëson se AMF, meqenëse është në proces për rishikimin e ligjit nr. 9752, datë 03.07.2006, të shohë mundësinë për eliminimin e këtij ngërçi ligjor.
Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Në lidhje me konstatimin e bërë nga grupi i auditimit për sa i përket miratimit të pagës, shpërblimeve si dhe trajtimeve financiare të anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv, krijojnë në mënyrë të pashmangshme konflikt interesi, pasi vendimmarrja e Bordit për këtë çështje ka interes të drejtpërdrejtë personal mbi vetë anëtarët e Bordit, është paraqitur observacion duke u paraqitur e gjithë baza ligjore që i jep të drejtë Bordit të AMF-së në lidhje me këtë çështje, duke evidentuar faktin se AMF duhet të jetë një institucion i pavarur, dhe një miratim nga një organ tjetër, do të përbënte shkelje të pavarësisë.
Së pari sqarojmë se grupi i auditimit gjithnjë është shprehur vetëm mbi shpërblimet e vetë bordit dhe asnjëherë tek punonjësit (në observacion është cituar edhe togfjalëshi "si dhe të punonjësve", të cilën grupi nuk e ka cituar).

Së dyti, AMF mund të gjejë forma të tjera të akordimit të pagës apo shpërblimeve për sa i përket Bordit, pa qenë e nevojetëshme të ketë një miratim nga një organ tjetër (siç p.sh. mund të jetëvendosja e një parashikimi ligjor ku të mirë përcaktohen rastet kur Bordi duhet të marrë shpërblim), duke mos e rrezikuar kështu pavarësinë e Bordit dhe vetë institucionit të AMF.
Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Gjetja	Funksionimi i Bordit pa anëtarët ekzekutivë
Situata:	Nga auditimi u konstatua se për periudhën 10.04.2020 - 28.05.2020, Bordi i AMF ka funksionuar me vetëm 3 anëtar, pa Drejtorin dhe Nëndrejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv, gjatë së cilës janë zhvilluar 2 mbledhje. Referuar nenit 16 të Ligjit nr. 9752, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, ñKompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutivò, ñ*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv organizon dhe administron veprimtarinë e Autoritetit dhe të administratës së këtij Autoriteti. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ka këto kompetenca:* *1. Përfaqëson Autoritetin.* *2. Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e administratës.* *3. Përgjigjet para Bordit për zbatimin e vendimeve të miratuara.* *4. I propozon Kryetarit të Bordit çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së* *Bordit dhe që janë të nevojetëshme për ushtrimin e funksioneve të Autoritetit dhe për mbarëvajtjen* *e veprimtarisë së tij*ò. *Kur Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv mungon, ose kur për shkaqe të jashtëzakonshme nuk mund të delegojë kryerjen e detyrave apo është në pamundësi për të vepruar, nëndrejtori ekzekutiv drejton Autoritetin për të siguruar mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të tij".* Sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se mungesa e të dy anëtarëve ekzekutivë, duhet të sjellë mos zhvillimin e mbledhjeve të Bordit, pasi: - nuk mund të propozohen çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Bordit (pika 4); - nuk mund të përgjigjet asnjë për zbatimin e vendimeve të miratuara (pika 3); - sjell pengesa në realizimin e aktivitetit administrativ të subjektit në përputhje me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Kriteri:	Neni 16, Ligji nr. 9752, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar.
Impakti:	Zhvillim i mbledhjeve pa anëtar ekzekutiv, të cilët ligjërisht kanë kompetenca të pa delegueshme.
Shkaku:	Mungesa e përkohshme e dy anëtarëve ekzekutivë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	AMF në vijimësi të marrë masat për zhvillimin e mbledhjeve të Bordit vetëm nëse pjesë e tyre është minimalisht një nga anëtarët ekzekutivë, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që lindin nga neni 16 i ligjit nr. 9752, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, ose të marrin masa për ndryshimet e nevojetëshme ligjore për delegimin e kompetencave të anëtarëve ekzekutivë në rast mungese.

Gjetja	Risk mbi ekzistencën e konfliktit të interesit gjatë vendimmarrjeve të Bordit për pagat dhe shpërblimet e anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv.

Situata: Nga auditimi u konstatua se përcaktimet dhe kompetencat e dhëna për Bordin, nga neni 9 dhe neni 14 i Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, për sa i përket *miratimit të pagës, shpërblimeve si dhe trajtimeve financiare të anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv*, janë në kundërshtim me nenin 22 të po këtij ligji, në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, ñPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò, i ndryshuar, si dhe nenin nr. 11 të rregullores ñPër funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së bordit të autoritetit të mbikëqyrjes financiareò, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 17, datë 28.04.2015, e ndryshuar, pasi vendimmarrja e Bordit për këtë çështje ka interes të drejtpërdrejtë personal mbi vetë anëtarët e Bordit..

Kriteri: Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, ñPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò, i ndryshuar, rregullore ñPër funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së bordit të autoritetit të mbikëqyrjes financiareò.

Impakti: Risk për konflikt interesi në vendimmarrjet mbi pagat dhe shpërblimet e anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv.

Shkaku: Neni 9 dhe neni 14 i Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, janë në kundërshtim me nenin 22 të po këtij ligji, në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, ñPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò, i ndryshuar, si dhe nenin nr. 11 të rregullores ñPër funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së bordit të autoritetit të mbikëqyrjes financiareò.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: AMF të marrë masat e nevojetëshme për ndryshimet ligjore në lidhje me miratimin e pagës, shpërblimeve si dhe trajtimeve financiare të anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv,pasi aktualisht mënyra e përcaktuar në nenet 9 dhe 14 të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 *"Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare",* i ndryshuar, krijon në mënyrë të pashmangshme konflikt interesi, duke qenë se vendimmarrja e Bordit për këtë çështje ka interes të drejtpërdrejtë personal mbi vetë anëtarët e tij.

IV.4. Mbi organizimin e mbikëqyrjes që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare të mbikëqyrura: licencim, monitorim, raportim dhe inspektim në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Baza ligjore mbi të cilën realizohet aktiviteti i licencimit sipas tregjeve financiare të mbikëqyrura përfshin:

Tregu i Sigurimeve

-Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"

-Rregullore nr. 37, datë 27.03.2019 ñMbi rinovimin e licencës së Aktuarit të Autorizuarò

-Rregullore nr. 57, datë 28.04.2016 "Mbi trajnimet e vazhdueshme profesionale dhe rinovimin e licencës së aktuarit të autorizuar"

-Rregullore nr. 85, datë 03.07.2017 "Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime" *(Ndryshuar me Vendimin e Bordit Nr. 36, datë 27.03.2019) (Ndryshuar me Vendimin e Bordit Nr. 164, datë 14.08.2019)*

-Rregullore nr. 79, datë 31.08.2015 "Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës*" (Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 215, datë 31.10.2018)*

-Rregullore nr. 48, datë 30.06.2015 "Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime" *(Ndryshuar me vendim Bordi nr. 18, datë 26.02.2016)*

-Rregullore nr. 35, datë 27.03.2019 ñPër organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò

Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive dhe Fondeve të Pensioneve

-Ligji Nr. 10198 datë 10.12.2009 ñPër Sipërmarrjet e Investimeve Kolektiveò

-Rregullore nr. 112, datë 31.08.2020 ñPër licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të Investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisëò.

-Rregullore nr. 128, datë 06.10.2011 "Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive"

-Rregullore nr. 68, datë 26.05.2011 "Për dhënien e licencës, veprimtarinë T, ofertën publike dhe kërkesat e raportimit për sipërmarrjen e Investimeve kolektive me ofertë publike të krijuar nga një shoqëri e huaj administruese"

-Rregullore nr. 69, datë 26.05.2011 "Për autorizimin e individëve për shitjen e kuotave/aksioneve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive me ofertë publike"

-Ligji Nr. 10197 datë 10.12.2009 ñPër Fondet e Pensionit Vullnetarò

Tregu i Titujve

-Ligji Nr. 9879, datë 21.02.2008 ñPër Titujtò,

-Rregullore nr. 165, datë 23.12.2008, ñPër licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit,brokerit dhe këshilltarit të Investimeve ò, e ndryshuar.

-Vendim nr. 55, datë 30.03.2011 "Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë"

-Rregullore nr. 124, datë 7.12.2010 ñMbi afatet, kushtet dhe procedurat për autorizim të Bve si kujdestarë të obligacioneveò

-Rregullore nr. 21, datë 26.03.2009 "Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë"

-Rregullore nr. 120, datë 02.10.2008 "Mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e bursës së titujve"

Në zbatim të Programit të Auditimit ñMbi përputhshmërinëò e aktivitetit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Relacioni teknik i përgatitur nga Drejtoria e Licencimit sipas secilës praktikë për të cilën u vendosën në dispozicion;
- Mendimi juridik paraqitur në Bordin e AMF nga Departamenti Juridik sipas rasteve në të cilat u vendos në dispozicion;
- Vendimi i Bordit, shkresa përcjellëse e vendimit të bordit, licenca përkatëse sipas praktikave të administruara dhe dokumentacion tjetër justifikues sipas rastit pjesë e dosjes së licencimit (CV, raporte kredimarrësi nga BSH, diploma, kontrata dhe memorandum bashkëpunimi, procesverbale, vërtetime nga institucione të ndryshme shtetërore, pasqyra financiare, deklarata, konferma të depozitave/llogarive bankare, relacione, rregullore, etj.).

Dhënia e licencës subjekteve kërkuese është objekt i vendimmarrjes së Bordit të AMF. Vendimmarrja e Bordit bazohet në relacionin shoqërues që përgatit drejtoria përgjegjëse të shoqëruar sipas rastit me mendim juridik. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit që shoqëron kërkesën për licencim kryhet nga Drejtoria e Licencimit që verifikon përmbushjen e kritereve për licencim dhe sipas rastit propozon miratimin apo refuzimin në Bord. Nga AMF është përcjellë informacioni mbi aktivitetin e licencimit sipas tregjeve të mbikëqyrura për periudhën objekt auditimi, i cili paraqitet si në vijim:

Viti 2019

TREGU I SIGURIMEVE	
Miratim Agjentë Individë	95
Licencim Shoqëri Agjenti (SAS)	1
Licencim banke dhe subjekte te tjera	13
Licencim aktuare	10
Licencim Vlerësues Dëmesh	13
Licencim Shoqëri Vlerësues Dëmesh	3
Licencim Shoqëri Sigurimi "A SJ" sh.a. (miratim dhe licencim)	2
Licencim Bfizik	9
Licencim shoqëri brokerimi	1
Zgjerim licence Agjenti subjekt	3
TREGU I TITUJVE	
Licencimi i shoqërisë "Regjistri Shqiprar i Titujve "	1
Licencimi i shoqërisë "As"sh.a	1
Bfizik në tregun e titujve (Z. P Gj)	1
Miratimi i zgjerimit të fushës së veprimtarisë së shoqërisë "AB"sh.a.	1
Miratimi i zgjerimit te fushës së veprimtarisë së shoqërisë "BC"sh.a.	1
Njohja me kusht si Agjent i shoqërive V dhe N	2
TREGU I FONDEVE	
Licencimi i shoqërisë administruese të FP dhe SIK "A It" sh.a.	1
Licencimi i shoqërisë "BC" si Depozitar i Fondeve të pensionit dhe SIK	1
Miratimi i zgjerimit të licences së shoqërisë "TB" dhe si Depozitar i Fondeve të SIK	1

Viti 2020

TREGU I SIGURIMEVE	
Miratim i ushtrimit të veprimtarisë si Agjentë Individë në sigurime	91
Licencim Subjekte te tjera	6
Rinovimin e licencës vlerësues dëmesh në sigurime (z. KL).	
Rinovimin e licencës vlerësues dëmesh në sigurime (z. NXh).	
Licencimin e shoqërise "A JoJ"sh.a, zgjerim ushtrim veprimtarie me klase 14	
Licencimin e shoqërisë ñTBò sh.a., për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime, në klasat e Jetës dhe Jo-Jetës.	1
TREGU I TITUJVE	
Licencim Bfizik në tregun e titujve (D Q)	
Licencim Bfizik në tregun e titujve (Z. AS)	2
Licencimi i shoqërisë së brokerimit në tituj "B S"sh.a. dhe z.A. Ll si Bfizik i saj	1
Njohja dhe regjistrimi me kusht i shoqërisë "V S"sh.a., për të vepruar si agjentë i brokerit të licencuar	1
Njohja dhe regjistrimi i shoqërisë "OT S"sh.a., për të vepruar si agjentë i brokerit të licencuar	1
Refuzim i njohjes së shoqërisë "A"sh.a., për të vepruar si agjentë i brokerit të licencuar	1
TREGU I FONDEVE	
Licencimi i shoqërisë administruese të SIK "ABI I"sh.a.	1

Për të gjitha licencimet e mësipërme pas kërkesës për informacion, nga Drejtoria e Licencimit u vendosën në dispozicion listat analitike të licencimeve, kryesisht për brokerat, agjentët individë dhe agjentët persona juridik në sigurime si dhe vlerësuesit e dëmeve në sigurime dhe aktuarët e licencuar. Pas marrjes së këtyre listave dhe vlerësimit të riskut u krye përzgjedhja e praktikave për tu audituar sipas aktivitetit të licencimit. Auditimi me zgjedhje për secilën praktikë të përzgjedhur për të cilën u vendosën dokumentet në dispozicion paraqitet:

1. Licencim agjentë person fizik: AL, për shoqërinë A sha me nr. 1314 datë 31.01.2019.

Kërkesa fillestare për licencim është paraqitur me nr. 4247 datë 19.12.2018 nga A sh.a për Z. AL e cila është shoqëruar me dokumentacionin bashkëngjitur:

- Formë kërkesa
- Certifikatë nga Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë me nr. 1230 datë 11.10.2018 për modulet bazë për shitës i produkteve të sigurimit të jo-Jetës;
- CV
- Deklaratë personale për mos qenien i dënuar, mos punësimin në shoqëri sigurimi dhe mos qenien subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë pagese;
- Vërtetim me nr. 1173 datë 19.11.2018 të BKT për bllokimin e shumës 300,000 lekë për efekt të marrjes së licencës;
- Vërtetim për pagim detyrimesh tatimore nga DRT;
- Policën e sigurimit të përgjegjësive profesionale në kufirin 100,000 lekë për çdo ngjarje të siguruar dhe 150,00 lekë për të gjitha rastet e sigurimit;
- Kontratën e agjentit datë 14.12.2018 nënshkruar ndërmjet A L dhe A sha.

Dokumentacioni është përditësuar me kërkesën për agjent në sigurime me nr. 62 datë 14.01.2019 nga A sh.a për Z. A L, shoqëruar me dokumentacionin bashkëngjitur:

- Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria pranë Rrethit Gjykatës së Shkallës së Parë;
- Diplomë nga Universiteti Politeknik Tiranë
- Kontratë qiraje me nr. 362 rep. 195 kol. Datë 19.02.2017 me afat 7-vjeçar;
- Certifikatë regjistrimi QKB ñAutoshkolla Lò në pronësi të A L

Nga Zyra e Licencimit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve është informuar bordi në datë 18.01.2019 mbi përmbushjen e kritereve për licencim dhe është propozuar miratimi i Z. A L për ushtrimin e agjentit në sigurime në klasat e joJetës në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit A N S sh.a.
Ky propozim është referuar edhe nga Departamenti i Çështjeve Juridike/Drejtoria Juridike dhe Integrimit në Bord në datë 22.01.2019.

Miratimi i licencës është dhënë me Vendimin e Bordit nr. 4 datë 31.01.2019 për Z. A L për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime për klasat e jo-Jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit A sha.
Ky vendim dhe Vërtetimi i agjentit të miratuar është dërguar shoqërisë së sigurimit me shkresën nr. 4247/2 datë 15.02.2019.
Për sa më sipër në këtë dosje të testuar nuk u konstatuan mos përputhshmëri.

2. -Licencim agjentë dhe subjekte të tjera: Shoqëria S 2 shpk për S UGA sha me nr. 1348 datë 31.05.2019;

Sipas relacionit teknik të paraqitur në Bord, kërkesa në licencim të kësaj shoqërie është paraqitur me kërkesën nr. 934 prot AMF datë 13.03.2019, për subjektin ñS2ò në klasat e jo Jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit ñS U G Aò sha. Dokumentacioni shoqërues justifikues i vendosur në dispozicion të grupit të auditimit përfshin:
-*Për plotësimin e kriterit marrëveshje e subjektit me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të së cilës do të kryejë veprimtarinë e agjentit në sigurime është paraqitur kontratë agjenti me S U G A me nr. 740 datë 21.02.2019*
-R*egullore "Mbi informimin, trajtimin e ankesave të klientëve dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit" që përfshin:*
i. Mënyrën e informimit të klientëve dhe trajtimit të ankesave;
ii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

-Deklarata për mos qenie palë e lidhur me një shoqëri sigurimi, shoqëri tjetër agjentësh apo shoqëri brokerimi në sigurime dhe risigurime; e përfaqësuesit ligjor A S të datës 20.02.2019.
-Vendim të organit vendimmarrës së shoqërisë për shtimin e objektit të veprimtarisë si agjent në sigurime përfshirë në statutin e shoqërisë;
-ekstrakt historik dhe certifikatë regjistrimi e biznesit;
-garanci financiare 500,000 lekë, policë e sigurimit të përgjegjësive profesionale nga shoqëria ñSUGAò sha datë 25.02.2019 e vlefshme deri në 24.02.2020.
-vërtetim për pagim detyrimesh datë 28.01.2019;
-kontratë qereje datë 01.01.2017 me afat 3 vjeçar duke filluar në datë 01.10.2016 me sipërfaqe 29.5 m2 e pa noterizuar.
-Për *kontratën e punësimit me kohë të plotë për të paktën një agjent të miratuar është referuar kërkesa për licencim e administratores së shoqërisë Zj. AS në të njëjtën kohë me kërkesën për licencim të subjektit juridik.*

Nga Zyra e Licencimit, Departamenti i Mbikqyrjes së Tregut të Sigurimeve është informuar bordi në datë 18.03.2019 me relacion për kërkesën e paraqitur nga SUGA sha me nr. 934 datë 13.03.2019 dhe dokumentacionin për licencimin e subjektit **"S2"** shpk për ushtrimin e veprimtarisë në sigurime për klasat e jo-Jetës në emër dhe për llogari të saj dhe miratimin e Znj. **AS** si agjent fizik në sigurime në emër dhe për llogari të subjektit **"S2"** shpk. *Në këtë informacion, Bordit i është propozuar licencimi i subjektit **"S2"** shpk për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime për klasat e jo-Jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "SUGA" sha. Departamenti i Çështjeve Juridike ka sugjeruar Bordit në datë 17.05.2019 licencimin e shoqërisë **"S2"**. Licencimi i shoqërisë është miratuar nga Bordi me Vendimin nr. 97 datë 31.05.2019 për licencimin e subjektit **"S2"** shpk për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime në klasat e jo-Jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "SUGA" sha. Vendimi i Bordit është komunikuar shoqërisë "SUGA" sha me shkresën nr. 1972 datë 17.06.2019.*
Për sa më sipër në këtë dosje të testuar nuk u konstatuan mos përputhshmëri.

3- Licencimi i shoqërisë "TB" sha për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime në klasat e Jetës dhe jo-Jetës.

Kërkesa për pasjen me licencë është paraqitur nga TB sha me nr. 694 datë 02.03.2020 për të kryer veprimtari brokerimi në sigurime. Kërkesa është shoqëruar me dokumentacionin bashkëngjitur:

- *Formë kërkesë sipas aneksit 3 të rregullores;*
- *Vendim nr. 9 datë 05.02.2020 i Këshillit Mbikëqyrës së B së Shqipërisë "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga TB sha";*
- *Struktura e njësisë së brokerimit;*
- *Plani i biznesit për tre vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit;*
- *Lista e brokerave të licencuar ku ka përfshirë kërkesën për licencim të brokerave fizikë Zj. OM dhe Zj. AGj.*
- *Rregullore "Aktiviteti i B si B në Sigurime" me parashikimet për:*
  i. Njohjen e konsumatorit;
  ii. Mënyrën e trajtimit të ankesave;
  iii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
  iv. Trajtimin e konfliktit të interesit;
  v. Funksionin e përputhshmërisë që siguron përputhjen e aktivitetit të shoqërisë së brokerimit me ligjet dhe rregulloret në fuqi

Miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës i BSH me vendim nr. 9 datë 05.02.2020 është dhënë për dhënien e miratimit paraprak për veprimtarinë financiare shtesë të ndërmjetësmit në sigurime në rolin e brokerit.

Kërkesa është paraqitur duke përfshirë dy punonjës të B të cilët do të realizojnë veprimtarinë e brokerit në sigurime. Bashkë me licencimin e BT për të ushtruar veprimtarinë e shoqërisë së brokerimit në sigurime është kryer edhe licencimi i Znj. OM për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime në klasat e J dhe të jo-Jetës për një periudhë pa afat në emër e për llogari të shoqërisë ñTBò sha me Vendim nr. 76 datë 15.06.2020 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Sipas relacionit teknik të paraqitur nga Drejtoria e Licencimit në Bordin e AMF është referuar se licencimi i Zj. Gj nuk është kryer pasi si rezultat i situatës pandemisë nuk ka kryer trajnimin profesional bazë dhe për rrjedhojë nuk ka qenë e mundur të hyjë në testim që organizohet nga AMF për Bnë sigurime.

Drejtoria e Licencimit (me nënshkrim relacioni MM, EK dhe VTH) ka paraqitur në Bord relacionin datë 20.05.2020 për licencimin e shoqërisë ñTBò sha për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime në klasat e Jetës dhe joJetës dhe licencimin e Zj. OM për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime në klasat e Jetës dhe të joJetës në emër e për llogari të shoqërisë TB sha duke propozuar miratimin e këtyre licencimeve.

Bordi me Vendim nr. 76 datë 15.06.2020 ka miratuar licencimin e shoqërisë "T Bë" sha për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime në klasat e Jetës dhe jo-Jetës (dhe licencimin e Znj. OM për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime në klasat e Jetës dhe të jo-Jetës për një periudhë pa afat në emër dhe për llogari të shoqërisë "TB" sha).

Vendimi i Bordit i është komunikuar shoqërisë ñTBò sha me shkresën nr. 694/1 datë 17.06.2020.

Nga auditimi konstatohet se afati i dhënies së licencës për këtë shoqëri brokerimi nuk është brenda 2 muajve nga plotësimi i dokumentacionit sipas përcaktimeve të bëra në pikën 3 të nenit 13 të rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 "Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime" ku citohet se *"Autoriteti, brenda 2 muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit të plotë nga ana e kërkuesit për licencë, jep ose refuzon licencën për ushtrim veprimtarie brokerimi në sigurime".*

Në lidhje me këtë praktikë licencimi janë paraqitur observacionet duke parashtruar që:

Sqarojmë se sipas nenit 7, pika 1, germa c) e rregullores 48 datë 30.06.2015 ñPër kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurimeò e ndryshuar, Veprimtaria e brokerimit në emër dhe për llogari të shoqërisë do të kryhet nga brokeri/at në sigurime të licencuar nga Autoriteti.
Shoqëria TB, ka depozituar dokumentacionin lidhur me Brokerin e Licencuar në sigurime Zj. OM në datë 06.05.2020 (protokolluar në Autoritet me nr. 1096 dhe 1097 prot., datë 18.05.2020). Referuar sqarimit të mësipërm afati fillon nga dokumenti më i fundit i datës 18.05.2020. Vendimi është marrë në mbledhjen e Bordit *datë 15.06.2020 ku Autoriteti ka miratuar licencimin e shoqërisë "TB" sha për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime. Pra Autoriteti, brenda 2 muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit të plotë nga ana e kërkuesit për licencë ka dhënë licencën për ushtrim veprimtarie brokerimi në sigurime*, brenda afateve të përcaktuara në nenin 13, pika 3, të rregullores 48 datë 30.06.2015 e ndryshuar. Në këto kushte çmojmë se konstatimi nuk qëndron pasi Autoriteti ka vepruar në përputhje me kërkesat rregullatorë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se dokumentacioni i dorëzuar në 18.05.2020 është për licencimin e brokerit fizik që vepron në emër dhe për llogari të TB dhe jo për kërkesën e TB si shoqëri brokerimi në tregun e sigurimeve. Kërkesa e TB për të ushtruar

veprimtari brokerimi në sigurime është paraqitur duke pretenduar se ka të punësuar Bfizik, si kriter për përmbushjen e kritereve të licencimit të shoqërisë së brokerimit, ndërkohë që këto Bfizik nuk kanë qenë të licencuar por pas kërkesës për licencim si shoqëri brokerimi kanë ushtruar kërkesën për licencim si Bfizik. Në këtë mënyrë, pas kërkesës për licencim si shoqëri brokerimi, në momentin e konstatimit që shoqëria nuk përmbushte kriteret për licencim si pasojë e mungesës së brokerit të licencuar, AMF duhet të merrte vendim për refuzim të licencimit. Plotësimi i dokumentacionit për licencimin e brokerit fizik është kryer duke zgjatur afatin edhe për licencimin e shoqërisë së brokerimit, ndërkohë që referuar kërkesës për licencim dhe dokumentacionit të paraqitur, kemi të bëjmë me dy praktika të ndryshme licencimi. Për këto arsye observacionet nuk merren në konsideratë.

Në lidhje me çështjet e trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit, me shkresën nr. 41/1 datë 29.09.2021, protokolluar në KLSH me nr. 845/6 datë 29.09.2021 janë paraqitur observacione për këtë praktikë duke parashtruar: Sqarojmë se neni 9, pika 3 e rregullores nr.48 datë 30.06.2015 ñPër kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurimeò e ndryshuar parashikon se ñVeprimtaria e brokerimit në sigurime nga B dhe /ose dega e B së huaj ushtrohet nëpërmjet brokerit të licencuar. T B sha ka depozituar kërkesën dhe dokumentacionin lidhur me brokerin e licencuar në sigurime Zj. OM në datë 06.05.2020. ....Pra autoriteti ka miratuar licencimin brenda 2 muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit të plotë nga ana e kërkuesit për licencë brenda afateve të përcaktuara. ....Gjithashtu edhe në licencën e brokerit fizik përcaktohet Sh B në emër e për llogari të cilit do të punojë brokeri. Ndaj procesi i licencimit është një i vetëm....

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Sqarojmë se kërkesa fillestare për tu licencuar nga shoqëria është paraqitur në 02.03.2020, ku për përmbushjen e kriterit të listës e brokerave të licencuar, ka përfshirë kërkesën për licencim të brokerave fizikë, kriter i cili nuk përmbushej në momentin e kërkesës duke qenë se nuk ishte paraqitur B aktualisht i licencuar, por një kërkesë për të licencuar një B dhe për brokerin tjetër nuk është licencuar në vijim. Kërkesa për licencim si shoqëri nuk parashikohet në rregullore që duhet të J në të njëjtën kohë me licencimin e brokerit fizik, por presupozohet që gjatë kërkesës është paraqitur dokumentacioni që provon ekzistencën e brokerave të licencuar si kriter i përmbushur dhe jo të atyre që pritet të licencohen si kriter që pritet të përmbushet në vijim. Këto kërkesa duhet të paraqiten të ndara duke qenë se sjellin mungesën e vendimmarrjes brenda afatit të përcaktuar në rregullore për përmbushjen ose jo të kritereve.
Gjithashtu në lidhje me pretendimin se në licencën e brokerit fizik përcaktohet se shoqëria në emër e për llogari të cilit do punojë brokeri sqarojmë se në nenin 3 ñKriteret e licencimit të brokerit në sigurimeò dhe nenin 4 ñDokumentacioni për licencimin e brokerit në sigurimeò të rregullores nr.48 datë 30.06.2015, të sipërcituar, nuk përcaktohet asnjë kriter dhe asnjë dokumentacion që e kushtëzon licencimin e brokerit fizik me një shoqëri brokerimi.
Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Gjetja: <u>Në praktikën e licencimit të TB si shoqëri brokerimi, afati i dhënies së licencës nuk është respektuar duke qenë se është trajtuar në të njëjtën kohë me licencimin e brokerit fizik i cili do të veprojë në emër dhe për llogari të shoqërisë së brokerimit.</u>

Situata: AMF me Vendim nr. 76 datë 15.06.2020 ka miratuar licencimin e shoqërisë ñTBò sha për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime në klasat e Jetës dhe jo-Jetës. Lista e brokerave të licencuar në kërkesën për licencim nuk përfshin Bfizik të licencuar nga AMF dhe në vijim është trajtuar lista e personave të paraqitur, si kërkesë për pajisjen me licencë për Bfizik. Licencimi i brokerit fizik dhe licencimi i shoqërisë së brokerimit janë dy

	procese të ndara të cilat në këtë praktikë licencimi janë trajtuar të bashkuara, gjë që ka sjellë edhe vonesën në licencimin e shoqërisë së brokerimit. Kërkesa për pajisjen me licencë është paraqitur nga TB sha me nr. 694 datë 02.03.2020 për të kryer veprimtari brokerimi në sigurime duke paraqitur listën e brokerave të licencuar me qëllim përmbushjen e kriterit përkatës, ndërkohë që brokerat nuk kanë qenë të licencuar por janë licencuar në të njëjtën kohë dhe praktikë me shoqërinë e brokerimit. Nga auditimi konstatohet se afati i dhënies së licencës për këtë shoqëri brokerimi nuk është brenda 2 muajve nga plotësimi i dokumentacionit sipas përcaktimeve të bëra në pikën 3 të nenit 13 të rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 *"Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime".*
Kriteri:	pika 3 e nenit 13 të rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 "Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime"
Ndikimi/Efekti:	Mos respektim i afatit për dhënien e licencës
Shkaku:	Trajtimi i kërkesës për licencim të shoqërisë në të njëjtën kohë me kërkesën për licencim të brokerit fizik
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga ana e AMF të merren masa që në rast të mos përmbushjes së kritereve specifike të shoqërisë së brokerimit për pasjen e brokerave të licencuar fizikë nga autoriteti, trajtimi i kërkesës për licencimin e brokerit fizik të kryhet veçmas nga trajtimi i kërkesës për licencim të shoqërisë së brokerimit, me qëllim shmangien e vonesave në praktikat e licencimit.

4- Licencimin i Zj. ASh si B për tregtimin e titujve në emër dhe për llogari të shoqërisë “”BAI” sha.

Kërkesa për marrje licencë Bnë tituj është paraqitur në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare me nr. 3241 datë 16.10.2019. Kjo kërkesë është shoqëruar me:
-formë kërkesë për llojin e veprimtarisë dhe shoqërinë përfaqësuese (BAI sha) të nënshkruar nga kërkuesi datë 09.10.2019;
-fotokopje ID;
-fotokopje kontratë pune datë 14.04.2014 si dokumenti që përcakton dhe rregullon marrëdhënien mes shoqërisë dhe kërkuesit;
-dëshmi penaliteti;
-vërtetim banimi;
-kopje e noterizuar e diplomës dhe Master në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës;
-CV e përditësuar dhe kontrata e punës në pozicionin e money market dealer si dëshmi/ dokumentacion që përcakton kualifikimin dhe përvojën të paktën një vjeçare në pozicione ku pjesë e punës kanë qenë operacione, analiza, këshillime, Iime me tituj.
-Letër referencë për reputacionin datë 27.09.2019 nga punëdhënësi epror direkt;
-fotokopje të certifikatës së trajnimit për kualifikim profesional ñBnë titujò organizuar nga AMF;
-Dokumenti që vërteton se brokeri/këshilltari ka kaluar testin e njohurive profesionale, (në bazë të Urdhrit të Drejtorit të AMF nr. 303 datë 11.12.2019 mbi ngritjen e komisionit të testimit të Zj. ASh është hartuar procesverbali nr. 3787/1 datë 24.12.2019 ku komisioni ka vendosur kalimin me sukses të testimit për licencë ñBnë titujò për Zj. ASh);
-deklarata personale për mungesën e dënimeve, mos qenien administrator/drejtuese apo kontrolluese në ndonjë shoqëri si dhe mos qenien punonjëse/anëtare e këshillit mbikëqyrës apo të bordit drejtues në ndonjë shoqëri tjetër brokerimi apo këshillimi.

Nga auditimi konstatohet se pjesë e dokumentacionit të vendosur në dispozicion mbi testimin e realizuar është urdhri për ngritjen e komisionit të testimit dhe procesverbali i komisionit përkatës të testimit, por jo testi i realizuar nga kërkuesi për licencim.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit nga ana e AMF është kërkuar me emali të datës 22.10.2019 plotësimi i dokumentacionit. Dokumentacioni plotësues është dërguar në AMF me shkresën nr. 3241/1 datë 20.11.2019:
-vërtetim nga gjykata;
-vërtetim nga prokuroria;
-raportin e kredimarrësit nga B e Shqipërisë;
-vërtetim nga Zyra Përmbarimore;
-vërtetim nga tatimet për kontributet e sigurimeve;
-vërtetim që është i padënuar nga AMF.
-pagesën e tarifës për shqyrtim dokumentacioni;
-deklarata përkatëse

Drejtoria e Licencimit / Departamenti i Çështjeve Juridike (me relacion të përgatitur nga EC dhe EK) ka paraqitur në Bord relacionin datë 06.01.2020 ñPër licencimin e Zj. ASh për të vepruar si Bfizik për tregtim e titujve në emër dhe për llogari të shoqërisë ñBAIò sha duke propozuar miratimin e licencimit.

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me Vendim nr. 6 datë 22.01.2020 ñPër miratimin e licencimit të Zj. ASh për të ushtruar veprimtari në tituj si Bfizik në emër dhe për llogari të shoqërisë BAI sha. ka vendosur licencimin e Zj. ASh për ushtrimin e veprimtarisë si Bfizik të Zj. ASh në emër dhe për llogari të shoqërisë ñBAI shaò. Vendimi i Bordit është dërguar me shkresë nr. 3241/2 datë 29.01.2020 shoqërisë ñBAI shaò.

Në lidhje me këtë praktikë licencimi janë paraqitur observacionet e mëposhtme duke parashtruar që:
Sqarojmë se bazuar në nenin 14, pika 1 të rregullores nr. 35, datë 27.03.2019 ñPër organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në autoritetin e mbikëqyrjes financiareò, ñDokumentacioni që është krijuar gjatë procesit të testimit, dorëzohet dhe ruhet në protokollin/arkivën e Autoritetit në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të fletëve të testimeve dhe ritestimeve të kandidatëve pjesëmarrësò. Për këtë arsye testimi është ruajtur së bashku me të gjithë dokumentet e tjerë dhe jo si pjesë e praktikës së licencimit. Gjithsesi, bashkëlidhur testi i zj. ASh.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në përgjigje të këtyre observacioneve shprehemi se duke qenë se është dërguar bashkëngjitur testimi përkatës, merren në konsideratë observacionet.

5- Licencimi i Zj. ET si aktuare e autorizuar;

Kërkesa me nr. 2007 datë 18.06.2019 është paraqitur nga Zj. ET shoqëruar me dokumentacionin bashkëngjitur. Bashkëngjitur kërkesës janë paraqitur:
-CV
-Vërtetim nga DRT Tiranë se nuk është e regjistruar
-Formular vetdeklarimi si i padënuar.
-Konfirmim nga sektori i edukimit financiar në AMF se Zj. ET ka përfituar në total 40.5 kreditë për periudhën Dhjetor 2016-Qershor 2019;
-Certifikatë elektronike nga AMF se rezulton i padënuar.

Kërkesa për rinovim dhe dokumentacioni është paraqitur në 18.06.2019 brenda afatit 6 mujor të përfundimit të licencës nr. 15/1 datë 24.11.2016 (me afat 3-vjeçar).

Zyra e Licencimit në Departamentin e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve (relacion përgatitur nga MM dhe LR) ka referuar në Bord në datë 08.07.2019 duke gjykuar mbi përputhshmërinë e

dokumentacionit të paraqitur me kriteret përkatëse dhe ka propozuar miratimin e rinovimit të licencës.
Departamenti i çështjeve juridike në 09.07.2019 ka sugjeruar gjithashtu miratimin e rinovimit të licencës.

Bordi i Mbikëqyrjes Financiare ka rinovuar licencën e Zj. ET me shkresën nr. 131 datë 24.07.2019 për të ushtruar veprimtarinë e aktuarit të autorizuar me afat 3-vjeçar
Vendimi i Bordit për licencimin e Zj. ET është dërguar me shkresën nr. 2550 datë 06.08.2019.
Për sa më sipër në këtë dosje të testuar nuk u konstatuan mos përputhshmëri.

6- Licencimin i Z. HXh si vlerësues i dëmeve materiale dhe shëndetësore

Kërkesa fillestare për rinovimin e licencës është paraqitur nga kërkuesi HXh me shkresën nr. 289 datë 23.01.2019 duke bashkëngjitur CV, formular vetdeklarimi të gjendjes gjyqësore, deklaratat personale, dokument që nuk ka detyrime fiskale nga tatimet dhe regjistri i kredive si dhe certifikatë trajnimi. Për përmbushjen e kritereve për edukimin në vazhdim për vlerësues dëmesh në sigurime, në relacionin teknik të paraqitur në Bord është cituar që sipas sektorit të edukimit financiar ka grumbulluar 24/24 kreditë të nevojetëshme, ndërkohë që për përmbushjen e pikës që të ketë kaluar me sukses testin e njohurive sipas pikës 7/h të rregullores është cituar se Z. HXhka marrë pjesë në testimin e organizuar në AMF për vlerësues dëmesh në datën 11.07.2019 dhe sipas pikëve të grumbulluara nga vlerësimi i komisionit të testimit e ka kaluar atë për të tre modulet, vlerësues i dëmeve materiale motorike, vlerësues i dëmeve materiale të pronës dhe vlerësues i dëmeve shëndetësore.

Dokumentacioni i dorëzuar është përditësuar me kërkesën nr. 2567 datë 06.08.2019 duke paraqitur edhe policë sigurimi për përgjegjësinë profesionale me limit për çdo dëm dhe në agregat nga I me nr. 654/2018. Bashkë me policën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale është dërguar edhe formë kërkesa për pajisje me licencë, raporti i kredimarrësit datë nr. 5164 datë 31.07.2019, deklaratat e kërkuara nga rregullorja dhe vërtetim për pagim detyrimesh tatimore datë 30.07.2019.
Relacioni teknik i Zyrës së Licencimit, Departamenti i Çështjeve Juridike (përgatitur nga JM dhe VTh) është paraqitur në Bord në 07.08.2019 duke propozuar rinovimin e licensës së Z. HXhpër ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të pavarur të dëmeve në sigurime të joJetës në grupet materiale motorike, materiale të pronës dhe shëndetësore. Në Bord ka paraqitur opinionin juridik Departamenti i Çështjeve Juridike në datë 07.08.2019 duke i sugjeruar Bordit miratimin e rinovimit të licencës.

Bordi me Vendim nr. 162 datë 14.08.2019 ka vendosur rinovimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime për Z. HXhnë grupet e sigurimit jo J (materiale motorike, materiale të pronës dhe shëndetësore). Vendimi i bordit dhe licenca e vlerësuesit është dërguar me shkresën nr. 3078 datë 01.10.2019.
Për sa më sipër në këtë dosje të testuar nuk u konstatuan mos përputhshmëri.

7- Licencimin me kusht i "VC" sha

Baza ligjore mbi të cilën është kryer licencimi është Rregullore nr. 71 datë 27.03.2019 ñPër veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në titujò.
Shoqëria VS sha ka paraqitur në AMF me shkresë nr. 3758 datë 06.12.2019 ka paraqitur në AMF kërkesë për miratim për të kryer veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit të licencuar. Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:
-deklaratë për burimin e parave për kapitalin e shoqërisë;
-vërtetim nr. prot. 034 datë 28.10.2019 mbi gjendjen e llogarisë Bre në shumën 57,349.45 Euro;
-kontrata qereje mbi burimin e të ardhurave;
-vërtetim për Z. ShB nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë që nuk ka proces penal;

-vërtetim nga prokuroria se nuk ka procedim penal; vërtetim nga Zyra e Përmbarimit Tiranë se nuk ka detyrime; dëshmi penaliteti; për aksionarin ShB;
-projekt statut i shoqërisë aksionere (mbi selinë degën, kapitalin themeltar prej 6,000,000 lekë, këshillin mbikëqyrës me përbërje BZ, MB, DXh, , administrator EGJ, aksionar i vetëm ShB;
-vërtetim nga prokuroria se nuk ka procedim penal; vërtetim nga Zyra e Përmbarimit Tiranë se nuk ka detyrime; dëshmi penaliteti; për administratorin Zj. EGj (së bashku me diploma universitare dhe CV si arkëtare dhe kryearkëtarë në B e Specialiste finance në Këshillin e Qarkut Fier;
-letër qëllimi për partneritet biznesi ndërmjet WGM dhe VS sha nënshkruar në 15.10.2019.
-ndryshim autorizimi të firmës së Investimeve në Qipro ñWGMò nga Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Këmbimit Qipro.
- vërtetim nga Zyra e Përmbarimit Tiranë se nuk ka detyrime; dëshmi penaliteti; për anëtarin e Këshillit Mbikëqyrës MB.
-Memorandum mirëkuptimi për trajnimin dhe kualifikimet e stafit të agjentit të lidhur;
-Deklaratë se shoqëria ka punësuar punonjës me kualifikim dhe përvojën e duhur në ofrimin e shërbimeve për klientët, kryerjen e trajnimeve të vazhdueshme, etj.;
-rregullore operative;
-Manual i procedurave të brendshme të WGM; politika e tregjeve Phoenix, WGM Politika e Ankesave; politika kundër pastrimit të parave, manuali i procedurave të brendshme të agjentit të lidhur.
-Letër e WGM për VS sha duke sqaruar pozicion e WGM për aplikimin e VS (WGM nuk ka punuar asnjëherë me asnjë kompani shqiptare; nuk ka asnjë aplikim për agjent të ndërlidhur për AMF; qëllimi i WGM është krijimi i një marrëdhënie biznesi me VS sapo autorizimi të jepet dhe implementimi i politikave dhe procedurave të marrëveshjes së agjentit të ndërlidhur dhe memorandumit të mirëkuptimit.

Nga ana e Drejtorisë së Licencimit me emali të datës 06.01.2020 dhe të datës 30.01.2020 është kërkuar shoqërisë plotësimi i dokumentacionit. Plotësimi i dokumentacionit është dërguar në AMF me shkresën nr. 3758/3 datë 27.02.2020 duke bashkëngjitur:
-Certifikatë regjistrimi;
-Vërtetim nr. 7 datë 22.02.2020 nga UB për balancën e llogarisë në lekë në shumën 6,090,000 lekë.
-Rregullore e brendshme e funksionimit të shoqërisë (mënyra e promovimit të shërbimeve të brokerit, mënyra e komunikimit me klientët, procedura e njohjes së klientëve, rregullat për parandalimin e pastrimit të parave, mënyra e shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, rregullore mbi vlerësimin e performancës dhe përshkallëzimin e shkeljeve.
-Për anëtarin e këshillit mbikëqyrës zj. GC që ka zëvendësuar Z.BZ janë paraqitur vërtetim nga prokuroria, gjykata, tatimet, dëshmi penaliteti, raport kredimarrësi, vërtetim nga zyra përmbarimore;
- Për anëtarin e këshillit mbikëqyrës MB vërtetim nga tatimet, raport kredimarrësi,deklaratë;
- Për anëtarin e këshillit mbikëqyrës DXh vërtetim nga tatimet, aplikim për raport kredimarrësi, deklaratë e nënshkruar;

Në vijim nga shoqëria VS sha është dërguar në AMF shkresa nr. 3758/4 datë 21.04.2020 ku është deklaruar:
-mungesa e dokumentacionit për provimin e mos dënimit apo qenies në proces penal për punonjësit duke qenë se shoqëria ende nuk ka marrë miratimin nga AMF dhe nuk ka nënshkruar kontratë me brokerin e licencuar dhe ende nuk ka kontrata punësimi të lidhur me individë;
-mungesa e dokumentacionit që vërteton se punonjësit e njësisë kanë njohuritë e duhura dhe certifikimet përkatëse sipas kërkesave të kuadrit rregullator ku është licencuar brokeri në tituj duke qenë se shoqëria ende nuk ka marrë aprovimin. Megjithatë, garanton se që në momentin e

parë të punësimit punësimit dhe në mënyrë të vazhdueshme të gjithë punonjësit do të jenë të aftë dhe të përshtatshëm për të realizuar shërbimet për të cilat kjo shoqëri ofron.
- mes VS dhe WGM ende nuk ka një kontratë për ofrimin e shërbimit dhe shoqëria garanton se do të përmbushë kërkesat e rregullores dhe do të krijojë sistemet e nevojetëshme për regjistrimin e telefonatave të kryera mes personelit të shoqërisë VS dhe klientëve të brokerit WGM
- garanton AMF se do të përmbushen kërkesat e rregullores dhe do ti vihen në dispozicion Autoritetit brenda një afati kohor nga data e njohjes së shoqërisë VS sha si agjent i brokerit të licencuar.
Bashkëngjitur janë dërguar edhe vërtetim nga prokuroria dhe gjykata dhe formular vetdeklarimi për DXh, Raporti i Kredimarrësit, vërtetim prokurori, gjykate, formular vetdeklarimi dhe për pagesën e detyrimeve tatimore për ShB; vërtetim për pagim detyrimesh tatimore nga DRT Tiranë për EGj/VS; formular vetdeklarimi për EGj, vërtetim gjykate dhe prokurorie për MB.

Me shkresë nr. 3758/5 datë 17.07.2020 është plotësuar dokumentacioni nga shoqëria duke dërguar ñLetër qëllimi për partneritet biznesiò midis WGM dhe VS sha.

Drejtoria e Licencimit, Departamenti i Çështjeve Juridike ka paraqitur në Bord relacionin teknik (të përgatitur nga E Ç, E K dhe V Th) datë 20.07.2020 duke propozuar Bordit të AMF miratimin e njohjes dhe regjistrimi të shoqërisë me kusht që aktiviteti i shoqërisë të filloje pasi shoqëria të depozitojë në autoritet brenda një afati kohor prej një muaji nga data e miratimit të njohjes:
-kontratë e shoqërisë me shoqërinë e brokerimi në tituj sipas letrës së angazhimit;
-dokumente që vërtetojnë se ka vendosur një sistem të regjistrimit të telefonatave dhe funksionit të përputhshmërisë;
dokumente që vërtetojnë se punonjësit e njësisë që promovojnë produktet dhe shërbimet e brokerit në tituj dhe komunikojnë me klientët kanë njohuritë e duhura si dhe certifikimet përkatëse sipas kërkesave të kuadrit rregullator ku është licencuar brokeri në titujt dhe dokumente që të mos kenë qenë dënuar për ndonjë vepër penale dhe të mos kenë çështje penale në proces.

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr. 105 datë 29.07.2020 ka vendosur njohjen dhe regjistrimin me kusht të shoqërisë VS sha për të vepruar si agjent i i shoqërisë së brokerimit në tituj ñWGMò e licencuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë të Qipros (SySEC) me kusht që aktiviteti i shoqërisë të fillojë pasi shoqëria të depozitojë në autoritet brenda një afati kohor prej një muaji nga data e miratimit të njohjes së veprimtarisë.

Vendimi i Bordit është komunikuar shoqërisë ñVSò sha me shkresën nr. 3758/6 datë 06.08.2020.
Për sa më sipër në këtë dosje të testuar nuk u konstatuan mos përputhshmëri.

8- Licencimi i AS sha si shoqëri brokerimi në tregun e titujve

Baza ligjore mbi të cilën është realizuar licencimi i shoqërisë është Rregullore nr. 165 datë 23.12.2008, ñPër licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit, brokerit dhe këshilltarit të Investimeve ò, e ndryshuar. Sipas kësaj rregulloreje, në fillim kryhet aplikimi për miratimin e aktit të themelimit dhe projekt statutit të shoqërisë dhe në vijim kryhet licencimi i shoqërisë pasi ka përmbushur kushtet për pasjen e një brokeri fizik të licencuar si dhe për kërkesat e tjera rregullator.

Aplikimi fillestar është paraqitur nga shoqëria AS sha me nr. 3812 datë 12.11.2018 për marrjen e miratimin për agjentin e brokerit të licencuar shoqëruar me:
-formë kërkesë për licencimin e shoqërisë së brokerimit/këshillimit për të blerë dhe shitur tituj me porosi të klientit, kapital fillestar 6,000,000 lekë nga aksionar FS 60% dhe NS 40% dhe

listë të personave të punësuar për të vepruar si BBM (përcaktuar edhe si administrator i shoqërisë).
-projekt Akti i Themelimit dhe projekt Statutin e shoqërisë aksionare.
-dokumentacioni në lidhje deklaratat, vërtetime banimi, dëshmi penaliteti dhe vërtetime të pagesës së detyrimeve tatimore etj për aksionarët dhe administratorin e kompanisë.

Në vijim me shkresë nr. 3812/1 datë 26.12.2018 nga ana e ASsha është dërguar informacion plotësues për plan biznesi, dhe pasqyrë llogarie Bre për aksionarët.

Shoqëria ASsha ka paraqitur kërkesë në AMF me nr. 83 datë 09.01.2019 duke bashkëngjitur informacion plotësues plan biznesi, ridërguar së bashku me planifikimin e shpenzimeve dhe projeksionin e të ardhurave me nr. 83/1 datë 28.01.2019.
Me shkresë nr. 83/3 datë 7.02.2019 është kërkuar informacion në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për aksionarët e shoqërisë duke bashkëngjitur deklaratat mbi origjinën e kapitalit dhe dokumentacionin përkatës, për të cilën është kthyer përgjigje me shkresën nr. 83/6 datë 14.02.2019.
Plani i biznesit është ridërguar me shkresën nr. 83/4 datë 14.02.2019 duke rishikuar të dhënat në lidhje me të ardhurat shpenzimet në periudhë trevjeçare.
Me shkresën nr. 83/6 datë 19.02.2019 është plotësuar dokumentacioni i kërkuar duke bashkëngjitur raportet e kredimarrësit për aksionarët.
Bordi i AMF me Vendim nr. 32 datë 04.03.2019 ka vendosur miratimin e aktit të themelimit dhe projekt statutit të shoqërisë ASsha i cili i është komunikuar shoqërisë me shkresën nr. 83/7 datë 08.03.2019.

Kërkesa fillestare është paraqitur nga shoqëria AS sha në AMF me shkresë nr. 1073 datë 28.03.2019 në të cilën është kërkuar marrja e miratimit për veprimtarinë e brokerit të licencuar për shoqërinë AS sha dhe për marrjen e aprovimit për kandidaturat e Këshillit të Administrimit për Z. FS (Kryetar), Z. N Sh anëtar dhe Z. B M anëtar.

Me shkresë nr. 1677 prot. AMF datë 21.05.2019 është paraqitur në AMF formë kërkesë për licencimin e brokerit/këshilltarit të Investimeve për BM dhe formë kërkesë për licencimin e shoqërisë së brokerimit/këshillimit. Nga ana e Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitalit dhe Fondeve pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit është kërkuar plotësimi dhe depozitimi i dokumentacionit të nevojetëshëm për licencim.

Nga ana e Zyrës së Licencimit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitalit dhe Fondeve është referuar për Bordin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare relacioni mbi licencimin e shoqërisë AS sha për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në tituj. Shoqëria ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për licencim me shkresat nr. 1073 datë 28.03.2019 dhe nr. 1677 datë 21.05.2019. Dokumentacioni i paraqitur përfshin:
-formë kërkesën për licencimin e shoqërisë së brokerimit;
-kopje të noterizuar të statutit të nënshkruar nga aksionarët në 21.05.2019;
-struktura organizative e shoqërisë;
-dokument që vërteton pagesën e kapitalit fillestar, lëshuar nga CB datë 11.07.2019 për bllokimin e shumës 6,000,000 lekë;
-vendimin e Bordit Drejtues për llojin e veprimtarisë që do kryejë shoqëria, bazuar në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme datë 26.03.2019;
-kopje e ekstraktit të regjistrit tregtar të shoqërisë në QKB;
-dokument që vërteton se Sh B ka punësuar një B në zbatim të kërkesës së nenit 48, pika 3 e ligjit nr. 9879 ku cilësohet se Z. SM do të punojë si B fizik në tituj në emër të shoqërisë pas miratimit nga AMF. Z. M me nr. licence 26 datë 27.07.2017 për shoqërinë **SC**, nga e cila ka ndërprerë marrëdhëniet e punës sipas vendimit të Asamblesë (të shoqërisë ku ishte punësuar më parë) të datës 06.06.2019 dhe me vendimin e datës 04.07.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë AS është vendosur punësimi si B fizik për shoqërinë ñASò. Në lidhje me këtë

praktikë licencimi nga auditimi konstatohet se nuk përmbushet kushtet për vërtetimin se shoqëria ka të punësuar një Bduke qenë se vendimi i asamblesë për marrjen në punë nuk përbën një marrëdhënie punësimi për të cilën evidentohen kushtet përkatëse sipas kërkesave të nenit 9 të rregullores nr. 165, datë 23.12.2008, *"Për licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit,brokerit dhe këshilltarit të Investimeve ",* e ndryshuar ku citohet se *"Dokumentacioni mbi shoqërinë kërkuese: ... Dokument që vërteton se Sh B/këshillimit ka punësuar një Bdhe/ose një këshilltar Investimi;".* Për plotësimin e këtij dokumentacioni është paraqitur Vendimi i asamblesë së shoqërisë AS për marrjen në punë të Z. SM si B licensuar por jo kontrata e punësimit të shoqërisë me brokerin fizik.

-një përshkrim mbi infrastrukturën dhe software që do të përdorë Sh B gjatë tregtimit të titujve. Me urdhër nr. 148 datë 11.06.2019 është ngritur komisioni për verifikimin e ambienteve infrastrukturës dhe software të shoqërisë AS me përbërje Zj. P.P, Z. E.C dhe Zj. E.Ç. Në zbatim të këtij urdhri janë kryer inspektimet në ambientet nga grupi dhe në lidhje me software është shprehur se shoqëria është në proces të zhvillimit të një sistemi për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave të klientit dhe u konstatua se ajo ka persona të duhur e me eksperiencë për zhvillimin e këtij sistemi. Sistemi mendohet të realizohet pas licencimit ë shoqërisë dhe sistemi kryesor që do përdorë shoqëria do J sistemi i tregtimit të bursës.
-nëse shoqëria ka ushtruar një aktivitet tjetër përpara kërkesës për të vepruar si shoqëri brokerimi në **Iime** nuk aplikohet pasi është shoqëri e re;
-vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatimit dhe taksave nuk ka se është shoqëri e re;
-dokument për shlyerjen e pagesave ndaj autoritetit, tarifa e paguar sipas mandatit prej 5,000 lekë pranë C B datë 21.05.2019.;
-Dokumentacioni mbi identitetin e kapitalit aksionar i cili është shqyrtuar gjatë fazës së miratimit të projekt statutit të shoqërisë;
-dokumentacioni mbi aktivitetin që do të kryhet dhe organizimin e tij, duke përfshirë plan biznesi 3-vjeçar, rregulloren e brendshme të shoqërisë AS, rregullore mbi masat për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit. Nga auditimi konstatohet se sipas plan biznesit të paraqitur është parashikuar rezultati me humbje i shoqërisë për tre vitet e para të operimit, parashikuar të financohet me anë të shtesave në kapital. Kapitali i parashikuar për vitet e operimit është projektuar në nivelet 400,000 lekë, 1,755,750 lekë dhe 2,005,000 lekë, duke reflektuar mos përmbushjen e nevojave për kapitalin minimal të kërkuar për shoqërinë në nivelin e 6,000,000 lekë përgjatë të gjithë periudhës së projektuar të ushtrimit të aktivitetit. Gjithashtu konstatohet se nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk paraqiten evidenca në lidhje me zotërimin e mjeteve të mjaftueshme nga aksionarët për mbulimin e shtesave të propozuara në kapital në vlerën 8,000,000 lekë për vitin e 2 dhe 14,500,000 lekë për vitin e 3.
-sipas neneve 14 dhe 15 të rregullores nr. 165 kërkesat për anëtarët e KA nga ku konstatohet në relacionin e prezantuar në Bord është referuar se plotësohen duke u shprehur se plotësohen kërkesat për anëtarët e KA vërtetuar me komisionin e ngritur në bazë të urdhrit nr. 147 datë 11.06.2019 ku sipas referimit të komisionit pas intervistimit (me përbërje Zj. FM, Zj. PP dhe Zj. E Ç) është gjykuar se anëtarët e propozuar i plotësojnë kërkesat ligjore për përshtatshmëri dhe aftësi që duhet të zotërojnë kandidatët për miratimin e tyre në pozicionin e administratorit dhe anëtarëve të këshillit të administrimit. Nga auditimi konstatohet se për anëtaret e KA Z. FS dhe Z. NSh nuk plotësohen kushtet e pikës 2 të nenit 15 të rregullores nr. 165, datë 23.12.2008, *"Për licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit,brokerit dhe këshilltarit të Investimeve ", e ndryshuar ku citohet se "Dokumentacioni që shoqëron kërkesën në lidhje me kandidaturën për anëtar të organeve drejtuese është: ... 2. CV së bashku me dëshmitë përkatëse që përcaktojnë kualifikimin dhe përvojën përkatëse, sidomos në fushën e transaksioneve me titujt;".* Dokumentacioni i vendosur në dispozicion grupit të auditimit dhe matrica e përmbushjes së kritereve për secilin anëtar të paraqitur me relacion teknik në Bord nuk

paraqiten dëshmi që përcaktojnë kualifikimin dhe përvojën përkatëse në fushën e transaksioneve me tituj. Konstatohet se propozimi në bord është kryer për përmbushjen e kërkesave rregullatore ndërkohë që referuar dokumentacionit justifikues nuk paraqiten përvojë/eksperiencë pune në fushën e tregtimit të titujve. Edhe përsa i përket kualifikimit konstatohet se administrator i propozuar dhe në të njëjtën kohë anëtar i këshillit të administrimit ka kualifikime në fushën e inxhinierisë së ndërtimit dhe për kualifikime në fushën financiare është paraqitur pranë grupit të auditimit certifikatë për trajnim për kualifikim profesional për Bnë tituj me nr. regjistri 261 për administratorin si dhe procesverbali nr. 3351/2 datë 28.12.2018 për kalimin e testimit nga administratori.

Mbështetur në dokumentacionin përkatës, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Kapitalit dhe Fondeve, Zyra e Licencimit me relacionin teknik (hartuar nga E Ç dhe N K) i ka rekomanduar Bordit të AMF të miratojë:
-Licencimin e shoqërisë AS për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në tituj dhe;
-Miratimin e Z.SM për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit fizik në tituj në emër dhe për llogari të shoqërisë AS sha.

Departamenti i Cështjeve Juridike ka paraqitur në Bordin e AMF opinionin juridik në 18.07.2019 mbi licencimin e shoqërisë AS sha për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit të tregtimit të letrave me vlerë ku referuar relacionit të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve është sugjeruar:
-Licencimin i shoqërisë AS sha për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në tituj në tregun e rregulluar B Shqiptare e Titujve ALSE dhe miratimin e Z. SM për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit fizik në tituj në emër dhe për llogari të shoqërisë AS sha.

Nga ana e Bordit të AMF me Vendim nr. 155 datë 24.07.2019 është vendosur licencimi i shoqërisë **AS** për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në tituj në B Shqiptare të titujve ALSE dhe miratimin e Z.SM për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit fizik në tituj në emër dhe për llogari të shoqërisë ASsha. Ky vendim është komunikuar me shkresën nr. 2477/1 datë 08.08.2019.

Me kërkesën nr. 3717 datë 03.12.2019 është kërkuar ristrukturimi i Këshillit të Administrimit dhe me zëvendësimin e Z. BM me Z. SM dhe ndryshimin e administratorit nga Z. BM me Z.FS, të reflektuara me ndryshim në statutin e shoqërisë AS sha. Kjo kërkesë është miratuar me Vendimin e Bordit nr. 231 datë 29.12.2019 për miratimin e ndryshimit të nenit 17.2 të statutit dhe nenit 19.3, komunikuar me shkresën nr. 3717/1 datë 31.12.2019.

Në lidhje konstatimet në këtë praktikë licencimi janë paraqitur observacionet si në vijim:

.....Autoriteti në përmbushje të kërkesës më sipër ka dokumentuar plotësisht këtë kërkesë duke marrë kontratën me brokerin e licencuar, përpos vendimit të asamblesë, menjëherë pas Licencimit të shoqërisë si shoqëri brokerimi në tregun e titujve. Bashkëngjitur ju vëmë në dispozicion kontratën e lidhur midis shoqërisë dhe brokerit të licencuar, dokument i depozituar në Autoritet.....
.....Sqarojmë se <u>kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e këshillit të administrimit janë të përcaktuara në nenin 14 dhe jo 15, si më poshtë:</u>
a. Të mos J dënuar për asnjë vepër penale dhe të mos ketë çështje penale në proces;
b. Të mos J administrator, drejtues apo kontrollues të shoqërive ndaj të cilave kanë filluar procedurat e falimentimit ose të cilat kanë falimentuar;
c. Të mos J në të njëjtën kohë punonjës, anëtar i këshillit mbikëqyrës apo i bordit drejtues në një shoqëri tjetër brokerimi;
d. Të J rezident në Republikën e Shqipërisë ose të ketë leje qëndrimi të vlefshme të lëshuar nga organet kompetente;
e. Të ketë një gjendje financiare të mjaftueshme për të mbuluar përgjegjësitë e tij;

f. Të paktën një prej anëtarëve të bordit të organeve drejtuese duhet të njohë gjuhën shqipe në rastin kur të gjithë kandidatët për anëtarë të bordit drejtues janë qytetarë të huaj;
g. Të ketë reputacion të mirë.
Neni 15 i rregullores të cilit i jeni referuar nuk përcakton kriteret, por dokumentacionin mbi bazën e të cilit është vlerësuar përmbushja e kritereve të mësipërme.
Në këto kushte çmojmë se konstatimi nuk qëndron pasi dokumentacioni i depozituar është sipas nenit 15 dhe provon plotësimin e kritereve për anëtarët sipas nenit 14.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se kontrata e punës mban datën 25.07.2019, pas datës së vendimmarrjes së Bordit 24.07.2019 për licencim, duke pranuar përmbushjen e kritereve të licencimit megjithëse nuk rezulton i punësuar një Bfizik në tregun e titujve, duke qenë në të njëjtën linjë me konstatimin e grupit. Për këtë arsye ky observacion nuk merret në konsideratë. Përsa i përket konstatimit mbi mos përmbushjen e kërkesave mbi anëtarët e këshillit të administrimit të shoqërisë së brokerimit sqarojmë se konstatimi është kryer mbi dokumentacionin dhe njëkohësisht mbi matricën e përmbushjes së kritereve për anëtar të organeve drejtuese, siç është pohuar se janë plotësuar në propozimin e bërë Bordit të AMF për marrjen e vendimit për licencim. Duke qenë se dokumentacioni nuk është sipas kërkesave të rregullores dhe në të njëjtën kohë është pohuar në bord me anë të matricës së përmbushjes së kritereve, observacioni nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me çështjet e trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit, me shkresën nr. 41/1 datë 29.09.2021, protokolluar në KLSH me nr. 845/6 datë 29.09.2021 janë paraqitur observacione për këtë praktikë duke parashtruar:
...Gjithashtu AMF në zbatim të urdhrit nr.100 datë 03.09.2020 të DPE ka ushtruar në datat 8-10 shtator 2020, inspektim në vend pranë shoqërisë me objekt për respektimin e kërkesave të licencimit dhe kryerjen e veprimtarisë në përputhje me licencën për periudhën 01 gusht 2019 deri në 31 gusht 2020. Në mbështetje të inspektimit të kryer si dhe informacionit të marrë nga Autoriteti Rregullator i një vendi të huaj, Bordi i AMF me vendimin nr. 166 datë 23.10.2020 vendoi heqjen e licencës së shoqërisë dhe heqjen e licencës së brokerit fizik.

Në përgjigje të këtyre observacioneve dhe në vijim të diskutimit në takimin ballafaques në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi këtë konstatim, efekti i heqjes së licencës reflektohet duke përshtatur rekomandimin e auditimit sipas konstatimit përkatës.

Gjetja: **Në praktikën e licencimit të shoqërisë së brokerimit në tituj, AS janë konstatuar mos përmbushje të kritereve për licencim për anëtarët e këshillit të administrimit, të kritereve për ekzistencën e kapitalin minimal gjatë viteve të ushtrimit të aktivitetit sipas plan biznesit të paraqitur dhe kritereve për ekzistencën e kontratës së punësimit të një brokeri fizik të licencuar.**

Situata: AMF me Vendim nr. 155 datë 24.07.2019 ka vendosur licencimin e shoqërisë ASpër ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në tituj në B Shqiptare të titujve ALSE dhe miratimin e Z. SM për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit fizik në tituj në emër dhe për llogari të shoqërisë AS sha.
-Nga auditimi konstatohet se me qëllim përmbushjen e kritereve të licencimit, në zbatim të kërkesës së nenit 48, pika 3 e ligjit nr. 9879 ku kërkohet dokument që vërteton se Sh B ka punësuar një broker, është referuar Z.SM, pajisur me licencë nr. 26 datë 27.07.2017. Për plotësimin e këtij dokumentacioni është paraqitur Vendimi i asamblesë së **shoqërisë A** për marrjen në punë të Z. SM, por jo kontrata e punësimit. Nga auditimi në lidhje me këtë praktikë licencimi konstatohet se nuk përmbushen kushtet për

vërtetimin se shoqëria ka të punësuar një B duke qenë se vendimi i asamblesë për marrjen në punë nuk përbën një marrëdhënie punësimi për të cilën evidentohen kushtet përkatëse sipas kërkesave të nenit 9 të rregullores nr. 165, datë 23.12.2008, *"Për licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit, brokerit dhe këshilltarit të Investimeve ",* e ndryshuar.

-Nga auditimi konstatohet se sipas plan biznesit të paraqitur është parashikuar rezultati me humbje i shoqërisë për tre vitet e para të operimit, parashikuar të financohet me anë të shtesave në kapital. Kapitali i parashikuar për vitet e operimit është projektuar në nivelet 400,000 lekë; 1,755,750 lekë dhe 2,005,000 lekë, duke reflektuar mos përmbushjen e nevojave për kapitalin minimal të kërkuar për shoqërinë në nivelin e 6,000,000 lekë përgjatë të gjithë periudhës së projektuar të ushtrimit të aktivitetit dhe nuk paraqiten evidenca në lidhje me zotërimin e mjeteve të mjaftueshme nga aksionerët për mbulimin e shtesave të propozuara në kapital në vlerën 8,000,000 lekë për vitin e 2 dhe 14,500,000 lekë për vitin e 3.

-Nga auditimi konstatohet se për anëtaret e KA nuk plotësohen kushtet e pikës 2 të nenit 15 të rregullores nr. 165, datë 23.12.2008, *"Për licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit, brokerit dhe këshilltarit të Investimeve ",* e ndryshuar. Konstatohet se propozimi në bord është kryer për përmbushjen e kërkesave rregullatorë ndërkohë që referuar dokumentacionit justifikues nuk paraqitet evidencë për përvojë/eksperiencë pune në fushën e tregtimit të titujve. Sipas observacioneve të paraqitura në KLSH mbi Projekt Raportin është referuar se kësaj shoqërie dhe brokerit fizik i është hequr licenca.

Kriteri: Neni 48, pika 3 e ligjit nr. 9879;
nenet 14 dhe 15 të rregullores nr. 165 *ku citohet se "Dokumentacioni që shoqëron kërkesën në lidhje me kandidaturën për anëtar të organeve drejtuese është: ... 2. CV së bashku me dëshmitë përkatëse që përcaktojnë kualifikimin dhe përvojën përkatëse, sidomos në fushën e transaksioneve me titujt;".*

Ndikimi/Efekti: Licencim i shoqërisë së brokerimit në tregun e titujve që nuk përmbush kriteret ligjore

Shkaku: Pranimi i dokumentacionit jo të plotë dhe mungesa e analizave mbi planin e biznesit të propozuar përsa i përket ndryshimeve në kapital dhe kërkesave minimale për kapital.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga ana e AMF të kryhen inspektime me qëllim testimin e respektimit të kushteve për mjaftueshmërinë e kapitalit në përputhje me rezultatet e operacioneve të biznesit sipas kërkesave të kuadrit rregullator si dhe të kërkesave në lidhje me përbërjen e anëtarëve të këshillit të administrimit, duke pezulluar/revokuar licencën përkatëse në rast të mos përmbushjes eventuale të këtyre kritereve në shoqëritë e brokerimit.

Në çdo rast kualifikimi i anëtarëve për KA të shoqërisë së brokerimit të kryhet mbi evidenca në formën e certifikimeve dhe jo trajnimeve në fushën e transaksioneve me tituj.

9- Refuzimi i licencimit për shoqërinë e sigurimit P për ushtrimin e veprimtarisë në klasat e jo Jetës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria P ka depozituar kërkesat për licencim me shkresat nr. 3581 datë 22.10.2018 dhe nr. 3685 datë 31.10.2018 për të ushtruar veprimtari sigurimi në klasat e joJetës. Bazuar në ligjin 52/2014 licencimin kalon në dy faza, miratimin paraprak dhe dhënien e licencës.
Më urdhër nr. 16 datë 17.001.2019 është ngritur grupi i punës për të shqyrtuar plotësimin nga shoqëria të kërkesave ligjore për licencim.
Grupi i punës konstatoi mungesa në dokumentacion të cilat janë bërë të ditur shoqërisë me shkresën nr. 329 datë 25.01.2019 me afat plotësimi brenda një muaji duke kërkuar:
-vërtetim që kapitali minimal fillestar është paguar një llogari të veçantë garancie;
-vërtetim që shoqëria e sigurimit ka ngurtësuar fond shtesë për shpenzime nisjeje jo më i vogël se 5% e kapitalit minimal fillestar.
-dokumentacion plotësues për anëtarët e këshillit mbikëqyrës;
-projekt kontrata për delegim funksionesh
-dokument Br që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës së aplikimit për pajisjen me licencë si shoqëri sigurimi.
Shoqëria ka depozituar brenda afatit ligjor me shkresën nr. 329/1 datë 27.02.2019 një pjesë të dokumentacionit të kërkuar dhe duke kërkuar që AMF të vendoste në dispozicion leje për hapjen e llogarisë qëllimore pranë një banke të nivelit të dytë sepse nga kontaktet nga Bt shoqërisë i është kërkuar leja si domosdoshmëri për ngurtësimin e kapitalit fillestar dhe fondit shtesë.
Nga AMF me shkresën nr. 329/2 datë 11.03.2019 i është kërkuar shoqërisë plotësimi i dokumentacionit që mungonte:
-depozitimin e fondit të garancisë dhe shpenzimet e nisjes;
-lidhur me burimin e kapitalit shoqëria të deklarojë dhe vërtetojë me dokumentacion se kontributet për kapitalin nuk burojnë nga fonde të marra hua nga publike, kredi Bre, hua të tjera nga fonde origjina e të cilave është e paligjetëshme ose paradhënie të paguara nga palë të treta;
-lidhur me çështjet aktuariale, depozitimin e projekt-kontratave që mungojnë për produktet e përfshira në klasën 10 të sigurimit
-të përshkruajë bazën teknike të dhënave të përdorura për llogaritjen e primit;
të depozitojë opinionin e aktuarit të autorizuar;
-shoqëria detyrohej të paguajë tarifën 20,000 lekë për depozitim e shqyrtim dokumentacioni.
Sipas relacionit të përgatitur nga grupi i punës i ngritur për licencimin e shoqërisë është referuar se deri në datën 14.05.2019 nuk është depozituar dokumentacioni i plotë sipas kërkesave ligjore, nuk janë respektuar kërkesat për depozitimin e fondit të garancisë dhe është shkelur afati 1-mujor për depozitimin e dokumentacionit të kërkuar.
Në relacion, Zyra e Licencimit pranë Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve ka propozuar Bordit refuzimin e kërkesës së shoqërisë së propozuar ñPò për licencimin e saj për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit në klasat e jo Jetës.
Nga Departamenti i Çështjeve Juridike në 20.05.2019 është dhënë opinion juridik për refuzimin e kërkesës së shoqërisë P sha për Bordin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ku është sugjeruar Bordit refuzimi i kërkesës së shoqërisë **P** sha për licencimin e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimi në klasat e joJetës në territorin e Republikës së Shqipërisë.
Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr. 105 datë 31.05.2019 ka vendosur refuzimin e kërkesës së shoqërisë **P** sha për licencimin e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit në klasat e joJetës në territorin e Republikës së Shqipërisë, komunikuar me shkresën nr. 1951 datë 14.06.2019.
Për sa më sipër në këtë dosje të testuar nuk u konstatuan mos përputhshmëri.

10- Licencimin i shoqërisë BC sha për ushtrimin e veprimtarisë së Depozitarit të fondeve të pensioneve vullnetare dhe fondeve të sipërmarrjes së Investimeve kolektive

Baza ligjore për licencimin e veprimtarisë si depozitar përfshin rregulloren nr. 128 datë 06.10.2011 ñMbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të

Investimeve kolektiveò, ligjin nr. 10198 datë 10.12.2009 ñPër Sipërmarrjet e Investimeve Kolektiveò dhe ligjin nr. 10197 datë 10.12.2009 ñPër Fondet e Pensionit Vullnetarò. Kërkesa dhe licencimi për këtë shoqëri si depozitar është kryer njëkohësisht si depozitar i fondeve të pensioneve vullnetare dhe depozitar i fondeve të sipërmarrjes kolektive.
Kërkesa për licencim nga BC sha është depozituar me shkresën nr. 1234 datë 04.04.2018. Dokumentacioni është plotësuar me shkresat nr. 1234/3 datë 19.07.2018, 1234/4 datë 21.09.2018 dhe nr. 1339 datë 19.04.2019.

Përmbushja e kritereve për licencim sipas kërkesave të kuadrit rregullator është reflektuar nëpërmjet dokumentacionit të mëposhtëm:
-pika 1 e nenit 42 të ligjit 10197 datë 10.12.2009 dhe pika 2 e nenit 47 të ligjit nr. 10198 datë 10.12.2009, BC është e licencuar me Licencë nr. 16 datë 31.03.2003 nga B e Shqipërisë dhe Aneksi datë 24.10.2011 mbi veprimtaritë e lejueshme.
-pika 2 e nenit 47 të ligjit 10197 datë 10.12.2009, 6 nga 7 anëtarët e Këshillit Drejtues të B kanë nënshkruar deklaratën datë 18.01.2018 sipas kërkesave të rregullores dhe ligjit me përmbajtje:
-deklaratë ku përcaktohet se B përmbush të gjitha kërkesat financiare, të përcaktuara në legjislacionin Br dhe në të gjithë legjislacionin në fuqi;
-deklaratë ku përcaktohet se B nuk ka dhe nuk do të zotërojë në të ardhmen aksione në një shoqëri administruese të fondeve kolektive të Investimit dhe fondeve të pensionit për të cilat ofron shërbimet e depozitarité
-deklaratë ku përcaktohet se B nuk ka dhënë dhe nuk do të japë apo marrë para nga shoqëria e administrimit që administron asetet e sipërmarrjeve të Investimeve kolektive ose asetet e fondeve të pensionit për të cilat ushtron shërbimin e depozitarit apo prej ndonjë pale të lidhuré
-deklaratë ku përcaktohet se B nuk ka dhe nuk do të ketë gjatë kohës së zotërimit të licencës punonjës apo anëtarë të stafit apo anëtarë të këshillit drejtues apo drejtorisë të cilët janë: i. anëtarë të organeve drejtuese apo punonjës të shoqërisë së administrimit që administron sipërmarrjet e Investimeve kolektive dhe fondet e pensionit për të cilat ushtron veprimtarinë e depozitarit; ii. anëtarë të organeve drejtuese apo punonjës të çdo palë të lidhur me shoqërinë e administrimit që administron sipërmarrjet e Investimeve kolektive dhe fondet e pensionit për të cilat ushtron veprimtarinë e depozitarit.

-pika 3 e nenit 47 të ligjit 10197 datë 10.12.2009, opinioni të pakualifikuar për pasqyrat financiare në raportet e auditimit financiar për 3 vitet e mëparshme; dhe njësi organizative të veçantë teknikisht e kualifikuar të ushtrojë aktivitetet e depozitarit, krijuar me vendim të Këshillit drejtues të BC nr. 19/1 datë 17.05.2018. Njësia e Depozitarit ka në përbërje një drejtues njësie dhe një specialist, drejtuese e njësisë Zj. NV e cila paraqitet edhe si anëtare e shoqërisë ñRegjistri Shqiptar i Titujveò sha. Drejtuesja e njësisë është përcaktuar me anë të dokumentacionit plotësues të dërguar me shkresën nr. 1339 datë 19.04.2019 në të cilën është paraqitur bashkëngjitur Jetëshkrimi. Për kërkesat teknike janë paraqitur:
a) për zotërimin e programit kompjuterik për kryerjen e aktivitetit të depozitarit është paraqitur Memorandumi i Mirëkuptimit 21.12.2018 me PS d.o.o me qendër në Zagreb për blerjen e mundshme të një software të quajtur PD.

Nga auditimi konstatohet se memorandumi i mirëkuptimit nuk është dokumentacion justifikues që vërteton zotërimin e programit kompjuterik pasi ai paraqet vetëm një mundësi për blerje. Pranimi i memorandumit të mirëkuptimit si evidencë për përmbushjen e kriterit nuk është në përputhje me kërkesat teknike sipas nenit 4 të rregullores Rregullore nr. 128, datë 06.10.2011 *"Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive"* ku përcaktohet se *"Kërkesat teknike që duhet të përmbushë njësia organizative, me qëllim kryerjen e aktivitetit të depozitarit janë: ... b) të zotërojë program kompjuterik për kryerjen e aktiviteteve të depozitarit;".*

b) për disponimin e linjave të komunikimit të ngritura me qëllim marrjen e instruksioneve dhe për komunikim të përgjithshëm me klientët janë raportuar në relacion pajisjet e përshtatshme kompjuterike dhe linjat e komunikimit të ngritura.
c)për procedurat e shkruara për marrjen e instruksioneve nga klientët instruksioneve nga klientët për menaxhimin e letrave me vlere dhe parasë është paraqitur Procedura Operacionale e Depozitarit
d) të ketë miratuar dhe të veprojë në bazë të rregullores se depozitarit për operacionet me shoqëritë e administrimit, të parashikuara në marrëveshjen midis kësaj të fundit dhe Depozitarit është paraqitur Procedura Operacionale e Depozitarit ku përcaktohen procedurat e shkëmbimit të informacionit, metodologjia për llogaritjen e vlerës neto të aseteve, etj.
e) të ketë miratuar dhe të veprojë në bazë të rregullores se depozitarit për operacionet me shoqëritë e administrimit, të parashikuara në marrëveshjen midis kësaj të fundit dhe Depozitarit;
Është paraqitur Memorandum mirëkuptimi me nr. 59007 datë 27.11.2017 ndërmjet BAI dhe BC ku përcaktohet mirëkuptimi i palëve për qëllimi i përbashkët për të nënshkruar një marrëveshje formale për ofrimin e shërbimeve të depozitarit të fondeve të Investimit nga ana e CB kundrejt shoqërisë administruese të fondeve të Investimeve në pronësi të B Amerikane të Investimeve , që do J shoqëria mëmë e kësaj shoqërie që do regjistrohet pasi të J licencuar nga AMF-ja. Memorandumi i mirëkuptimit është amenduar duke shtyrë afatin e tij deri në 31.12.2019.
Në relacionin e datës 13.05.2019 të paraqitur nga Zyra e Licencimit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Fondeve të Kapitalit (hartuar nga E Ç dhe N K) drejtuar Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është referuar se duke qenë se BC zotëron aksione në masën 76% tek shoqëria administruese CI e cila administron fondin e InvestimitCP dhe Fondin e pensionit CP është kërkuar opininion ligjor nëse ekziston konflikt interesi për depozitarin dhe shoqërinë administruese, ku është paraqitur se sic është paraqitur në nenin 49 pika 2 e ligjit në fuqi për SIK ndalohet që shoqëria administruese të ketë lidhje me depozitarin e aseteve të SIK që ajo administron. Në këtë relacion është rekomanduar Bordit licencimin e shoqërisë BC për ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit të fondeve të pensioneve vullnetare dhe të fondeve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive.
Nga ana e Departamentit të Çështjeve Juridike në datë 28.05.2019 është paraqitur në Bord opinioni juridik (hartuar nga MS dhe VTh) duke sugjeruar Bordit licencimin e shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit të fondeve të pensioneve vullnetare dhe të fondeve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive.
Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr. 8 datë 06.06.2019 ka vendosur licencimin e shoqërisë BC sha për ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit të fondeve të pensioneve vullnetare dhe fondeve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive. Ky vendim është komunikuar BC sha me shkresën nr. 1900 datë 11.06.2019.

Nga auditimi konstatohet se deklarata e paraqitur në praktikën e licencimit të mësipërme të BC si depozitar nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 47 të ligjit nr. 10197 datë 10.12.2009 *"Për fondet e pensionit vullnetar"* ku përcaktohet se *"Për të marrë licencën e depozitarit nga autoriteti, B duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme dhe të dorëzojë pranë autoritetit dokumentacionin e mëposhtëm: deklaratën e nënshkruar nga këshilli drejtues, ku përcaktohet se B, gjatë kohës që është e licencuar, nuk zotëron dhe nuk do të zotërojë aksione në një shoqëri administruese ose aksione të ndonjë personi, që është palë e lidhur me këtë shoqëri administruese, apo se nuk do ketë marrëdhënie të tjera financiare me këta persona;"*.
Sipas relacionit teknik të paraqitur në Bord, është referuar se B Czotëron aksione në masën 76% tek shoqëria administruese CI sha e cila administron FIVCP dhe FCPP, duke përcaktuar që në fakt B zotëron aksione në një shoqëri administruese. Deklarata dhe kriteri përkatës që

përcakton pika 2 e nenit 47 të ligjit nr. 10197 datë 10.12.2009 *"Për fondet e pensionit vullnetar"* nuk janë përmbushur për këtë praktikë licencimi.

Në lidhje me konstatimet mbi këtë praktikë licencimi janë paraqitur observacionet ku është parashtruar që:

.....Nisur nga sa më sipër sqarojmë se Memorandumi i mirëkuptimit midis palëve përcakton angazhimin e tyre për të përfunduar një marrëdhënie bashkëpunimi lidhur me programin kompjuterik për ofrimin e shërbimeve të depozitarit. Subjekti fillimisht ka depozituar këtë memorandum pasi është një Iim financiar i konsiderueshëm duke marrë parasysh se përdorimi i këtij programi kompjuterik është i lidhur fillimisht me licencimin e subjektit si Depozitar i Fondeve dhe me pas, duke marrë parasysh edhe nevojat e tregut për të pasur Depozitar. Duhet mbajtur parasysh se licencimi i Bve si Depozitar edhe pse është një aktivitet që nuk ka përfitueshmëri për të justifikuar angazhimin, është nevojë që ka tregu i Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive për funksionimin e tij dhe mbrojtjen e Iitorëve. Gjithashtu duhet marrë parasysh se kërkesa e B për tôu licencuar si Depozitar i Fondeve është kryer në një moment kur nuk kishte një mundësi konkrete bashkëpunimi për të ofruar këto shërbime menjëherë. Mendojmë se konstatimi nuk qëndron pasi Autoriteti vlerësoi se dokumentacioni i depozituar jepte garanci të mjaftueshme për zotërimin e programit kompjuterik i cili aktualisht është në përdorim nga Depozitari.....

....Lidhur me sa më sipër sqarojmë se Ligji dhe kërkesat e tij janë shqyrtuar në tërësi dhe me objektivitet për të kuptuar qëllimin dhe implementimin e tij të drejtë dhe të duhur për të realizuar detyrën e Autoritetit që është mbrojtja e Iitorit. Referuar raportit tuaj, pika 2 e nenit 47 është trajtuar e veçuar nga pikat e tjera të po atij neni i cili trajton shmangien e konfliktit të interesit dhe si i tillë sigurohet që B në cilësinë e Depozitarit të mos e ofrojë këtë shërbim për Fonde të cilat administrohet nga një shoqëri administruese e kontrolluar prej saj. Qëllimi i këtij ligji dhe i ligjeve të tjera në përgjithësi, për konfliktin e interesave kërkon parandalimin e ndikimit në vendimmarrjet e njeri-tjetrit. Ligji nr. 10197 datë 10.12.2009 *"Për fondet e pensionit vullnetar"* në nenin 20, pika 1, përcakton se shoqëria administruese e fondeve duhet të zotërohet në **51% të saj nga B** ose institucione financiare dhe në nenin 47 pika 1, përcakton se ñ...**Vetëm B** e licencuara nga B e Shqipërisë, për kryerjen e shërbimeve të kujdestarisë, depozitimit dhe të besimit, **mund të licencohen nga autoriteti për të kryer veprimtarinë e depozitarit të fondit të pensionit**.ò Siç shihet qartë vetë Ligji në dispozitat e tij kufizon subjektet që mund të kontrollojnë një shoqëri administruese dhe subjektet që mund të kryejnë shërbimet e depozitarit rrjedhimisht kjo nuk mund të çôbëhet nga një deklarata mbi konfliktin e interesit. Në nenin 47, pika 2, germa c) dhe ç), ligji është shprehur qartë se gjithmonë në kuadër të shmangies së konfliktit të interesit, B që do të ofrojë shërbimet e Depozitarit duhet të shmangë marrëdhëniet me shoqërinë administruese të cilën e ajo e kontrollon. Gjithashtu, në faqen zyrtare të AMF-së në versionin anglisht, të Ligjit 1097, germa b) e pikës 2 të nenit 47, shprehja ñ*a statement signed by the board of directors, stating the bank does not, and will not, ëhile holding the licencë,* ***hold any shares in a management company of the relevant pension fund,*** *or any shares in an entity that is a related party of that management company, and maintain any other financial relationship with those persons; Përkthimi i kësaj nën ndarje të pikës 2 të kësaj dispozite nuk ka qenë i plotë dhe i saktë.* Sa më sipër Autoriteti çmon se kjo gjetje nuk qëndron pasi bie ndesh me frymën e ligjit dhe dispozitave të tjera themelore të këtij ligjit si dhe me parimet e direktivave të BE lidhur trajtimin e konfliktit të interesit për këtë çështje.

Në lidhje me observacionin se memorandumi i mirëkuptimit jep garanci të mjaftueshme për zotërimin e programit kompjuterik i cili aktualisht është në përdorim nga depozitari sqarojmë se në momentin e licencimin, ky program nuk ka qenë se zotërim sikurse përcaktohet nga kriteret për licencim dhe për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me observacionin mbi përmbushjen e kritereve pikës 2 të nenit 47 të ligjit sqarojmë se nuk janë paraqitur argumente mbi mungesën e përputhshmërisë sipas konstatimit, por

interpretime mbi frymën e ligjit dhe dispozitave të tjera themelore të tij. Gjithashtu, referimi në versionin anglisht të ligjit në faqen e AMF, citon ñrelevant pension fundò dhe jo ñrelated pension fundò për dokumentacionin dhe kriteret përkatëse të kësaj pike. Kryerja e përkthimeve dhe nënndarjeve të dispozitave me qëllim shmangien e problematikave në rast se do ishte vlerësuar e pasaktë dhe jo e plotë, duhej reflektuar në kohë. Për këto arsye, observacioni nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me çështjet e trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit, me shkresën nr. 41/1 datë 29.09.2021, protokolluar në KLSH me nr. 845/6 datë 29.09.2021 janë paraqitur observacione për këtë praktikë duke parashtruar:
..Memorandumi i mirëkuptimit midis palëve përcakton angazhimin midis palëve për të përfunduar një marrëdhënie bashkëpunimi... Autoriteti vlerësoi se dokumentacioni i depozituar jepte garanci të mjaftueshme për zotërimin e programit kompjuterik i cili aktualisht është në përdorim nga Depozitari.
...por B nuk mund të J depozitar i aseteve të fondit të pensionit të administruar nga shoqëria administruese ku kjo B është aksionere. Gjithashtu në nenin 47, pika 2 e ligjit të sipërcituar, germa ñbò dhe germat e tjera ñcò, ñç/iò dhe ñç/iiò të gjitha së bashku synojnë shmangien e konfliktit të interesit, përmes deklarimit nga anëtarët e këshillit drejtues të B në cilësinë e depozitarit me qëllim që të mos ofrohet ky shërbim për fondet e pensionit të cilat administrohen nga një shoqëri administruese e kontrolluar prej saj. Qëllimi i këtij neni është parandalimi i konfliktit të interesit midis shoqërisë administruese dhe depozitarit. B nuk mund të J depozitar i aseteve të fondit të pensionit të administruar nga një shoqëri ku kjo B është aksionare pasi në këtë rast ka konflikt interesi gjë që nuk ndodh në rastin kur B është depozitar i një fondi pensioni të administruar nga një shoqëri e cila nuk kontrollohet nga depozitari. Aktualisht B Cnuk kryen veprimtarinë e depozitarit për asnjë fond pensioni.

Qëndrimi i grupit të auditimit
Në përgjigje të këtyre observacioneve dhe në vijim të takimit ballafaques të zhvilluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit ku u parashtrua që ñlicencimi është kryer edhe për depozitar të fondin të pensioneve edhe për depozitar të fondeve të Investimeve , dhe në ligjin për SIK është përcaktuar si kriter mungesa e lidhjes së depozitarit me shoqërinë përkatëse që administron fondet SIK ndërkohë që në ligjin për FP nuk është përcaktuar kjo lidhje në mënyrë të drejtpërdrejtë por ndalohet licencimi nëse shoqëria/aksionarët zotërojnë aksione në një shoqëri administruese të fondit të pensionit sqarojmë:
-Fakti që ligji për FP nuk e lejon licencimin e depozitarit të fondeve të pensioneve nëse zotërohen interesa në një shoqëri administruese është kriteri mbi të cilin është formuluar konstatimi nga auditimi. Intrepretimi i ligjit të FP duke e krahasuar me atë të SIK për licencimin e depozitarit është çështje e rregullimeve ligjore që në rast se AMF e gjykon të arsyeshme që duhen bërë, ka për detyrë paraqitjen në organet ligjvënëse dhe në vijim zbatimin e ligjit sipas shprehjes së vullnetit me anë të miratimit të këtyre ndryshimeve apo jo.
-Gjithashtu, në Republikën e Shqipërisë ekzistojnë disa B të licencuara për ushtrimin e aktivitetit nga B e Shqipërisë, të cilat nuk zotërojnë interesa në shoqëri administruese të fondeve të pensionit dhe janë pikërisht këto B, që në rast kërkese për ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit të fondeve të pensionit mund të ushtrojnë rolin e depozitarit për ato B dhe shoqëri të tjera që administrojnë fonde të pensionit vullnetar.
Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Gjetja: Në licencimin e B Cpër ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit të fondeve të pensioneve vullnetare dhe fondeve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive nuk janë respektuar kriteret e licencimit duke dhënë licencën për ushtrimin e veprimtarisë pavarësisht se kjo shoqëri zotëron aksione në një shoqëri administruese të fondeve të pensionit.

Situata:	AMF me vendimin nr. 8 datë 06.06.2019 ka vendosur licencimin e shoqërisë B Csha për ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit të fondeve të pensioneve vullnetare dhe fondeve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive. -Nga auditimi mbi këtë praktikë licencimi konstatohet se kriteret për licencim nuk janë përmbushur në kërkesat e ligjit për mos dhënien e licencës së depozitarit shoqërive që zotërojnë aksione në një shoqëri administruese të fondit të pensionit, pasi B C sipas relacionit teknik të paraqitur në momentin e licencimit zotëron aksione në masën 76% tek shoqëria administruese C Isha. Nga auditimi konstatohet se deklarata e paraqitur në praktikën e licencimit të mësipërme të B Csi depozitar nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 47 të ligjit nr. 10197 datë 10.12.2009 *"Për fondet e pensionit vullnetar".* Sipas relacionit teknik të paraqitur në Bord, është referuar se B C zotëron aksione në masën 76% tek shoqëria administruese C I sha e cila administron dhe FPCP, duke përcaktuar që në fakt B zotëron aksione në një shoqëri administruese. -Gjithashtu konstatohet se nuk janë përmbushur kriteret e licencimit për sa i përket zotërimit të një programi kompjuterik për kryerjen e aktivitetit të depozitarit përpara marrjes së licencës, por për përmbushjen e këtij kriteri është paraqitur memorandum mirëkuptimi. Pranimi i memorandumit të mirëkuptimit si evidencë për përmbushjen e kriterit nuk është në përputhje me kërkesat teknike sipas nenit 4 të rregullores Rregullore nr. 128, datë 06.10.2011 *"Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive".*
Kriteri:	pika 2 e nenit 47 të ligjit nr. 10197 datë 10.12.2009 *"Për fondet e pensionit vullnetar* neni 4 i rregullores Rregullore nr. 128, datë 06.10.2011 *"Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive"*
Ndikimi/Efekti:	Dhënia e licencës në kushtet e mos përmbushjes së kritereve
Shkaku:	Pranimi i dokumentacionit jo të plotë dhe të saktë si dhe ekzistenca e aksioneve në zotërim të B në një shoqëri administruese të fondeve të pensionit
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga ana e AMF të merren masa për rishikimin e licencës së depozitarit sipas përcaktimeve ligjore në rolin e depozitarit të fondeve të pensioneve dhe depozitarit të fondeve të sipërmarrjes së Investimeve kolektive me qëllim shmangien e konfliktit në përmbushjen e kritereve të depozitarit të licencuar i cili zotëron aksione në një shoqëri administruese të fondeve të pensionit.

11- Miratimi i zgjerimit të fushës së veprimtarisë së shoqërisë A B .

B ka paraqitur në AMF kërkesën me nr. 3498 datë 05.11.2019 për zgjerimin e fushës së veprimtarisë së tregtimit të titujve në B ALSE dhe në tregun me pakicë në Republikën e Shqipërisë sipas përcaktimeve në relacionin teknik të paraqitur në Bord. B është licencuar nga AMF si shoqëri brokerimi me licencë nr. 15 datë 31.10.2016 vetëm për tregtim në letra me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në bursë dhe në tregun me pakicë. Me vendim Bordi nr. 88 datë 03.07.2017 u licencua B ALSE ku A Bështë aksionare 45.59% dhe anëtare nga 07.11.2017, duke filluar tregtimin në 22.02.2018. B ALSE ka filluar përpjekjet për prezantim dhe tregtim të titujve tregtarë dhe B ka kërkuar zgjerimin e veprimtarisë për brokerim në transaksione me tituj.

Sipas relacionit teknik dokumentacioni i ridepozituar nga B përfshin:

-plan biznes për tre vitet e para të aktivitetit;

-rregullore e veprimtarisë me tituj;
-rregullore/procedura të B për njohjen e klientit;
-rregullore për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizimit për pjesën e tregut të titujve;
-kontratë tip me klientin
Drejtoria e Licencimit me relacionin e datës 15.11.2019 (hartuar nga E Ç, E K dhe V Th) drejtuar Bordit ka propozuar miratimin e zgjerimit të fushës së veprimtarisë së shoqërisë B A I shoqëri brokerimi sipas licencës nr. 15 datë 31.10.2016 miratuar me Vendim Bordi nr. 175 datë 31.10.2016 në ñShoqëri brokerimi në tituj për blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit nëpërmjet marrjes dhe ekzekutimit të urdhrave (broker) dhe në emër ose për llogari të vet (dealer), në B Shqiptare të Titujve (ALSE) dhe në tregun me pakicë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
Për sa më sipër në këtë dosje të testuar nuk u konstatuan mos përputhshmëri.

12- Licencimin i shoqërisë A S I – shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të Investimeve kolektive

Shoqëria A SJ sha ka paraqitur në AMF me shkresën nr. 3201 datë 11.10.2019 kërkesën dhe dokumentacionin për licencimin e shoqërisë A S I - shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të Investimeve kolektive.
Dokumentacioni është rishikuar dhe plotësuar me shkresat nr. 3201/1 datë 05.11.2019, 3201/2 datë 07.11.2019 dhe 3201/3 datë 12.11.2019.
Dokumentacioni i licencimit përfshin:
-*Dokumente që vërtetojnë se subjekti është një shoqëri aksionere e themeluar dhe regjistruar, statutin dhe dokumente që provojnë se kapitali minimal i kërkuar është shlyer plotësisht në para dhe dokumente që vërtetojnë burimin e kapitalit, mjaftueshmërinë....* Janë depozituar akti i themelimit dhe Statuti të nënshkruara nga përfaqësuesi i aksionarit të vetëm shoqëria ñA SJò sha Z. ES si dhe certifikata e regjistrimit datë 04.10.2019. Kapitali i nënshkruar dhe tërësisht i paguar i shoqërisë A S I sha është 32,000,000 leke, i zotëruar plotësisht nga shoqëria ñA SJò sha, sipas Vendimit nr. 5 datë 03.10.2019 i aksionarit të vetëm shoqërisë A SJ për themelimin dhe vënien në dispozicion të kapitalit dhe Vendimit nr. 1 datë 01.11.2019 për zmadhimin e kapitalit.
- Organet e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Administrimit i përbërë nga Z. IL, Z. DK, Z. EB, Z. EK dhe Z. AR. Administrator është emëruar Z. EK.
- Lidhur me burimin e kapitalit, sipas Vendimit nr. 03. datë 27.09.2019 të A S sha ñPër transferim fondesh nga shoqëria ñA Sò te shoqëria ñA SJò është vendosur transferimi i shumave prej (160,000 USD), 17,944,000 lekë dhe 14,056,000 lekë te shoqëria A SJ për rritje kapitali. Sipas vendimit nr. 04/1 datë 01.10.2019 të A SJ sha është miratuar transferimi i fondeve të mësipërme për themelimin dhe rritjen e kapitalit të shoqërisë A S I. Duke qenë se A SJ është subjekt i mbikëqyrur nga autoriteti, nga ana e DMTS është informuar se bazuar në raportimin e datës 30.09.2019 nuk ka mundësi të investojë pa rritje kapitali, por investimi në shoqërinë administruese të fondeve nuk do cënonte kapitalin e shoqërisë A S nëse do të miratohej dhe bëhej efektive rritja e kërkuar e kapitalit. Për shoqërinë A S bazuar në raportimin e datës 30.09.2019 është informuar se ka mundësi për të përballuar shtesën e kapitalit duke ruajtur edhe parametrat e kërkuar ligjorë.
-Dokumenti Br nr. 256 datë 05.11.2019 nga T B konfirmon se A S I sha është mbajtës i depozitës dhe balanca e depozitës në 05.11.2019 është 32,000,000 lek dhe deklaratë sipas së cilës kapitali nuk përbëhet nga hua nga publiku, kredi nga B, paradhënie apo hua nga subjekte e palë të treta.

-Dokumentacioni që vërteton se aksionerët ndikues të shoqërisë, drejtorët, kontrolluesi kryesor, anëtarët e KA, drejtuesit ekzekutivë dhe kontrollori i brendshëm janë individualisht dhe kolektivisht të përshtatshëm për të drejtuar veprimtari T
- Aksioneri shoqërisë A S I është shoqërisë A SJ. Aksioner i shoqërisë A SJ është shoqëria A S. Shoqëria A S ka aksioner fundorë Z. Sh K me 84% dhe Z. L Xhme 10%. Të gjithë subjektet e mësipërme mbikëqyren dhe miratohen nga AMF dhe zotërohet informacioni për to që nga themelimi. Nga A S jo J ka deklaratë me shkrim se do të mbështesin në çdo moment nëse do J e nevojetëshme me kapital shtesë shoqërinë A S I.
Janë printuar nga sistemi elektronik i DRT Tiranë vërtetimi për mungesën e detyrimeve tatimore të A SJ sha dhe është paraqitur raporti i kredimarrësit nga BSH sipas të cilit rezulton se nuk ka kredi. për shoqërinë A SJ sha. Janë paraqitur vërtetimet si i padënuar penalisht, jo në gjykim për vepra penale dhe jo në ndjekje penale nga Gjykata dhe Prokuroria si dhe mos qenien në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera për A SJ sha nga Zyra Përmbarimore Tiranë.
- *Anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratori*janëZ. I L, Z. D K, Z. EB, Z. EK dhe Z. A R. Mbi përmbushjen e kërkesave ligjore që duhen dhe përcaktimi i përmbushjes së tyre për secilin:
Për anëtarët ekzekutiv të përfaqësuar nga Administatori Z. EK dhe Zv/Administratori Z. A R, për përmbushjen e kritereve të përcaktuar në ç, d dhe dh të nenit 17 të ligjit janë paraqitur CV për eksperiencën drejtuese, letër referencë bashkëpunëtorë si dhe kualifikime e certifikime të përfituara. Gjithashtu administratori i shoqërisë është testuar në bazë të Urdhrit të DPE të AMF nr. 270 datë 04.11.2019, nga i cili pas korrigjimit të testit nga komisioni ka kaluar me sukses. Dokumentacioni vendosur në dispozicion të grupit të auditimit përfshin vetëm procesverbalin e komisionit nga ku është pohuar se pas korrigjimit të testit rezultoi se kandidati e kaloi me sukses, duke mos paraqitur evidencë mbi testin.

-Planin e biznesit për shoqërinë administruese për një minimum prej tre vitesh
Plani i biznesit i dorëzuar nga shoqëria përfshin një periudhe 5-vjeçare duke përfshirë përshkrim të strukturës organizative të shoqërisë, planin e marketingut, produktet që do të ofrohen, planin operacional të shoqërisë, sistemin raportues, planin financiare etj. Është dorëzuar organigrama sipas së cilës këshilli i administrimit është organi i vetëm i administrimit. Funksioni i kontrollit të brendshëm dhe disa funksione të tjera janë parashikuar të ofrohen nga A S sha sipas kontratës së shërbimit të lidhur midis palëve. Funksioni i administrimit të riskut është parashikuar të J nën përgjegjësinë e Zj. KB. Për sistemet teknologjike që do përdoren është përcaktuar përdorimi i atij të kompanisë Primera 7 që ofron sisteme operative për dy shoqëri administruese dhe një depozitar në Shqipëri dhe është cilësuar nga Departamenti i zhvillimeve strategjike dhe operative me emali që sistemet e shoqërisë A S I konsiderohen të përshtatshme për të filluar aktivitetin.

<u>Nga auditimi konstatohet se pjesë e dokumentacionit të plotë për licencim nuk janë pasqyrat financiare të shoqërisë A SJ si personi juridik themelues i shoqërisë së administrimit të sipërmarrjes së Investimeve kolektive A S I, duke qenë jo në përputhje me kërkesat e rregullores</u> Nr. 124 datë 21.06.2019 òPër disa kërkesa shtesë për aksionarët themelues, aksionarët ndikues, anëtarin ekzekutiv të këshillit të administrimit të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të Investimeve kolektiveò ku në nenin 3 të saj citohet *"Çdo aksionar themelues i shoqërisë administruese, që ka paraqitur kërkesën për ushtrim veprimtarie në fushën e sipërmarrjeve të Investimeve kolektive, depoziton si pjesë të dokumentacionit të plotë për licencim, dokumentacionin si më poshtë: .... Pasqyrat financiare të audituara të 3-viteve të fundit, që tregojnë se natyra dhe burimet financiare të personit juridik janë të tilla që mund të sigurojnë mbështetje me kapital shtesë të veprimtarisë së shoqërisë administruese si dhe evidencën e mjaftueshmërisë së mjeteve monetare në arkë dhe në B, për pagimin e kapitalit dhe*

për personin jurdik me më pak se 3 vjet aktivitet, pasqyrat financiare për të gjitha vitet e aktivitetit;".

Kjo mospërputhje konstatohet se vjen si pasojë e kohës së shkurtër të licencimit të shoqërisë themeluese të shoqërisë A S I dhe për këtë janë paraqitur bilance vërtetues dhe jo pasqyra financiare, duke qenë se vetë shoqëria A SJ është themeluar vetë disa muaj përpara themelimit të shoqërisë A S I. Në këtë mënyrë konstatohet se, nuk është arritur siguria mbi mbështetjen me kapital shtesë përgjatë periudhës së parashikuar në planin e biznesit të veprimtarisë së shoqërisë administruese sipas kërkesave të rregullores por është kërkuar nga shoqëria themeluese që kapitali minimal të J më i lartë (në nivelin e 200% mbi kërkesat ligjore) dhe njëkohësisht është paraqitur deklaratë nga shoqëria A S jo J se do mbështetet në çdo moment në se do të J e nevojetëshme me kapital shtesë shoqërinë administruese A S I. Konstatohet se kërkesat për kapital në nivelin 200% burojnë nga kërkesat e ligjit për SIK dhe ligjit për FP, ku në kërkesat minimale për licencim përfshihen edhe kapitali në shumën 15,625,000 lekë respektivisht për një shoqëri administruese të fondeve të pensionit dhe 15,625,000 lekë për një shoqëri administruese të fondeve të Investimit.

Gjithashtu nga analiza e projeksioneve të gjendjes së kapitalit dhe pasqyrës së fitim humbjes së shoqërisë administruese konstatohet se vlera e kapitalit fillestar projektohet në fund të vitit të dytë në shumën 20,223,730 lekë dhe në fund të vitit të tretë në shumën 16,913,363 lekë, duke parashikuar në të njëjtën kohë edhe shtesa në kapital në fund të vitit të dytë 4,000,000 lekë dhe në fund të vitit të tretë 5,000,000 lekë. Në këtë mënyrë, që në planin e biznesit parashikohet mos respektimi në vitet në vijim për kërkesat për kapital themeltar sipas kufijve të përcaktuar për fondin e pensionit dhe fondin e sipërmarrjes së Investimeve kolektive. Edhe kapitali i parashikuar për tu shtuar, në momentin e regjistrimit nuk është paraqitur me dokumentacion justifikues i cili mungon duke qenë se shoqërisë themeluese i mungon historiku, aktiviteti dhe nuk ka paraqitur pasqyra financiare vjetore.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se në dokumentacionin e licencimit mungon deklarata nga eksperti kontabël i jashtëm mbi sistemin e informimit sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2/c të nenit 16 të ligjit nr. 10198 datë 10.12.2009 ñPër Sipërmarrjet e Investimeve Kolektiveò ku parashikohet *"Kërkesa për t'u pajisur me licencë për kryerjen e veprimtarisë së administrimit të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive shoqërohet me:..... iii) informacion për sistemet teknologjike, që do të përdoren, përfshirë një deklaratë nga eksperti kontabël i jashtëm, që vërteton se sistemi i informimit të shoqërisë administruese është i përshtatshëm për të siguruar informacionin e kërkuar, sipas këtij ligji."*.

-Për kriterin e depozitarit është lidhur marrëveshja paraprake në formën e kontratës së shërbimit me depozitarin ñT Bò sha për fondin e Investimit me nr. 02 datë 11.11.2019 dhe për fondin e pensionit me nr. 01 datë 07.11.2019.

-Në relacion janë paraqitur edhe rregullore për parandalimin dhe menaxhimin e çdo konflikti interesash, rregulla për ndarjen e administrimit të fondit të Investimit nga të gjitha veprimtaritë e tjera në të cilat është angazhuar shoqëria administruese e fondit të Investimit; rregulla për transparencën, etj.

Për këtë praktikë licencimin, nga ana e Drejtorisë së Licencimit në Departamentin e Çështjeve Juridike është përgatitur (nga E C, E K, V Th) për Bordin e AMF relacioni datë 15.11.2019 në të cilën është gjykuar propozimi i licencimit të shoqërisë ñA S I ï shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të Investimeve kolektiveò për të vepruar si shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit si dhe administrimin e aseteve të sipërmarrjes së Investimeve .

Departamenti i Çështjeve Juridike, Drejtoria Juridike dhe Përputhshmërisë (përgatitur nga I.Xh, L.B dhe V.Th) në 19.11.2019 ka paraqitur në Bordin e AMF opinionin mbi licencimin e shoqërisë A S I duke sugjeruar licencimin e shoqërisë.

Bordi i AMF me Vendim nr. 210 datë 22.11.2019 ka vendosur ka vendosur licencimin e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve kolektive A S I sha si dhe miratimin e fondit të pensionit vullnetar A S nën administrimin e A S I-shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të Investimeve kolektive; miratimin e kontratës tip individuale të anëtarësimit, kontratës tip të punëdhënësit dhe kontratës së punëmarrësit në planin e krijuar nga punëdhënësi; miratimin e prospektit të fondit të pensionit vullnetar A S. Vendimi i Bordit është komunikuar me shkresën nr. 3201/6 datë 03.12.2019.
Bordi i AMF me vendim nr. 255 datë 30.12.2019 ka miratuar krijimin e fondit të Investimit ñA S Standardò i administruar nga shoqëria administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve kolektive ñA S Iò. Ky vendim është komunikuar me shkresën nr. 3872/1 datë 06.01.2020. Miratimi i prospektit të fondit të Investimit është miratuar me Vendimin e Bordit të AMF me nr. 254 datë 30.12.2019, përcjellë shoqërisë me shkresën nr. 3872/2 datë 06.01.2020.

Në lidhje me këtë praktikë licencimin janë paraqitur observacione mbi konstatimet duke parashtruar që:

.....Sa më sipër sqarojmë se, sipas kërkesave të rregullores (siç është referuar edhe në raportin tuaj), ñ.....për personin juridik me më pak se 3 vjet aktivitet, pasqyrat financiare për të gjitha vitet e aktivitetitò. Ligjit dhe rregullorja shprehin qartë se pasqyrat financiare të aksionarit lidhen me krijimin e sigurisë për përmbushjen e kërkesave për Kapital në momentin fillestar dhe në vijimësi. Në këto kushte, Autoriteti në vlerësimin e tij ka mbajtur parasysh të gjithë dokumentacionin e depozituar nga shoqëria. - Konkretisht, shoqëria A SJ, aksionarë e vetme e shoqërisë administruese A S I, është pjesë e një grupi dhe ka aksionar të vetëm shoqërinë A Ssh.a. shoqëri sigurimi e cila është subjekt i mbikëqyrur nga Autoriteti dhe kemi të gjithë informacionin e nevojetëshëm për të vlerësuar kapacitetet e saj financiare për mbështetjen me mjete financiare të A SJ dhe shoqërisë administruese A S I. - Autoriteti për të arritur një siguri më të lartë, ka kërkuar jo vetëm pasjen e burimeve të mjaftueshme financiare nga aksionarët por ka kërkuar që kapitali minimal fillestar të J ndjeshëm mbi nivelet e kërkuar ligjore duke çuar atë në 200% të vlerës fillestare dhe rrjedhimisht duke siguruar që përpara fillimit të aktivitetit vijimësinë e tij për vitet e para.- Gjithashtu, në konfirmim të sa më sipër dhe vlerësimit të drejtë të kryer nga Autoriteti për aftësinë financiare të aksionarit të shoqërisë Administruese A S I, e cila gjatë vitit 2020 ka kontribuar sërish duke rritur kapitalin e nënshkruar të shoqërisë administruese A S I në vlerën 54,000,000 lekë duke e çuar në mbi 300% të nivelit të kërkuar ligjor.....
..... Sa më sipër, aplikanti shoqëria administruese A S I ka depozituar informacionin mbi sistemet e informacionit që do të përdoren sipas kërkesave të Ligjit. Gjithashtu, informacioni i depozituar është konsultuar edhe strukturat e TI brenda në Autoritet për të vlerësuar përshtatshmërinë e tij. Shoqëria administruese për administrimin dhe llogaritjen e vlerës së aseteve që është dhe thelbi i aktivitetit dhe pjesa me e rëndësishme e sistemeve të TI, bashkëpunon me Kompaninë Primera 7, duke qenë se ajo i përmbushte të gjitha kërkesat dhe funksionalitetet e biznesit. Primera 7 është e pranishme në tregun Shqiptarë që nga viti 2012, aktualisht ofron shërbimet e sistemeve operative për dy shoqëri administruese dhe një depozitar në Shqipëri dhe gjatë kësaj periudhe nuk rezulton të ketë pasur pakënaqësi nga kompanitë në treg për këtë sistem operativ. Gjithashtu ajo kontrollon të paktën 50% të tregut në Maqedoni, Serbi, Kroaci dhe ka filluar aktivitetin në vitin 1997 dhe <u>është e specializuar për sistemet operative të fondit të Investimit dhe të pensionit.</u> Autoriteti ka kryer një vlerësim gjithëpërfshirës dhe objektiv me qëllim sigurimin e përmbushjes së kritereve ligjore dhe rregullatorë dhe ofrimin e shërbimit më të mirë për Iitorët dhe nuk është bazuar në një kontroll formal na një ekspert **kontabël** i cili kurrsesi nuk ka njohuritë dhe kapacitetet teknike për tâu shprehur lidhur me sistemet e informacionit të një shoqërie administruese. Gjithashtu termi ekspert kontabël nuk ka ekzistuar në Ligjin ñNr. 10 091, datë 5.3.2009 ñpër auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuarò i ndryshuar, por Ligji i referohet me termin Auditues Ligjor dhe në përkufizimet e tij përcakton qartë së në

tagrin e tij është *"një auditim i pavarur i pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara".*
Lidhur me konstatimin e Auditimit se mungon testi për administrator z. EK, po ju a vendosim në dispozicion bashkëngjitur.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në lidhje me pretendimet në observacione për paraqitjen e pasqyrave financiare lidhur me krijimin e sigurisë për përmbushjen e kërkesave për kapital në momentin fillestar dhe në vijimësi, sqarojmë se sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion në praktikën e licencimit, nuk ka pasur pasqyra financiare vjetore, por vetëm pasqyrë të gjendjes së llogarive për muajt e ushtrimit të aktivitetit. Gjithashtu në observacione pretendohet se janë përmbushur kërkesat për sigurimin e kapitalit minimal nëpërmjet kërkesës së dyfishit të kapitalit të kërkuar, që nuk rezulton e tillë pasi kërkesat për kapital minimal duhet të ishin dyfish duke qenë se kemi të bëjmë me kërkesë për kapital minimal dhe themelues edhe në bazë të ligjit për SIK edhe në bazë të ligjit për FP. Shtesat në kapital në nivelin e 54,000,000 lekë të pretenduara janë jashtë objektit të vendimmarrjes në momentin e licencimit, duke referuar gjithashtu edhe mungesën e argumentimit mbi konstatimet për planin e biznesit të paraqitur në momentin e licencimit. Për këto arsye observacionet nuk merren në konsideratë.
Në lidhje me observacionet mbi deklaratën e ekspertit kontabël mbi sistemet e informacionit si kriter për licencim sqarojmë se ligji ka kërkuar kryerjen e shërbimit nga eksperti kontabël dhe jo përdorimin e gjykimit të autoritetit si kusht për licencim. Gjithashtu edhe pretendimi mbi mungesën e njohurive dhe kapaciteteve teknike nga ana e ekspertit kontabël si dhe problemi i përdorimit të termit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10 091, datë 5.3.2009, mund të ishte adresuar në kohën e duhur nga autoriteti për ndryshime në ligjin për SIK/FP me qëllim reflektimin e atyre kërkesave për licencim të cilat gjykohen se duhen ndryshuar. Duke qenë se për periudhën dhe praktikën objekt auditimi kjo është baza ligjore dhe kriteret përkatëse mbi të cilat është ushtruar veprimtaria e licencimit, observacioni nuk merret në konsideratë.
Në lidhje me observacionin për vendosjen në dispozicion të testimit të kandidatit për administrator dhe anëtar të këshillit, duke qenë se është dërguar bashkëngjitur provimi përkatës merret në konsideratë observacioni.

Në lidhje me çështjet e trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit, me shkresën nr. 41/1 datë 29.09.2021, protokolluar në KLSH me nr. 845/6 datë 29.09.2021 janë paraqitur observacione për këtë praktikë duke parashtruar të njëjtat pretendime të paraqitura mbi akt konstatimet të cilat janë paraqitur më sipër.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Duke qenë se nuk janë paraqitur argumenta dhe informacione shtesë, observacioni nuk merret në konsideratë.

Gjetja: Nga auditimi mbi licencimin e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit dhe fondeve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive A S I sha janë konstatuar mos përmbushje të kritereve përsa i përket dorëzimit të pasqyrave financiare të aksionarit, që tregojnë se natyra dhe burimet financiare të personit juridik janë të tilla që mund të sigurojnë mbështetje me kapital shtesë të veprimtarisë së shoqërisë administruese; mungesës së deklaratës së ekspertit kontabël për sistemin e informimit dhe mungesës së kapitalit të nevojetëshëm për licencim sipas planit të biznesit të paraqitur dhe mundësisë së aksionarit ñShoqërisë A SJ shaò për mbulimin me kapital të humbjeve të projektuara me efekt në kapitalin aksionar

Situata: AMF me Vendim nr. 210 datë 22.11.2019 ka vendosur ka vendosur licencimin e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit dhe fondeve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive A S I sha si dhe miratimin e fondit të pensionit vullnetar A S.

-Nga auditimi konstatohet se pjesë e dokumentacionit për licencim nuk janë pasqyrat financiare të shoqërisë A SJ si personi juridik themelues i shoqërisë së administrimit të sipërmarrjes së Investimeve kolektive A S I, duke qenë jo në përputhje me kërkesat e rregullores Nr. 124 datë 21.06.2019 ñ*Për disa kërkesa shtesë për aksionarët themelues, aksionarët ndikues, anëtarin ekzekutiv të këshillit të administrimit të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive"*. Kjo mospërputhje konstatohet se vjen si pasojë e kohës së shkurtër të licencimit të shoqërisë themeluese të shoqërisë A S I dhe për këtë janë paraqitur bilance vërtetues (disa mujorë). Në këtë mënyrë konstatohet se, nuk është arritur siguria mbi mbështetjen me kapital shtesë të veprimtarisë së shoqërisë administruese sipas kërkesave të rregullores por është kërkuar nga shoqëria themeluese që kapitali minimal të J më i lartë (në nivelin e 200% mbi kërkesat ligjore) dhe njëkohësisht është paraqitur deklaratë nga shoqëria A S joJ se do mbështesë në çdo moment në se do të J e nevojetëshme me kapital shtesë shoqërinë administruese A S I. Konstatohet se kërkesat për kapital në nivelin 200% burojnë nga kërkesat e ligjit për SIK dhe ligjit për FP.

-Gjithashtu nga analiza e projeksioneve të gjendjes së kapitalit konstatohet se vlera e kapitalit fillestar projektohet në fund të vitit të dytë në shumën 20,223,730 lekë dhe në fund të vitit të tretë në shumën 16,913,363 lekë., duke parashikuar mos respektimin në vitet në vijim të kërkesave për kapital themeltar sipas kufijve të përcaktuar. Edhe kapitali i parashikuar për tu shtuar, në momentin e regjistrimit nuk është paraqitur me dokumentacion justifikues duke qenë se shoqërisë themeluese i mungon historiku, aktiviteti dhe nuk ka paraqitur pasqyra financiare vjetore.

-Nga auditimi konstatohet se në dokumentacionin e licencimit mungon deklarata nga eksperti kontabël i jashtëm mbi sistemin e informimit sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2/c të nenit 16 të ligjit nr. 10198 datë 10.12.2009 ñPër Sipërmarrjet e Investimeve Kolektiveò.

Kriteri: neni 16 i ligjit nr. 10198 datë 10.12.2009 ñPër Sipërmarrjet e Investimeve Kolektiveò

neni 3 i rregullores Nr. 124 datë 21.06.2019 òPër disa kërkesa shtesë për aksionarët themelues, aksionarët ndikues, anëtarin ekzekutiv të këshillit të administrimit të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të Investimeve kolektiveò

Ndikimi/Efekti: Dhënia e licencës në kushtet e mos përmbushjes së kritereve

Shkaku: Pranimi i dokumentacionit jo të plotë dhe të saktë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga ana e AMF të kryhen inspektime me qëllim verifikimin e respektimit të kushteve për mjaftueshmërinë e kapitalit në përputhje me rezultatet e operacioneve të biznesit sipas kërkesave të kuadrit rregullator si dhe të kërkesave në lidhje me deklaratën mbi sistemin e informimit, duke pezulluar/revokuar licencën përkatëse në rast të mos përmbushjes eventuale të këtyre kritereve.

13- Licencimin i shoqërisë "Regjistri Shqiptar i Titujve ARG"

Baza ligjore për licencimin e regjistrarit përcaktohet në nenet 127-133 të ligjit nr. 9879 datë 21.02.2008 ñPër titujtò.

Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve ka paraqitur në 15.01.2019 në Bord relacionin mbi licencimin e shoqërisë aksionare ñRegjistri Shqiptar i Titujve ARGò për

ushtrimin e veprimtarisë së regjistrarit të titujve duke propozuar bordit të AMF-së licencimin e shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë së organizmit dhe administrimit të dhënave për titujt pa përfshirë aktivitetin e klerimit dhe shlyerjes për të gjithë titujt e transferueshëm të borxhit me ofertë private dhe publike dhe të gjithë titujt e transferueshëm të kapitalit që listohen/tregohen në B A E.

Departamenti i Çështjeve Juridike ka paraqitur në Bord në 21.01.2019 opinionin juridik mbi licencimin e shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë së regjistrarit të titujve duke sugjeruar licencimin e shoqërisë si regjistrar për ushtrimin e veprimtarisë së organizimit dhe administrimit të dhënave për titujt.
Referuar relacionit, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për licencim me shkresat nr. 1109 datë 21.03.2018, nr. 1651 datë 07.05.2018, nr. 1651/1 datë 18.05.2018, nr. 1651/2 datë 31.05.2018, nr. 3726 datë 05.11.2018, nr. 3809 datë 09.11.2018, nr. 3926 datë 20.11.2018, nr. 3926/1 datë 12.12.2018 dhe nr. 4241 datë 19.12.2018.

Shoqëria është themeluar në 10.03.2016 dhe statuti i saj është miratuar nga AMF me Vendimin nr. 133 datë 26.11.2015.

Të dhënat për ortakët e shoqërisë përfshijnë ñBCò, ñB Amerikane e Investimeve ò dhe Z. Artan Gjergji dhe historikun për tre vitet e fundit. Për personat juridikë janë depozituar në AMF kopje të aktit të themelimit, statutit si dhe pasqyrat financiare të viteve 2015, 2016 dhe 2017. Gjithashtu janë paraqitur të dhëna për personelin drejtues, përfshirë administratoren Zj. MT dhe anëtarët e këshillit mbikqyrës Zj. OP, Zj. VK dhe Zj. NV, duke përfshirë përmbushjen e kërkesave për diplomë të arsimit të lartë, përvojë pune të paktën 3 vite në specialitetin ku është diplomuar, eksperiencë pune në poste drejtuese dhe deklaratë mbi plotësimin e kërkesave të nenit 133 të ligjit dhe mbi gjendjen gjyqësore. Në bazë të urdhrit nr. 286 datë 13.12.2018 të drejtorit të AMF është ngritur komisioni i cili ka zhvilluar intervistë me drejtuesit.
Për përmbushjen e kritereve për pajisjet, hapësirat dhe shkallën e automatizimit të veprimtarisë është paraqitur informacion për zhvillimin e aktivitetit në 3 zyra me sipërfaqe 130 m2 (sipas kopjes së kontratës së nën qirasë datë 03.01.2018), njësitë kompjuterike të parashikuara si dhe sistemin elektronik ñQuick Clearò sipas kontratës lidhur më datë 13.12.2016 me kompaninë Market Evolution Softëare Products limited dhe nën suportin e kompanisë I F X. Në lidhje me sistemin është kryer inspektim pranë kompanisë në 19.12.2018 ku sipas relacionit të grupit të inspektimit ka rezultuar se sistemi plotëson të gjitha standardet e operimit vërtetuar edhe nga certifikatat ISO.
Për sigurimin e ambienteve nga zjarri është depozituar certifikatë lëshuar nga DMZNSH Bashkia Tiranë nr. 3278 datë 07.05.2018.
Shoqëria ka paraqitur rregulloret:
-Rregullore e Regjistrit Shqiptar të Titujve;
-Rregullore Operacionale ARG;
-Rregullore Teknike AR G
Kërkesat e nenit 130 të ligjit për rregullat janë parashikuar në Rregulloren e Përgjithshme dhe Rregulloren Operacionale ku janë parashikuar rregullat për:
-dhënia e informacionit dhe konfidencialiteti i të dhënave;
-organizimi i regjistrit në varësi të titujve për të cilin kërkohet licenca si regjistrar;
-pezullimi dhe mbyllja e aktivitetit;
-procedurat e transferimit të pronësisë mbi titujt për të cilën kërkohet licenca si regjistrar.

Në funksion të kësaj praktike licencimin nga autoriteti është kërkuar edhe dokumentacion shtesë që përfshin planin e biznesit, marrëveshje me Bn kujdestare në rast të pezullimit/mbylljes së aktivitetit dhe procedura të menaxhimit të rreziqeve (IT disaster Recovery Plan, Business Continuity Plan).
Në relacionin teknik të paraqitur në Bord është propozuar Bordit që licencimin i shoqërisë të kryhet për veprimtarinë e organizimit dhe administrimit pa përfshirë veprimtarinë e klerimit

dhe shlyerjes dhe që pas marrjes së licencës të mbahet parasysh që lista e tarifave të paraqitet për miratim në AMF parafillimit të aktivitetit.
Bordi me Vendimin nr. 228 datë 19.12.2019 ka vendosur miratimin e ushtrimit nga shoqëria të veprimtarisë së klerimit dhe shlyerjes në B ALE dhe përfshirjen e veprimtarisë së klerimit dhe shlyerjes së titujve në licencën e shoqërisë.
Vendimi i Bordit është komunikuar me shkresën nr. 1732/7 datë 31.12.2019.
Për sa më sipër në këtë dosje të testuar nuk u konstatuan mos përputhshmëri.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme është mbajtur akt konstatimi nr. 6 datë 29.01.2021 me personat përkatës Z. EM, Z. EK, Zj, VTh, Z. E K dhe Z. NK, sipas problematikave të konstatuara në praktikat respektive të licencimit, për të cilat janë paraqitur observacione dhe dokumentacioni bashkëngjitur me shkresën nr. 41/6/1 prot. AMF datë 05.02.2021, reflektuar si më sipër.

IV.4.2 Mbi monitorimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare të mbikëqyrura në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Përsa i përket organizimit të monitorimit së subjekteve që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare të mbikëqyrura, në departamentin e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, zyra e monitorimit të ndërmJetësve në sigurime ka një rol shumë të rëndësishëm.
Kjo zyre organizohej me ane të Vendimit të Bordit nr. 129 të datës 31.08.2017 ku Departamenti i Mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve përgjatë periudhës kohore vendimi i mësipërm ishte ne fuqi kishte në varësi Drejtorinë e Administrimit të Riskut, Drejtorinë e Mbikëqyrjes së tregut të Sigurimeve, Zyrën e Licencimit dhe Zyrën e monitorimit të ndërmJetësve në sigurime. Me anë të vendimit të Bordit nr. 154 të datës 24/07/2019 Departamenti i Mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve ka pasur nën varësi Drejtorinë e Administrimit të riskut dhe Drejtorinë e Mbikëqyrjes së tregut të Sigurimeve e cila ka pasur nën varësi edhe Mbikëqyrjen e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve dhe Monitorimi i ndërm J sve në Sigurime.
Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të specialistëve/kryespecialist të monitorimit dhe NdërmJetësve janë:

1) Monitoron zbatimin e kërkesave të licencimit, gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës, tek ndërmJetësit dhe operatorët e tjerë që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit;
2) Monitoron zbatimin e politikave dhe/ose procedurave të hartuara për rregullat e brendshme të funksionimit të ndërmJetësve dhe operatorëve të tjerë që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit;
3) Kryen kontrolle, të pjesshme ose të plota, si dhe kontrolle të përbashkëta, me kërkesë dhe në bashkëpunim me njësi të tjera të Autoritetit ose me institucione të tjera në bazë të marrëveshjeve që Autoriteti ka, mbi veprimtarinë e ndërmJetësve dhe operatorët e tjerë, që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit, sipas programeve të miratuara për këtë qëllim si dhe harton raporte konstatimi në përfundim të tyre;
4) Shqyrton dhe përpunon pasqyra financiare dhe raporte statistikore, të depozituara sipas formateve të miratuara, nga ndërmJetësit dhe operatorët e tjerë që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit;
5) Mban dhe përditëson regjistrin e ndërmJetësve dhe operatorëve të tjerë që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit;
6) Propozon masat dhe rekomandimet, për subjektet që mbikëqyr, tek drejtori i departamentit;
7) Propozon ndryshime në akte ligjore dhe nënligjore në lidhje me veprimtarinë e ndërmJetësve dhe operatorëve të tjerë që ushtrojnë aktivitet në tregun e sigurimit;
8) Propozon përmirësime në bazën rregullatorë ligjore dhe nënligjore;

9) Punon profesionalisht, me pozitivitet dhe është bashkëpunues si pjesë e shkëmbimit të informacionit brenda AMF-së në mënyrë të shpejtë dhe të plotë;

10) Përmbush detyrat me profesionalizëm, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe rregullat e Autoritetit;

11) Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët brenda objektivave të punës së sektorit.

Aktiviteti i mbikëqyrjes së ndërmjetësve në sigurime

Bazuar në legjislacionin e sigurimeve në fuqi, ndërmJetës në sigurime janë të gjithë personat fizikë apo juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësmit, që përfshin veprimtarinë e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së veprimeve të tjera përgatitore deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënia e asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, përkundrejt pagesave dhe komisioneve të përcaktuara sipas dispozitave ligjore.

Veprimtaria e ndërmjetësmit në sigurime, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ushtrohet nga:

-*Agjentë persona* fizike, shoqëri agjentësh, Bt, degët e Bve të huaja ose subjektet financiare joB, si dhe subjekte të tjera, kur shitja e produkteve të sigurimit nga këto subjekte, përputhet apo plotëson veprimtarinë parësore T të tyre;

-*Brokera persona fizike*, shoqëri brokerimi, B dhe/ose dega e B së huaj në Shqipëri, institucione financiare jobanke.

Përsa i përket regjistrit të licencuarve në tregun e sigurimeve që përbën bazën mbi të cilën realizohet aktiviteti i monitorimit rezulton se janë 12 shoqëri sigurimi,1 shoqëri ri sigurimi, përsa i përket agjent dhe Bnë sigurime,1 shoqëri agjentësh,4 B agjent,38 subjekte të tjera agjent,745 agjent individ,14 shoqëri brokerimi, 5 B broker, 5 Bfizik i regjistruar, 53 Bindivid në faqen zyrtare të AMF-së ndërkohë që në excelin e vendosur ne dispozicion nga AMF të licencuarve, rezultojnë 55.58 vlerësues dëmesh dhe 13 aktuar të autorizuar.

Sektori i monitorimit të ndërmJetësve e realizon aktivitetin e tij nëpërmjet monitorimit në distancë dhe inspektimit në vend. Monitorimin në distancë e realizon nëpërmjet shqyrtimit te pasqyrave financiare të shoqërive së brokerimit/agjentëve.

Përsa i përket situacionit financiar të shoqërive të brokerimit për vitin 2019 sektori i Mbikëqyrjes së BSHS-së dhe monitorimit të ndërmJetësve ka përgatitur pasqyrën financiare ku rezulton se nga 13 shoqëri brokerimi të cilat janë aktive, në një shoqëri ASSBrezulton me humbjet për vitin 2019,ndërkohë që 12 shoqëritë e tjera kanë rezultuar me fitim. Nga aktiviteti i ndërmjetësmit në sigurime në total janë realizuar 646.943.420 lekë të ardhura. Në bazë të rregullores për ñKriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurimeò te miratuar me vendimin e bordit nr. 48 të datës 30.06.2015 në nenin 8 të tij në pikën 1 shkronja ñh ñthotë që dokumenti Br që vërteton pagimin e kapitalit bazë prej të paktën 3,000,000 lekësh në një nga Bt e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e Shqipërisë. Gjithashtu në bazë të ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò në nenin 211 të tij pika 1 a thotë: ñSh B, e cila ushtron veprimtari brokerimi në sigurime, paraqet në Autoritet kërkesën për licencim së bashku me dokumentet përkatëse që vërtetojnë kushtet e të ketë kapitalin bazë të paguar në para prej tij, të paktën 3.000.000 lekëshò

Në bazë të pasqyrave financiare të konsoliduara të përgatitura nga ana e sektorit të monitorimit të ndërmJetësve për vitin 2019 rezulton që AssBnuk e respektojnë këtë kriter .Ku në totalin e kapitalit AssBka vetëm 471.258 lekë. Pra AssBnuk e respektojnë këtë kriter as në totalin e kapitalit. Ndërsa po ti referohemi nenit të sipërcituar të ligjit 52/2014 thotë që kushtet e kapitalit bazë duhet të jenë të paguara në para, pra në mjete monetare ku AssBdhe S Bnuk e respektojnë këtë kriter ku kanë në mjete monetare vetëm 127.863 lekë dhe 1.189.424 lekë.

Në bazë të planit vjetor për vitin 2019 zyra e licencimit dhe sektori i monitorimit të ndërmJetësve në sigurime ka planifikuar: 1)inspektime në vend në 2 shoqëri brokerimi në tregun e sigurimit në përputhje me kërkesat ligjore.2)Është planifikuar inspektim në vend në shoqëritë subjekte të tjera agjentë në tregun e sigurimeve në përputhje me kërkesat ligjore. 3)

Inspektime tematike në shoqëritë e brokerimit lidhur me ndjekjen e rekomandimeve të AMF në inspektimet e mëparshme.4) Inspektime në vend, për verifikimin e ankesave të raportuara në AMF lidhur me agjentët dhe punonjës të shitjes së shoqërive të sigurimit (rast pas rasti sipas raportimeve) Përsa i përket kryerjes së analizave off-site dhe të tjera:1) Shqyrtimi i raportimit dhe Analiza off-site për shoqëritë e brokerimit (me bazë gjashtëmujore dhe vjetore).
2) Propozim i masave mbikëqyrëse duke respektuar parimet e efektshmërisë, vazhdimësisë, proporcionalitetit me rrethanën apo veprimin që përbën shkelje dhe ndikimit mbi interesat e të siguruarve.
3) Bashkëpunime me Drejtoritë/Departamentet e tjera duke dhënë kontributin përkatës në hartimin e raportit vjetor, raportit të mbikëqyrjes, planikifimit të buxhetit etj.
Në bazë të planit vjetor nuk është realizuar,sipas shpjegimeve të AMF-së për shkak të mungesës së stafit, inspektimi në vend në shoqëritë subjekte të tjera agjentë në tregun e sigurimit në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi
Referuar pikës 1 të planit vjeto, përsa i përket inspektimeve në shoqëritë e borkerimit në tregun e sigurimit, programi i inspektimit është miratuar me shkresën nr. 1435.Prot të datës 19.04.2018. Në programin e inspektimit në fund të tij tregohet që inspektimet duhet të bëhen sipas grafikut të inspektimeve bashkangjitur për vitin 2018. Ndërkohë me anë të memos nr. 2639 Prot. të datës 01.08.2018 grafiku është ndryshuar. Inspektimet e bëra përgjatë vitit 2019 i janë referuar programit dhe grafikut të miratuar në vitin 2018 ku nuk parashikon inspektimin e 2 shoqërive të inspektuara përgjatë vitit 2019 ku më konkretisht: Ass sha dhe S Bsha. Gjithashtu janë inspektuar edhe agjentët z. AP agjent në sigurime pranë shoqërisë ñA N Sòsha dhe znj RS punonjës shitje i E sha. Inspektimi i agjentëve është bërë për shkak të ankesave të ardhura pranë AMF-së ndërkohë i shoqërive të sigurimit sipas shpjegimeve të AMF-së është realizuar për shkak të mos inspektimit përgjatë vitit 2018.
Në raportin vjetor të vitit 2019 përsa i përket ndërmjetësmit në sigurimi/monitorimi i agjentëve të punonjësve në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorit në përgjigje të ankesave të depozituar ka marrë në shqyrtim aktivitetet:
1-Ndaj znj. RSduke marrë shkas nga një ankesë e ardhur pranë AMF-së më datën 29.01.2019, ku pretendohej për shitje të një police TPL me numër serie 190060997, nga një person në pikën e shitjes së shoqërisë I, në Fushë Prezë, ndërkohë që polica mbante logon e shoqërisë E dhe emrin e agjentes RS dhe jo të asaj që e kishte lëshuar, si dhe faktin që ajo policë nuk figuronte e shitur në sistem në ditën që ishte lëshuar, bëri verifikimin në vend të këtij rasti, në bazë të Autorizimit Nr. 367 Prot., datë 30.01.2019. Qëllimi i këtij inspektimi ishte verifikimi lidhur me mënyrën e shitjes së asaj police sigurimi dhe mënyra e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Grupi i inspektimit shkoi në pikën e kolaudimit të automjeteve në Shkozet, Durrës, ku ushtronte aktivitetin e saj znj. RS, punonjëse e shoqërisë E, kodin e së cilës mbante polica TPL me nr. serie 190060997, që do të verifikohej.
Në bazë të Autorizimit për kryerjen e inspektimit, i kërkoi printimin nga sistemi të gjithë policave të shitura nga kodi i saj, që nga data 28 ï 30.01.2019 (duke qenë se polica që do të verifikohej i përkiste kësaj periudhe), si dhe dokumentin përkatës për furnizimin me polica nga shoqëria.
Në listën që u printua nga sistemi me kodin e saj, si dhe nga dokumenti i firmosur prej saj në datë 14.01.2019, për furnizimin me polica TPL me seritë nga 190060921 deri 190061000 (80 copë), rezultonte edhe polica TPL me nr. serie 190060997 si e shitur prej saj. Në momentit e krahasimit të policës TPL me nr. serie 190060997, që ishte dhënë personit të siguruar, e cila nuk përputhej me të dhënat e kopjes së asaj serie police që disponohej nga punonjësja e shitjes, gjë që bie në kundërshtim të plotë me kërkesat e pikës 2 të nenit 38, të Ligjit Nr. 10 076, datë 12.02.2009 ñPër sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportitò. Znj RS pranon se i ka dhënë seritë nga 190060991 deri 190060998 (8 copë) z. LF, i cili ndodhej i pranishëm aty në atë moment dhe që sipas tyre ushtronte aktivitetin e shitjes së policave kufitare në Portin e Durrësit, për llogari të shoqërisë E, ndërkohë që ky person nuk është i licencuar nga Autoriteti.

Grupi i inspektimin i AMF-së sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 6, të nenit 199, të Ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimitò, për të gjitha këto veprime që përbëjnë shkelje të dispozitave të atij ligji, si dhe të Rregullores Nr. 23, datë 26.02.2018, ñPër regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorikò, i propozoi bordit të AMF-së që të pezullojë ushtrimin e veprimtarisë së agjentit për një periudhë deri në 6 muaj, ose të ndalojë ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime dhe ta çregjistrojë atë nga regjistri i agjentëve.
Me anë të vendimit nr. 24 të datës 04.03.2019 Bordi i AMF-së ñPër marrjen e masës administrative, ndaj punonjëses pranë shoqërisë së sigurimeve ñEò SH.A, në Shkozet, Durrës, Znj R S vendosi ti pezullohet ushtrimi i veprimtarisë për shitjen e policave të sigurimit për një periudhë 6 mujore. Ndërkohë sipas nenit 199 pika 5 ç e ligjit nr.52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimitò thotë: Autoriteti ndalon ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime dhe e çregjistron atë nga regjistri ,nëse: Kryen mashtrime gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve.
Shkelja e konstatuar për zonjën RSi nënshtrohet pikës 5 ç të nenit 199 të ligjit të sipërcituar.
2-Po ashtu përgjatë vitit 2019 me anë të autorizimit nr. 755 Prot të datës 27.02.2019 DPE autorizon 3 punonjës të AMF-së të ushtrojnë inspektimin në vend pa paralajmërim pranë pikës së shitjes së shoqërisë së sigurimit A N S sha me objekt verifikimin në vend të licencës së agjentëve/punonjësve të shoqërive të autorizuar për shitjen e policave të sigurimit. Ky inspektim vjen duke marrë shkasë nga një ankesë e ardhur pranë AMF-së, nëpërmjet adresës së emalit zyrtar me datë 26.02.2019 nga një agjent i licencuar i shoqërisë së sigurimit ñSUGAò i cili pretendonte se në pikën e shitjes së shoqërisë së sigurimit ñA N Sò sh.a, ku ka ushtruar aktivitetin si agjent në sigurime z. AP, i cili tashmë i është pezulluar licenca për një afat prej 6 muaj, ushtrojnë aktivitetin persona të pa licencuar nga AMF. Me anë të memos informuese nr. 755/1 të po së njëjtës datë të daljes së autorizimit, pra me 26.02.2019,grupi i inspektimit të AMF-së konstatoi se pasi shkuan në pikën e shitjes së shoqërisë së sigurimit ñA N Sò sh.a pranë kolaudimit Tiranë, personi paraqiti dokumentin që vërtetonte si ishte Z. EP, punonjës shitje i shoqërisë A N S sh.a me kod shitje A18206. Pas vendosjes në dispozicion të kopjeve të policave të shitura gjatë ditëve të javës nga numri 190115759 deri në 190115770 dhe të atyre të pa shitura që fillonin nga seria 190115771 deri në 1901158000 u konstatua se numri i serisë së parë të policave të pa shitura vinte menjëherë pas numrit të fundit të policave të shitura ,çka tregonte se policat shiteshin në mënyrë kronologjike.
Për sa i përket inspektimeve të shoqërive të brokerimit që ushtrojnë aktivitetin në tregun e sigurimeve plani i shoqërive për tu inspektuar është bërë me nr. 1435 Prot të datës 19.04.2018 ku nuk përfshihen dy shoqëritë e brokerimit të inspektuara përgjatë vitit 2019 pra më konkretisht AssBsha dhe S BSha.
3-Përsa i përket inspektimit të S Bsha programi i inspektimit është miratuar me Nr.1845 Prot të datës 06.06.2019 dhe si afat për inspektimin parashikohet në datat 12-14 Qershor 2019.Në projekt raportin e inspektimit me nr. 1845/1 të datës 01.07.2019 për sa i përket problematikave të konstatuara nga AMF rezultoi se:1)Sh BStTBsh.a nuk ka një llogari të posaçme për derdhjen e primeve pasi nuk arkëton prime.2)Shoqëria S Bsha nuk ka database për të dhënat e klientëve të ndërmjetësuar për sigurimin e Jetës dhe nuk ka regjistër për evidentimin e tyre, por mjaftohet vetëm me të dhënat e dërguara në korrespondencën me emali të klientëve. Po kështu nuk ka dosje të veçantë për identifikimin dhe ruajtjen e dokumenteve për çdo klientë të ndërmjetësuar , me vulën e subjektit si parashikohet në Ligjin për PPP/FT nr. 9917 datë 19.05.2008 i ndryshuar neni 5 pika 2
3) Personi përgjegjës për PPP&FT në shoqëri,(ndonëse shoqëria ka edhe një punonjës me kohë të plotë)nuk ka të përgatitur program vjetor për trajnimin e stafit në drejtim të PPP&FT, sikurse parashikohet në pikën 9 të rregullores së AMF, miratuar me Vendim të Bordit nr. 58/2015,òMbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmitò e ndryshuar. Gjithashtu në

projekt raportin e inspektimit konfirmohet se Sh B disponon kapitalin bazë prej të paktën 3.000.000 lekësh. Në përfundim të problematikave të konstatuara jepen dhe rekomandimet përkatëse ku më konkretisht 6 rekomandime ku për asnjë nga rekomandimet nuk jepet asnjë afat dhe nuk ka asnjë ndjekje të procesit të realizimit të tyre. Gjithashtu AMF nuk ka një raport përfundimtar pasi S Bnuk ka dërguar observacione dhe nga ana e AMF-së projekt raporti është konsideruar si raport përfundimtar.
Gjithashtu në bazë të ligjit nr. 9572 të datës 03.07.2006 ñPër autoritetin e Mbikëqyrjes financiareò në nenin 19 të tij për sa i përket inspektimit në pikën d thotë që ñRaporti për çdo inspektim përgatitet në dy kopje dhe nënshkruhet nga nëpunësi i Autoritetit që kryen inspektimin, si dhe i paraqitet për kundër firmë personit që përfaqëson subjektin e mbikëqyrur. Në këtë rast subjekti i mbikëqyrur nuk e ka firmosur projekt raportin e konsideruar si raport përfundimtar nga AMF në kundërshtim të dispozitës ligjore të mësipërme.
Kjo problematikë konstatohet për shkak të mos pasjes nga ana e AMF-së së një rregulloreje të standardizuar për procesin e inspektimit, duke përfshirë afatet, monitorimin, ndjekjen e rekomandimeve dhe etapat e inspektimit
4-Përsa i përket inspektimit të Ass sha programi i inspektimit është miratuar me nr. 1995 Prot të datës 18.06.2019 me objekt:1)Verifikimin nëse shoqëria disponon një rregullore të brendshme për mënyrën e funksionimit dhe sa e ka zbatuar atë gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj. 2) Verifikimin nëse Sh B plotëson kërkesat themelore për kryerjen e veprimtarisë së tij si: disponimi i policës së sigurimit të përgjegjësisë profesionale, disponimi i fondit të garancisë financiare. 3)Verifikimin nëse Sh B disponon kapitalin bazë prej të paktën 3.000.000 lekësh. 4)Verifikimin nëse shoqëria gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj ka një Btë licencuar fizik ,me kontratë me kohë të plotë. 5)Verifikimin nëse shoqëria disponon një llogari të veçantë për mbledhjen e primeve nga të siguruarit, të ndryshme nga ajo e ushtrimit të aktivitetit të saj. 6)Verifikimin nëse shoqëria ka derdhur rregullisht tarifën e Mbikëqyrjes në Autoritet, sipas përcaktimit të pikës 1 e 2 të nenit 5,të rregullores nr. 155,datë 23.12.2014 ñPër përcaktimin e elementëve të përllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyreò.
Në rastin e Ass sha nuk është dërguar projekt raporti por menjëherë raporti përfundimtar nga AMF me shkresën nr. 1995/1 të datës 10.07.2019,e justifikuar nga AMF për dërgimin menjëherë të raportit përfundimtar për arsye të mos dërgimit të rekomandimeve
Në raportin përfundimtar të dërguar nga AMF për Ass sha përsa i përket pikës 1 te programit të inspektimit, AMF në raportin përfundimtar për Ass, rezulton se disponon dy rregullore. Për sa i përket pikës 2 të programit të inspektimit, AMF në raportin përfundimtar të inspektimit deklaron se Ass i përmbush kushtet e zotërimit të policës së përgjegjësisë profesionale. Përsa i përket pikës 3 të programit të inspektimit, AMF në raportin përfundimtar të inspektimit deklaron se Ass i përmbush kushtet e disponimit të kapitalit bazë prej të paktën 3.000.000 lekësh. Përsa i përket pikës 4 të programit të inspektimit,AMF në raportin përfundimtar të inspektimit deklaron se Ass i përmbush kushtet përsa i përket ushtrimit të aktivitetit të saj ku ka një Btë licencuar fizik me kontratë të plotë. Përsa i përket pikës 5 të programit të inspektimit, AMF në raportin përfundimtar të inspektimit deklaron se Ass i përmbush kushtet ku verifikohet se shoqëria disponon një llogari të veçantë për mbledhjen e primeve nga të siguruarit, të ndryshme nga ajo e ushtrimit të aktivitetit të saj. Përsa i përket pikës 6 të programit të inspektimit, AMF në raportin përfundimtar të inspektimit deklaron se Ass i përmbush kushtet përsa i përket derdhjes se tarifës në Autoritet sipas përcaktimit të pikës 1 e 2 të nenit 5 të rregullores nr. 155 të ndryshuar, përsa i përket vitit 2018 dhe 3 mujorit të parë të vitit 2019.
Gjithashtu në bazë të ligjit nr. 9572 të datës 03.07.2006 ñPër autoritetin e Mbikëqyrjes financiareò në nenin 19 të tij përsa i përket inspektimit në pikën d thotë që ñRaporti për çdo inspektim përgatitet në dy kopje dhe nënshkruhet nga nëpunësi i Autoritetit që kryen inspektimin, si dhe i paraqitet për kundër firmë personit që përfaqëson subjektin e mbikëqyrur.

Në këtë rast subjekti i mbikëqyrur nuk e ka firmosur raportin përfundimtar në kundërshtim të dispozitës ligjore të mësipërme.
Kjo problematikë konstatohet për shkak të mos pasjes nga ana e AMF-së së një rregulloreje të standardizuar për procesin e inspektimit, duke përfshirë afatet, monitorimin, ndjekjen e rekomandimeve dhe etapat e inspektimit
Nga auditimi konstatohet se edhe pse dy shoqëritë e brokerimit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e sigurimeve, të inspektuara përgjatë vitit 2019 ku më konkretisht Ass sha dhe S B sha ku në bazë të inspektimeve të kryera për shoqërinë e brokerimit Ass sha nuk është lënë asnjë rekomandim nga ana e AMF-së, ndërsa për shoqërinë e brokerimit S Bsha janë lënë 6 rekomandime si më poshtë të përmbledhura:
1)Shoqëria S Bsha të rishikoj dhe miratoj Rregulloren e brendshme të emërtuar ñMbi masat e Vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmitò
2)Shoqëria S Bsha në zbatim të ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 ñPër parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ñi ndryshuar, neni 11,germa b, të emëroj një person përgjegjës për çështje të PPP/FT
3)Të bashkëpunoj me Autoritetin Përgjegjës për krijimin e infrastrukturës së nevojetëshme elektronike për të bërë të mundur komunikimin online me DPPPP, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në ligjin nr. 9917 datë 19.05.2008 ñPër parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ñi ndryshuar
4)Shoqëria S Bsha të krijojë një data basë për të dhënat e klientëve të ndërmjetësuar për sigurimin e Jetës dhe të ruaj në dosjet e klientëve dokumentet për çdo klient të ndërmjetësuar , me vulën e subjektit ñS ò B sha në zbatim të Ligjit nr.9917,datë 19.05.2018,i ndryshuar neni 5 pika 2
5)Të merren masa në vazhdimësi për identifikimin e pronarit përfitues të policës së sigurimit të Jetës, duke qenë se klasifikohet si tregues i nivelit të lartë të rrezikut sipas pikës ñsò, paragrafi 3,Aneksi I, të rregullores nr. 58/2015. Pas verifikimit të identitetit të pronarit përfitues të merren dhe masat përkatëse si në rast se klienti është për PEP,OJF ose klient jo rezident veprohet sipas nenit 8 të ligjit 9917,datë 19.05.2018 ñPër parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmitò i ndryshuar
6)Bazuar në rregulloren ñMbi Masat e Vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmitò miratuar me vendimin e bordit nr. 58 datë 30.06.2015 i ndryshuar neni 8 pika 9,të hartohet programi vjetor për PPP&FT në lidhje me trajnimin e stafit të shoqërisë S B sha
Në bazë të inspektimit të kryer nga AMF në rastin e S Bpërsa i përket rregullores për ñKriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurimeò te miratuar me vendimin e bordit nr. 48 të datës 30.06.2015 në nenin 8 të tij në pikën 1 shkronja ñhò thotë që dokumenti Br që vërteton pagimin e kapitalit bazë prej të paktën 3,000,000 lekësh në një nga Bt e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e Shqipërisë. Gjithashtu në bazë të ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò në nenin 211 të tij pika 1 a thotë: ñSh B,e cila ushtron veprimtari brokerimi në sigurime, paraqet në Autoritet kërkesën për licencim së bashku me dokumentet përkatëse që vërtetojnë kushtet e të ketë kapitalin bazë të paguar në para prej tij, të paktën 3.000.000 lekëshò ajo trajtohet si verifikimi nëse Sh B disponon kapitalin bazë prej të paktën 3,000,000 lekësh dhe në këtë rast në projektraportin e inspektimit të përgatitur nga AMF <u>i rezulton se Sh BSTB sha ka një kapital të nënshkruar në vlerën e kërkuar nga ligji prej 3,5000,000 lekësh</u>
Po ashtu përsa i përket AssB sha në bazë të rregullores për ñKriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurimeò te miratuar me vendimin e bordit nr. 48 të datës 30.06.2015 në nenin 8 të tij në pikën 1 shkronja ñhò thotë që dokumenti Br që vërteton pagimin e kapitalit bazë prej të paktën 3,000,000 lekësh në një nga Bt e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e Shqipërisë. Gjithashtu në bazë të ligjit

nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò në nenin 211 të tij pika 1 a thotë: ñSh B, e cila ushtron veprimtari brokerimi në sigurime, paraqet në Autoritet kërkesën për licencim së bashku me dokumentet përkatëse që vërtetojnë kushtet e të ketë kapitalin bazë të paguar në para prej tij, të paktën 3.000.000 lekësh ñajo trajtohet si verifikimi nëse Sh B disponon kapitalin bazë prej të paktën 3,000,000 lekësh dhe në këtë rast në raportin përfundimtar të inspektimit të përgatitur nga AMF i rezulton se Sh BAss sha ka një kapital të nënshkruar në vlerën e kërkuar nga ligji prej 3,5000,000 lekësh

Nga auditimi me zgjedhje konstatohet se përsa i përket pasqyrave financiare të datës 31.12.2019 AssBnë totalin e kapitalit ka vetëm 471.258 lekë.

Ndërsa po ti referohemi nenit të sipërcituar të ligjit 52/2014 thotë që kushtet e kapitalit bazë duhet të jenë të paguara në para, pra në mjete monetare ku asnjëra nga AssBdhe S Bnuk e respektojnë këtë kriter ku kanë në mjete monetare vetëm 127.863 lekë dhe 1.189.424 lekë. Në kushte të tilla sektori i monitorimit llogaritjen mbi verifikimin nëse Sh B disponon kapitalin bazë prej të paktën 3.000.000 lekësh duhet ta realizonte duke ju referuar ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimitò në nenin 211 të tij pika 1 a të sipërcituar.

Pas mos përmbushjes së kushtit të sipërpërmendur për asnjë nga shoqëritë e brokerimit të mësipërme, nuk është dërguar një grup inspektimi edhe pse në rastin e Ass sha kemi të bëjmë edhe me mosrespektimin e kriterit në totalin e kapitalit ku ka vetëm 471.258 lekë.

Viti 2020-Në bazë të planit vjetor për vitin 2020 sektori i monitorimit të ndërmJetësve në sigurime ka planifikuar:1)Lidhur me kryerjen e inspektimeve tek ndërmJetësit në tregun e sigurimeve Është planifikuar inspektim në vend në 1 BT që kryen aktivitet brokerimi në tregun e sigurimit. Është planifikuar inspektim në vend në 3 BT që kryejnë aktivitet si agjentë në tregun e sigurimit. Është planifikuar inspektim në vend në shoqëritë subjekte të tjera agjentë në tregun e sigurimit. Inspektime tematike në shoqëritë e brokerimit dhe agjentët e licencuar, lidhur me ndjekjen e rekomandimeve të AMF.2) Lidhur me kryerjen e analizave off-site dhe të tjera është planifikuar shqyrtimi i raportimit dhe Analiza off-site për shoqëritë e brokerimit (me bazë gjashtëmujore dhe vjetore).

Propozim i masave mbikëqyrëse duke respektuar parimet e efektshmërisë, vazhdimësisë, proporcionalitetit me rrethanën apo veprimin që përbën shkelje dhe ndikimit mbi interesat e të siguruarve.

Bashkëpunime me Drejtoritë/Departamentet e tjera duke dhënë kontributin përkatës në hartimin e raportit vjetor, raportit të mbikëqyrjes, planifikimit të buxhetit etj.

3)Lidhur me ndjekjen e zbatueshmërisë së vendimeve është planifikuar ndjekja e vendimeve të Autoritetit në funksion të monitorimit dhe mbikëqyrjes se subjekteve të mbikëqyrura. Dhënia e Rekomandimeve për marrje masash si rezultat i problematikave të konstatuara nga mbikëqyrja (analiza, inspektime).

Përgjatë vitit 2020sektori i monitorimit të ndërmJetësve në sigurime nuk e ka realizuar planin përsa i përket inspektimeve në 1 BT që kryen aktivitet brokerimi në tregun e sigurimeve, gjithashtu nuk ka realizuar planin përsa i përket inspektimeve në 3 BT që kryejnë aktivitet si agjentë në tregun e sigurimit, gjithashtu nuk është kryer asnjë inspektim në vend në shoqëritë subjekte të tjera agjentë në tregun e sigurimit dhe asnjë inspektim tematik në shoqëritë e brokerimit.

Sektori i monitorimit të ndërmJetësve në sigurime në bazë të ankesës së datës 22.01.2020 me anë të emalit nga EM përfaqësues i agjentit YH ka kryer inspektime pa paralajmërim tek Z. EP agjent në sigurime pranë shoqërisë së sigurimeve I sha. Në bazë të autorizimit me nr.295 Prot të datës 30.01.2020 AMF autorizon inspektimin në vend por nuk ka të evidentuar subjektin të cilin do të inspektohet në kundërshtim me nenin 136 të ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò

Gjatë inspektimit u mbajt një procesverbal nga ana e grupit të inspektimit të autorizuar nga AMF për fotokopje të policave të TPL, fotokopje të licencës së personit të punësuar, fotokopje të kontratës dhe mandatet e marrjes në dorëzim të policave. Me anë të kërkesës për informacion

me nr216/1 Prot të datës 31.01.2020 AMF i drejtohet shoqërisë së sigurimit I sha përsa i përket inspektimit mbi konstatimin se seriali i policës së sigurimit 200021349 rezultonte e paplotësuar në sistemin e shitjes së shoqërisë I sha, me të dhëna të njëjta me ato të policës fizike me serial 200014169 me status ñdorëzuar ñpor që nuk përmban kodin unik të raportimit të AMF në sistem. Gjithashtu në kërkesën për informacion AMF sqaron se i është vendosur në dispozicion komunikimi nëpërmjet emali midis agjentit të shitjes, drejtorisë rajonale dhe asaj qendrore të shoqërisë I sha në lidhje me pretendimin e agjentit të shitjes lidhur me humbjen e policës së sigurimit TPL me seri 200021349,që përkon pikërisht me policën e sipërpërmendur. I sha në email e datës 14.01.2020 kërkon që të njoftohet komisariati i policisë. Në përfundim të kësaj shkrese AMF i kërkon shoqërisë I sha sqarime mbi situatën. I sha i kthen përgjigje AMF me datë 04.02.2020 me anë të shkresës nr. 254/1 ku sqaron se polica 200021349 rezulton në gjendje në kodin e agjentit EP dhe e pa shitur me statusin ñDorëzuarò në sistemin e raportimit online. I në shkresën dërguar AMF konfirmon se në datën 13.01.2020 agjenti ka njoftuar me email zyrat qendrore që polica rezulton e humbur. Agjenti i është shprehur AMF se një klient është paraqitur pranë zyrës së tij dhe ka kërkuar informacion lidhur me primin e siguracionit TPL të mjetit të tij. Kjo shpjegon faktin sipas agjentit që TPL me seri 200021349 rezulton tek moduli ñKërko Policaôò me të dhëna të plotësuara por që është e pa shitur, më pas agjenti ka konstatuar humbjen e policës dhe polica e vënë në dispozicion nga AMF nuk është firmosur nga ai. Pas këtij komunikimi AMF njofton denoncuesin mbi ngjarjen e mësipërme me anë të shkresë nr. 216/3 të datës 13.02.2020.Në rastin e mësipërm grupi i inspektimit nuk ka përgatitur një raport përmbledhës mbi inspektimin e kryer.
Grupit të auditimit ju shpjegua nga ana e AMF-së se shkak për mos përmbushjen e disa pikave të planit vjetor për vitin 2020 nga sektori i monitorimit të ndërmJetësve në sigurime, kanë qenë pushimet në këtë sektor dhe efektet e pandemisë COVID-19.

Observacioni i subjektit : Me shkresën me nr. 41/11 prot., datë 29.09.2021, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit, mbi auditimin e ushtruar në AMF e cila është protokolluar në KLSH me nr. 845/6, datë 29.09.2021 si më poshtë:
-Referenca e nenit 211 pika 1 e ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimitò Dhe e nenit 8 pika 1 shkronja òhò e rregullores nr.48 datë 30.06.2015 ñPër kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurimeò lidhet me procesin e licencimit dhe ligji nuk parashikon ngurtësimin e tij gjatë veprimtarisë së shoqërisë. Ndërsa neni 205 pika 3 e ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimitò shpreh detyrimin e shoqërisë së brokerimit që të ketë garancinë financiare jo më pak se 1 milion lekë.
- Sqarojmë se Sektori i Ndërmjetësve në Sigurime, nuk përgatit pasqyra financiare të konsoliduar, pasi nuk ka parashikime ligjore apo rregullatorët për përllogaritje treguesish teknikë financiarë për shoqëritë e brokerimit. Informacioni i përgatitur nga ky sektor që ju është vënë në dispozicion është informacion përmbledhës i pasqyrave financiare të shoqërive të brokerimit më 31.12.2019, sipas raportimit të tyre.
-Referuar tabelës përmbledhëse për vitin 2019, nga sektori i ndërmJetësve, rezulton se ASS B ka kryer klasifikim të pasaktë brenda zërit të aktivit, të garancisë financiare prej 1 milionë lekë, duke e përfshirë atë në zërin ñ Iime afatgjatëò në vlerën 3,563,263 lekë. Kjo pasaktësi nuk sjell efekte financiare, pasi është brenda aktivit të bilancit.
Për këtë klasifikim shoqëria ka vënë në dispozicion statement të B C të datës 15.04.2020, sipas së cilës AssBka të bllokuar që në datë 22.12.2017, garancinë financiare në shumën 1 milionë lekë në llogarinë e shoqërisë me numër me numër 1010370, dhe dokumentin e datës 16.01.2020, të Shoqërisë C I, në të cilin vërtetohet se vlera 2,566,270 lekë përfaqëson Investimin e shoqërisë tek C I. Gjithashtu për vitin 2019, shoqëria zotëron policën e

përgjegjësisë profesionale me nr.7701LIB0001128, datë 03.01.2019, për periudhën 03.01.2019 deri në 02.01.2020. Po ashtu, edhe Sh BS T B, ka deklaruar në pasqyrat Financiare të raportuara, se disponon në llogari B re, vlerën e garancisë Financiare. STB zotëron policën e përgjegjësisë profesionale me nr. 59123291, datë 28.03.2019, për periudhën 28.03.2019 deri në 27.03.2020, si dhe disponon fondin e garancisë të ngurtësuar në formën e një depozite Bre, pranë BC, dega T 1, në vlerën 1 milion lekë, në llogarinë e shoqërisë me numër 00000971710. - Për shoqërinë e brokerimit STBsh.a bordi la detyrë plotësimin e kërkesës ligjore të vlerës së kapitalit,e cila ju komunikua me shkresat 1119 prot datë 28.04.2021.Shoqëria i ktheu përgjigje autoritetin se ka shtuar kapitalin e saj duke plotësuar kërkesat ligjore <u>Qëndrimi i audituesve shtetëror të KLSH:</u> Në bazë të ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò në nenin 211 të tij pika 1 a thotë: ñSh B,e cila ushtron veprimtari brokerimi në sigurime, paraqet në Autoritet kërkesën për licencim së bashku me dokumentet përkatëse që vërtetojnë kushtet e të ketë kapitalin bazë të paguar në para prej tij, të paktën 3.000.000 lekëshò. Gjithashtu pika b dhe c e tij thotë si më poshtë: óTe ketë të paktën një Btë punësuar me kohë të plotë sipas një kontrate punësimiò ñTë mos J palë e lidhur me një shoqëri sigurimiò Pra këto kërkesa të nenit të mësipërm i nënshtrohen shoqërisë së brokerimi jo vetëm përsa i përket kushteve për dhënien e licencës, por përgjatë kryerjes së aktivitetit

Gjetja Mangësi në monitorimin për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit të shoqërive të brokerimit bazë të pasqyrave financiare.

Situata: Përsa i përket situacionit financiar të shoqërive të brokerimit për vitin 2019 sektori i mbikëqyrjes së BSHS-së dhe monitorimit të ndërmJetësve ka monitoruar pasqyrat financiare ku rezulton se nga 13 shoqëri brokerimi të cilat janë aktive, në një shoqëri, ASS Broker, rezulton me humbjet për vitin 2019, ndërkohë që 12 shoqëritë e tjera kanë rezultuar me fitim. Nga aktiviteti i ndërmjetësmit në sigurime në total janë realizuar 646,943,420 lekë të ardhura. Në bazë të rregullores për ñKriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurimeò te miratuar me vendimin e bordit nr. 48 të datës 30.06.2015 në nenin 8 të tij në pikën 1 shkronja ñhò thotë që dokumenti B që vërteton pagimin e kapitalit bazë prej të paktën 3,000,000 lekësh në një nga Bt e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e Shqipërisë. Gjithashtu në bazë të ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò në nenin 211 të tij pika 1 a thotë: ñSh B,e cila ushtron veprimtari brokerimi në sigurime, paraqet në Autoritet kërkesën për licencim së bashku me dokumentet përkatëse që vërtetojnë kushtet e të ketë kapitalin bazë të paguar në para prej tij, të paktën 3,000,000 lekëshò.

Në bazë të pasqyrave financiare të konsoliduar nga ana e sektorit të monitorimit të ndërmJetësve për vitin 2019 rezulton që AssBnuk e respektojnë këtë kriter .Ku në totalin e kapitalit AssBka vetëm 471,258 lekë. Pra AssBnuk e respektojnë këtë kriter as në totalin e kapitalit. Ndërsa po ti referohemi nenit të sipërcituar të ligjit 52/2014 thotë që kushtet e kapitalit bazë duhet të jenë të paguara në para, pra në mjete monetare ku AssBdhe S Bnuk e respektojnë këtë kriter ku kanë në mjete monetare vetëm 127,863 lekë dhe 1,189,424 lekë. Në kushte të tilla sektori i monitorimit pas mos përmbushjes së detyrimeve duhet të dërgonte një grup inspektimi edhe pse për AssBdhe S Bishte zhvilluar inspektimi përgjatë vitit 2019 pa identifikimin e këtyre problemeve.

Kriteri: Neni 211, iLigjit 52/2014 ñPër Veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò

Impakti: Monitorim jo i saktë i shoqërive të brokerimit

Shkaku:	Interpretimi jo i saktë Nenit 211, të Ligjit 52/2014 ñPër Veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	AMF të realizojë inspektim në shoqëritë e identifikuara me mungesë të kapitalit minimal në para, sipas raportimit të kryer në pasqyrat financiare nga ana e tyre dhe në rast të mos përmbushjes së kritereve ligjore të marrë vendim për pezullim deri në përmbushje të kritereve apo revokim të licencës.

IV.4.3Mbi inspektimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare të mbikëqyrura në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Mbështetur në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, AMF ka zhvilluar inspektime në shoqëritë e sigurimit. Referuar Udhëzimit ñPër procedurat e inspektimit në subjektet financiare jo Breò miratuar me vendimin e Bordit nr. 2, datë 21.11.2007, i ndryshuar, inspektimi në subjektet financiare jo-Bre ka si qëllim zbulimin dhe parandalimin e shkeljeve ligjore, parregullsive, gabimeve dhe marrjen e masave në kohë të përshtatshme për korrigjimin e tyre. Ky qëllim realizohet nëpërmjet:
-Vlerësimit të veprimtarisë së subjekteve financiare jo-Bre në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
-Vlerësimit të politikave të ndjekur nga subjektet financiare jo-Bre mbi trajtimin ligjor dhe të ndershëm të të siguruarve;
-Diskutimit të strategjisë së biznesit të këtyre subjekteve;
-Vlerësimit të sistemit të menaxhimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm;
-Vlerësimit të gjendjes financiare të subjektit;
-Identifikimit të transaksioneve të reja ose të pazakonta;
-Diskutimit të çështjeve apo problemeve specifike.
Inspektimi, pavarësisht nga objekti i tij kalon në fazat: Përcaktimi i qëllimit dhe formës së inspektimit; Grumbullimi dhe shqyrtimi i të dhënave; Hartimi i programit të inspektimit; Emërimi i personelit inspektues; Prezantimi i programit të inspektimit me drejtuesit e subjektit; Kryerja e inspektimit; Hartimi i projekt raportit të inspektimi; Dërgimi i projekt raportit tek subjekti i inspektuar dhe marrja e opinionit; Përgatitja e raportit përfundimtar.
Grupi i auditimit është mbështetur mbi raportet përfundimtare të auditimeve të zhvilluara nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve si dhe masat e marra në lidhje me shkeljet e konstatuara.
Për periudhën objekt auditimi, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve ka zhvilluar inspektime mbi shoqëritë e sigurimit, të cilat paraqiten të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

Inspektimet e zhvilluara nga DMTS për periudhën 2019-2020

Viti	Inspektime të plota	Inspektime tematike	Inspektime të përbashkëta
2019	2	14	4
2020	2	5	

Burimi: AMF, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga inspektimet e mësipërme, grupi i auditimit vlerësoi të verifikonte inspektimet e plota të zhvilluara nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve. Për vitin 2019 janë zhvilluar inspektime të plota në shoqëritë ñA N Sò Sh.A dhe ñS SIò Sh.A, ndërsa për vitin 2020 janë zhvilluar inspektime të plota në shoqëritë e sigurimit ñA Sò Sh.A dhe ñEò Sh.A. Nga këto, inspektimi i ñEò Sh.A është ende në proces. Në mënyrë të hollësishme konstatohet se:

A. Gjatë vitit 2019, DMTS ka zhvilluar inspektim të përgjithshëm në shoqërinë e sigurimit ñA N Sò Sh.A.
Raporti përmbledhës për këtë inspektim është hartuar nga grupi i inspektimit i përbërë nga MV, përgjegjëse, SZ, LK, EH, RK, JM dhe EH. Program i inspektimit është dërguar me shkresën nr. 3022 prot, datë 24.09.2019.
Relacioni përmbledhës është paraqitur në Bordin e AMF në datën 23.07.2020 nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve.
Me vendimin nr. 95, datë 29.07.2020 të Bordit të AMF, është miratuar marrja e masave të mbikëqyrjes ndaj shoqërisë së sigurimit ñA N Sò Sh.A.
Nga verifikimi i vendimit të marrë nga Bordi mbi raportin e hartuar nga grupi i inspektimit, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò. Saktësisht, në 4 (katër) raste janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë ndaj kompanisë së sigurimit si dhe personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. Në mënyrë të hollësishme:
1. Gjetja nr. 14 e raportit: ñ*Shoqëria A N S Sh.A ka siguruar përgjegjësi të tejkalimit të mbulimit të saj maksimal, në shkelje të nenit 116 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit". Ky fenomen u konstatua në 12 kontrata të portofolit të Sigurimit të Kontratës*ò.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/h ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: h) ka ri siguruar në kundërshtim me nenin 116 të këtij ligji*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.
2. Gjetja nr. 32 e raportit: ñ*Nga 10 kontrata bashkëpunimi të kontrolluara, 8 (tetë) prej tyre rreziku i siguruar në kontratën e sigurimit nga shoqëria A N S Sh.A, apo nga një bashkim i përkohshëm i disa shoqërive sigurimi është ndarë më tej me një shoqëri tjetër, apo me gjithë shoqëritë e sigurimit në treg, me anë të një kontratë bashkëpunimi midis tyre, në mungesë të plotë transparence ndaj të siguruarit. Gjithashtu, në kundërshtim me ligjin 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit" rreziku i siguruar nga këto kontrata sigurimi është ceduar më tej në një ose disa kompani të tjera sigurimi, duke shmangur kalimin e rrezikut në ri sigurimit*ò.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/m ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: m) shkel dispozitat e parashikuara në pikën 3, të nenit 119, të këtij ligji*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.
3. Gjetja nr. 37 e raportit: ñ*Nga verifikimi rezultoi se shoqëria kryen aktivitet me BT, të cilat nuk janë të licencuara nga Autoriteti për të kryer aktivitet ndërmjetësmi në sigurime. Konkretisht shoqëria bashkëpunon me T B, F Bank e I B, të cilat janë të pa licencuara për të ushtruar veprimtarinë e ndërmjetësmit në sigurime.*
Kontratat e lidhura me Bt e pa licencuara janë të përcaktuara si kontrata bashkëpunimi, ku komisioni që ju jep shoqëria trajtohet komision për shërbimin e llogarisë e jo si komision

ndërmjetësmi. Gjithashtu shoqëria kryen aktivitet me agjenci udhëtimesh, të cilat nuk janë të licencuara nga Autoriteti për të kryer aktivitet ndërmjetësmi në sigurimi.
*Ky veprim është në shkelje të dispozitave të nenit 215, pika 1, të ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/o ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: o) lidh kontratë ndërmjetësmi në kundërshtim me pikën 1, të nenit 215, të këtij ligji*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.
4. Gjetja nr. 4/c e raportit: ñ*Shoqëria paraqet në llogarinë 46101 "Debitorë për qira ambiente" vlerën 3,023,875 lekë të cilat sipas shpjegimeve të shoqërisë, përfaqësojnë qira të njërit prej objekteve në pronësi të shoqërisë dhe ende të pashlyera, megjithëse ka kaluar më shumë se një vit. Edhe pse në vlerë jo material, shoqëria nuk ka kryer ndonjë zhvlerësim për këto llogari dhe për rrjedhojë ka rritur padrejtësisht rezultatin financiar*ò.
Gjetja nr. 4/d e raportit: ñ*Si rezultat i mos arkëtimit të padive të regresit për praktikat e Fondit të Kompensimit janë krijuar llogari të arkëtueshme më të vjetra se një vit dhe shoqëria nuk ka evidentuar ndonjë zhvlerësim si në 31.12.2018 ashtu edhe në 30.06.2019, edhe pse nuk ka asnjë arkëtim për këto vlera për një periudhë mbi një vit. Për rrjedhojë shoqëria nuk ka evidentuar në shpenzime vlerën 5,032,887 lekë duke rritur padrejtësisht fitimet si në vitin 2018 ashtu edhe në 6 mujorin e parë të vitit 2019*ò.
Gjetja nr. 6/b e raportit: ñ*Shoqëria nuk klasifikon saktë zërat në shpenzimet e marrjes në sigurim. Gjatë vitit 2018 dhe deri në 30.06.2019 shoqëria ka përfshirë në shpenzimet e marrjes në sigurim shpenzimet për paga të stafit drejtues së shoqërisë, me arsyetimin se puna e tyre është e përqendruar në aktivitetin e shitjeve. Gjithashtu shoqëria klasifikon të gjitha shpenzimet e reklamave si shpenzime të marrjes në sigurim pavarësisht se një pjesë e reklamave janë për shoqërinë në tërësi dhe jo vetëm për produkte të veçanta, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e rregullores nr. 34, datë 28.05.2015, "Për raportimin e detyruar dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe ri sigurimit". Në shpenzimet e marrjes në sigurim në 30.06.2019 janë përfshirë edhe shpenzime konsulenti faturuar nga subjekti Eduart 2010 sh.p.k. Kjo praktikë e shoqërisë bie në kundërshtim me parashikimet e rregullores së Autoritetit nr. 34, datë 28.05.2015, "Për raportimin e detyruar dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe ri sigurimit*ò.
Gjetja nr. 6/c e raportit: ñ*Shoqëria nuk llogarit saktë shpenzimet e shtyra të marrjes në shtyra të marrjes në sigurim (DAC). Në raportimin e periudhës 30.06.2019, sipas formatit të llogaritjes së shpenzimeve të shtyra të marrjes në sigurim të vënë në dispozicion nga shoqëria, nga përllogaritja e grupit të inspektimit rezulton një diferencë prej 57,000,000 lekë më tepër në totalin e shpenzimeve të marrjes në sigurim, duke sjellë për rrjedhojë rritje të shpenzimeve të shtyra të marrjes në sigurim (DAC) dhe rritje të aktivit në periudhën raportuese*ò.
Gjetja nr. 7 e raportit: ñ*Evidenca kontabël e shoqërisë nuk siguron informacione për llogaritjen e vJrsisë së llogarive të pagueshme T (kreditore) dhe afateve të maturimit të tyre. Për rrjedhojë shoqëria nuk llogarit saktë raportet ditore për normën e likuiditetit. Raportimet e shoqërisë për këtë tregues janë të pasakta dhe nuk pasqyrojnë saktësisht normën e likuiditetit të shoqërisë*ò.
Konstatimet e mësipërme përbëjnë kundërshtim të neneve 109 dhe 110 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014. Neni 109 ñMbajtja e kontabilitetit dhe e dokumentacionitò: ñ*Shoqëria e sigurimit mban në mënyrë të vazhdueshme kontabilitetin, përgatit regjistrimet kontabël, vlerëson aktivet dhe detyrimet, përgatit pasqyrat financiare, mban dokumentacionin e veprimtarisë së sigurimit, si dhe të dhënat e tjera mbi administrimin ose veprimtarinë T në një zyrë brenda territorit të*

*Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të mundësojë në çdo kohë kontrollin për kryerjen e veprimtarisë së sigurimit, në përputhje me rregullat e administrimit të rrezikut, legjislacionin në fuqi për metodologjitë e mbikëqyrjes dhe sipas rregullave të hartuara nga Autoriteti e standardeve profesionale*ò.
Neni 110 ñPërgjegjësia e shoqërisë së sigurimitò: ñ*Shoqëria e sigurimit duhet të garantojë që informacioni, dokumentacioni dhe të dhënat e parashikuara në nenin 109, të këtij ligji, të jenë të sakta dhe të pasqyrojnë gjendjen e vërtetë financiare të shoqërisë*ò.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/k ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: k) nuk mban librat e kontabilitetit, nuk vlerëson zërat e kontabilitetit dhe nuk harton pasqyrat financiare dhe dokumentet kontabël, në përputhje me përcaktimet e neneve 109 e 110 të këtij ligji*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.

Sa më sipër, konstatohet se grupi i inspektimit nuk ka propozuar sanksione. Gjithashtu Bordi i AMF, nuk ka marrë vendim për sanksionimin me masë gjobe për 4 rastet e evidentuara në masën totale 8,000,000 lekë deri 12,000,000 lekë, ndaj shoqërisë së inspektuar, në kundërshtim me nenin nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014.
Gjithashtu, për rastet e përmendura më sipër, nuk ka sanksionuar personin përgjegjës të shoqërisë së sigurimit në masën totale 1,200,000 lekë deri 1,600,000 lekë, në kundërshtim me nenin nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2.

B. Gjatë vitit 2019, DMTS ka zhvilluar inspektim të përgjithshëm në shoqërinë e sigurimit ñS SIò Sh.A.
Raporti përmbledhës për këtë inspektim është hartuar nga grupi i inspektimit i përbërë nga E K, përgjegjëse, AM, RC, SZ, EP, JM dhe AB. Program i inspektimit është dërguar me shkresën nr. 2025 prot, datë 19.06.2019.
Relacioni përmbledhës është paraqitur në Bordin e AMF në datën 07.01.2020 nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve.
Me vendimin nr. 17, datë 22.01.2020 të Bordit të AMF, është miratuar marrja e masave të mbikëqyrjes ndaj shoqërisë së sigurimit ñS SIò Sh.A.
Nga verifikimi i vendimit të marrë nga Bordi mbi raportin e hartuar nga grupi i inspektimit, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò. Saktësisht, në 2 (dy) raste janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë kundrejt kompanisë së sigurimit si dhe personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. Në mënyrë të hollësishme:
1. Gjetja nr. 2 e raportit: ñ*Nga verifikimi rezultoi se shoqëria kryen aktivitet me BT, të cilat nuk janë të licencuara nga Autoriteti për të kryer aktivitet ndërmjetësmi në sigurime. Siç dhe është deklaruar nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve, në mbledhjen e Këshillit mbikëqyrës, të datës 21.12.2018, shoqëria bashkëpunon me 6 BT (BKT, C, T B, UB, A Be ICB), nga to 3 B (T B, UB e ICB) janë të pa licencuara për të ushtruar veprimtarinë e ndërmjetësmit në sigurime.*
Kontratat e lidhura me B e pa licencuara janë të përcaktuara si kontrata bashkëpunimi, ku komisioni që ju jep shoqëria trajtohet komision për shërbimin e llogarisë e jo si komision ndërmjetësmi.

Gjithashtu shoqëria kryen aktivitet me agjenci udhëtimesh, të cilat nuk janë të licencuara nga Autoriteti për të kryer aktivitet ndërmjetësmi në sigurimi. Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se vetëm për 6 mujorin e parë të vitit 2019, është kryer aktivitet me 23 agjenci të pa licencuara nga AMF.
*Ky veprim është në shkelje të dispozitave të nenit 215, pika 1, të ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/o ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: o) lidh kontratë ndërmjetësmi në kundërshtim me pikën 1, të nenit 215, të këtij ligji*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit duhet të ishte sanksionuar me gjobë.
Në zbatim të nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, Bordi i AMF ka sanksionuar me gjobë personin përgjegjës të shoqërisë së sigurimit në masën 300,000 lekë.
2. Gjetja nr. 6 e raportit: ñ*Kontratat e sigurimit "C.A.R." nr. 240 dhe "All risk" nr. 868, të cilat janë bashkë sigurime me shoqërinë e sigurimit I, janë lidhur me të siguruarit vetëm nga shoqëria I. Pas nënshkrimit të kontratave me të siguruarin, shoqëria I ka ndarë rrezikun me anë të një kontrate me shoqërinë Sivig, përkatësisht në datat 01.03.2019 dhe 20.03.2019, pa u vënë në dijeni i siguruari. Këto kontrata bashkëpunimi (partneriteti), ndërmjet dy shoqërive, janë në kundërshtim me nenin 119 të ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit"*.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/m ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: m) shkel dispozitat e parashikuara në pikën 3, të nenit 119, të këtij ligji*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit duhet të ishte sanksionuar me gjobë.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit duhet të ishte sanksionuar me gjobë.

Sa më sipër, konstatohet se grupi i inspektimit nuk ka propozuar sanksione. Gjithashtu Bordi i AMF, nuk ka marrë vendim për sanksionimin me masë gjobe për 2 rastet e evidentuara në masën totale 4,000,000 lekë deri 6,000,000 lekë, ndaj shoqërisë së inspektuar, në kundërshtim me nenin nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014.
Gjithashtu, për rastet e përmendura më sipër, nuk ka sanksionuar personin përgjegjës të shoqërisë së sigurimit në një rast në masën totale 300,000 lekë deri 400,000 lekë, në kundërshtim me nenin nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2.

C. Gjatë vitit 2020, DMTS ka zhvilluar inspektim të përgjithshëm në shoqërinë e sigurimit ñA Sò Sh.A. Pjesë e grupit të inspektimit janë punonjës nga DMTS, DAR, SMN dhe DTI.
Raporti përmbledhës për këtë inspektim është hartuar nga grupi i inspektimit i përbërë nga Marsela Vaska, përgjegjëse, Paqësor Pepi, Eris Poshi, Daver Berberi, Aranit Muja, Indrit kaba, Jollanda Memaj dhe Arlinda Bejko. Program i inspektimit është dërguar me shkresën nr. 3856 prot, datë 20.12.2019.
Relacioni përmbledhës është paraqitur në Bordin e AMF në datën 12.10.2020 nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve.

Për këtë inspektim është diskutuar në mbledhjen nr. 12/2020 të Bordit të AMF, por nuk rezulton të J marrë asnjë vendim mbi gjetjet e grupit të inspektimit.
Nga verifikimi i gjetje-rekomandimeve në raportin e hartuar nga grupi i inspektimit, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò. Saktësisht, në 3 (tre) raste janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 dhe 247 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë ndaj kompanisë së sigurimit si dhe personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. Në mënyrë të hollësishme:
1. Gjetja nr. 6, seksioni D/I i raportit: ñ*Shoqëria A S Sh.a ka vepruar në kundërshtim me nenin 204, pika 5 të ligjit nr. 52/2014, pasi ka në fuqi marrëveshje ndërmjetësmi me Bt e nivelit të dytë të cilat nuk janë të licencuara, T B, UB, për produkte të ndryshme sigurimi. Edhe në rastin e marrëveshjes me ISPBe cila është licencuar si agjent në emër dhe për llogari të shoqërisë I Vig Sh., shoqëria ka vepruar në kundërshtim me nenin 204, pika 5 të ligjit nr. 52/2014*ò.
(Shënim i grupit të auditimit: Shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit përkon me shkelje të nenit 215 të ligjit 52/2015, dhe jo me nenin 204).
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/o ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: o) lidh kontratë ndërmjetësmi në kundërshtim me pikën 1, të nenit 215, të këtij ligji*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit duhet të ishte sanksionuar me gjobë.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit duhet të ishte sanksionuar me gjobë.
2. Gjetja nr. 4, seksioni D/III i raportit: ñ*Shoqëria ka dhënë hua pa interes për palët e lidhura veprim i cili përfaqëson një transaksion jo në përputhje me kushtet e tregut (interesat e kredive që ofrojnë institucionet e kreditit nuk kanë qenë zero), si dhe është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 23, pika 4 e ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò *sipas të cilit "Marrëdhëniet dhe transaksionet e biznesit me palë të lidhura dhe të tretë, në të cilat anëtari i këshillit të administrimit/mbikëqyrjes ka interes, kryhen në përputhje me kushtet normale të tregut, ku nuk ka asnjë favorizim të padrejtë të fituar nga njëra palë në përfitim të palës tjetër*òò.
Referuar nenit nr. 247 ñSanksioni me gjobë ndaj anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrësò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, ku citohet: ñ*Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë ndaj anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës nëse ai: a) vepron në kundërshtim me përcaktimet e neneve 22 dhe 23 të këtij ligji*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit duhet të ishte sanksionuar me gjobë.
3. Gjetja nr. 2, seksioni D/V i raportit: ñ*a) Shoqëria nuk klasifikon saktë llogaritë e arkëtuese nga veprimtaria e sigurimit sipas vJrsisë. Sipas raportimit të shoqërisë për 30.09.2019 vlera e llogarive të arkëtuese me vJsi deri 90 ditë rezulton 150,211,517 lekë ndërsa sipas klasifikimit të grupit të inspektimit rezulton 127,973,039 lekë, ose 22,238,478 lekë më pak. Për rrjedhojë është rritur padrejtësisht aftësia e pagesës për vlerën 22,238,478 lekë.*
b) Bazuar në regjistrin e kredive të B së Shqipërisë të datës 03.02.2020 rezulton që shoqëria ka vënë peng mjetet e saj monetare për kredi marrës si person i lidhur për kredi me BKT me vlerë të mbetur 2,984,147, dhe garanci me OTP B me vlerë të mbetur 10,000,000 lekë. Në pasqyrat financiare të 30.09.2019 shoqëria nuk i ka raportuar vlerat e mësipërme si elemente të zbritshëm në llogaritjen e kapitalit, veprim i cili është në kundërshtim me përcaktimet sipas nenit 4, pika 1, germa j e rregullores së Autoritetit nr. 87, datë 27.06.2016 "Mbi elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit të shoqërive të sigurimit". Për rrjedhojë kapitali i shoqërisë në 30.09.2019 është rritur padrejtësisht për 12,984,147 lekë.

c) Bazuar në kontratën noteriale nr. 3124 Rep., datë 01.11.2018, shoqëria ka realizuar shkëmbimin e ndërtesës së saj me nr. Pasurie 46/146, zonë kadastrale Nr. 2735, vol. 11, Faqe 46 me pasuritë në pronësi të z. Sh Kme nr. 6/470-N3; 6/470-N9; 6/470-10; 6/596/ND; 6/595/ND dhe 6/594/ND. Edhe pse kontrata e shkëmbimit është e datës 01.11.2019, si dhe certifikatat e pronësisë për shoqërinë A S për pronat me nr. 6/470-N3 dhe 6/470-N10 janë të datës 28.12.2018 (për 3 pronat e tjera shoqëria nuk ka depozituar certifikatë apo kartelat e pronësisë), shoqëria nuk ka evidentuar në kontabilitet si dhe nuk ka raportuar në pasqyrat financiare të vitit 2018, si dhe në pasqyrat financiare të 31.03.2019, 30.06.2019 dhe 30.09.2019 gjendjen e ndërtesave sipas kontratës së shkëmbimit. Shoqëria i ka evidentuar ato në 3 mujorin e katërt të vitit 2019.

*Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet sipas paragrafit 22 "Baza e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara" të framework (kuadri) të SNK, sipas të cilit "...pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj baze, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen kur ato ndodhin (dhe jo kur mjetet monetare ose ekuivalentët e tyre janë arkëtuar ose paguar) dhe ato regjistrohen në regjistrat kontabël dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhave me të cilat ato lidhen...*ò.

Konstatimet e mësipërme përbëjnë janë në kundërshtim me nenin 109 dhe 110 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014

Neni 109 ñMbajtja e kontabilitetit dhe e dokumentacionitò: ñ*Shoqëria e sigurimit mban në mënyrë të vazhdueshme kontabilitetin, përgatit regjistrimet kontabël, vlerëson aktivet dhe detyrimet, përgatit pasqyrat financiare, mban dokumentacionin e veprimtarisë së sigurimit, si dhe të dhënat e tjera mbi administrimin ose veprimtarinë T në një zyrë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të mundësojë në çdo kohë kontrollin për kryerjen e veprimtarisë së sigurimit, në përputhje me rregullat e administrimit të rrezikut, legjislacionin në fuqi për metodologjitë e mbikëqyrjes dhe sipas rregullave të hartuara nga Autoriteti e standardeve profesionale*ò.

Neni 110 ñPërgjegjësia e shoqërisë së sigurimitò: ñ*Shoqëria e sigurimit duhet të garantojë që informacioni, dokumentacioni dhe të dhënat e parashikuara në nenin 109, të këtij ligji, të jenë të sakta dhe të pasqyrojnë gjendjen e vërtetë financiare të shoqërisë*ò.

Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/k ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: k) nuk mban librat e kontabilitetit, nuk vlerëson zërat e kontabilitetit dhe nuk harton pasqyrat financiare dhe dokumentet kontabël, në përputhje me përcaktimet e neneve 109 e 110 të këtij ligji*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit duhet të ishte sanksionuar me gjobë.

Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit duhet të ishte sanksionuar me gjobë.

Sa më sipër, konstatohet se grupi i inspektimit nuk ka propozuar sanksione. Gjithashtu Bordi i AMF, nuk ka marrë vendim për sanksionimin me masë gjobe për 2 rastet e evidentuara në masën totale 4,000,000 lekë deri 6,000,000 lekë, ndaj shoqërisë së inspektuar, në kundërshtim me nenin nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014.

Gjithashtu, për rastet e përmendura më sipër, nuk ka sanksionuar personin përgjegjës të shoqërisë së sigurimit në 2 raste në masën totale 600,000 lekë deri 800,000 lekë, në kundërshtim me nenin nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2.

Si dhe nuk ka sanksionuar me gjobë anëtarin e këshillit të administrimit/mbikëqyrës në 1 rast në masën 300,000 lekë deri në 500,000 lekë, në kundërshtim me nenin nr. 247 ñSanksioni me gjobë ndaj anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrësò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014.

Inspektimet e zhvilluara nga Drejtoria e Administrimit të Riskut

Mbështetur në ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar dhe udhëzimit ñPër procedurat e inspektimit në subjektet financiare jo Bò miratuar me vendimin e Bordit nr. 2, datë 21.11.2007, i ndryshuar, për periudhën objekt auditimi Drejtoria e Administrimit të Riskut ka zhvilluar inspektime tematike në shoqëritë e sigurimit, të cilat paraqiten të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

Inspektimet e zhvilluara nga DAR për vitin 2019

Viti	Mbi aktivitetin e ri sigurimit	Për produktin sigurim garancie	Mbi verifikimin e një police ñGaranci Kontrate"
2019	11	8	2

Burimi: AMF, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga inspektimet e mësipërme, grupi i auditimit vlerësoi të verifikonte inspektimet mbi aktivitetin e ri sigurimit të zhvilluara nga Drejtoria e Administrimit të Riskut. Nga 8 inspektime të zhvilluara mbi aktivitetin e ri sigurimit në shoqëritë e jo Jetës, në 6 raste janë konstatuar problematika, ndërsa 2 prej tyre kanë përfunduar pa gjetje. Në mënyrë të hollësishme kemi:

A. Gjatë vitit 2019, DAR ka zhvilluar inspektim tematik në shoqërinë e sigurimit ñA Sò Sh.A, me objekt ñAktiviteti i ri sigurimitò.

Raporti përmbledhës për këtë inspektim është hartuar nga grupi i inspektimit i përbërë nga AM, DV dhe EH. Program i inspektimit është dërguar me shkresën nr. 741 prot, datë 26.02.2019. Afati i inspektimit 04.03.2019 ï 06.03.2019.

Gjetjet dhe rekomandimet përfundimtare janë dërguar me shkresën 741/3 prot, datë 15.07.2019.

Nga verifikimi i gjetje-rekomandimeve të konstatuar nga grupi i inspektimit, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò. Saktësisht, në 1 (një) rast janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë ndaj kompanisë së sigurimit si dhe personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. Në mënyrë të hollësishme:

Gjetja nr. 2: ñ*Referuar kontratave fakultative të Ri sigurimit, ku të siguruar janë: ALBCONTROL sh.a.; KESH sh.a.; Komanda e Forcave Ajrore dhe Komanda e Forcave Detare, konstatohet se shoqëria e sigurimit A N S sh.a ka ceduar në Ri sigurim në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2, germa b) të Rregullores Nr. 85/1, datë 30.09.2015 "Për kriteret e Ri sigurimit", e ndryshuar*ò.

Rregullorja Nr. 85/1, datë 30.09.2015 është hartuar në mbështetje të nenit 116, pika 3, nenit 117, pika 7, 118, pika 2 dhe 119, pika 4, të Ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò.

Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/h ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: h) ka ri siguruar në kundërshtim me nenin 116 të këtij ligji; i) shkel dispozitat e përcaktuara në pikat 1 dhe 5, të nenit 117, të këtij ligji;m) shkel dispozitat e parashikuara në pikën 3, të nenit 119, të këtij ligji;*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.

Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.

B. Gjatë vitit 2019, DAR ka zhvilluar inspektim tematik në shoqërinë e sigurimit ñAò Sh.A, me objekt ñAktiviteti i ri sigurimitò.
Raporti përmbledhës për këtë inspektim është hartuar nga grupi i inspektimit i përbërë nga AM, DV dhe EH.. Program i inspektimit është dërguar me shkresën nr. 742 prot, datë 26.02.2019. Afati i inspektimit 06.03.2019 ï 08.03.2019.
Gjetjet dhe rekomandimet përfundimtare janë dërguar me shkresën 742/3 prot, datë 15.07.2019.
Nga verifikimi i gjetje-rekomandimeve të konstatuar nga grupi i inspektimit, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò. Saktësisht, në 1 (një) rast janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë ndaj kompanisë së sigurimit si dhe personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. Në mënyrë të hollësishme:
Gjetja nr. 1: ñ*Referuar kontratave fakultative të ri sigurimit, ku të siguruar janë: Albcontrol Sh.a; Kesh Sh.a; Komanda e Forcave Ajrore dhe Komanda e Forcave Detare, konstatohet që shoqëria e sigurimit Antlantik Sh.A ka ceduar në ri sigurim në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2, germa b) të Rregullores Nr. 85/1, datë 30.09.2015 "Për kriteret e Ri sigurimit", e ndryshuar.*ò
Rregullorja Nr. 85/1, datë 30.09.2015 është hartuar në mbështetje të nenit 116, pika 3, nenit 117, pika 7, 118, pika 2 dhe 119, pika 4, të Ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/h ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: h) ka ri siguruar në kundërshtim me nenin 116 të këtij ligji; i) shkel dispozitat e përcaktuara në pikat 1 dhe 5, të nenit 117, të këtij ligji;m) shkel dispozitat e parashikuara në pikën 3, të nenit 119, të këtij ligji;*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.

C. Gjatë vitit 2019, DAR ka zhvilluar inspektim tematik në shoqërinë e sigurimit ñEò Sh.A, me objekt ñAktiviteti i ri sigurimitò.
Raporti përmbledhës për këtë inspektim është hartuar nga grupi i inspektimit i përbërë nga AM, DV dhe EH.. Program i inspektimit është dërguar me shkresën nr. 955 prot, datë 18.03.2019. Afati i inspektimit 25.03.2019 ï 28.03.2019.
Gjetjet dhe rekomandimet përfundimtare janë dërguar me shkresën 955/3 prot, datë 15.07.2019.
Nga verifikimi i gjetje-rekomandimeve të konstatuar nga grupi i inspektimit, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò. Saktësisht, në 1 (një) rast janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë ndaj kompanisë së sigurimit si dhe personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. Në mënyrë të hollësishme:
Gjetja nr. 2: ñ*Referuar kontratave fakultative të Ri sigurimit, ku të siguruar janë: ALBCONTROL sh.a.; KESH sh.a.; Komanda e Forcave Ajrore dhe Komanda e Forcave Detare, konstatohet se shoqëria e sigurimit E sh.a ka ceduar në Ri sigurim në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2, germa b) të Rregullores Nr. 85/1, datë 30.09.2015 "Për kriteret e Ri sigurimit", e ndryshuar.*ò
Rregullorja Nr. 85/1, datë 30.09.2015 është hartuar në mbështetje të nenit 116, pika 3, nenit 117, pika 7, 118, pika 2 dhe 119, pika 4, të Ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò.

Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/h ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: h) ka ri siguruar në kundërshtim me nenin 116 të këtij ligji; i) shkel dispozitat e përcaktuara në pikat 1 dhe 5, të nenit 117, të këtij ligji;m) shkel dispozitat e parashikuara në pikën 3, të nenit 119, të këtij ligji;*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.

D. Gjatë vitit 2019, DAR ka zhvilluar inspektim tematik në shoqërinë e sigurimit ñIò Sh.A, me objekt ñAktiviteti i ri sigurimitò.
Raporti përmbledhës për këtë inspektim është hartuar nga grupi i inspektimit i përbërë nga AM, DV dhe EH.. Program i inspektimit është dërguar me shkresën nr. 956 prot, datë 18.03.2019. Afati i inspektimit 28.03.2019 ï 02.04.2019.
Gjetjet dhe rekomandimet përfundimtare janë dërguar me shkresën 956/3 prot, datë 15.07.2019.
Nga verifikimi i gjetje-rekomandimeve të konstatuar nga grupi i inspektimit, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò. Saktësisht, në 1 (një) rast janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë ndaj kompanisë së sigurimit si dhe personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. Në mënyrë të hollësishme:
Gjetja nr. 2: ñ*Referuar kontratave fakultative të Ri sigurimit, ku të siguruar janë: ALBCONTROL sh.a.; KESH sh.a.; Komanda e Forcave Ajrore dhe Komanda e Forcave Detare, konstatohet se shoqëria e sigurimit I sh.a ka ceduar në Ri sigurim në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2, germa b) të Rregullores Nr. 85/1, datë 30.09.2015 "Për kriteret e Ri sigurimit", e ndryshuar.*ò
Rregullorja Nr. 85/1, datë 30.09.2015 është hartuar në mbështetje të nenit 116, pika 3, nenit 117, pika 7, 118, pika 2 dhe 119, pika 4, të Ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/h ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: h) ka ri siguruar në kundërshtim me nenin 116 të këtij ligji; i) shkel dispozitat e përcaktuara në pikat 1 dhe 5, të nenit 117, të këtij ligji;m) shkel dispozitat e parashikuara në pikën 3, të nenit 119, të këtij ligji;*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.

E. Gjatë vitit 2019, DAR ka zhvilluar inspektim tematik në shoqërinë e sigurimit ñA Sò Sh.A, me objekt ñAktiviteti i ri sigurimitò.
Raporti përmbledhës për këtë inspektim është hartuar nga grupi i inspektimit i përbërë nga AM, DV dhe EH.. Programi i inspektimit është dërguar me shkresën nr. 1271 prot, datë 15.04.2019. Afati i inspektimit 23.04.2019 ï 26.04.2019.
Gjetjet dhe rekomandimet përfundimtare janë dërguar me shkresën 1582/3 prot, datë 15.07.2019.
Nga verifikimi i gjetje-rekomandimeve të konstatuar nga grupi i inspektimit, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë

e sigurimit dhe ri sigurimitò. Saktësisht, në 1 (një) rast janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë ndaj kompanisë së sigurimit si dhe personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. Në mënyrë të hollësishme:
Gjetja nr. 1: ñ*Referuar kontratave fakultative të ri sigurimit, ku të siguruar janë Komanda e Forcave Ajrore dhe Komanda e Forcave Detare, konstatohet që shoqëria e sigurimit A S sh.a. ka ceduar në ri sigurim në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2, germa b) të Rregullores Nr. 85/1, datë 30.09.2015 "Për kriteret e ri sigurimit", e ndryshuar.*ò
Rregullorja Nr. 85/1, datë 30.09.2015 është hartuar në mbështetje të nenit 116, pika 3, nenit 117, pika 7, 118, pika 2 dhe 119, pika 4, të Ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/h ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: h) ka ri siguruar në kundërshtim me nenin 116 të këtij ligji; i) shkel dispozitat e përcaktuara në pikat 1 dhe 5, të nenit 117, të këtij ligji;m) shkel dispozitat e parashikuara në pikën 3, të nenit 119, të këtij ligji;*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni*ò, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.

F. Gjatë vitit 2019, DAR ka zhvilluar inspektim tematik në shoqërinë e sigurimit ñSUGAò Sh.A, me objekt ñAktiviteti i ri sigurimitò.
Raporti përmbledhës për këtë inspektim është hartuar nga grupi i inspektimit i përbërë nga AM, DV dhe RC. Program i inspektimit është dërguar me shkresën nr. 1582/3 prot, datë 13.05.2019. Afati i inspektimit 20.05.2019 ï 22.05.2019.
Gjetjet dhe rekomandimet përfundimtare janë dërguar me shkresën 1582/3 prot, datë 15.07.2019.
Nga verifikimi i gjetje-rekomandimeve të konstatuar nga grupi i inspektimit, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò. Saktësisht, në 1 (një) rast janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë ndaj kompanisë së sigurimit si dhe personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. Në mënyrë të hollësishme:
Gjetja nr. 2: ñ*Shoqëria e sigurimit S UGA sh.a në bazë të licencës nr. 1/2006, datë 22.06.2006 ka të drejtën për të ushtruar aktivitetin e ri sigurimit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Bazuar në të dhënat e raportuara në AMF, konkretisht në lidhje me risqet e ri siguruara si më poshtë:... Konstatohet se shoqëria e sigurimit S UGA sh.a ushtron aktivitetin e Ri sigurimit në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2, germa b) të Rregullores Nr. 85/1, datë 30.09.2015 "Për kriteret e Ri sigurimit", e ndryshuar.*ò
Rregullorja Nr. 85/1, datë 30.09.2015 është hartuar në mbështetje të nenit 116, pika 3, nenit 117, pika 7, 118, pika 2 dhe 119, pika 4, të Ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò.
Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 1/h ku citohet: ñ*1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2,000,000 deri në 3,000,000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo: h) ka ri siguruar në kundërshtim me nenin 116 të këtij ligji; i) shkel dispozitat e përcaktuara në pikat 1 dhe 5, të nenit 117, të këtij ligji;m) shkel dispozitat e parashikuara në pikën 3, të nenit 119, të këtij ligji;*ò, shkelja e konstatuar nga grupi i inspektimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.

Referuar nenit nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2, ku citohet: ñ*Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300,000 deri në 400,000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neniò*, personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit **duhet të ishte sanksionuar me gjobë**.

Sa më sipër, konstatohet se grupi i inspektimit nuk ka propozuar sanksione për këto inspektime, duke mos u marrë vendim për sanksionimin me masë gjobe për 6 rastet e evidentuara (një rast për çdo shoqëri) në masën totale 12,000,000 lekë deri 18,000,000 lekë, ndaj shoqërisë së inspektuar, në kundërshtim me nenin nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014.
Gjithashtu, për rastet e përmendura më sipër, nuk është sanksionuar personin përgjegjës të shoqërisë së sigurimit në 6 rastet e evidentuara (një rast për çdo shoqëri) në masën totale 1,800,000 lekë deri 2,400,000 lekë, në kundërshtim me nenin nr. 246 ñSanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimitò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, pika 2.

Inspektimet2019-2020 të kryera nga sektori i ndërmJetësve në sigurime
Për periudhën objekt auditimi, sektori i ndërmJetësve në sigurime ka zhvilluar inspektime mbi shoqëritë e brokerimit dhe agjentët, të cilat paraqiten të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

Inspektimet e zhvilluara nga sektori i ndërmJetësve në sigurime për vitin 2019-2020

Viti	Shoqëri borkerimi	Agjentë
2019	2	2
2020		2

Burimi: AMF, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga inspektimet e bëra nga sektori i ndërmjetesve në sigurime, vetëm në një rast ka rezultuar me gjetje, për të cilën është marrë vendim nga Bordi i AMF për sanksionim ndaj agjentit, ndërsa inspektimet e tjera kanë rezultuar pa problematika referuar çështjeve të inspektuara.

Me shkresën me nr. 41/11 prot., datë 29.09.2021, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit, mbi auditimin e ushtruar në AMF.
Në lidhje me konstatimin e bërë nga grupi i auditimit se për shkeljet e konstatuara nga inspektimet e bëra në shoqëritë e sigurimit, nuk janë marrë masat me gjobë të përcaktuara në nenet 245 e në vijim, ndër të tjera, në observacion evidentohet se: "parimi kryesor i ligjit është mundësimi i rikuperimit të situatës financiare të shoqërive të sigurimit, dhe përshkallëzimi i masave mbikëqyrëse në rast të mosrespektimit të kërkesave të Autoritetit.
Kapitulli i masave mbikëqyrëse, është një kuadër efektiv masash të cilat orientohen nga natyra parandaluese dhe bën të mundur që AMF të ketë instrumente ndërhyrjeje bazuar në nivelin e rrezikut të shoqërisë së sigurimit. Masat administrative të parashikuar në kreun XIV, neni 245 e në vijim, konsiderohen si masa plotësuese, dhe në kuadrin e një mbikëqyrje efektive bazuar në metodologjinë me bazë rrezikun, këto sanksione vendosen, kur evidentohet kryerja e një kundërvajtjeje admirativë në frymën dhe në zbatim të përcaktimeve të ligjit.
Në respektim të përcaktimeve ligjore, Autoriteti gjykon dhe vlerëson efektshmërinë e përdorimit të masave administrative në formën e sanksioneve".
Qëndrimi i grupit i auditimit vlerëson parimin e përdorur nga AMF, por gjithsesi nenet 245 e në vijim të ligjit nr. 9752, datë 03.07.2006, nuk lënë hapësirë për interpretim. Sipas këtyre neneve, në rast shkeljeje të një dispozite, shoqëria, agjenti etj., duhet të sanksionohen me gjobë.
Së pari, jo të gjitha llojet e shkeljeve, janë sanksionuar me gjobë, pra vetë ligji i ka përshkallëzuar shkeljet. Në inspektime ka patur shumë shkelje, për të cilat janë dhënë masa organizative. Grupi i auditimit ka vënë theksin vetëm tek ato të cilat ligjërisht duhet të sanksionohen me gjobë.

Së dyti, për rastet e sanksionuara me gjobë, ligji ka lënë tolerancë në vendosjen e vlerës (2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë apo 300,000 lekë deri 400,000 lekë), pra Bordi mund të vendos minimumin ligjor me qëllim mos dëmtimin e shoqërive apo përfaqësuesve të tyre.
Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.
Për sa i përket komenteve të bëra rast pas rasti për inspektimet e cituara nga grupi i auditimit, sqarojmë se:
Grupi i auditimit ka vlerësuar mbi konstatimet e bëra nga grupi i inspektimit të AMF. Grupi i auditimit nuk mund t'i vlerësojë këto çështje me thellë nga sa është paraqitur në raportet e inspektimit (pasi do të duhej që të ribënte inspektimet, gjë që është e pamundur). Në të tilla kushte, citimet e grupeve të inspektimit të AMF mbi kundërshtimet ligjore të konstatuara në shoqëritë e sigurimit, janë në të njëjtën vijë mendimi me grupin e auditimit për sa i përket shkeljes. Por, këto shkelje duhet të ishin sanksionuar me gjobë sipas ligjit nr. 9752, datë 03.07.2006.
Dëshirojmë të theksojmë se grupi i auditimit ka evidentuar vetëm ato raste të cilat janë shkelje evidente të dispozitave ligjore, dhe nuk është ndalur tek ato raste të cilat janë të diskutueshme.
Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Gjetja Nuk është marrë masë për sanksionim me gjobë ndaj shkeljeve të konstatuara.

Situata:

- Nga verifikimi i vendimit nr. 95, datë 29.07.2020 të marrë nga Bordi i AMF mbi inspektimin e zhvilluar në shoqërinë e sigurimit ñA N Sò Sh.A, u konstatua se në 4 (katër) raste janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñ*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë nga 2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj kompanisë së sigurimit si dhe nga 300,000 lekë deri në 400,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit.
- Nga verifikimi i vendimit nr. 17, datë 22.01.2020 të marrë nga Bordi i AMF mbi inspektimin e zhvilluar në shoqërinë e sigurimit ñS S Interalbanianò Sh.A, u konstatua se në 2 (dy) raste janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñ*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë nga 2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj kompanisë së sigurimit si dhe nga 300,000 lekë deri në 400,000 lekë (në një nga rastet është sanksionuar, ndërsa në një rast jo) ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit.
- Nga verifikimi i diskutimeve të zhvilluara nga Bordi i AMF në mbledhjen nr. 12/2020 (nuk është marrë vendim mbi këtë çështje) mbi inspektimin e zhvilluar në shoqërinë e sigurimit ñA Sò Sh.A, u konstatua se, në 2 (dy) raste janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñ*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë nga 2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj kompanisë së sigurimit dhe nga 300,000 lekë deri në 400,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. Në 1 (një) rast është konstatuar shkelje e cila referuar nenit 247 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñ*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò, duhet të ishte sanksionuar me gjobë nga 300,000 lekë deri 500,000 lekë ndaj anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës.
- Nga verifikimi i 6 (gjashtë) inspektimeve tematike me objekt ñ*Aktiviteti*

*i ri sigurimit*ò të zhvilluara në shoqëritë e sigurimit ñA N Sò Sh.A, ñAò Sh.A, ñEò Sh.A, ñIò Sh.A, ñA Sò Sh.A dhe ñSUGAò, u konstatua se nuk është marrë vendim për sanksionimin me masë gjobë për shkeljet e evidentuara në masën totale 2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë për secilën nga shoqërisë e inspektuar, në kundërshtim me nenin 246 ñ*Sanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimit*ò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñ*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit".*

Gjithashtu, për rastet e përmendura më sipër, nuk është sanksionuar personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit në masën 300,000 lekë deri 400,000 lekë, në kundërshtim me nenin 246, pika 2, të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñ*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò.

Kriteri: Neni 246, ligji nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò.

Impakti: Nuk janë sanksionuar shkeljet sipas përcaktimeve ligjore.

Shkaku: Përpjekja për zgjidhje të problematikave pa shkaktuar penalitete.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bordi i AMF në vijimësi të marrë masa, në drejtim të sanksionimit me gjobë për shkeljet e përcaktuara si të tilla për të gjitha rastet e konstatuara, për një trajtim të barabartë për shkelje të njëjta, të të gjithë kompanive të sigurimit në zbatim të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò.

IV.5 Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i Byrosë Shqiptare të Sigurimit ñMbi administrimin e Fondit të Kompensimitò si më poshtë:

- *Përbërja e Byrosë*

Statuti i Byrosë, miratuar me vendim nr. 40, datë 19.06.2009 përcakton se anëtarë të byrosë janë detyrimisht siguruesit e licencuar me organe drejtuese : Asamblenë e Përgjithshme dhe Këshillin Administrativ. Drejtimi i Përgjithshëm kryhet nga Drejtori Ekzekutiv. Asambleja e Përgjithshme përbehet nga përfaqësuesit e çdo kompanie që licencohet në tregun e sigurimeve. Asambleja është organi më i lartë i Byrosë dhe ka të drejtën ekskluzive të marrjes së vendimeve për të gjitha çështjet. Këshilli Administrativ përbëhet nga jo më pak se 8 anëtarë nga të cilët 7 anëtarë me të drejtë vote, të zgjedhur nga vetë Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve dhe një anëtar pa të drejtë vote, i zgjedhur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Këshilli Administrativ, me shumicë të thjeshtë votash, zgjedh Kryetarin e tij. Asambleja e Përgjithshme emëron Drejtorin Ekzekutiv. Pra, vendimet lidhur me shlyerjen e dëmeve objekt të Fondit të Kompensimit, merren nga Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues i BSHS-së, <u>praktikisht vetë përfaqësuesit e kompanive të sigurimit dhe të zgjedhurit prej tyre.</u>

Në zbatim të paragrafit të parë, pika 2 e nenit 43, të Ligjit nr.10.076, datë 12.02.2009 ñpër sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportiò, i ndryshuar dhe nenit 10 të statutit të BSHS-së, me vendim nr. 115, datë 31.08.2020 të Bordit të AMF është miratuar riemërimi i znj. Anila Hoxha, si Drejtor Ekzekutiv i Byrosë Shqiptare të Sigurimeve për një periudhë 1 vjeçare. Nga auditimi konstatohet se <u>në kundërshtim me nenin 19 të statutit të BSHS-së, i cili përcakton se drejtori ekzekutiv zgjidhet për një periudhë kohore prej tre vitesh me të drejtë ri emërimi,</u> emërimet për këtë pozicion për periudhën 2018-2020 kanë qenë më afat 3 mujor, 6 mujor dhe 1 vjeçar. Kështu, znj. AH është emëruar në këtë pozicion me vendim nr.105, datë 18.07.2018 për një periudhë 6 mujore. Në përfundim të këtij afati, me vendim nr. 1, datë 18.01.2019 është riemëruar për një afat 1 vjeçar, dhe më pas me vendi m nr.18, datë 22.01.2020 është riemëruar me një periudhë 3 mujore deri në 22.04.2020.

Kuadri ligjor lidhur me Fondin e Kompensimit

Në bazë të ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 òPër sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportitò, neni 45, shoqëritë e sigurimit që operojnë në sigurimin e detyrueshëm motorik janë të detyruara të kontribuojnë çdo vit në fondin e kompensimit. Ky kontribut duhet të J në përpjesëtim të drejtë me primet bruto të shkruara në këto lloj sigurimesh për vitin paraardhës. Në zbatim të pikave 2 dhe 3 shkronja b të nenit 45, pas propozimit të byrosë (brenda datës 30 Nëntor) AMF miraton shumat e financimit të fondit të kompensimit të vitit pasardhës brenda datës 31 Dhjetor.

Megjithatë, pavarësisht se kjo rregullonte parashikonte zgjidhjen e problematikave të konstatuara për vite me radhë lidhur me likuidimin e dëmeve veçanërisht të shkaktuara përpara vitit 2013, si dhe atyre pas vitit 2014, me vendimin nr. 114, datë 31.08.2020 të Bordit të AMF, ñPër miratimin e zgjatjes së afatit dhe ndryshimeve në rregulloren nr. 119, datë 06.06.2019 ñMbi administrimin e fondit të kompensimitò, kompanive të sigurimit u është zgjatur edhe me **1 vit** afati për plotësimin e detyrimeve kundrejt këtij akti rregullator.

Gjithashtu, në këtë vendim të Bordit të AMF, me propozim të BSHS-së, janë miratuar disa ndryshime në rregulloren nr. 119. Një ndër to është edhe **heqja e nenit 10/4,** ku fillimisht ishte përcaktuar se ñ*Në qoftë se Byroja Shqiptare nuk bën shpërndarjen e praktikave të dëmeve të Fondit të Kompensimit tek shoqëritë e sigurimit anëtare të saj sipas vlerave respektive të detyrimit të tyre**, shpërndarja për pagesë tek shoqëritë e sigurimit, do të bëhet nga vetë AMF**. Byroja Shqiptare e Sigurimit brenda 7 ditëve nga data e marrjes dijeni nga Autoriteti të shpërndarjes së praktikës do të vijojë me dërgimin e autorizimit dhe kopjen e praktikës tek shoqëria e sigurimit e caktuar nga Autoriteti. Kjo procedurë do të ndiqet edhe në rastet kur shoqëritë kthejnë në Byro praktika të Fondit të Kompensimit për të cilat janë deleguar nga BSHS*.ò. Me këtë ndryshim, AMF i hiqet kompetenca për të ndërhyrë në rastet kur BSHS nuk ka përmbushur detyrimet e saj lidhur me shpërndarjen e praktikave të detyrueshme për ekzekutim.

Si rezultat, plotësimi i detyrimeve të dëmeve të lindura mbetet nën autoritetin e vetë BSHS-së, strukturë kjo e përbërë me anëtarë përfaqësues të kompanive të sigurimit përgjegjëse për krijimin e fondit të kompensimit dhe likuidimin e përfituesve.

Në një ndryshim të kryer në rregulloren nr. 119, me vendimin nr. 114, datë 31.08.2020 të Bordit të AMF, është miratuar se Byroja në fund të çdo periudhe financiare do të hartojë bilancin e Fondit të Kompensimit, ku në ndryshim të rasteve të përcaktuar në nenin 6 (dëme të shkaktuara nga mjete motorike të siguruara dhe/ose të paidentifikuara, trajtimi, pagesa dhe rimbursimi i të cilave administrohet nga BSHS), ku në bilanc do të ndahen pasqyra e kontributeve dhe pagesave; për rastin e nenit 4 (dëme të shkaktuara nga mjete motorike të pasiguruara të cilat trajtohen, paguhen dhe rimbursohen nga shoqëritë e sigurimit, anëtare të BSHS për llogari të Fondit të Kompensimit) në bilancin e Byro-së do të pasqyrohen **vetëm pagesat e fondit** dhe jo kontributet.

Raporti periodik i BSHS

Problematike shfaqet situata edhe lidhur me saktësinë e raportimit dhe ecurinë e pagesave të bëra nga shoqëritë e sigurimit. Në vijim të detyrimit të tyre për derdhjen në llogari të pjesës respektive të fondit, kompanitë e sigurimit nuk rezultojnë të bashkëlidhin në formatet respektive të raportimit edhe dokumentet Bre (bank statement) që justifikojnë ecurinë e këtij fondi në aspekt të kontributeve, dhe pagesave për të likuiduar detyrimet e të dëmtuarve.

Viti 2019

-Me shkresë nr. 1268, prot datë 20.02.2019 Byroja Shqiptare e sigurimeve ka raportuar lidhur me pagesat e kompensimit për periudhën janar-31 Janar 2019, në zbatim të Rregullores ñPër standardet e raportimit dhe mbikëqyrjes së BSHSò, miratuar me vendim të Bordit të AMF-së datë 28.01.2010, i ndryshuar.

-Me vendimin nr., 118, datë 06.06.2019 të Bordit të AMF, në vijim të inspektimit të kryer pranë BSHS-së për periudhën janar-mars 2019, është konstatuar se në raportimin periodik që

BSHS kryen në zbatim të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010 nuk është pasqyruar saktë detyrimi i Fondit të Kompensimit dhe pagesat e kryera nga shoqëritë. Për këtë arsye AMF ka vendosur: kryerjen deri në 17.06.2019 të shpërndarjes së praktikave të përfunduara detyrueshme për tu ekzekutuar; shpërndarjen e çdo praktike të përfunduar sipas afateve në pikën 4 dhe 6 të rregullores nr. 36, datë 21.03.2012 ñPër krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeveò; hartimin e formularëve të raportimit periodik; si dhe rishikimin e nevojës për shtesë të Fondit të Kompensimit.
-Me vendimin nr. 150, datë 24.07.2019 të Bordit të AMF ñPër marrjen e masave korrigjuese ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimitò, është konstatuar se raportimi periodik i periudhës janar-qershor 2019 i BSHS nuk paraqitet në përputhje me kërkesat e vendimit të sipërcituar të AMF, për sa i përket vlerës së detyrimit dhe pagesave lidhur me fondin e kompensimit. Në këtë vendim është përcaktuar se pagesa në total gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2019 janë në vlerë 323,204,438 lekë, ndërsa duke përfshirë edhe marrëveshjet niveli i pagesave është rreth 76% e detyrimit të 6 mujorit të parë të vitit 2019. Deri në këto momente, BSHS kishte shpërndarë vetëm 6 praktika. Si rezultat, AMF ka vendosur që shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS të plotësojnë detyrimin përkatës të Fondit të Kompensimit; Boroja të kryejë shpërndarjen e detyrueshme për tu ekzekutuar deri në 15.08.2019, në të kundër autoriteti të bëjë shpërndarjen e praktikave të përfunduara; BSHS të analizojë situatën e Fondi të Kompensimit nëse ka nevojë shtesë të fondit; Për moszbatim paralajmërohet për shkarkim drejtori ekzekutiv i BSSH..

Viti 2020

-Me shkresë nr. 208 prot datë 16.01.2020 Byroja Shqiptare e sigurimeve ka raportuar lidhur me pagesat e kompensimit për periudhën **janar-31 Dhjetor 2020**, në zbatim të Rregullores ñPër standardet e raportimit dhe mbikëqyrjes së BSHSò, miratuar me vendim të Bordit të AMF-së datë 28.01.2010, i ndryshuar.
-Me shkresë nr. 4011, prot datë 13.10.2020 Byroja Shqiptare e sigurimeve ka raportuar lidhur me pagesat e kompensimit për periudhën **Janar-30 Shtator 2020**, në zbatim të Rregullores ñPër standardet e raportimit dhe mbikëqyrjes së BSHSò, miratuar me vendim të Bordit të AMF-së datë 28.01.2010, i ndryshuar.

Pagesat dhe detyrimet lidhur me Fondin e Kompensimit

Në mijë lekë

Viti	Vendim	Propozimi BSHS	Propozimi AMF			
			Dëme deri 31.12.2013	Dëme pas 2014	Dëme gjatë vitit pasardhës	Total
2018	Vendimi nr. 217, datë 28.12.2017	650,000	433,123	312,079	150,000	**895,203**
	Vendim nr. 155, datë 30.07.2018			+181,912		
	Vendim nr. 219, datë 31.10.2018				+274,421	
	TOTALI 2018	650,000	433,123	493,991	424,421	**1,351,535**
2019	Vendimi nr. 260, datë 28.12.2018	100,000	218,588	245,873	100,000	**566,461**
2020	Vendimi nr. 250, datë 24.12.2019	311,215				**446,418**

Në mijë lekë

Periudha e ngjarjes	Emërtimi i dëmit	Viti		
		2017	2018	2019
(a) Ngjarje deri në 31.12.2013	Dëme të miratuara po të papaguara	82,515	11,098	37,848
	Dëme të ekzekutueshme	734,972		183,263
	TOTAL Për Pagesë (I)	**817,488**	**11,098**	**221,112**
	Dëme në proces të papaguara (II)	**433,123**	**282,103**	**274,021**
	Total (I)+(II)	**1,250,612**	**293,202**	**495,133**
(b) Ngjarje pas 1 janar 2014	Dëme të miratuara po të papaguara	93,525	96,736	47,550
	Dëme të ekzekutueshme	12,613	3,918	89,725
	TOTAL Për Pagesë (I)	**105,866**	**100,654**	**137,275**
	Dëme në proces të papaguara(II)	**312,079**	**455,389**	**555,181**
	Total (I)+(II)	**417,945**	**556,044**	**695,456**
Total (a) + (b)	Dëme të miratuara po të papaguara	176,040	107,834	85,399
	Dëme të ekzekutueshme	747,585	3,918	272,988
	TOTAL Për Pagesë (I)	**923,354**	**111,752**	**358,387**
	Dëme në proces të papaguara(II)	**745,202**	**737,492**	**829,202**
	TOTAL (I)+(II)	**1,668,556**	**849,244**	**1,187,589**

Për sa më sipër, konstatohet se vlerat e raportuara për dëmet e periudhës para vitit 2013, kanë pësuar ndryshime të vazhdueshme, që mund të vijnë për shkak të ndryshimit të shkallës së gjykimit të tyre, sipas raportimit që kryhen Byroja pranë AMF-së. Kjo mënyrë e raportimit, nuk garanton siguri për mbikëqyrjen e fondit me qëllim saktësimin e tyre.

Në mbledhjen e BSHS-së datë 5.02.2019 është vendosur që masa e kontributit për fondin e kompensimit të vitit 2020 të jete **311,215,112 lekë**. Megjithatë, në shkresën datë 11.12.2019 të AMF është konstatuar se në raportimin e byrosë si referencë në analizë është marrë fondi i miratuar nga Asambleja dhe jo nga Autoriteti, si më poshtë:

Periudha e ngjarjes	**Ngjarje deri në 31.12.2013**	**Ngjarje pas 1 janar 2014**	**Total**
Dëme të miratuara po të papaguara	37,848,998	47,550,576	85,399,574
Dëme të ekzekutueshme	186,263,099	89,725,121	272,988,220
TOTAL Për Pagesë	**221,112,097**	**137,275,697**	**358,387,794**
Dëme në proces të papaguara	274,021,267	555,181,581	829,202,848

Referuar pagesave të kryera deri në datë 30.11.2019, sipas AMF, situata e pagesave në nivel tregu, referuar detyrimeve për fondin e kompensimit paraqitet:

Në milion lekë

Detyrim teprice 2018, duke zbritur marrëveshjet	**FK 2019, sipas vendimit 28.12.2018**	**Total detyrim për FK 2019 (ngjarje deri në 2013)**	**Total detyrim për FK 2019 (ngjarje pas 2014)**	**Totali i**	**Pagesa deri 2013 (duke zbritur marrëveshjet**	**Pagesa pas 2014**	**Total Pagesa**	**Vlera e mbetur e fondit**
191	218	410	331	742	157	254	412	330

Në këtë tabelë nuk janë përfshirë marrëveshjet detyrim dhe pagesat gjatë 2019.
Fondi i 2019 nuk është konsumuar, me vlerë të mbetur rreth 330 milion lekë, pra me diferencë rreth 28 milion lekë për të përballuar pagesat e dëmeve pezull të miratuar për tu paguar. Por sikundër paraqiten në tabelën më sipër, duke përfshirë dhe vlerën rreth 829 milion lekë si provigjon për çështjet gjyqësore dhe në proces, masa e kompensimit sipas vlerësimit të AMF duhet të jete në vlerën 100 milion lekë.

Gjithashtu nga prezantimi më i hollësishëm i vendimeve të mësipërme dhe auditimve të kryera rezultoi se:

*****

Në bazë dhe për zbatim të nenit 13, 14, pika 23 dhe nenit 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò dhe nr. 10076, datë 12.02.2009 ñPër sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportitò, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, konstatoi se : në përputhje me kërkesat e neneve 2 dhe 19 të Ligjit 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, me Ligjin nr. 54/2014, datë 29.05.2014 dhe të nenit 42, të Ligjit 10076, datë 12.02.2009 ñPër sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportitò, ka kryer inspektim në Byronë Shqiptare të Sigurimit në datat 6 dhe 7 maj 2019, në zbatim të shkresës nr. 1068/7, datë 25.04.2019. Me shkresën nr. 1068/16, datë 09.05.2019, projekt raporti Ju dërgua BSHS-së, e cila me shkresën nr. 3201 prot., datë 15.05.2019, ka depozituar observacione mbi projekt raportin e inspektimit.
Gjetjet kryesore të këtij inspektimi lidhen kryesisht me zbatimin e afateve të Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012, për shpërndarjen te shoqëritë e sigurimit të praktikave të përfunduara.
Pas shqyrtimit të observacioneve të dërguara nga BSHS, grupi i inspektimit vlerëson se observacionet nuk qëndrojnë përsa i përket zbatimit të afateve në Rregulloren nr. 36, datë

21.03.2012 ñPër krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeveò, e ndryshuar,
Gjithashtu, Byroja në raportimin periodik që harton në zbatim të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, nuk ka të pasqyruar saktë detyrimin e Fondit të Kompensimit, si dhe pagesat e kryera nga shoqëritë e sigurimit.
Për këto, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, referuar situatës së Byrosë Shqiptare të Sigurimit, lidhur me performancën e saj dhe domosdoshmërinë për ndjekjen e problemeve që lidhen me Fondin e Kompensimit, vendosi me: **Vendim nr. 118, datë 06.06.2019** për marrjen e masave korrigjuese ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimit i cili i është dërguar me shkresën nr. Nr. 1919, datë 12.06.2019 si më poshtë:

1. Bazuar në nenin 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, urdhërohet Byroja Shqiptare e Sigurimit:
   1.1 Të kryejë deri më datë 17 qershor 2019, shpërndarjen e praktikave të përfunduara, të detyrueshme për tu ekzekutuar, te shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së;
   1.2 Të kryejë shpërndarjen e çdo praktike të përfunduar, te shoqëritë e sigurimit sipas afateve të përcaktuara në pikën 4, të nenit 6, të Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012 ñPër krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeveò, e ndryshuar;
   1.3 Të hartojë formularët e raportimit periodik, në zbatim të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, duke pasqyruar saktë detyrimin e Fondit të Kompensimit, si dhe pagesat e kryera nga shoqëritë e sigurimit;
   1.4 Të rishikojë nevojën për shtesë të Fondit të Kompensimit, duke marrë në konsideratë çdo vendim që do të merret i formës së prerë.
2. Byroja Shqiptare e Sigurimit të depozitojë informacion mbi zbatimin e kërkesave të mësipërme deri më 10 korrik 2019.
3. Në rast të moszbatimit të kërkesave të mësipërme, Autoriteti do të vijojë me përshkallëzim të masave administrative.
4. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Për zbatueshmërin e këtij vendimi nga ana e AMF janë marrë këto masa e konkretisht:

- Për zbatimin e këtij vendimi e konkretisht të pikës 1.1 AMF kërkon me shkresën nr. 1919/1, datë 19.06.2019 informacion për zbatimin e këtij detyrimi mbi shpërndarjen e praktikave të përfunduara, të detyrueshme për tu ekzekutuar, te shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së deri më datë 17 qershor 2019;
- Me shkresën nr. 1919/2, datë 21.06.2019 AMF njofton BSHS për verifikimin në vend të pikës 1.1 të vendimit nr. 118, datë 06.06.2019 të saj nëpërmjet një grupi pune;
- Departamenti i Çështjeve Juridike dhe Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve më datë 17.07.2019 kanë përgatitur një relacion mbi zbatimin e vendimit të Bordit nr. 118, datë 06.06.2019 dhe ecurinë e fondit të kompensimit për 6 mujorin e parë të vitit 2019 të cilët në bazë të konstatimeve propozojnë:
  - Paralajmërim për shkarkimin e drejtorit Ekzekutiv të BSHS-së, bazuar në nenin 32 të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar,
  - Shoqëritë e sigurimit anëtare të SSHS-së të plotësojnë detyrimin përkatës të fondit të kompensimit me qëllim përmbushjen e detyrimeve të prapambetura si dhe detyrimet e fondit të kompensimit të vitit 2019,
  - BSHS të kryejë shpërndarjen e praktikave të përfunduara të detyrueshme për tu ekzekutuar, të shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së duke njoftuar Autoritetin deri me datë 5 shator 2019, në të kundërt Autoriteti të bëjë shpërndarjen e praktikave të përfunduara, sipas pikës 10.4 neni 10 të rregullore nr. 119, datë 06.06.2019, ñMbi administrimin e Fondit të Kompensimit,

- BSHS të analizojë situatën e fondit të kompensimit për të vendosur nëse ka nevojë për shtesë të fondit të kompensimit për vitin 2019.

❖ Në bazë dhe për zbatim të nenit 13, 14, pika 23 dhe nenit 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò dhe Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 ñPër sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportitò, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare konstatoi se: në përputhje me kërkesat e neneve 2 dhe 19 të Ligjit 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, nenit 45, të Ligjit 10076, datë 12.02.2009 ñPër sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportitò, në vijim të procesit të ndjekjes së Fondit të Kompensimit si dhe në zbatim të vendimeve të Bordit nr. 260, datë 28.12.2018 dhe nr. 118, datë 06.06.2019, se:

BSHS me shkresën nr. 4585 prot, datë 10.07.2019, ka depozituar raportimin periodik për periudhën janar ï qershor 2019. Formati i raportimit nuk është në përputhje me kërkesat e Autoritetit sipas vendimit të Bordit nr. 118, datë 06.06.2016, si përsa i përket vlerës së detyrimit të Fondit të Kompensimit ashtu dhe pagesave të kryera nga shoqëritë.

Pagesa në total gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2019, për detyrime të Fondit të Kompensimit janë në vlerën 323,204,438 lekë, ndërsa duke përfshirë dhe marrëveshjet niveli i pagesave është rreth 76% të detyrimit të 6-mujorit të parë të vitit 2019.

Përsa i përket zbatimit të vendimit të Bordit nr. 118, datë 06.06.2019, si dhe inspektimet e kryera pranë BSHS-së, rezulton se:

Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 4581 prot. datë 10.07.2019, ka depozituar informacion lidhur me zbatimin e vendimit të mësipërm, ku informon se ka vijuar shpërndarjen e praktikave objekt i Fondit të Kompensimit dhe aktualisht janë shpërndarë vetëm 6 praktika, si dhe në mbledhjen e APA të BSHS-së datë 25.06.2019 është vendosur se do të analizohen pagesat e kryera deri më 30.06.2019, për të konkluduar nëse ka nevojë për shtesë të Fondit të Kompensimit.

Lidhur me afatin e përcaktuar sipas pikës 1.1 të këtij vendimi, AMF ka kryer inspektim më datë 24.06.2019, pranë BSHS-së me shkresën nr.1919/2 prot., datë 21.06.2019, me objekt verifikimin mbi zbatimin e pikës 1.1, të vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 118, datë 06.06.2019, lidhur me shpërndarjen e praktikave të përfunduara të detyrueshme për tu ekzekutuar te shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së. Lidhur me disa ankesa të depozituara në AMF janë kryer disa inspektime tematike në vend te Byroja Shqiptare e Sigurimit si më poshtë nga ku rezultoi se Byroja nuk ka bërë shpërndarjen e praktikave dhe nuk ka autorizuar asnjë shoqëri sigurimi për pagesë, në shkelje të nenit 6, pika 1, të Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012, e ndryshuar, praktikë të cilën duhet tõia kishte kaluar Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve për shpërndarje dhe BSHS të lëshonte autorizimin për pagesë.

Duke qenë se ka pasur një dakordësi për ngjarjet deri 31.12.2013, është marrë vendimi i APA nr. 09, datë 07.03.2019, që të rishpërndahet për të gjitha shoqëritë e sigurimit në vitin 2019, vlerën prej 213,599,369 lekë, (që i përket vendimeve gjyqësore të cilat janë fituara nga shoqëritë e sigurimit E sh.a. (FK 2015-2016), A N S sh.a. (FK 2015-2016-2017) dhe A S sh.a. (FK 2018), aktualisht kërkojnë të tërhiqen nga kjo marrëveshje.

Për këto Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, vendosi me**Vendim nr. 150, datë 24.07.2019** për marrjen e masave korrigjuese ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimit:

1. Shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së të plotësojnë detyrimin përkatës të Fondit të Kompensimit.
2. Byroja Shqiptare e Sigurimit të kryejë shpërndarjen e praktikave të përfunduara, të detyrueshme për tu ekzekutuar, te shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së, duke njoftuar Autoritetin deri më datë 15 gusht 2019, në të kundër Autoriteti të bëjë shpërndarjen e praktikave të përfunduara, sipas pikës 10.4, neni 10, të Rregullores nr. 119, datë 06.06.2019 ñMbi administrimin e Fondit të Kompensimitò.

3. BSHS të analizojë situatën e Fondit të Kompensimit për të vendosur nëse ka nevojë për shtesë të Fondit të Kompensimit për vitin 2019.
4. Për moszbatim të vendimeve të Bordit të Autoritetit, bazuar në nenin 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, paralajmërohet për shkarkim Drejtori Ekzekutiv i BSHS-së.
5. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

❖ Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, nenit 113, të Kodit të Procedurës Administrative, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, konstatoi se: Bordi i AMF-së me anë të vendimit nr. 17, datë 28.02.2014 ñMbi Fondin e Kompensimit për vitin 2014ò, miratoi Fondin e Kompensimit për vitin 2014.

Byroja Shqiptare e Sigurimit, ankimoi në Gjykatën Administrative Vendimin nr. 17, datë 28.02.2014, të AMF-së, dhe kërkoi marrjen e masës së sigurimit të padisë, pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ nr. 17, datë 28.02.2014 etj.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 1916, datë 28.04.2014 ka vendosur ñPranimin e padisë, shfuqizimin e pikës 3 të vendimit nr. 17, datë 28.02.2014 të AMF-së, detyrimin e palës së paditur për të nxjerrë aktin administrativ për miratimin e vendimit nr. 45, datë 27.12.2013 të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009ò.

AMF ka ankimuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 3610 datë 01.10.2014 ka vendosur ñPrishjen e Vendimit nr. 1916, datë 28.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranëò dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

BSHS ka depozituar rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë e cila me vendimin nr. 00-2016-3398, datë 18.05.2016, ka vendosur ñPrishjen e vendimit nr. 3610 datë 01.10.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.ò

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin e datës 20.03.2019, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me prani të palëve.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1544 datë 20.05.2019, ka vendosur ñLënien në fuqi të Vendimit nr. 1916, datë 28.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranëò, si më poshtë:

"Shfuqizimin e pikës 3 të vendimit nr. 17 datë 28.02.2014 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si dhe detyrimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të nxjerr vendimin për miratimin e vendimit nr. 45, datë 27.12.2013, të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, në përputhje me nenin 45, të ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

Për këto Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare vendosi me**Vendim nr. 151, datë 24.07.2019** për një ndryshim në vendimin e bordit nr. 17, datë 28.02.2014 ñMbi fondin e kompensimit për vitin 2014ò :

1. Shfuqizimin e pikës 3, të Vendimit të Bordit nr. 17, datë 28.02.2014 ñMbi Fondin e Kompensimit për vitin 2014ò.
2. Miratimin e Vendimit nr. 45, datë 27.12.2013 ñPër miratimin e masës së kontributit për Fondin e Kompensimit për vitin 2014ò, të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

- ❖ Me shkresën nr. 3075, datë 01.10.2019 AMF njofton BSHS për Inspektimin tematik në vend të BSHS me objekt:
  - Mbi verifikimin e konstatimeve të dala nga inspektimi i kryer pranë shoqërive të sigurimit, sipas programit të inspektimit nr. 2816, datë 02.09.2019 dhe nr. 2816/1, datë 10.09.2019.
  - Mbi zbatimin e vendimeve të bordit nr. 118, datë 06.06.2019 dhe nr. 150, datë 24.07.2019.
  - Mbi verifikimin e të dhënave që lidhen me dëmet pezull deri më 31.08.2019, të pasqyruara në raportin periodik të BSHS-së për këtë periudhë. të saj nëpërmjet një grupi pune;

Për këtë inspektim së bashku me rezultatet e tij apo vendimin së bashku me relacionin përkatës nuk paraqiten të dhëna nga ana e AMF çka tregon se mund të mos J kryer asnjë veprim.

Për të gjitha shkeljet e konstatuara edhe më sipër AMF jep rekomandime të cilat nuk gjejnë zbatim të plotë në BSHS siç është dhe rekomandimi për shkarkim Drejtori Ekzekutiv i BSHS sepse drejtimi i këtij institucioni bëhet nga të zgjedhurit e shoqërive të sigurimit të cilët zgjedhin atë ose nuk mund të dënojnë personin që mbron interesat e tyre.
Kështu në zbatim të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò i ndryshuar, parashikohet që për parandalimin ne shkeljeve autoriteti ka të drejtën sipas nenit 32 që të përdorin masa administrative *"*Bordi, për parandalimin apo ndërprerjen e veprimeve që përbëjnë shkelje të ligjit dhe të akteve të Autoritetit në zbatim të tij, parandalimin apo ndërprerjen e pasojave të rënda të shkeljeve të ligjit dhe në rastet e pengesave për ushtrimin e veprimtarisë mbikëqyrëse të Autoritetit, mund të miratojë vendime për subjektet e mbikëqyrura, të cilat duhet të trajtojnë mënyrën që duhet të ndjekin subjektet e mbikëqyrura për të korrigjuar situatën apo për të parandaluar dëmin. Këto vendime përcaktojnë afate për kryerjen e ndryshimeve apo korrigjimin e veprimeve, si dhe mund të parashikojnë detyrimin për ndryshimin e administratorëve ose të drejtuesve, në rastet kur vërehen veprime në kundërshtim me ligjinò.

*****

Nga të dhënat e paraqitura dhe auditimi i dokumentacionit për vitet 2019 dhe 2020 *të venë në dispozicion nga AMF rezulton se, për* fondin e garancisë kartonit jeshil dhe*llogaritë qëllimore në të cilën mbahet fondi i kompensimit nuk ka* vendime ku të jenë miratuar rregullore në të cilat përcaktohet administrimi dhe mënyra sesi Autoriteti i monitoron këto llogari si krijimin e tyre e nëse kanë fonde të vlefshme në çdo kohë, sipas neneve 44 dhe 46 të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò i ndryshuar, e konkretisht :
Neni 44 Fondi i garancisë i kartonit jeshil
1. Fondi i garancisë i kartonit jeshil administrohet nga byroja dhe ka për qëllim garantimin e detyrimeve financiare, që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e kartonit jeshil.
2. Çdo anëtar i byrosë, i autorizuar për të lëshuar karton jeshil, duhet të depozitojë një garanci Bre pranë një banke të nivelit të dytë në Shqipëri, në favor të byrosë, në shumën që përcaktohet nga asambleja e anëtarëve, por jo më të vogël se 200 000 euro.
3. Kontributi i çdo anëtari në fondin e garancisë së kartonit jeshil, afatet për derdhjen e tij, procedura e rinovimit, si dhe afatet e rivendosjes miratohen çdo vit nga autoriteti, me propozimin e asamblesë së përgjithshme të anëtarëve.
4. Fondi i garancisë së kartonit jeshil përdoret: në rastet e mos përmbushjes së detyrimeve financiare të një anëtari të byrosë, përgjegjës për pagesën e dëmshpërblimit, sipas rregullave të sistemit të kartonit jeshil;
b) për pagesën e dëmeve të ndodhura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në një vend anëtar të sistemit të kartonit jeshil, në rastin kur dëmi është shkaktuar nga mjeti motorik i

regjistruar në Shqipëri, i pajisur me karton jeshil fals, për të cilin byroja është përgjegjëse, sipas rregullave të sistemit të kartonit jeshil;
c) kur fondi i garancisë mund të preket nga byroja me vendim të asamblesë së përgjithshme të anëtarëve.
5. Fondi i garancisë së kartonit jeshil nuk përfshihet në llogaritjen e fondit të garancisë së shoqërisë së sigurimit, sipas përcaktimeve të ligjit që rregullon veprimtarinë e sigurimit në Shqipëri.

Neni 46
1. Fondi i kompensimit mbahet i veçantë në llogaritë qëllimore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Fondi i kompensimit mund të Iohet në letra me vlerë të qeverisë dhe depozita Bre për një periudhë maturimi jo më të gjatë se 3 muaj.
2. Byroja i paraqet për miratim autoritetit rregulloren për administrimin e fondit të garancisë dhe fondit të kompensimit. Autoriteti mund të miratojë rregulla shtesë për mënyrën e mbajtjes dhe të përdorimit të aktiveve në mbulim të këtyre fondeve.
3. Byroja paraqet në autoritet çdo muaj raportin për gjendjen e aktiveve në mbulim të fondit të garancisë dhe të fondit të kompensimit.
4. Byroja është e detyruar të njoftojë menjëherë autoritetin, kur shoqëria e sigurimit vepron në kundërshtim me parashikimet e neneve 48 pika 1 e 49 pikat 1 e 2 të këtij ligji. Kur shoqëria e sigurimit nuk ka zbatuar sanksionet e parashikuara në këtë ligj për shkelje të neneve të parashikuara në këtë pikë, autoriteti i revokon shoqërisë licencën, për kryerjen e veprimtarisë së sigurimit të detyrueshëm.

Për pikën e trajtuar në projektraport "Të ndryshme të dala gjatë auditimit"me shkresën me nr. 41/11 prot., datë 29.09.2021, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit, mbi auditimin e ushtruar në AMF e cila është protokolluar në KLSH me nr. 845/6, datë 29.09.2021.
Nga ana e AMF materiali i trajtuar në projektraport së bashku me gjetjet e rekomandimet nuk është dakordësuar plotësisht duke ngritur si pretendim përmirësimin ligjor të realizuar nëpërmjet ligjit 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit"i cili ka hyrë në fuqi më datë 1 korrik 2021.
Për sa më sipër sqarojmë se pretendimi për përmirësimin ligjor nuk i përket periudhës së auditimit si dhe ky ndryshim ligjor përkon me gjetjet dhe rekomandimet e KLSH i cili ka kërkuar përmirësime ligjore dhe hartimin e rregulloreve nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Gjetja Për administrimin e fondit të kompensimit rezultojnë disa mangësilidhur me shlyerjen e dëmeve objekt të Fondit të Kompensimit.

Situata: Ngaauditimi mbiadministrimin e fondit të kompensimit konstatohen disa mangësi si:

- vendimet lidhur me shlyerjen e dëmeve objekt të Fondit të Kompensimit, merren nga Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues i BSHS-së, praktikisht vetë përfaqësuesit e kompanive të sigurimit dhe të zgjedhurit prej tyre;
- zonja. Anila Hoxha është emëruar(Drejtor ekzekutiv i BSHS) në kundërshtim me nenin 19 të statutit të BSHS-së, i cili përcakton se drejtori ekzekutiv zgjidhet për një periudhë kohore prej tre vitesh me të drejtë ri emërimi;
- shtyrjen e zgjidhjes së problematikave të konstatuara për vite me radhë lidhur me likuidimin e dëmeve edhe për një periudhë 1 vjeçare;
- heqjes së kompetencave të veta AMF, për të ndërhyrë në rastet kur

BSHS nuk ka përmbushur detyrimet lidhur me shpërndarjen e praktikave të detyrueshme për ekzekutim duke lenë atë nën kompetencë të BSHS-së, strukturë me anëtarë e përfaqësues të kompanive të sigurimit përgjegjëse për krijimin e fondit të kompensimit, likuidimin e përfituesve dhe mos likuidimin e përfituesve;

- ndryshimit mënyrës raportimit bilancit Fondit të Kompensimit nga BSHS, në pasqyrimin vetëm të fondit pagesavedhe jo kontributeve;
- problematika lidhur me saktësinë e raportimit dhe ecurinë e pagesave të bëra nga shoqëritë e sigurimit.
- për të gjitha shkeljet e konstatuara edhe më sipër AMF jep rekomandime të cilat nuk gjejnë zbatim të plotë në BSHS, si rekomandimi për shkarkim Drejtori Ekzekutiv të BSHS-së i cili miratohen çdo vit nga autoriteti, me propozimin e asamblesë së përgjithshme ku anëtaret e saj janë të zgjedhurit e shoqërive të sigurimit e mbrojnë interesat e tyre;
- nga ana e AMF nuk është kryer asnjë veprim për inspektimin tematik në vend të BSHS sipas njoftimit të saj me shkresën nr. 3075, datë 01.10.2019;
- nuk ka rregullore të miratuaranë vitet 2019 dhe 2020 ku të përcaktohet administrimi dhe mënyra sesi Autoriteti monitoron krijimin e fondit të garancisë kartonit jeshil si dhe nëse llogaria e saj ka fonde të vlefshme në çdo kohë, sipas nenit 44 ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò i ndryshuar;
- nuk ka rregullore të miratuaranë vitet 2019 dhe 2020 ku të përcaktohet administrimi dhe mënyra sesi Autoriteti monitoron krijimin e *llogarisë qëllimore në të cilën mbahet fondi i kompensimit* si dhe nëse llogaria e saj ka fonde të vlefshme në çdo kohë, sipas nenit 46 ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò i ndryshuar.

Kriteri: -ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, të ndryshuar;
-ligji nr. 10076, datë 12.02.2009 ñPër Sigurimin e detyrueshëm në sektorin e Transportitò, të ndryshuar;
-Rregullore ñMbi administrimin e fondit të kompensimitò, miratuar me vendimin e Bordit nr. 119, datë 06.06.2019;
-Vendime të bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;

Impakti: Është shumë e rëndësishme marrja e masave efikase e mbikëqyr kompanitë e sigurimit, nëpërmjet përcaktimit të detyrave të strukturave, duke parashikuar në mënyrë të qartë përgjegjësitë e tyre, arritjes së objektivave, përmirësimeve ligjore për përmirësimin e sistemit i cili siguron përshtatjen me standardet evropiane, në përputhje me prioritetet për zvogëlimin e riskut që të ruajë stabilitetin e transparencën në fushën e sigurimeve, titujve dhe pensioneve private vullnetare, gjithashtu dhe për *parandalimin apo ndërprerjen e pasojave të rënda të shkeljeve të ligjit dhe në rastet e pengesave për ushtrimin e veprimtarisë dhe afateve për kryerjen e ndryshimeve apo korrigjimin e tyre*për të siguruar mbrojtje të interesave të konsumatorit.

Shkaku: Mungesë e bashkëveprimit midis drejtorive dhe institucioneve të tjera, me qëllim arritjen e objektivave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiar në bashkëpunim me institucionet ligjvënëse të mundësojë përmirësime ligjore në drejtim të raporteve vendimmarrëse me BSHS mirë administrimin e fondit të kompensimit dhe ekzekutimin e tij në përputhje të plotë me kriteret ligjore;

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiar të hartojë rregullore ku të përcaktohet administrimi dhe mënyra e krijimit të fondit garancisë kartonit jeshil garancia dhe kontrolli i gjendjes saj në çdo kohë;
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiar të hartojë rregullore ku të përcaktohet administrimi dhe mënyra e krijimit të llogarisë qëllimore në të cilën mbahet fondi i kompensimit garancia dhe kontrolli i gjendjes saj në çdo kohë;

*****

Mbi sistemet që AMF përdor për përmbushjen e aktivitetit të saj.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare gjatë aktivitetit të saj përdor dy sisteme:

1. Regjistri elektronik online i sigurimit të detyrueshëm motorik (sistemi i shitjeve).
2. AMF InReg (sistemi i raportimit).

Sistemi i shitjeve përdoret nga kompanitë e sigurimit për prerjen e primeve të mjeteve motorike. AMF ka rolin e pronarit dhe administratorit të këtij sistemi. Veprimet në këtë sistem kryhen në kohë reale. Në raste të popullimit të gabuar nga kompanitë e sigurimit, sistemi i lejon kompanitë ta anulojnë primin.

Sistemi i raportimit shërben për raportimet mujore të cilat kompanitë e sigurimit dërgojnë në AMF, për shitjet e tyre mujore të primeve. Raportimet i përkasin të gjitha llojeve të primeve.

Me qëllim krahasimin e sistemeve, grupi i auditimit mori të dhënat në vlerë dhe në numër të primeve të TPL, Kartonit Jeshil (KJ) dhe Pikave Kufitare (PK). Më poshtë paraqiten të përmbledhura:

Primet në vlerë sipas sistemeve për vitet 2019-2020

	Sistemi i shitjeve		Sistemi AMF InReg	
	2019	**2020**	**2019**	**2020**
TPL	9,027,460,230 Lekë	9,391,530,688 Lekë	9,031,980,088 Lekë	9,393,079,085 Lekë
KJ	13,672,823 Euro	7,955,801 Euro	13,753,209 Euro	7,965,941 Euro
PK	4,162,730 Euro	1,812,871 Euro	4,112,119 Euro	1,808,432 Euro

Burimi: AMF, përpunuar nga grupi i auditimit

Primet në numër sipas sistemeve për vitet 2019-2020

	Sistemi i shitjeve		Sistemi AMF InReg	
	2019	**2020**	**2019**	**2020**
TPL	490,753	519,507	490,879	519,388
KJ	187,095	74,401	187,042	74,374
PK	77,269	28,289	77,041	28,290

Burimi: AMF, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga sa më sipër konstatohet vlerat dhe sasia e këtyre primeve ndërmjet dy sistemeve nuk rakordojnë në asnjë rast, si në numër dhe në vlerë. Grupi i auditimit vlerëson se rakordimi ndërmjet dy sistemeve është i nevojetëshëm për një monitorim të saktë ndaj tregut të sigurimeve për sa i përket sigurimit të detyrueshëm motorik.

Grupi i auditimit analizoi të dhënat nga regjistri elektronik online i sigurimit të detyrueshëm motorik në lidhje me anulimet e bëra nga shoqëritë e sigurimit.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i kontratave të anuluara për vitin 2019 kundrejt numrit total të kontratave totale, e shprehur në përqindje sipas llojit.

Përqindja e kontratave të anuluara, viti 2019

Shoqëria e sigurimit	Lloji i kontratave	Nr. i kontratave të anuluara	Nr. Total i kontratave	Përqindja e anulimit
A S	TPL	437	54889	0.796152235
	KJ	298	20153	1.478688037
	PK	148	14608	1.013143483
	SPP	11	270	4.074074074
A N S	TPL	541	44647	1.211727552
	KJ	304	16377	1.856261831
	PK	59	4985	1.183550652
	SPP	7	119	5.882352941
A	TPL	249	44255	0.562648288
	KJ	0	0	
	PK	114	12346	0.923375992

	SPP	0	189	0
E	TPL	256	70600	0.362606232
	KJ	403	34904	1.154595462
	PK	93	9398	0.989572249
	SPP	3	404	0.742574257
I	TPL	285	41519	0.686432718
	KJ	209	12527	1.668396264
	PK	55	5918	0.92936803
	SPP	3	258	1.162790698
I	TPL	231	57993	0.398323936
	KJ	333	30564	1.089517079
	PK	55	8383	0.656089705
	SPP	1	411	0.243309002
S	TPL	618	99907	0.618575275
	KJ	655	42899	1.526842118
	PK	292	14033	2.08080952
	SPP	4	1086	0.368324125
S S	TPL	356	76943	0.462680166
	KJ	343	29671	1.15601092
	PK	43	7598	0.565938405
	SPP	1	599	0.166944908
Total	TPL	2973	490753	0.605803734
	KJ	2545	187095	1.36027152
	PK	859	77269	1.111700682
	SPP	30	3336	0.899280576

Burimi: AMF, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga përmbledhja e të dhënave në tabelën e mësipërme, konstatohet se anulimi i kontratave të TPL arrin mesatarisht 0.6% të totalit të kontratave TPL të prera. Anulimi i kontratave KJ arrin mesatarisht 1.36% të totalit të kontratave KJ të prera. Anulimi i kontratave PK arrin mesatarisht 1.11% të totalit të kontratave PK të prera. Anulimi i kontratave SPP arrin mesatarisht 0.9% të totalit të kontratave SPP të prera.
Vihet re sa ka një diferencë mjaft të lartë ndërmjet anulimeve të kontratave KJ dhe atyre TPL, çka tregon për një risk të lartë të anulimit të qëllimshëm të kontratave KJ.

Me shkresën me nr. 41/11 prot., datë 29.09.2021, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit, mbi auditimin e ushtruar në AMF.
Në lidhje me konstatimin e dy sistemeve, AMF shprehet se: "Rakordimi ndërmjet sistemit të shitjeve dhe AMF-in Reg, të cilat përdoren për qëllime të ndryshme, nuk mund te realizohet në asnjë rast tërësisht, pasi raportimi statistikor kryhet për datën e fundit të çdo muaji ndërsa Regjistri Elektronik Online i Shitjeve fotografon gjendjen në ditën që gjenerohen të dhënat.
Sqarojmë se grupi i auditimit gjatë filtrimeve që ka kërkuar për të dhënat e Regjistrit Elektronik Online i Shitjeve, i ka marrë në konsideratë të gjitha elementët të cilat mund të ndikojnë në mungesën e rakordimit të tyre. Në vlerësimin tonë sistemet duhet të jenë në të njëjtën linjë.
Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.
Në lidhje me konstatimin mbi anulimet e KJ, grupi i auditimit nuk shprehet mbi ligjetëshmërinë e këtij procesi, por mbi një dyshim të arsyeshëm nisur nga statistikat e nxjerra. Dhe vlerësojmë se duhet të J objekt inspektimi nga ana e AMF.

Gjetja Dy sistemet elektronike të AMF nuk rakordojnë me njëri tjetrin.

Situata: Nga verifikimi dhe analizimi i të dhënave të vëna në dispozicion për dy sistemet që AMF dhe kompanitë e sigurimit përdorin, konkretisht AMF InReg dhe Regjistri Elektronik Online i Shitjeve, u konstatua se primet e prera nga shoqëritë e sigurimit, si në vlerë ashtu edhe në numër, nuk rakordojnë për periudhën e audituar. Në vlerësimin e grupit të auditimi, ky fenomen përbën risk të lartë për mungesë monitorimi ndaj shoqërive të sigurimit.

	Gjithashtu konstatohet, përqindje e lartë e anulimit të kontratave kartoni jeshil (KJ). Nga analizimi i të dhënave të nxjerra nga Regjistri Elektronik Online i Shitjeve, në lidhje me anulimin e kontratave të primeve të sigurimit, u konstatua se anulimi i kontratave kartoni jeshil (KJ) arrin 1.36% të kontratave të prera, ose 2.27 herë më shumë se anulimi i kontratave TPL, çka tregon për një risk të lartë të anulimit të kontratave kartoni jeshil (KJ).
Kriteri:	Rakordimi i sistemeve.
Impakti:	Mungesë në monitorimin e treguesve të raportuar.
Shkaku:	-
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	AMF të marrë masat e nevojetëshme për zhvillimin e Regjistrit Elektronik Online të Shitjeve, me qëllim monitorimin e të dhënave me sistemin In-Reg, si dhe të zhvillojë inspektimet përkatëse për verifikimin rast pas rasti të të dhënave të këtij regjistri.

*****

Mbi pensionin vullnetar të B së Shqipërisë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua:

Ligji Për fondet e Pensionit Vullnetar specifikon në nenin 110 se dispozitat e këtij ligji nuk do të zbatohen për fondin e pensionit, të krijuar sipas ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 ñPër Bn e Shqipërisëò, të ndryshuar.

Pavarësisht këtij përjashtimi nga të dhënat paraprake vihet re se kontributi i B së Shqipërisë në skemën profesionale të pensionit të punonjësve të B, është në vlera të konsiderueshme.

Kjo do të thotë që aktivet nën administrim të fondit të pensionit të B së Shqipërisë janë në një madhësi të konsiderueshme, megjithëse ende nuk dihet një shifër e saktë e këtyre aktiveve, duke përfshirë edhe numrin e anëtarëve në këtë skemë për faktin se ato nuk raportohen dhe nuk mbikëqyren nga Autoriteti.

Autoriteti është duke rishikuar ligjin në drejtim të përputhshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian, specifikisht direktivën e IORP II e cila mbulon, Institucionet e Planeve Profesionale të Pensionit. Kjo direktivë përcakton detyrimet ligjore për mbikëqyrjen e Fondeve Profesionale të Pensionit

Sipas direktivës IORP II *Directive (EU) 2016/2341* (neni 6) IORP është një institucion, *pavarësisht formës së tij ligjore*, që operon mbi bazën e financimit, i themeluar veçmas nga çdo ndërmarrje sponsorizuese (punëdhënësi) apo union, me qëllim ofrimin e përfitimeve të pensionit në kontekstin e një veprimtarie profesionale, në bazë të një marrëveshjeje ose kontrate të rënë dakord:

a)individualisht ose kolektivisht (punëdhënës-punëmarrës)

b)me persona të vetëpunësuar, individualisht ose kolektivisht

Veprimtaria e IORP është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme nga autoriteti kompetent i cili mbikëqyr tregun e fondeve të pensionit.

Nga sa më sipër gjykojmë se edhe fondi i administruar nga B e Shqipërisë, duke u bazuar në karakteristikat e këtij fondi, tipologjinë, mënyrën e derdhjes së kontributeve si edhe përfitimit të anëtarëve është një forme e IORP (Institutions of Occupational Retirement Provisions)

Bazuar në Ligjin për AMF, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mbikëqyr tregun e fondeve të pensionit vullnetar, duke përfshire edhe skemat e pensioneve vullnetare.

Sa më sipër është e nevojetëshme që AMF të ketë të paktën informacion në lidhje me të gjitha skemat profesionale të pensioneve vullnetare, duke përfshirë numrin e anëtarëve, aktivet nën administrim, politikën që ndiqet etj.

Ky informacion duhet të merret edhe për fondin e administruar nga B e Shqipërisë, për këtë arsye si dhe duke konsideruar rëndësinë e raportimit të dhënave statistikore, të cilat janë tepër

të rëndësishme për të krijuar një panoramë të rëndësisë të tregut të pensioneve, *vlerësojmë që në zhvillimin e legjislacionit të ri të përfshihen kërkesa për raportim në lidhje me Fondin e Pensioneve të administruar nga B e Shqipërisë për punonjësit e saj.*

Gjetja	Mungesa e përfshirjes së fondit të pensioneve të BSH në raportimin statistikor të AMF.
Situata:	Bazuar në Ligjin Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, AMF mbikëqyr tregun e fondeve të pensionit vullnetar, duke përfshirë edhe skemat e pensioneve vullnetare. Nga auditimi u konstatuamungesa e përfshirjes së fondit të pensioneve të BSH në raportimin statistikor të AMF bazuar kjo në Ligjin ñPër fondet e Pensionit Vullnetarò i cili specifikon në nenin 110 të tij se dispozitat e këtij ligji nuk do të zbatohen për fondin e pensionit, të krijuar sipas ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 ñPër Banken e Shqipërisëò, të ndryshuar. Kjo do të thotë që aktivet nën administrim të fondit të pensionit të B së Shqipërisë, nuk përfshihen në raportimet që AMF kryen për këto fonde, as për vlerën e aktiveve dhe as për numrin e anëtarëve në skemën që aplikon B e Shqipërisë.
Kriteri:	Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 ñPër Bn e Shqipërisëò, të ndryshuar,Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar,Ligji ñPër fondet e Pensionit Vullnetarò.
Impakti:	Raportimi statistikor i AMF nuk përfshin fondin e BSH, duke mos qenë plotësisht i saktë.
Shkaku:	BSH nuk i jep të dhëna AMF-së në lidhje me fondin e saj të pensioneve.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në procesin e hartimit të projekt ligjit ñPër fondet e Pensionit Vullnetarò, të përfshijë dhe B e Shqipërisë në raportimin statistikor në lidhje aktivet dhe numrin e anëtarëve të saj me qëllim që informacioni që publikon AMF të J i plotë dhe të përfshijë të gjitha skemat profesionale të pensioneve vullnetare në vend.

Me shkresën me nr. 41/11 prot., datë 29.09.2021, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit, mbi auditimin e ushtruar në AMF. Observacioni mbi pensionin vullnetar të Bakës së Shqipërisë nuk merret në konsideratë, pasi nuk janë paraqitur fakte dhe argumente të reja.

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIME:

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi janë konstatuar mangësi nisur nga kriteret e pozicionit sipas përshkrimeve të punës dhe emërimeve.

Në referim të rregullores për marrëdhëniet e punës të punonjësve në AMF, specialistët, nisur nga kriteret e pozicionit sipas përshkrimeve të punës kërkojnë shtesë dhe një përvojë pune 2 vjeçare, ndërsa personat që kandidojnë për pozicionin Drejtor Drejtorie duhet të kenë përveç kërkesave të tjera edhe të paktën 5 vite eksperiencë në institucion, ndërsa personat që kandidojnë për Drejtor Departamenti përveç kërkesave të tjera duhet të kenë edhe të paktën 7 vite eksperiencë pune. Rregullorja për marrëdhëniet e punës gjithashtu në një nen tjetër të saj parashikon gjithashtu kriteret për pozicionin e kryespecialistit ku kërkon përvojë pune në institucion mbi 6 vjet. Rregullorja e marrëdhënieve të punës ka një kontradiktë ku pozicioni i kryespecialistit ka kritere shumë më të forta dhe më të mëdha plotësimi se ai i Drejtorit edhe

pse në gradën e organikës dhe në nivelin e pagës është në rang më të ulët se ai i drejtorit. *(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Nga ana e AMF të kryhen ndryshimet në rregulloren për marrëdhëniet e punës punonjësve në AMF të miratuar me vendimin e bordit nr. 170 datë 14.08.2019, sipas pozicioneve të punës duke rishikuar sipas shkallës hierarkike kriteret për rekrutim/punësim në harmonizim me kompetencat/detyrat përgjegjësitë sipas pozicionit dhe nivelit të përcaktuar të shpërblimit për këto pozicione.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Konstatohenmangësi gjatë procedurave të planifikimit i cili kryesisht realizohet në bazë të eksperiencës dhe pritshmërisë realizimit të treguesve dhe jo i dokumentuar plotësisht e rakorduar në përfshirjen e të gjithë treguesve dhe të dhëna më të plota si:për treguesit sipas nivelit të primeve të shkruara bruto për shoqëritë e sigurimit, për kontribuuesit dhe për vlerën neto të aseteve për llogaritjen e tarifës për shoqëritë administruese të fondeve të pensionit, për fondet e Investimit dhe depozitarin e fondit të Investimeve , për numrin e subjekteve që parashikohet të licencohen si dhe tarifat përkatëse të licencimit, sipas tregjeve të mbikëqyrura nga AMF, për gjobat e vendosura për subjektet e mbikëqyrura dhe individët, për të ardhurat në formën e interesave Bre të përfituara për tepricat e llogarive që ka Autoriteti pranë Bve të nivelit të dytë.

Konstatohet seraporti dëme/prime është në nivele të ulëta ku luhatet në një mesatare tregu nga 23% deri në 47 % ndërsa diapazoni është nga 50% deri në 80%; raporti shpenzime/prime është në nivele të larta me një mesatare tregu e cila është nga 62% deri në 75 % ndërsa diapazoni është 25-50% ; numri i kontratave të sigurimit të lidhura të cilat në disa raste ka patur tendencë uljeje; tregu i sigurimeve vazhdon të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës; tregu i sigurimeve vazhdon të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e detyrueshme me ligj;

Në tregun e sigurimeve evidentohet se: plani i të ardhurave me planin e shpenzimeve është i njëjtë ose planifikohet i barabartë. Në këtë mënyrë, shpenzimet e aktivitetit të AMF nga viti në vit janë rritur për tëju përafruar realizimit të të ardhurave, praktikë e cila nuk mund të vijojë përpjesëtimisht me rritjen e të ardhurave. Për më tepër, tepricat e të ardhurave të realizuara nga AMF (diferenca të ardhura ï shpenzime) pas mbulimit të rezervës ligjore, ju kthehen shoqërive të sigurimit ku pjesë e tyre janë edhe gjobat që vendosen për shkelje të ndryshme, duke i bërë këto masa administrative jo efektive, ndërkohë që këto teprica mund të shkojnë në rritjen e rezervës ligjore të institucionit mbikëqyrës apo në forma të tjera përdorimi të këtyre tepricave. *(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Drejtoritë përgjegjëse të planifikimit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiar të rrisin bashkëpunimin për hartimin e treguesve ekonomiko financiarë, duke marrë edhe informacione shtesë nga institucione të tjera dhe tregu i sigurimeve, duke i dokumentuar e rakorduar ato sipas treguesve.

2.2. Rekomandimi: Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me institucionet ligjvënëse të mundësojë përmirësime ligjore në drejtim kriterit për rritje të rezervës ligjore, për mos kthim të tepricave të të ardhurave të shoqërive të sigurimit, si dhe të mos përfshirjes së gjobave si të ardhura që u duhen kthyer shoqërive ñme shkeljeò si diference të ardhura shpenzime, por ato të mbeten pjesë e kësaj rezerve.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën 10.04.2020 - 28.05.2020, Bordi i AMF ka funksionuar me vetëm 3 anëtar, pa Drejtorin dhe Nëndrejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv, gjatë së cilës janë zhvilluar 2 mbledhje.

Referuar nenit 16 të Ligjit nr. 9752, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, ñKompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutivò, ñ*Drejtori i*

Përgjithshëm Ekzekutiv organizon dhe administron veprimtarinë e Autoritetit dhe të administratës së këtij Autoriteti. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ka këto kompetenca:
1. Përfaqëson Autoritetin.
2. Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e administratës.
3. Përgjigjet para Bordit për zbatimin e vendimeve të miratuara.
4. I propozon Kryetarit të Bordit çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Bordit dhe që janë të nevojetëshme për ushtrimin e funksioneve të Autoritetit dhe për mbarëvajtjen
*e veprimtarisë së tij*ò.
Kur Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv mungon, ose kur për shkaqe të jashtëzakonshme nuk mund të delegojë kryerjen e detyrave apo është në pamundësi për të vepruar, nëndrejtori ekzekutiv drejton Autoritetin për të siguruar mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të tij".
Sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se mungesa e të dy anëtarëve ekzekutivë, duhet të sjellë mos zhvillimin e mbledhjeve të Bordit, pasi:
- nuk mund të propozohen çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Bordit (pika 4);
- nuk mund të përgjigjet asnjë për zbatimin e vendimeve të miratuara (pika 3);
- sjell pengesa në realizimin e aktivitetit administrativ të subjektit në përputhje me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.3. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1. Rekomandimi: AMF në vijimësi të marrë masat për zhvillimin e mbledhjeve të Bordit vetëm nëse pjesë e tyre është minimalisht një nga anëtarët ekzekutivë, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që lindin nga neni 16 i ligjit nr. 9752, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, ose të marrin masa për ndryshimet e nevojetëshme ligjore për delegimin e kompetencave të anëtarëve ekzekutivë në rast mungese.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se përcaktimet dhe kompetencat e dhëna për Bordin, nga neni 9 dhe neni 14 i Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, i ndryshuar, për sa i përket *miratimit të pagës, shpërblimeve si dhe trajtimeve financiare të anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv*, janë në kundërshtim me nenin 22 të po këtij ligji, në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, ñPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò, i ndryshuar, si dhe nenin nr. 11 të rregullores ñPër funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së bordit të autoritetit të mbikëqyrjes financiareò, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 17, datë 28.04.2015, e ndryshuar, pasi vendimmarrja e Bordit për këtë çështje ka interes të drejtpërdrejtë personal mbi vetë anëtarët e Bordit..*(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.3. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
4.1 Rekomandimi: AMF të marrë masat e nevojetëshme për ndryshimet ligjore në lidhje me miratimin e pagës, shpërblimeve si dhe trajtimeve financiare të anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv,pasi aktualisht mënyra e përcaktuar në nenet 9 dhe 14 të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 *"Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare",* i ndryshuar, krijon në mënyrë të pashmangshme konflikt interesi, duke qenë se vendimmarrja e Bordit për këtë çështje ka interes të drejtpërdrejtë personal mbi vetë anëtarët e tij.

Tremujori i parë 2022.

5. Gjetjenga auditimi:AMF me Vendim nr. 76 datë 15.06.2020 ka miratuar licencimin e shoqërisë së brokerimit për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime në klasat e Jetës dhe jo-Jetës. Lista e brokerave të licencuar në kërkesën për licencim nuk përfshin Bfizik të licencuar nga AMF dhe në vijim është trajtuar lista e personave të paraqitur, si kërkesë për

pajisjen me licencë për Bfizik. Licencimi i brokerit fizik dhe licencimi i shoqërisë së brokerimit janë dy procese të ndara të cilat në këtë praktikë licencimi janë trajtuar të bashkuara, gjë që ka sjellë edhe vonesën në licencimin e shoqërisë së brokerimit. Kërkesa për pajisjen me licencë është paraqitur nga subjekti me nr. 694 datë 02.03.2020 për të kryer veprimtari brokerimi në sigurime duke paraqitur listën e brokerave të licencuar me qëllim përmbushjen e kriterit përkatës, ndërkohë që brokerat nuk kanë qenë të licencuar por janë licencuar në të njëjtën kohë dhe praktikë me shoqërinë e brokerimit. Nga auditimi konstatohet se afati i dhënies së licencës për këtë shoqëri brokerimi nuk është brenda 2 muajve nga plotësimi i dokumentacionit sipas përcaktimeve të bëra në pikën 3 të nenit 13 të rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 *"Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime".(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.4. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Nga ana e AMF të merren masa që në rast të mos përmbushjes së kritereve specifike të shoqërisë së brokerimit për pasjen e brokerave të licencuar fizikë nga autoriteti, trajtimi i kërkesës për licencimin e brokerit fizik të kryhet veçmas nga trajtimi i kërkesës për licencim të shoqërisë së brokerimit, me qëllim shmangien e vonesave në praktikat e licencimit.

Në vijimësi.

6. Gjetjenga auditimi:AMF me Vendim nr. 155 datë 24.07.2019 ka vendosur licencimin e shoqërisë së brokerimit për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në tituj në B Shqiptare të titujve ALSE dhe njëkohësisht miratimin e brokerit fizik për ushtrimin e veprimtarisë në tituj në emër dhe për llogari të shoqërisë.

-Nga auditimi konstatohet se me qëllim përmbushjen e kritereve të licencimit, në zbatim të kërkesës së nenit 48, pika 3 e ligjit nr. 9879 ku kërkohet dokument që vërteton se Sh B ka punësuar një broker, është referuar brokeri fizik, pajisur me licencë nr. 26 datë 27.07.2017. Për plotësimin e këtij dokumentacioni është paraqitur Vendimi i asamblesë së shoqërisë **A** për marrjen në punë të brokerit por jo kontrata e punësimit. Nga auditimi në lidhje me këtë praktikë licencimi konstatohet se nuk përmbushen kushtet për vërtetimin se shoqëria ka të punësuar një Bduke qenë se vendimi i asamblesë për marrjen në punë nuk përbën një marrëdhënie punësimi për të cilën evidentohen kushtet përkatëse sipas kërkesave të nenit 9 të rregullores nr. 165, datë 23.12.2008, *"Për licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit, brokerit dhe këshilltarit të Investimeve ",* e ndryshuar.

-Nga auditimi konstatohet se sipas plan biznesit të paraqitur është parashikuar rezultati me humbje i shoqërisë për tre vitet e para të operimit, parashikuar të financohet me anë të shtesave në kapital. Kapitali i parashikuar për vitet e operimit është projektuar në nivelet 400,000 lekë; 1,755,750 lekë dhe 2,005,000 lekë, duke reflektuar mos përmbushjen e nevojave për kapitalin minimal të kërkuar për shoqërinë në nivelin e 6,000,000 lekë përgjatë të gjithë periudhës së projektuar të ushtrimit të aktivitetit dhe nuk paraqiten evidenca në lidhje me zotërimin e mjeteve të mjaftueshme nga aksionerët për mbulimin e shtesave të propozuara në kapital në vlerën 8,000,000 lekë për vitin e 2 dhe 14,500,000 lekë për vitin e 3.

-Nga auditimi konstatohet se për anëtaret e KA nuk plotësohen kushtet e pikës 2 të nenit 15 të rregullores nr. 165, datë 23.12.2008, *"Për licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit, brokerit dhe këshilltarit të Investimeve ",* e ndryshuar. Konstatohet se propozimi në bord është kryer për përmbushjen e kërkesave rregullatorë ndërkohë që referuar dokumentacionit justifikues nuk paraqitet evidencë për përvojë/eksperiencë pune në fushën e tregtimit të titujve. Sipas observacioneve të paraqitura në KLSH mbi Projekt Raportin është referuar se kësaj shoqërie dhe brokerit fizik i është hequr licenca. *(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.4. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Nga ana e AMF të kryhen inspektime me qëllim testimin e respektimit të kushteve për mjaftueshmërinë e kapitalit në përputhje me rezultatet e operacioneve të biznesit sipas kërkesave të kuadrit rregullator si dhe të kërkesave në lidhje me përbërjen e anëtarëve të

këshillit të administrimit, duke pezulluar/revokuar licencën përkatëse në rast të mos përmbushjes eventuale të këtyre kritereve në shoqëritë e brokerimit.
6.2. Rekomandimi:Në çdo rast kualifikimi i anëtarëve për KA të shoqërisë së brokerimit të kryhet mbi evidenca në formën e certifikimeve dhe jo trajnimeve në fushën e transaksioneve me tituj.

Në vijimësi.

7. Gjetjenga auditimi: AMF me vendimin nr. 8 datë 06.06.2019 ka vendosur licencimin e B së nivelit të dytë për ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit të fondeve të pensioneve vullnetare dhe fondeve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive.Sipas relacionit teknik të paraqitur në Bord, është referuar se B zotëron aksione në masën 76% tek shoqëria administruese e fondeve të pensionit. Konstatohet se,B në momentin e licencimit zotëron aksione tek shoqëria administruese e fondit të pensionit dhe deklarata e paraqitur në praktikën për licensimin si depozitar nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 47 të ligjit nr. 10197 datë 10.12.2009 *"Për fondet e pensionit vullnetar".*
-Gjithashtu konstatohet se për të përmbushur kriteret e licencimit për sa i përket zotërimit të një programi kompjuterik për kryerjen e aktivitetit të depozitarit përpara marrjes së licencës është paraqitur memorandum mirëkuptimi. Pranimi i memorandumit të mirëkuptimit si evidencë për përmbushjen e kriterit nuk është në përputhje me kërkesat teknike sipas nenit 4 të rregullores Rregullore nr. 128, datë 06.10.2011 *"Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive".(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.4. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
7.1. Rekomandimi: Nga ana e AMF të merren masa për rishikimin e licencës së depozitarit sipas përcaktimeve ligjore në rolin e depozitarit të fondeve të pensioneve dhe depozitarit të fondeve të sipërmarrjes së Investimeve kolektive me qëllim shmangien e konfliktit në përmbushjen e kritereve të depozitarit të licencuar i cili zotëron aksione në një shoqëri administruese të fondeve të pensionit.

Në vijimësi.

8. Gjetjenga auditimi: AMF me Vendim nr. 210 datë 22.11.2019 ka vendosur ka vendosur licencimin e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit dhe fondeve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive.
-Nga auditimi konstatohet se pjesë e dokumentacionit për licencim nuk janë pasqyrat financiare të shoqërisë themeluesetë shoqërisë së administrimit të sipërmarrjes së Investimeve kolektive duke qenë jo në përputhje me kërkesat e rregullores Nr. 124 datë 21.06.2019 ñ*Për disa kërkesa shtesë për aksionarët themelues, aksionarët ndikues, anëtarin ekzekutiv të këshillit të administrimit të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive"*. Kjo mospërputhje konstatohet se vjen si pasojë e kohës së shkurtër të licencimit të shoqërisë themeluese dhe për këtë janë paraqitur bilance vërtetues (disa mujorë). Në këtë mënyrë, nuk është arritur siguria mbi mbështetjen me kapital shtesë të veprimtarisë së shoqërisë administruese sipas kërkesave të rregullores por është kërkuar nga shoqëria themeluese që kapitali minimal të J më i lartë (në nivelin e 200% mbi kërkesat ligjore) dhe njëkohësisht është paraqitur deklaratë nga shoqëria kontrolluese se do mbështesë në çdo moment në se do të J e nevojetëshme me kapital shtesë shoqërinë administruese. Kërkesat për kapital në nivelin 200% burojnë nga kërkesat e ligjit për SIK dhe ligjit për FP.
-Gjithashtu nga analiza e projeksioneve të gjendjes së kapitalit konstatohet se vlera e kapitalit fillestar projektohet në fund të vitit të dytë në shumën 20,223,730 lekë dhe në fund të vitit të tretë në shumën 16,913,363 lekë, duke parashikuar mos respektimin në vitet në vijim të kërkesave për kapital themeltar sipas kufijve të përcaktuar. Edhe kapitali i parashikuar për tu shtuar, në momentin e regjistrimit nuk është paraqitur me dokumentacion justifikues duke qenë

se shoqërisë themeluese i mungon historiku, aktiviteti dhe nuk ka paraqitur pasqyra financiare vjetore.
-Nga auditimi konstatohet se në dokumentacionin e licencimit mungon deklarata nga eksperti kontabël i jashtëm mbi sistemin e informimit sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2/c të nenit 16 të ligjit nr. 10198 datë 10.12.2009 ñPër Sipërmarrjet e Investimeve Kolektiveò. *(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.4. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
8.1. Rekomandimi: Nga ana e AMF të kryhen inspektime me qëllim verifikimin e respektimit të kushteve për mjaftueshmërinë e kapitalit në përputhje me rezultatet e operacioneve të biznesit sipas kërkesave të kuadrit rregullator si dhe të kërkesave në lidhje me deklaratën mbi sistemin e informimit, duke pezulluar/revokuar licencën përkatëse në rast të mos përmbushjes eventuale të këtyre kritereve.

Në vijimësi.

9. Gjetje nga auditimi: Mangësi në monitorimin për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit të shoqërive të brokerimit bazë të pasqyrave financiare.
Përsa i përket situacionit financiar të shoqërive të brokerimit për vitin 2019 sektori i mbikëqyrjes së BSHS-së dhe monitorimit të ndërmJetësve ka monitoruar pasqyrat financiare ku rezulton se nga 13 shoqëri brokerimi të cilat janë aktive, në një shoqëri, rezulton me humbje për vitin 2019, ndërkohë që 12 shoqëritë e tjera kanë rezultuar me fitim. Nga aktiviteti i ndërmjetësmit në sigurime në total janë realizuar 646,943,420 lekë të ardhura. Në bazë të rregullores për ñKriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurimeò te miratuar me vendimin e bordit nr. 48 të datës 30.06.2015 në nenin 8 të tij në pikën 1 shkronja ñhò thotë që dokumenti Br që vërteton pagimin e kapitalit bazë prej të paktën 3,000,000 lekësh në një nga B e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e Shqipërisë. Gjithashtu në bazë të ligjit nr. 52/2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò në nenin 211 të tij pika 1 a thotë: ñSh B,e cila ushtron veprimtari brokerimi në sigurime, paraqet në Autoritet kërkesën për licencim së bashku me dokumentet përkatëse që vërtetojnë kushtet e të ketë kapitalin bazë të paguar në para prej tij, të paktën 3,000,000 lekëshò.
Në bazë të pasqyrave financiare të konsoliduara nga ana e sektorit të monitorimit të ndërmJetësve për vitin 2019 rezulton që një shoqëri nuk e respekton këtë kriter, ku në totalin e kapitalit ka vetëm 471,258 lekë, pra nuk e respekton këtë kriter as në totalin e kapitalit. Ndërsa po ti referohemi nenit të sipërcituar të ligjit 52/2014 thotë që kushtet e kapitalit bazë duhet të jenë të paguara në para, pra në mjete monetare ku dy shoqëri nuk e respektojnë këtë kriter ku kanë në mjete monetare vetëm 127,863 lekë dhe 1,189,424 lekë. Në kushte të tilla sektori i monitorimit pas mos përmbushjes së detyrimeve duhet të dërgonte një grup inspektimi edhe pse këto shoqëri ishte zhvilluar inspektimi përgjatë vitit 2019 pa identifikimin e këtyre problemeve. *(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.4. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
9.1. Rekomandimi:AMF të realizojë inspektim në shoqëritë e identifikuara me mungesë të kapitalit minimal në para, sipas raportimit të kryer në pasqyrat financiare nga ana e tyre dhe në rast të mos përmbushjes së kritereve ligjore të marrë vendim për pezullim deri në përmbushje të kritereve apo revokim të licencës.

Në vijimësi.

10. Gjetje nga auditimi: Nga AMF nuk janë marrë masa për sanksionim me gjobë ndaj shkeljeve të konstatuara e detajuar rast pas rasti si më poshtë:

- Nga verifikimi i vendimit nr. 95, datë 29.07.2020 të Bordit të AMF mbi inspektimin e zhvilluar në shoqërinë e sigurimit u konstatua se në 4 (katër) raste janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñ*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë nga 2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj kompanisë së sigurimit si dhe nga 300,000 lekë deri në

400,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit.

- Nga verifikimi i vendimit nr. 17, datë 22.01.2020 të marrë nga Bordi i AMF mbi inspektimin e zhvilluar në shoqërinë e sigurimit, u konstatua se në 2 (dy) raste janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñ*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë nga 2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj kompanisë së sigurimit si dhe nga 300,000 lekë deri në 400,000 lekë (në një nga rastet është sanksionuar, ndërsa në një rast jo) ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit.
- Nga verifikimi i diskutimeve të zhvilluara nga Bordi i AMF në mbledhjen nr. 12/2020 (nuk është marrë vendim mbi këtë çështje) mbi inspektimin e zhvilluar në shoqërinë e sigurimit, u konstatua se, në 2 (dy) raste janë konstatuar shkelje të cilat referuar nenit 246 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñ*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò, duhet të ishin sanksionuar me gjobë nga 2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj kompanisë së sigurimit dhe nga 300,000 lekë deri në 400,000 lekë (për secilin nga rastet e konstatuara) ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit. Në 1 (një) rast është konstatuar shkelje e cila referuar nenit 247 të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñ*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò, duhet të ishte sanksionuar me gjobë nga 300,000 lekë deri 500,000 lekë ndaj anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës.
- Nga verifikimi i 6 (gjashtë) inspektimeve tematike me objekt ñ*Aktiviteti i ri sigurimit*ò të zhvilluara në shoqëritë e sigurimit u konstatua se nuk është marrë vendim për sanksionimin me masë gjobë për shkeljet e evidentuara në masën totale 2,000,000 lekë deri 3,000,000 lekë për secilën nga shoqërisë e inspektuar, në kundërshtim me nenin 246 ñ*Sanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimit*ò të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñ*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit".*

Gjithashtu, për rastet e përmendura më sipër, nuk është sanksionuar personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit në masën 300,000 lekë deri 400,000 lekë, në kundërshtim me nenin 246, pika 2, të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñ*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*ò. *(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.4.*

<u>10.1. Rekomandimi:</u>Bordi i AMF në vijimësi të marrë masa, në drejtim të sanksionimit me gjobë për shkeljet e përcaktuara si të tilla për të gjitha rastet e konstatuara, për një trajtim të barabartë për shkelje të njëjta, të të gjithë kompanive të sigurimit në zbatim të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 ñPër veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimitò.

Në vijimësi.

11. Gjetje nga auditimi: Ngaauditimi mbiadministrimin e fondit të kompensimit konstatohen disa mangësi si:

- vendimet lidhur me shlyerjen e dëmeve objekt të Fondit të Kompensimit, merren nga Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues i BSHS-së, praktikisht vetë përfaqësuesit e kompanive të sigurimit dhe të zgjedhurit prej tyre;
- zonja. Anila Hoxha është emëruar(Drejtor ekzekutiv i BSHS) në kundërshtim me nenin 19 të statutit të BSHS-së, i cili përcakton se drejtori ekzekutiv zgjidhet për një periudhë kohore prej tre vitesh me të drejtë ri emërimi;
- shtyrjen e zgjidhjes së problematikave të konstatuara për vite me radhë lidhur me likuidimin e dëmeve edhe për një periudhë tjetër 1 vjeçare;
- heqjes së kompetencave të veta AMF, për të ndërhyrë në rastet kur BSHS nuk ka përmbushur detyrimet lidhur me shpërndarjen e praktikave të detyrueshme për ekzekutim duke lenë atë nën kompetencë të BSHS-së, strukturë me anëtarë e përfaqësues të kompanive të sigurimit përgjegjëse për krijimin e fondit të kompensimit, likuidimin e përfituesve dhe mos likuidimin e përfituesve;

- ndryshimit mënyrës raportimit bilancit Fondit të Kompensimit nga BSHS, në pasqyrimin vetëm të fondit pagesavedhe jo kontributeve;
- problematika lidhur me saktësinë e raportimit dhe ecurinë e pagesave të bëra nga shoqëritë e sigurimit.
- për të gjitha shkeljet e konstatuara edhe më sipër AMF jep rekomandime të cilat nuk gjejnë zbatim të plotë në BSHS, si rekomandimi për shkarkim Drejtori Ekzekutiv të BSHS-së i cili miratohen çdo vit nga autoriteti, me propozimin e asamblesë së përgjithshme ku anëtaret e saj janë të zgjedhurit e shoqërive të sigurimit e mbrojnë interesat e tyre;
- nga ana e AMF nuk është kryer asnjë veprim për inspektimin tematik në vend të BSHS sipas njoftimit të saj me shkresën nr. 3075, datë 01.10.2019;
- nuk ka rregullore të miratuaranë vitet 2019 dhe 2020 ku të përcaktohet administrimi dhe mënyra sesi Autoriteti monitoron krijimin e fondit të garancisë kartonit jeshil si dhe nëse llogaria e saj ka fonde të vlefshme në çdo kohë, sipas nenit 44 ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò i ndryshuar;
- nuk ka rregullore të miratuaranë vitet 2019 dhe 2020 ku të përcaktohet administrimi dhe mënyra sesi Autoriteti monitoron krijimin e *llogarisë qëllimore në të cilën mbahet fondi i kompensimit* si dhe nëse llogaria e saj ka fonde të vlefshme në çdo kohë, sipas nenit 46 ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.5. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1. Rekomandimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me institucionet ligjvënëse të mundësojë përmirësime ligjore në drejtim të raporteve vendimmarrëse me BSHS për mirë administrimin e fondit të kompensimit dhe ekzekutimin e tij në përputhje të plotë me kriteret ligjore;

11.2. Rekomandimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të hartojë rregullore ku të përcaktohet administrimi dhe mënyra e krijimit të fondit garancisë kartonit jeshil garancia dhe kontrolli i gjendjes së saj në çdo kohë;

11.3. Rekomandimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të hartojë rregullore ku të përcaktohet administrimi dhe mënyra e krijimit të llogarisë qëllimore në të cilën mbahet fondi i kompensimit garancia dhe kontrolli i gjendjes së saj në çdo kohë;

Në vijimësi.

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi dhe analizimi i të dhënave të vëna në dispozicion për dy sistemet që AMF dhe kompanitë e sigurimit përdorin, konkretisht AMF InReg dhe Regjistri Elektronik Online i Shitjeve, u konstatua se primet e prera nga shoqëritë e sigurimit, si në vlerë ashtu edhe në numër, nuk rakordojnë për periudhën e audituar. Në vlerësimin e grupit të auditimi, ky fenomen përbën risk të lartë për mungesë monitorimi ndaj shoqërive të sigurimit.
Gjithashtu konstatohet, përqindje e lartë e anulimit të kontratave kartoni jeshil (KJ). Nga analizimi i të dhënave të nxjerra nga Regjistri Elektronik Online i Shitjeve, në lidhje me anulimin e kontratave të primeve të sigurimit, u konstatua se anulimi i kontratave kartoni jeshil (KJ) arrin 1.36% të kontratave të prera, ose 2.27 herë më shumë se anulimi i kontratave TPL, çka tregon për një risk të lartë të anulimit të kontratave kartoni jeshil (KJ).*(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.5. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi:AMF të marrë masat e nevojetëshme për zhvillimin e Regjistrit Elektronik Online të Shitjeve, me qëllim monitorimin e të dhënave me sistemin In-Reg, si dhe të zhvillojë inspektimet përkatëse për verifikimin rast pas rasti të të dhënave të këtij regjistri.

Në vijimësi.

13. Gjetje nga auditimi: Bazuar në Ligjin Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, AMF mbikëqyr tregun e fondeve të pensionit vullnetar, duke përfshirë edhe skemat e pensioneve vullnetare. Nga auditimi u konstatuamungesa e përfshirjes së fondit të pensioneve të BSH në raportimin statistikor të AMF bazuar kjo në Ligjin ñPër fondet e Pensionit Vullnetarò i cili specifikon në nenin 110 të tij se dispozitat e këtij

ligji nuk do të zbatohen për fondin e pensionit, të krijuar sipas ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 ñPër Bn e Shqipërisëò, të ndryshuar. Kjo do të thotë që aktivet nën administrim të fondit të pensionit të B së Shqipërisë, nuk përfshihen në raportimet që AMF kryen për këto fonde, as për vlerën e aktiveve dhe as për numrin e anëtarëve në skemën që aplikon B e Shqipërisë. *(Trajtuar më hollësisht në Kapitullin IV.5. të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1. Rekomandimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në procesin e hartimit të projekt ligjit ñPër fondet e Pensionit Vullnetarò, të përfshijë dhe Bn e Shqipërisë në raportimin statistikor në lidhje me aktivet dhe numrin e anëtarëve të saj me qëllim që informacioni që publikon AMF të J i plotë dhe të përfshijë të gjitha skemat profesionale të pensioneve vullnetare në vend.

Në vijimësi.

B. MASA DISIPLINORE

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar për kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, kërkojmë fillimin e dhënies së masave disiplinore nga ñVërejtjeò deri në ñLargim nga punaò për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

V. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Autoritetit Mbikëqyrjes Financiare, bazuar në ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 ñPër Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiareò, të ndryshuar si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që mbi të cilën e ushtron veprimtarinë subjekti i audituar. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e AMF-së janë evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e ñBazës për Opinioninò, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Baza për opinionin e kualifikuar

Problematikat e konstatuara përfshijnë:

- Mangësi në procesin e planifikimit, i cili duhet të dokumentohet plotësisht e rakorduar në përfshirjen e të gjithë treguesve sipas tregjeve;
- Risk për ekzistencën e konfliktit të interesit gjatë vendimmarrjeve të Bordit për pagat dhe shpërblimet e anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv;
- Ineficensë në menaxhimin e tepricave të të ardhurave të realizuara nga AMF (diferenca të ardhura ï shpenzime) të cilat ju kthehen shoqërive të sigurimit ku pjesë e tyre janë edhe gjobat që vendosen për shkelje të ndryshme.
-mangësi në licencimin e shoqërive të brokerimit në tituj, për mos përmbushje të kritereve për licencim për anëtarët e këshillit të administrimit, të kritereve për ekzistencën e kapitalit minimal gjatë viteve të ushtrimit të aktivitetit sipas plan biznesit të paraqitur;
-mangësi në licencimin e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit dhe fondeve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive ku janë konstatuar mos përmbushje të gjithë kritereve ligjore.
-Mangësi të konstatuara gjatë inspektimet e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në zbatim të kuadrit ligjor duke mos marrë masa për sanksionim me gjobë ndaj shkeljeve të konstatuara.
-Mangësi në monitorimin për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit të shoqërive të brokerimit bazë të pasqyrave financiare të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në zbatim të kuadrit ligjor.
- mangësi në administrimin e fondit të kompensimit, marrëdhëniet dhe kompetencat mbikëqyrës mbi Byronë Shqiptare të Sigurimit.

Përgjegjësitë e Drejtimit të AMF
Drejtimi i AMF është përgjegjës ndër të tjera për vendimmarrjeve të Bordit, aktivitetetet e planifikimit dhe realizimin e të ardhurave, kryerjen e licencimit, inspektimit dhe monitorimit të subjekteve , administrimin e fondit të kompensimit, marrëdhëniet me BSH etj.
Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë
Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e AMF është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit.
Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.
Gjithashtu ne: Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.
Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të AMF.
Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të raportimit të treguesve janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit përfundimtar të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.
Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.
Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë ne lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.
Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion u konsiderua i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu

si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve të mbajtura si dhe observacioneve të paraqitura për këto akte u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

VI. ANEKSE

Të gjitha evidencat janë pjesë e projekt raportit sipas pikave të programit dhe janë trajtuar në mënyrë të detajuar më sipër.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT